ARAVANTINI

# HISTORIË

E

# ALI PASHË TEPELENËS

PREJ

I. M. QAFËZEZI

Me shtattë ilustráta.

SHTYPUR
NDË BUKURESHT

BKSH

BKSH

BKSH

ARAVANTINI

# HISTORIË

E

# ALI PASHË TEPELENËS

## I MBIEMËRUAR „LUAN' I SHQIPËRISË"

PREJ

I. M. QAFËZEZI

EDICJË E I-RË

□ □ BUKURESHT □ □

—

SHTYPËSHKONJA
□ □ D. C. IONESCU □ □
□ STR. CÂMPINEANU, 9. □

BKSH

*Ç' do ezempllár bie ndënëshkrim*

BKSH

*Nallésës Së Tij*

*Kurón-Princit të Shqipërisë*

# *Karol Viktor-Skënderbegut*

*Të Cilit i gjithë kombi Shqipëtar I uron tradicionalin „Rroftë sa malet", e u bëftë burrë trim për të pritmin plot shpresa të lumura edhe fatbardhësië të Shqipërisë së bukur*

**Me përulësië edhe me besë i dedikohet**

BLSH

BKSH

# I DASHUR KËNDONJËS

Po u fal Shqipëtarëvet «*Historin' e Ali Pashë Tepelenës*» mbas Aravantinit.

Që prej shumë vjetesh më ishte rrënjosur dëshira që pranë *Historiës të Gjergj Kastriotit* të të mbiemëruarit *Skënder-Beg* nukë lipset të na mungonjë edhe *Historië e Ali Pashë Tepelenës* të të mbiemëruarit. «*Luan i Shqipërisë*», ashtu, si-do që të jetë ajo.

Nga gjithë veprat e shkrimtarëvet të huaj që kanë shkruar punëmëdhajat edhe jetën e Ali Pashës zgjodha për më të sosur të Aravantinit, i cili ka gjyrmuar shkrimtarët kutemporanë më me rëndësië si Pouqueville, Smart Hughes, Leake, edhe shumë të tjerë.

Nga këta, Pouqueville-i si Konsull' i Guvernës Frënge pranë Ali Pashës na e përshkruan hollësisht jetën e Vezirit gjer di-ca vjete përpara se të bjerë ndë mërië të Sultan Mahmudit. Të dy të tjerët të dërguar nga an' e guvernës Inglize, edhe si organizatorë të ushtëriës Ali Pashës, rellatojnë mbi luftrat edhe drobitjen e Suljotëvet edhe përmbi jetën e veçanëshme të «Luanit».

Shkrimtarët e huaj cili më shumë e cili më pak e prezantojnë Ali Paşhën me karakteret që pasojnë : Hero të Shqipërisë, Pirro të Ri, sundimtar të zotin, dipllomat mendar dhe të matur, edhe shumë të rreptë

pa edhe brutal kur ishte puna për të mposhtur adversorët edhe gjithë sa i pengojin mbrothësiën. Sulltan Mahmudi e pat dekoruar dyke-i-dhënë titllin «Arsllan» për trimërinë që tregoj kur mori pjesë për të mposhtur kryengritjen e Kara Mahmud Pashë Shkodranit, edhe më pas edhe me ferman kur urdhërohej të marë pjesë mdë marshimin kundër Pazvan Ogllos, Pashës të Vidinit.

Për kombin Shqipëtar Ali Pasha ishte edhe ka për të qënë ndë gjithë jetët «Luan i Shqipërisë» ashtu sikurse e emërojin gjithe dashamirët Evropianë, edhe veçanërisht Anglezët te cilët e admirojin.

Kush nukë ka dëgjuar edhe sot akoma këngët e tij heroike tepër të mallënjyëshme të cilat kallëzojnë punëmëdhájat e tij trimërore kundër gjith' armiqvet të tij edhe më fort ato të mbramet mbassi nalltoj flamurin e kryengritjes për t'u bërë Mbret i Shqipërisë. Strofet e më poshtme që na i ep vjelëtóri këngash popullore Z. Th. Mitko ndë librin «Mbleta Shqipëtare» janë sadó që t'a bëjnë cilin-do t'i ngjethet trupi:

*Kush e ka parë Asllan Alinë,*
*Nd'atë të shkretën Janinë,*
*Ndë kalá mbyllur të zinë,*
*Rrahu të kthenjë Shqipërinë.*

. . . . . .

*Urdhëroftë Perëndia,*
*Dhe na nxjertë faqebardhë,*
*Thanë na vjen Rumelia,*
*Njëzet e dy Pashallárë.*

. . . . . .

*Duró gjyle, dhe kumbará,*
*Moj kalaja me bedena*
*Se lufton me Padishahun*
*Ali Pashë Tepelena.*

. . . . . .

Edhe tani imagjinó i dashur këndonjës që ç' farë çudirra mundej të bënte ky trim sikur të ishte që gjuha jonë të kishte që asi-kohe këtë çapin e sotshëm si gjuhë letrare.

Qëllimi që gjyrmonte Ali Pasha që përpara edhe më fort mbassi hypi ndë fronin e Governorit Janinës ishte *te kthenjë Shqipërinë* sikurse thotë muza popullore, t'a bënjë Shqipërinë më vethe dyke adoptuar kanunet qeverimi të atëhershme të Francës, të cilat i kishte gjetur për më të mira nga të ç'do shteti tjatër; këjo ësht' e pamohuarshme sepse vetë keqpërfólësit e tij e përkujtojnë.

Përandaj pra Ali Pashë Tepeléna për Shqipërinë edhe për Shqipëtárët s' mundet të jetë përveç se *Hero legjendár* edhe *Luán* pas Pirros edhe pas të famëshmit Gjergj Kastriot.

Nga ana ime edhe e disa miqve e gjeta me udhë botimin e veprës edhe nukë dyshonj që ka për të mbushur një zbrazje të ndjejtëshme ndë letratyrën t'onë të re.

Me besë

I. M. QAFËZEZI

*Bukuresht 1916*

P. Sh. — Vjershat të shtuara ndë këtë vepër të cilat u përqasen ngjarjevet më të shumat i mora prej librit «Mbleta Shqipëtare» të Z. Thimi Mitko edha disa i pata vjelë vetë prej popullit. Gjith'ashtu edhe fytyrat përveç ujdhesës Janinës i mora që gjetkë.

I. M. Q.

BKSH

1744

1822

ALI PASHË TEPELENA

BKSH

# HISTORIË
## E
# ALI PASHË TEPELENËS
## I mbiemëruar „Luan' i Shqipërisë"

### KREJ I.

Ndaj mezit të shekullit XVII (1640), një i quajtur Hyso, erdhi nga një katund' i Shqipëriës Mesme edhe përnguli ndë Tepelenë, qytet i Shqipëriës Poshtme [1]). Aty hyri si kujdestar ndë një Teqé prane qytetit, edhe më pas u martua edh' u vendos përgjithmonë dyke-harrijtur të bëhet edhe pronar i di-ca çifligjeve [2]).

Gojdhëniet nuk' përmëndin më tepër për të, po vetëm vërtetohet që ky ka qënë stërgjyshi i Ali

---

1) Ndë kohët e Skënder Begut, Tepeléna me përqarkjen e saj ishte Principatë i së cilës princ i atëhershëm luftonte bashkë me të kundrë Sulltan Muradit II-të.

2) Disa nga shkrimtarët e huaj bashkë me Pouqueville-in thonë që stërgjyshi i Ali Pashës pat ardhur prej Qytahjës të Asiës Vogël, por frëngu I. Manzour i cili pat shërhyer mjaft vjete pranë Ali Pashës, si kumandan i nalltë i trupit ingjinérëvet, edhe më të sigurtat tradita e përgënjeshtrojnë krejt këtë shpifje, duke na siguruar për origjinën e tij fjesht Shqipëtare.

Tepelenës, Herójt të Shqipëtarëvet, mbas Pirros edhe mbas Gjergj Kastriotit [1]).

Hysos i lindi vetëm një djalë i quajtur Mustafa. Mustafaj që i vogël ishte trim edhe passi u rrit u bë i dëgjuarshëm ndë nahien e Tepelenës. U martua me një bijë-beu, e cila i lindi dy djen, të quajtur njëri Beqir dhe tjatri Myhtar.

Pas vdekjes të átës tyre, bijtë trashëguan tittlin Bej nga âma, me që ajo isthe prej fisi Bejlérësh. Për Beqirë s' tregohet gjë veç që, një i vetëm bir i tij quhej Islam Bej, për të cilin dotë flasim më poshtë, pra-po Myhtari ishte Gjeneral i trumbavet Shqipëtare të rekrutuar ndë qarkun e Tepelenës ndënë Serasqerin Kara Mustafa Pashën, i cili më 1716 me një ushtëri të madhe luftonte kundër Korfuzit, edhe u vra ndë një asallt të rreptë për zapëtimin e fortesës [2]). Korfuzi mprohej prej gjeneralit të Venecjanëvet Shylemburg ndë kohët e luftavet të Republikës Venetikut me Perandoriën Otomanë. Shkrimtari frënk Pouqueville, ndë shkrimet e tija mbi origjinën e Ali Pashës, thotë që Myhtari si gjeneral u tregua shum' i zotì ndë këtë fushatë, edhe ishte i çquar për cilësiat e tij ushtëriake.

Të dy djemt' e Mustafajt, Beqiri dhe Myhtari, pas zakonit shqipëtar jetojin bashkë. Pas vdekjes të Myh-

---

1) The historical Ali gave the Albanian race a second hero and a legendary leader e. t. c.

*D-r H. N. Brailsford*

2) Kënga popullore e kësaj ngjarje historike.

*Myhtar Begu hipur kalit,*
*Lëfton si petrit i malit,*
*Me trimatë Shqipëtarë,*
*Po lufton Korfuz-Kalanë;*
*Po Korfuzi ka të zonë,*
*Të zonë Shën-Spiridhonë.*
*Spiridhon o Shënjt i gjallè,*
*Re ndë det e dolle mb'anë,*
*Shpëto-e Korfuz-Kalanë;*
*Tetë kandile t'ergjënda,*
*Katër jasht' e katër brënda,*
*Tri të lara me flori,*
*As e fal o Perëndi.*

tarit, i cili la pas një djalë të quajtur Veli Bej, edhe dy vajza, krej i familjës Hysollarëve ishte Islami i bir i Beqirit me qënë më i math nga kushërir' i tij Veliu.

Islami ishte shum' i zoti edhe i matur, përandaj e përmirësoj dhe e shtoj kamjen shtëpiare, madhoj famën sikurse edhe inflluencën të *hoxhakut* ndë gjithë rredh' e Tepelenës edhe të Beratit; fitoj dashurin' e gjithëvet, u bë sundimtar i kazasë Tepelenës, edhe ndë çdo nevojë që kishte i ndihmojin përveç myslimanëve edhe gjithë të krështerët e Zagorit, edhe veçanërisht katër katunde të Rizës: Hormova, Lekli, Renda, edhe Labova.

Veli Beu u martua me një shqipëtare prej një nga më të fismet shtëpi Bejleresh të Tepelenës, edhe pas vdekjes t' Islam Beut, ky u bë kryetar i shtëpiës Hysollarëve. Si i tillë pra, mbante në shtëpi të tij të mbeturën-e-vé të kushëririt parë edhe jetimët. Si protektor i jetimëvet i dashuronte posi fëmijën e vet. Më pas Veli Beu mori dhe një grua të dyte të quajtur Hamko, bijën e Zejnel Beut, një nga më të fuqishmit bejlerë të Konicës, derë Pashallarësh, deshqendante e Kastriotëvet [1]).

Prapo gruaja e parë i lindi Veli Beut dy djem, Ismail Bejnë, Tahir Bejnë edhe dy vajza me Hamkon i lintnë më 1744 Aliu, herój ynë, dhe një vajzë e quajtur Hajnicë, lindur pas katër vjet të djalit.

Veli Beu, i àt' i Aliut vdiq më 1753, edhe gjithë kujdeset e shtepisë mbenë në duart' të âmës Aliut, Hamkos, e cila ishte grua mendare. Fëmijën e Islam Beut sikurse edhe të shoqen e tij si *amanet* që i kishte, i donte më shumë se fëmijët a saj. Pshatrat që kishte trashëgim nga Veli Beu, Hormova, Lekli, edhe disa të tjera të Rizës, ndë çdo nevojë po t'i thëritte ishin në këmbë, veçanërisht Hormovitët të cilët ishin 500 pushkë. Kësifarësh Hamkua zotonte ndë kaza të Tepelenës që përbëhej prej katër ka-

1) The mother of Ali, who was an Amazon, was a descendant of Scanderbeg. (Sutherland Menzies, Albania and the Albanians).

tunde të Hormovës, shtatë të Zagorit, edhe dica të Pogonit. Si kqyrës ndë gjithë marëdhëniet shtëpiare dhe ndënurdhëronjëse kishte një të krështerë Hormovit i quajtur Mitro Çaush Prifti, i bir' i priftit Hormovës. Më tej dotë shohim qysh edhe nga ç' shkake Çaushi është punitur me vdekje.

Midis këtyre, kur Hamkua ishte dyke ormisur shtëpinë, ndë mes të qetësiës fëmijake, armikët cmirushqenjës të derës Hysollarëve të cilët dojin prishjen e tyre, filluan të këllasin intriga dyke ngacmuar të mbeturën-e-ve të të ndyerit Islam Bej për t' u ndarë prej Hamkos me gjithë fëmijën e saj dyke-marë për vethe edhe pronjat që i bijin. Për çudi e bindën, edhe lypi të ndahet. Hamkua s'donte t'a ndanjë dhe e kështilloj sa mundi të mos bënjë një të tillë çap, po pas si e pa që ajo kish venduar definitiv të ndahej, bëjti mbi emër t' asaj gjymsën e pronjavet, dhe kësifarësh e-mbetura-e-ve e Islam Beut bashkë me fëmijën e saj u t' hoq nga shtëpi e Veli Beut.

## KREJ II.

Mbetur vetëm Hamkua me fëmijët pas pakë kohë u ngrit nga Tepelena edhe vajti u vendos ndë Kàrjan, një nga më të mirat pronja (çifligje) të Veli Beut. Aty Hamkua dedikonte kohën me rritjen e fëmijëve të cilët përpiqej t'i pajonte në arësim dhe mbrothësi mendore, veçanërisht të vetëmin bir, Alinë.

Thamë më nalt që kur rronte Veli Beu kish nënurdhër pshatrat Hormovë, Lekli, Kokosë, e.t.j. të cilat pas methodhat Tyrke t'atëhërshme nuk' njihjin të tjerë nëpunës të qeveriës përveç Beut të cilit i ishim të detyruar t'i paguajn një farë pagese *(harraç)*.

Pas pak kohë që nga ngjarjet e më-sipërme myslimanët e katundit Kokosë (midis Telepenës dhe Gardhiqit), bëjtin një mbledhje tek venduan të mos i apën më pagesat e përmotshme, edhe nuk'u mjaftuan vetëm ndë këto vendime, po biseduan që lipset t'a prishin shtëpin' e Veli Beut. Hormovitët m'anë tjatër për të cilit thamë që ishin besëtarë te Hamkua,

me t'u lajmëruar për vendimet e Kokosarëve ndruan dhe ata taktikë edhe bëjtin marëveshje me Kokosarët që te mëndjes tyre janë edhe këta, edhe që t'i apën funt punës, venduan të vërviten së bashku kundër familjes Veli Beut.

Kështu pra një mbrëmje më 27 Korik 1762, treqint Kokosarë venë ndë Hormovë edhe duke-u-bashkuar më Hormovitët u vërsulën kundër Kárjanit, goditin njerëzit e Hamkos që ishin të pakë, edhe e marin atë bashkë me bijën e saj Hajnicën. (Aliu i cili ishte në moshë 17 vjeç kish vajtur për vizitë në një katund edhe s'u ndoth ndë shtëpi). Gjithë gjënë u'a bëjtin plaçkë edhe passi u vune dhe zjarrë i çuan skllavet ndë Gardhiq. Aty ndënë syt' e tyrë hodhë shört për plaçkat e rrëmbyera edhe dyke-i-përqeshur skllavet, i pyesjin për çmimim e tyre edhe u thoshin nje mijë fjalë qesëndimesh të cilat u rrëzojin nderë,...

Këndonjësi munt t'i magjinojë hidhërimin që me të drejtë ndjente ëm' e Aliut për turpërinë dhe çnderimin që i bëhej, kur njëri prej ta kuxoj t'u heqë dhë mbëlesën e fytyrës, dhe për t'a zgjatur hironiën u epjin rrosóke (rrecka) që me to të mbuloheshin. Fundja si mbaruan nga këto i muar i mbyllë ndë një burg t'errët edhe i lanë atje të urrëta. Q'aty, mburon si-kur-se dot shohim më poshtë, prishj' e Gardhiqit prej Ali Pashës si ahmarje për të më-si-përmet. Pas di-ca javë që nga kjo ngjarje, një nga parësi e Gardhiqit, Haxhi Agaj, i mallënjyer për të këqiat që hiqjin skllavet, vendoj t'i shëllbonjë nga duart' e mundonjësvet edhe passi përdori mjetet e posaçme sukqedoj përikjen e tyre dyke-i-çuar ndë Gjatë, katund ndë qarkun e Rizës, pronjë e Veli Beut, edhe për t'i siguruar ndënj dhe ay atje me trimat e vet. Gardhiqjotët me të dëgjuar për këto u mbushnë ndë zëmërim edhe që t'i marin ahun Haxhiut venë i plaçkitin shtëpit' e tij edhe passi i-a doqnë, ngrehnë pllane që s'andejmi të vërsulen me më tepër tërbim për ndë Gjatë tek kish trévën Hamkua. Po e prajtnë lëvizjen e re, se mësuan që për mprojtje te saj kishin vrapuar shumë ndihmës nga pshatrat e afërta mysliman' e të krështerë simpathi-

zonjës të familjes Hysollarëve. Kësi-mjeti e mjera Hamko mundi të shpëtonjë nga rreziku i sigurtë që e pritte, po, si shqipëtare, pësimet që hoqi mbinë në shpirt të saj, veçan ndë të fëmijës, edhe u bëjtin dëshirë që një dit të marin shpagën nga insulltatorët Gardhiqotë edhe shokët e tyre. Edhe mbassi pallatin e familjes ndë Karjan u'a doqnë, Hamkua trajtoj tjatër më të mirë ndë Gjatë, si kur-se edhe disa kulla të shëndosha. Aliu tani kishte kapërxyer nga mosha 17 vjeç edhe armiqtë parashikojin që do të bëhej i rrezikshëm për 'ta andaj disa herë atentuan kundër tij që t'a vrasën. Dyke-parë Hamkua që jeta e djalit në Gjatë s'ish në siguri, iku për ca kohë nga pallati që aty edhe vajti prapë ndë Tepelenë. Po që ditën që iku prej Gjate, armiqtë nuk' mënuan të sulen për atje, shtëpine i-a djegin edhe kullat i rrëzojnë.

Ndë duresë të këtyre ngjarjeve, Aliu i cili nuke kish mbushur édhe të 18-in vit të moshës, po trim pa shok, dyke parë rreziket q'e rrethojin dhe mbassi e kish kuptuar që ish i vlefshëm të përdornjë mirë pushkën dhe jataganë, organizon një çetë të shëndoshë prej më të zgjedhurit trima të shprovuar besnikë dhe të devotshëm të shtëpiës tij, dhe u hoq nër malet tek u kasnecoj armiqve të tij t'urdhërojin të provojnë trimërinë balla-ballës me të, dhe jo me të përdhunë. Një dit, ndë një mal afër Kokosës dëgjohen disa krisma pushkash; Kokosarët u mblodhë të gjithë edhe passi mësuan që ish Kapedan Aliu, zunë vise dhe u ndes një luft' e rreptë ndë të cilën u vranë 80 Kokosarë; fundja me një mijë lemerime, dhe si u err u hoqnë në katund. Të tjëra përpjekje të tilla bënte afro nga dit me armikët e tij gjer sa së mbramì si e panë që nuk' i-a diljin dot, venduan t'i anëkohen Kurt Pashajt të Beratit i cìli ishte dhe Inspektor i rrugëvet (Dervenat Nazër) ndë tërë Shqipërin' e poshtmë dhe ndë Thesali. Kurt Pashaj dërgon disa ushtarë që gjoja t'a kapin të gjallë, dhe më tjatër anë i çoj një kasnec pshehtazi me një letrë ku duke-i-kumentuar se ka dëshirë t'a bënjë dhëndër, i lutej të përepet ndë duart e ushtarëve të tij. Aliu

u dhelatua nga fjalët e kasnecit si-kur-se edhe nga letra e Pashës Beratit edhe pa fare rezistencë përrepet nër duart e ushtarëvet të Kurtit edhe u çua ndë Berat. Pas një dit të ndënjur ndë pallat të Kurt Pashës u lirua ndënë pretëkst që i akuzuari brigand (haidut) ishte minor nga mosha. Kësi-farësh Aliu mori amnesti edhe më pas me lutje nga an' e Kurtit ndënj di-ca dit ndë Berat si gostiar.

S'andejmi u kthye ndë Tepelene edhe mbeti aty dyke-u-marur me punët shtëpiake. Përveç Çaush Priftit si kqyrës i familjës Aliu kishte dhe një arap të quajtur Isuf. Kur u kthye këtë herë Aliu në shtëpi, Arapi i kallëzon që nàmëta kishte rrelláta të paligjëshme me Hamkon. Nga ky skak Aliu e përzuri atë edhe emëroj Isuf Arapnë përmi-kqyrës ndë vënt të Çaushit [1]).

Thamë më sipër që të falurit edhë përdhënia e Aliut nër duart e Kurtit nuk' ishte kurrgjâ tjatër përveç se mbassi Kurti i premtoj t'a bënjë dhëndër, Aliu ushqente shpresa të nalta nga afërimi me páshën e Beratit, edhe ngrehte pllane të mëdha për pritmin e vet passi të realizóhej martesi. Mirë-po pas jo shumë kohë, përhapet një lajm që Kurt Pashaj e mbloj të bijën te Ibrahim Be Vlona, i cili edhe ay ishte prej familje të famëshme dhe fisnike.

Ky lajm e zëmëroj tepër Alinë kundrë Kurtit për shkeljen e premtimit, por me-gjith'-këto dykembuluar zemëratën, i çon një letrë nek i dërgonte urimet e tija, edhe në funt, vetëm i përmëndte shkeljen e premtimit.

Nërmjet këtyre, armiqt' e Aliut, të cilët nuk rijin kurrë të qetë, shtyjtin-shkak duke-përfituar nga ngjarjet e mâ-nalltme, edh' e ngacmojnë Kurtin që namëta Aliu ka qëllime të liga për të. Kurti duke-udhënë besim shpifjevet çon ushtëri për t'a kapur përsëri Aline ndë Tepelenë. Po Aliu, i lajmuar për këto, ftoj së-rish shokët besnikë të tij edhe zuri malet

1) Isuf Arapi ishte mendar i matur, trim, besëtar, dhe i devotshëm te patronët, përandaj më pas mori ofiqe të mëdha prej, Aliut i cili e donte dhe e nderonte.

përpara se të mbërrijnë ushtëri e Kurtit ndë Tepelenë. Ndë këtë kryengritje të dytë të Aliut nuk' pësojin të tjerë përveç se armiqt' e tij për të cilët bëjtim fjalë si: Kokosarët, Hormovitët, Lekljotët, edhe Gardhiqotët. Me këta kish goditje të rrepta dhe të gjakshme parreshtur, edhe këtë herë i shtypi krejt se ndë kohë të shkutër formoj një çetë prej 1500 brigandësh *(kaçakë)*; sa mâ-së-fundi si e panë që Kapedan Aliu dot' i shuante vajtën te Kurt Pashaj dyke-i-ulutur të çonjë ushtëri kundër Aliut edhe ata t' i vejin ndihmës që të mundin t'a kapin të gjallë ose t' a vrasën.

Duke-parë Kurti rrezikun më-të-keq q' e qarkonte, vendoj të marë masa më të rrepta për ndjekjen e rrebellit dhe të shokëvet tij. Ndë pikë të pare gjith' armiqvet të Aliut u dha lirië të plottë të vepërojnë si të duan në lëvizjet e tyre. Prapo ata duke-marë sy nga Kurti, vërviten me tërbim ndë katundin Gjatë tek kishte pronja, plaçkitin shtëpit' e bujqërvet të tij që i punojin selishtat, disa i-a vranë edhe të tjerët i-a përzunë prej katundit. S' andejmi vanë ndë Berat edhe po ngrehjin pllane të mëdha që të vërviten kundrë Tepelenës me një fuqi ushtëriake të madhe dhe me vetë Kurtin ndë ballë, të merjin skllave âmën dhe motrën e Aliut, që kësi-mjeti t'a nxonitjin të përepej vetë.

Po ky pllan i tyre u kotësua se edhe Aliu nukë flinte. Ato dit ky ndodhej ndë Radovickë afër Janinës me çetën e madhe edhe me t' u lajmuar për pllanet e armiqvet, vrapoj me një herë, shkoj ndëpër përqarkjen e Rizës, zapëtoj katundin Labovë edhe i-a preu udhën Kurtit dyke-zënë disa pozita strategjike. Pas këto harrijti Kurt Pasha me ushtërin' e ti dhe bashkë me 'ta edh' armiqt' e tjerë të Aliut; aty u ndes luft' e përgjakshme, e cila u zgjat 24 orë. Ndë këtë përpjekje, thonë gojdhëniet, mijëra kurt-pashalias shkuan ndënë shpatën e Aliut edhe pas-si mbërrini nata, krejt i dërmuar Kurt Pásha u kthye prapë ndë Berat me mbetinat e ushtërisë shkatërruar.

Kjo luftë, sikurse edhe të tjerat, na kallëzojnë ndë Historin' e Ali Pashës të parat sukçese të shkëlqyera

të karierës tij kur nukë kish harrijtur akoma moshën 25 vjetsh. Me gjith' këto ndë kohët e dimrit vepërimet e Kurtit për ndjekjen e tij nukë rreshtjin, edhe disa herë ishte rrezikuar të bjerë në duart' e armiqvet. Ndë Jenar te vitit 1766 kishte për trevë (limer) katundin Hosten, të Zagorit i ndënjur prej të krështerësh Shqipëtarë. Këta dyke-e-hospetuar gjenerozisht, me kokën e tyre mohuan t'a japën në duart' e armiqve, edhe më pas e përcuall ndë siguri gjer ndë malet e Gjinokastrës. Përandaj Aliu u ishte mirënjohës Hostenarëvet edhe ndë kohën e vlukut të lavdiës tij si u bë sundimtar, u ndihmonte ndë çdo nevojë.

Nd'ato kohë krahina e Delvinës e cila kishte qëndrë sundimi Gjinokastrën, qeverisej prej Kapllan Pashës, i cili ish kompetitór' i Kurt Pashë Beratit. Kapllani e priti krahë-hapët Alinë edhe pas pak kohë e vloj me bijën e tij Eminen. Dasmët e Aliut u festuan me solemnitét ndë Gjinokastrë më 1768, edhe mbajtin dy muaj, aty i lindi pas dy vjet i parî djalë, Myhtari, më pas, pas katër vjet Emineja lindi të dytin djalë Vëline dhe q'atherë më s'lindi të tjerë fëmijë. Kështu Aliu duke-u-lidhur me Sundimtar' e Delvinës me mjet të këti martesi më pas i proponoj vjehrit që t'a forcojnë akoma lidhjen e tyre shtëpiare duke vluar motrën e tij Hajnicën me djalën e parëlindur të Kapllanit edhe proponimi u akseptua. S'munt të përshkruhet ngazllimi që ndjente Kapllan Pasha për ruaret q'u bëjtin; po i gjith' ky gëzim pas pak kohë u kthye ndë helm! Deshtini (e thëna) e pruri që i gjori Kapllan të mos gëzohej per shumë kohë.

Kish krisur lufta midis Turqisë dhe Rusisë, edhe disa nahie të Pelloponisies dhe t'Epirit, duke-përfituar nga kjo luftë, të ngacmuar prej Admiralit të flotës Ruse i cili lundronte nër ujrat e Detit Egjeut, marën armët kundrë Turqisë. Një nga këto distrikte ish dhe Himara, (Bregu i Detit), që ishte ndënë administratë të Pashajt të Delvinës, po të cilën si duket Kapllani nuk dihet përse e përkrahte shumë.

Përveç Brekdetasve ishte ndërkryer dhe Mal' i Zi

prapë me gisht të Rusiës, andaj Port' e Naltë që t'i përmbytnjë këto kryengritje të brëndëshme, çoj më 1767 ushtëri të mjaftë ndënë kumandë të Valiut Rumeliës, Zilihtar Muhamet Pashës; ndënë flamuret e këti u urdhëruan ndë fushátë edhe shumë kryevendarë, midis të cilëvet edhe Kapllan Pasha i Delvinës. Pas luftës t'ushtërisë Turke me Malëzestë, Brekdetasit dyke-mos-mundur të rezistojnë me gjith' përkrahjet e pshehta të protektorit të tyre Kapllan, përiknë në malet e paafruëshme të tyre, po me që dhe s'andejmi u ndoquë prej ushtërisë madhe të Turqve më të shumit u çatdhesuan në Korfuz, edhe s'andejmi shumë vanë n'Itali.

Armiq të Kapllan Pashës që i-a dijin marëveshjet me Brekdetasit venë dhe e kallëzojnë te Valiu i Rumeliës si shkakëtar të revolltës Himarës edhe përkrahës të kryengritësvet. Andaj pas prajtjes të kryengritjës, Serasqeri e thëriti Kapllan Pashën ndë Manastir edhe i preu kryet. Kur mësoj Aliu për vrasjen e vjehrit s'i-u ndënjt mâ po sakaqëherash ftoj gjithë parësin' e vëndit edhe u kasnecoj që për të marë shpagë për gjakun e Kapllanit të vejin t'i bijin ushtërisë Tyrke edhe t'a vrisjin Muhamet Pashën.

Si do që fuqi e miqvet të Kapllanit nuk' isht e madhe po Port' e Naltë dyke-pikasur për këtë lëvizje, nga frika e një kryengritjeje të re për t'i satisfaktuar simpathizonjësit e Kapllanit emëroj për sundimtar të Delvinës të bir' e Kapllanit, Ali Bejnë. Me këtë mjet që përdori Divani, shpëtoj nga një kryengritj' e sigurtë. Aliu niset nga Tepelena për ndë Gjinokastrë të përhironjë kunatin për postin që mori edhe që ato dit filluan pregatitjet për martesin e Ali Beut me Hajnicën. Posi dhe dasm' e parë edhe kjo u festua me të madhe pompë, mijëra krushq muar pjesë nga të dyja palët.

Kapllan Pasha lá pas gjashtë djem nga të cilët pesë ishin vëllezër të thjeshtër të Aliut; këta quhëshin, Sulejman, Shishman, Seid, Hodo edhe Myrteza. Disa vjet pas vdekjes t'et, vëllazëria jetuan mirë po më pas u hyri grindje nërmjet tyre për t'u ndarë prej Aliut. Një mos-kuptim lindi midis tyre përmi

ndarjen e pronjave edhe Sulejmani ndë zëmërim e sipër bie e vret të vëllanë Ali Bejnë. Lajmet e ngjarjes tragjike vanë ndë Tepelenë edhe Aliu niset për ndë Gjinokastrë për të ngushëlluar motrën e tij si dhe për të mprojtur interesat e saj, e cila pak kohë përpara tragjedisë kish lindur një vajzë. Kjo ngjarje dotë bjente përfundime të shëmtuara midis Aliut dhe vrasësit të Ali Beut, po, për të çuditur, nërmjetonjës të shëndoshë hyjtin i pajcuan; dhe jo vetëm kuqë po Hajnica mori për burrë të dytë Sulejmanin, vëllanë kriminal të Ali Beut.

Nërmjet këtyre, kur Sulejmani dotë zinte postin e zbrazët të vëllajt tij, dy nga parësi e Gjinokastrës, Mustafa Agá Koka, edhe Selim Mustafa Bej, kryetarë të fortë të dy partesh opozitare dalën kandidatë për kryetarësiën e Delvinës. Pas një fushatë elektorale të përzgjatshmë zotoj part' i Mustafa Kokës edhe u njoh prej Nahies si Bej i Delvinës. Kjo indikatë i-u dha dhe me dekrét (ferman) prej Divanit.

Ndë këto e sipër Aliu kthehet ndë Tepelenë tek merrej me sundimin e vëndit tij lérës. Tepelena dhe përqarkj' e saj shkojin në qetësi të madhe dhe kjo i detryohej Aliut i cili, si dotë shohim, ishte i vetëmi për përmbajtjen e qetësiës, edhe ndë tërë Perandorinë ish i dëgjuarshëm për këtë virtytë.

Nuk kaluan dy vjet dhe u bë ndryshim ndë sundimim e Delvinës. Adversór' i të prokllamuarit Bej, Selim Mustafa Bej, me mjet miqsh të fortë ndë Stamboll, edhe me të paguar mitë (ryshfet), mundi t'a rrëzonjë Mustafa Kokën edhe t'emërohet sundimtar.

Po dhe ky si edhe të tjerët nukë pati fat të qëndronjë shumë kohë, si dotë shohëm; Ndë këtë kohë lufta midis Turqisë dhe Rusisë po vazhdonte. Venecjanët të cilët kishin ndënë pushtim nisiat Ioniane u ndihjin Rusërve.

Ndë mes të anëdetjeve te Toskërisë të pushtuara nga Venecjanët ishte dhe Vuthrotój, dherrat e të cilit kufizohëshin me Sanxhakun' e Delvinës. Selim Beu u pat shitur Venecjanëve disa vënde t'anëdetjes sikur-se edhe një pyll të math afër liqenit Pelloth që ishim pronja të Sanxhakut të tij. Pa vonuar shumë

u kallëzua ndë Konstandinopojë prej njerës të vëndit si dëmtor i interesave të Shtetit që shet pronjat publike. Pas pak kohë dolli ferman Perandoràk ndë të cilin dënohej Selimi me vdekje si trathëtor i Perandoriës. Përmbushja e fermanit i ngarkohej Ali Tepelenës i cili gjith-kohësh porositej te marë ndë dorë edhe sundimin e përtashme të Sanxhakut.

Selim Pasha u ezekutua edhe pas emërit të dekretit Aliu mori ndë dorë sundimin e përtashmë të Delvinës, po me që vetë s'mundej te vij ndë Delvinë vuri nëkëmbës edhe përfaqësonjës një të quajtur Ibrahim Agë Kallëpi. Si këshilltar pranë Kallëpit emëroj të depozuarin Mustafa Koka, edhe passi mori me vethe të bir' e Selimit, Shahin Bejnë, u kthye ndë Tepelenë. Thuhet se Aliu me që kishte për qëllim zaptimin definitiv të Delvinës, djalin e Selimit e mbante mbyllur ndë pallatet e tij në Tepelenë që të mos mundinj të bënjë ndonjë atent për të zaptuar përsëri postin e t'et. Po Selimi një dit tek kish dalë ndë hobor të pallatit, përiku vërrejtjen e gardianit që kish pas edhe dyke-evaduar iku ndë Delvinë tek u psheh dhe rinte nër miqt e fuqishmë të vet. Aty dyke gërmuar ndëpër pallat të t'et, gjeti të pshehur (prej atit tij) një rrësk, qyp me florinj, edhe me mjet të të hollave dhe të miqve të partit të tij ndë Stamboll, gjeti hirë për të shtënë ndë dorë postin e t'et. Kësi-mjeti pra me unanimët e tij, zëvendësin e Aliut, Ibrahim Kallëpin e nxori, këshilltarë Mustafa Kokën e vrau, edhe zaptoj Pashallëkun e Delvinës. Ghith me të tilla mjete muntnë të kamatojnë prej Divanit, që t'u legalizohet kuximi i tyre me *ferman* dyke u njohur si i ligjëshm Mustafaj i bir' i Selimit me titllin Pashà i Delvinës.

## KREJ III.

Thamë ndë krejin II që Hamkua kishte si mbikqyrës një të krështerë Hormovit të quajtur Çaush Prifti dhe të cilin më pas Aliu e përzuri nga shkaket që treguam.

Çaushi nga kjo mërië, dhe duke përfituar nga armiqësia që kishin Hormovitët edhe Lekljotët mbë Alinë, me shumë-farësh mjete bint katundarët e tij të ngrenë krye ndënë kryesi të tij për të mos i paguar Aliut pagat e përmotshmë edhe spahinjtë të mos i-a qasin. Aliu me t'u lajmëruar cili ishte shkakëtar i këtyre lëvizjeve çon Isuf Arapin me një tufë ushtarë edhe ndë një përpjekje me Hormovitët, disa prej ta u vranë prapo Çaushi u kap i gjallë prej Isuf Arapit, i cili pas gojdhëniet popullore e shkoj për helli të gjallë edhe e poqi ndë një lëmë [1]).

Të tilla lëvizje kryengritëse bëjtin edhe Lekljotët, Labovitët dhe Maleshovitët, po këta pas jo shumë kohë u përkulën me gjith që kishin dhe përkrahjen e Kurt Pashë Beratit.

Ndë periudhën midis vitevet 1781—1786, Aliu nukë dolli fare prej Tepelenës qytetit të tij vëntlerm, nek rij bashkë me âmën; tani e gjejme mjaft të

---

1) Këng' e Çaush Priftit Hormovës (Shihni librin «Mbleta Shqiptare» të Thimi Mitkos faqe 98.):—

*Kini par' a skini parë,*
*Të pjekë i biri t'anë?* **)
*Që Hormov' e tatëpjetë*
*Kapedan se ç' jeshë vetë*
*Me një qint e pesëdhjetë.*
*S' falja Turk mbë këtë jetë.*
*Kapedan o Çaush Prifti*
*Ç deshe ti te Hormoviti?*
*Mos na shkoni nga Zhulati,*
*Se na sheh Isuf Arapi,*
*Pa na pjek si dhjamë cjapi.*
*Kapedan Çaush Hormova*
*Dhjam' e dyllë të pikova*
*Ty dot besën s't'a ndërrova.*
*Nëne moj, e zeza nënë!!*
*Del e shih Çaushnë t'ënë*
*Tek e pjekinë ndë lëmë*
*Isuf Arapi një gjëmë!*
*Tyn' ore Isuf Arapi,*
*Ç't'erthka ndore si kasapi.*

**) Alluzjë që, si duket, Aliu kur ishte i mitur i thëritte Çaush Priftit babë.

fuqishëm dhe me influencë të madhe jo vetëm ndë kazan' e Tepelenës, dhe perqarkjet fqinjë, po edhe ndër banorët brënda dhe përtej Thesaliës.

Mbas vdekjes të Kurt Pashë Beratit, postin e tij e zu i dhëndëri Ibrahim Pasha, Vlonjaku ; ky ishte fare i pavlefshëm për të mbajtur qetësiën e vëndit që kishte ndënë sundim, edhe keqbërjet e kusarëvet *(hajdutërisë)* ishin ndë urdhërim të dites.

Rastet nuk' vonuan shumë për mbrothësimin e Aliut. Guverna Otomane kishte informata të përherëshme përmi shtetin e keq të vëndevet Thesaliës ndë pikëpamje administrative dhe qetësie edhe për vuajtjet që pësonte populli. Mirë-po për stabilimin e qetësisë lipsej njeri i zoti icili të ish' i shprovuar për këtë barrë të rëndë që të shpëtonte gjindjen e mjerë nga çetat e kusarëvet. Edhe me që nga gjithë sundimtarët e Shqipërisë Aliu ishte treguar më i zoti për qetësinë publike, këti i-u ngarkua kjo misiunë.

Kështu pra më 1785 Aliu emërohet rezident i Inspektòrit përgjithshëm i udhëvet Rumelisë *(Dervenat-Nazër)*, edhe më pas, më 1786, sundimtar i Thesaliës [1]).

Posa mori postin ndë pranin, Aliu ngrehte pllanet me të cilat ishte sigur që dotë diltë faqe-bardhë edhe që ditët e para të emërimit, rekrutój prej kazasë Tepelenës një batalon prej 600 ushtarësh të zgjedhur me të cilët duke-kaptuar malet e Pindos, dëpërtoj Zagorin edhe hyri ndë Tërhallë. Aty filloj të vepëronjë rreptësisht përmi pikën-e-parë të misiunës që i ishte ngarkuar d. m. th. për ndjekjen edhe shpërdarjen e çetavet kusare dhe përgjithërisht për sigurimin e qetësiës botëshme. Kësi farësh ndë kohë të shkurtër mundi t'i përndajë tërë çetat e kusarëve dyke-i-munxuar nër viset thellë Maqedhoniës edhe gjetkë, pruri urdhërin e posaçëm që gjer atëherë as që dihej nd'ato vënde, edhe shumë shtëpiarë të krështerë që patnë ikur nga Thesalia për

1) Kur më pas mori ndënë sundim të tij edhe Janinën Ali Pasha ndë një letrë që i çonte mbretit Anglisë, titullohej Administrator i Përgjithsëm i Janinës edhe i Tërhallës.

shkak të paprëhjes dhe të cfilitjevet që hiqjin, u kthyen prapë ndë vatrat e tyre.

Nuk kaloj shumë kohë që trimëri e 'tij sikurse edhe abilitéti i çuditshëm për stabilimin e qetësisë i prunë pemët e merituëshme. Më 1786 i dolli dekret perandorak nek emërohej Sundimtar *(pashà)* i Tërhallës. Ftoj gjithë parësinë Mysliman' e të krështerë, edhe pas-si u këndua *fermani*, u dekllaroj qe, ndënë sundim të tij dotë punitej ashpër ay qe dotë bënjë më të vogëlën keqbërje. Gjith-po-ashtu çoj njerës edhe ndë të tjerë qytete me urdhrime të sevèrshmë dyke-pastruar vëndin nga gjithë brigandët. Ndë Llarsë disa bejlerë që zhvatjin gjindjen e ngratë, i dërgoj vargoj-lidhur ndë Konstandinopojë tek u dënuan me vdekje. Dhe kështu *hajdutërija* edhe çdo keqbërës vetëm emërin e tij kur i dëgjojin, dridhëshin posi bishat nga luani.

Dyke-vepëruar me këtë system Ali Pasha ndë Thesali mëkonte çuditërisht pllanet të cilat prej kohësh po i shtudijonte për pushtimin e Pashallëkut të Janinës. Edhe me të vërtet passi ndë dy vjet mundi t' e shtrojë vëndin që ishte ndënë sundim të tij, u famëzua mbë ç'do anë për Governor i-pa-shoq ndë Perandorië.

## KREJ IV.

Janina, kryeqytet i Toskërisë është qytet me histori të qëmotshme. Të shuma edhe të ndryshme janë mendimet e Historishkronjësvet përmi emërin e saj, po më të shumët thonë se qyteti u ndënjt prej vëndësit e ikur nga qyteti i vjetër, sot një katund' i vogël që quhet Kastricë, rrebeshuar më 1150 pas Kr., edhe emërin qyteti e mori nga manastir' i vjetër i Shën Janit, që dirgjet mbi një shkëmp ose promontór ndë perëndim të liqenit të paémërshm. Që nga veriu ndë jugë Janina qarkohet prej malesh të lartë. Nga lindja nalltohen me madhështi malet e Pindos, të Tomorit, pas tyre zgjatet Miçëkeli, ndë rrëzat e të cilit ndehet liqeni. Ky liqen, që pa dy-

shim s' ka qënë fare ndë kohët e vjetra, u formua pak-e-nga-pak nga ujrat e burimevet të shuma që rrjedhin prej Miçëkelit dhe Tomorit, të çilat dyke-u-dergjur ndëpër gllapa kanë bërë pellgje të mëdhenj edhe më pas uja dyke u-naltësuar, u pasformua ndë liqen.

Qytet' i Janinës formon shkabë dykrenore, i së cilës, trupi është Kalaja, të dy krerët janë të dy promontorët, te dy krahët janë të dy mëhallët e mëdha që ndehen njëra nga perëndimi edhe tjatra nga lindja, edhe bishti mëhalla e Llucës ; dhe kështu si-kur është dezenuar një-me-një ndë të akvilla e Shqipërisë.

Nga të katër çipat fortesa ujitet prej liqenit, prapo ana e pestë veçohot prej qytetit me mjet të një hendeku që bashkohet nga të gjith' anët me 'të, ndek rrjedhën edhe ujrat e anës së tejme. Një urrë përdoret për komunikatën e qytetit me *kalanë* ndë të cilën jetojnë Myslimanë edhe Israilitë. Kundrejt fortesës afëro një qillometër distansë ndë mes të liqenit është një nisië e ndënjur prei ca të pakë stëpiarë peshkatarë, e cila ka edhe 5 manastire sa-do të mëdhenj ; midis tyre ësht' edhe Manastir' i Pandelimonit ndë të cilin sikurse dotë shohim, eshtë vrarë Ali Pasha.

Që nga pozita m'e lartër e fortesës është një çitadellë e ndarë me një mur të çmërshtë edhe me një derë të veçme. Pamja e saj është e bukur se fillon prej kryes-qytetit, ka një orizont të math përpara edhe së këtejsmi syr' i njeriut munt të përmbledhë Pindon, Tomorrë gjithë malet a Çamërisë dhe të Labërisë, s.kur-se edhe të tërë fushën e Malësiës. Ndë mes të kësaj çitadèlle është pallat' i Ali Pashës, godinë e katërçiptë edhe fort e fllashtë.

Kështu pra, Janina nga pasuri e vëndit edhe për pozitat gjeografike edhe strategjike, ishte shumë e rëndësiëshme për Ali Pashën, edhe nga kjo gjë ky me të marë pashallëkun e Tërhallës, qëlluarjet edhe përpjekjet e tija u drejtuan aty.

Sanxhaku i Janinës me qëndrë qytetin homonym, përbëhej prej katër distriktesh të cilat ishin këto që

pasojnë: — Distrikt' i Zagorit mbë veri të Janinës që përmblithe 47 katunde, i Mallakastrës mbë lindje 50 katunde, i Çarkovishtës mbë jugë 45, edhe i Kurentës ndë perëndim 32 katunde. Ky Sanxhak ose pashallëk, që më 1740 ishte dependencë e Sanxhakut Thesaliës, q'e kish qëndrën ndë Tërhallë; Sundimtari i Tërhallës emëronte një nëkëmbës ndë Janinë, zakonërisht një prej më të çquarit myslimanë të qytetit, me konsencjën e Divanit. Po më 1760 i-u hoq dependenca edhe Sanxhaku q' atëherë sundohej prej Pasháj, i emëruar drejt-për-drejt prej Portës së Nalltë.

Ndë këto kohë shteti i Janinës ishtë sikurse pason: - Pas vdekjes të Sundimtarit Mehmet Pashë të cilit nga zëmërmirësi e tij i thoshin edhe Pashaj i Mirë, ndë fronin sundimtar e sukçesoj atë Ali Pasha (jo Luani ynë) më 1775—1778, edhë Beqir Pasha (1775—1780). Pas këti më 1780, Sundimtar i Janinës u emërua Sulejman Pasha nip' i Pashajt të Mirë; ky ish nga karakteri i dobët, pa-moral, edhe e pruri vëndin ndë një anarhië të patreguarshme. Më 1786 pas shumë anëkime që bëjtìn popull' i Sanxhakut ndë Konstandinopojë, u vra me urdhërim të Sulltanit. E shoq' e tij (mbetur-e-ve) e cila ishte mjaft e pasur, me pëlqim të saj u martua me Kryepolicàjin e Janinës i quajtur Ali Zot Agà. Ky me mjet të miqvet të së shoqes ndë Stamboll, mundi të emërohet ndë vënt të Sulejmanit. Pra, Sundimtar i Janinës më 1788 ishte Ali Zoti që thamë, edhe i cili ndë kohën që zëmë ngoje ndodhi të jetë absent prej fronit, shkaku se kishte përmarshuar bashkë me të tjërë Pashallarë kundrë Tunës se ishte lufta midis Tyrqisë me Austrinë dhe Rusinë. Ndënë qeverim të këti dhe të së shoqes, anarhia ishte kulmuar ndë Janinë, nga shkaku se midis ndënjësvet myslimanë ishin formuar pàrte të fuqishmë të cilët ishin gjithëmonë ndë konflikte se hahëshin kush-e-cili të marë kryetarinë. Përmbi këto vëndi gjëndej ndë një shtet të tmershëm, përdita ngjisjin vrasje dhe keqbërje mbë ç'do anë të kazasë.

Port' e Naltë dyke-u-lajmëruar për gjith këto

ngjarje të Sanxhakut Janinës vendoj dhe i çoj Ali Pashës të mbledhë ushtërin' e tij dhe të xbresë ndë Janinë të shtrojë vëndin duke-mbajtur qetësine gjer të emëronjë Divani nonjë Sundimtar. Andaj Ali Pasha ndë muajin Tettor të vitit 1788 passi lajmoj ndënjësit e sanxhakut që dotë shkelnjë me ushtëri për të përzënë çetat e kusarëve dhe për përmbajtjen e qetësiës posaçme, dolli nga kufiret e tij me nj'ushtëri të mjaftë, edhe kyke-kaptuar me shpejtësi malet e Pindos harrijti në katundin Pranë që ishte ndë rrëzat e Miçëkelit, dhe aty kuqendroj ushtërinë. Bejlerët e Janinës i kapi tmerri kur u erth befas, dhe më tepër që Ali-Zoti s'ndodhej aty, dhe pandehjin se mos Ali Pasha vij të grabitnjë postin e Ali Zotit, përandaj me gjith që ishin të përçarë u bashkuan edhe bëjtin vendim t'a dbojnë s'andejmi. Mblodhë sa muntnë luftarë me Kryetar një djalosh të quajtur Asim Bej, edhe e goditnë me gjith fuqi afër katundit Bizdun. Beteja krisi e rreptë ndë krye, po pas nj'a dy orësh Asim Beu dhe shokët e tij të dërmuar krejt u ngutnë te përprapsen ndë fortesat e qytetit. Ali Pasha nuk' i ndoqi gjer brënda qytetit me gjith që po të donte hynte me ushtërin' e tij po nuk' e bëntë këtë se as që ish i pregatitur për këtë masë e cila mundej të tërhiqte dhe vërejtjen e Portës kundër tij, edhe kësi farësh passoj fushatën e tij pas urdhërit që ish ngarkuar dyke perzekutuar kusarët edhe dyke-pastruar vëndin nga ç'do keqbërës. Midis këtyre ngjarjeve, ndë Janinë formohet një part Bejlerësh q'e dojin Ali Pashën ; këta dërgojnë ndë K/pojë një peticjë ndë të cilën dyke u lutur i lypjin Divanit emërimin e tij ndë fronin e Pashallëkut Janinës; Ali Pasha kishte dhe miq të tij të veçanëshm në K/pojë q'e përkrahjin edhe puna po vente mbroth. Po edhe parti tjatër me të cilin bashkëpunonte edhe e shoq' e Ali-Zotit [1]), nuk mbet pa vepëruar po dërgonte ndë K/pojë njerës që kallëzojin veprat e Ali Pashës për lëvizje kryengritëse.

1) Quhej Aishé edhe ishte motër e Mehmet Pashës Mirë.

Po Port' e Naltë dyke-mos-marë fare nër sy kallzimet kundër tij, pas pak kohë vulosi dekretin e e emërimit Ali Pashës për Sundimtar dhe i Janinës, dyke-u-njohur Pashallëku i Janinës si pjesë e shtuar e Sanxhakut Tërhallës. U mbush pra dëshir' e flagështme e Ali Pashës, dhe kundërvepërimet e Ali-Zotit u kotësuan.

Pas këto Ali Pasha vendosi për ndëvënt të tij ndë Thessali të birin Veli Bejnë me një keshilltar t'urtë dhe të përvuajtshëm, edhe fllloj me një zell te patreguarshm përformimin edhe organizatën e pashallëkut të ri. Vepr' e parë e tij ishte nxjerja nga puna Spahinjtë edhe të tjerë nëpunës të cilët torturojin gjindjen e mjerë për t'e rrjepur me shumëfarësh shpekulla edhe padrejtësirra; kishte takuar shpeshherë ndë mes te ditës lakuriqosjin, rrihjin, vrisjin, dhe kishin harrijtur ndë një të tillë grad paturpësije sa të rrëmbejnë gòca edhe djelmosha sa që çquanin ndë bukurië.

Disa nga anëtarët e partit që vepëroj kundër tij nga ndruajtja se mos u merte ahun, dojin të ikëjn prej Janine' po Ali Pasha i thërriti dhe i këshilloj të mos ikin duke-i-siguruar se përveç që nuk' dotë persekutohen do-t' u èpej edhe nëpunësië gjitëcilit pas merituarjes.

Kësifarësh, ndë pak kohë u vendos urdhëri edhe legjisllata e mirë mbë gjithë vëndin.

Mbas një mot kur mbretëronte Sulltan Selimi, Ali Pasha bashkoj çdo autoritét që kishte nevojë me mjet të së cilës përzgjëroj zotërimin e tij jo vetëm ndë Shqipërin' e Rrëposhme, dhe ndë Thesali, po edhe ndë tërë Morenë. Gjithë turmat e brigandëve i shtypi gjer-sa më s'dëgjohej as këmbë *hajduti.*

## KREJ V.

Ndë përqarkjen e Çarkovishtës, që ndodhet ndë jugë-perëndim të fushës Janinës ishte ndë ato kohë Tribi *(Bajraku)* i Suljotëvet.

I tërë vëndi që përmblidhet ndë këtë distrikt po

veçanërisht Suli ësthë malësi edhe tumbe. Duke ardhur nga fush' e Llurës ndë veri, dhe duke shkuar malet e Paramithisë tfaqet së pari mal' i Zallëngës, edhe pak orësh distansë më tej janë malet e Sulit, nga të cilët më të çquarit quhen: *Flamuri, Guri, Gështenja, Vuçi, Kopani,* edhe *Dybliri.* Kacambitj' e këtyre nis që më të djathtë të burimeve të lumit Aher, shkon ndë veri edhe sos ndë rrëzat e kodravet mbi të cilat janë katundet Sistruni, Kllavica, edhe Tagari. Gjith-po-aty kanë qënë të katër katundet më të çquara të Tribit, d.m.th., Avariku, Qafa, Samoniva, edhe Suli. Ky qark ka qënë sheshi i shumë bllatimesh (therorësiash).

Dyke-shkuar nga Vuçi tek ndodhet Manastir 'i Romanojt ndë jugë, distansë një or'e gjymsë dirgjën rrënimet e Sulit ose të Kakosulit, të përndara këtukëtje. S'andejmi duke-ecur gjith nga juga nonjë gjymës ore hasim të tjera rrënime të Samonivës, edhe nonjë gjymës ore më poshtë edhe të tjera rrënime të Qafës; pak më posthë gjith po n'aqë distansë rrënimet e Avarikut. Nga Perëndimi i rrënimeve Suljote si nj'a dyzet minuta lark, nalltohet madhështor shkëmbi konik i Kuçit dhe i Shën-e-Prëmtes. Nga mesditës' i Kuçit distansë 15 minuta është tumba e Birit e ndarë prej Kuçit me mjet të një bugazi tek shkon Aheri.

Mbi tumbën e Qafës, Ali Pasha ka ngrehur një fortesë passi pushtoj Sulin; ajo ndodhet edhe gjer sot po e rrëzuar. Nga gjithë pozitat strategjike Suljotët ndë luftat qe bëjtin me Ali Pashën vetëm në Kuç kishin fortesë të shëndoshë, në të tjerat pozita vetëm fortesime të përtashme trajtojin.

Më 1860, kufiret e Sulit ishin mjaft të ndera. Nga juga dhe nga perëndimi ndeheshin afro gjer ndë Llucë dhe në Margarit, nga veriu dhe nga lindja gjer ndë Kurentat dhe ndë Çarkovishtë.

Që malësi e Sulit tek dirgjen tani rrënimet e katër katundeve, ka qënë e ndënjtur në kohët më të moçime duket jashtë ç'do dyshimi, me që vëndi është'i pajuar me klimë të kandëshme dhe t'ëmbël, edhe me vënde të mira për kullotë. Thuhet se ndënjësit

e epokës që zumë ngoje nuk ishin indigjenë po të ardhur. Po ndë ç'kohe ardhi ky popullim ndë këtë vënt edhe qysh ngjau ikja e tyre është bisedim që ka mbetur i errët gjër tani. Shkrimtari Frënk, Pouqueville thotë që: ndë rrjedhje të shekujve vëndi ka qënë i ndënjur gjithmonë, edhe Suljotët nuk janë përyeç se stërnipat a Epirotëve të motshëm të cilët pas prishjes t'Epirit prej Paul Emilianit shpëtuan ndëpër malet dhe ndëpër shpellat, edhe se emri Sul është korruptë e emërit Sella, d.m.th., vëndi tek rijin më parë. Të tjerë shkrimtarë thonë që ndënjësit e motshëm të Sulit ishin mbetina nga luftëtarët e Gjergj Kastriotit (Skënder Beut) të ikur ndë Shqipërin'e Poshtme pas vdekjes edhe përndarjes të dinastiës së tij' ndë Shqipëri të Sipërme prej Tyrqve. Po m'e drejt'e fjalës nga sa dëshmon vëndi do të jetë kjo: Vëndi tek dirgjen sot rrënimet e të katër kryekatundeve Suljote me qënë i pandënjtur në gjymsën e dytë të shekullit XV, shumic e madhe shqipëtarësh të krështerë nga vëndet përqark Çamëriës ardhe dhe ngulë ndë të. Kjo kolloni, i dha emërin Sul katundit parë ndë të cilin u vendos, si-kur-se edhe në disa katunde të Shqipërisë e gjejmë këtë emër [1]). Më pas emëri Sul dyke-u-për gjithësuar i-u dha edhe gjithë tribit. Këta Shqipëtarë të krështerë u vendosnë ndë sul ndë kohët kur Toskëria ish e ngutur me të pahir për t'u islamizuar ndë shekullin e XV edhe këta dyke-mos-u-bindur ndë shtrëngimet e njëkombasvet të tyre për t'i gjyrmuar ata, u hoqnë ndë këtë vënt ku me ndihmën e naturës të vëndit muntnë të mprohen nga ç'do rrezik. Ndënjësit primitivë të Sulit filluan ma-së-pari të katër katundet e para d.m.th. Sulim, Qafën, Samonivën edhe Avarikun. Suljotët ndahëshin në fise të origjinuara që nga Kryfisasi (Barjaktari) primitiv. Këto fise dyke-u-shumuar, në kohën kur ishin ndë vluk të fuqisë harrijtin gjer më dyzet; po më te lashta dhe më të shënuarshme midis tyre ishin fiset

1) Katundi Suli nde kazá të Devollit

e Boçarenjvet dhe e Xhavellenjvet. Ndë gjithë-cilin fis kryesonte m'i çquarshmi Kryefisas i cili zakonërisht ishte edhe m'i lashtë nga mosha.

Krerët e fiseve të trupëzuar së bashku formojin Pleqësinë e cila kish detyra ezekutive dhe gjyqesh. Pleqësia rregulonte taksàtat e vëndit edhe rekrutimet kur ish kohë lufte. Kjo barrë u ngarkohej krerëve të ç'do fisi me që cilido Kryetar i anëzonte fisit tij. Përpara kësaj pleqësije shtrohëshin edhe çështjet politike dhe penale. Në ç'do çeshtje gjyqi, në pikat e para të ligjevet t'adoptuara zotojin zakonet e vëndit. Ndë subjekte përmi vendime serioze, vjen fjala për luftë osë paqë, Pleqësia ftonte gjithë meshkujt e Tribit në miting të përgjithshëm, tek kishin të drejtë të çfaqnjë gjith-cili mendimin e vet. Zakonet e Suljotëve ishin pa as qime-ndryshimi poato të Shqiptarëvet të gjithë Shqipërisë. I rrënjosuri zakon i vendettës (ahmarjes) nga i cili armiqësia ish' e përherëshme nër 'ta, edhe fjala e nderit (besa, qe epjin në bashkëvendimet e tyre, dëshmojnë kjarisht origjinën e tyre fjesht Shqipëtare. Gjithë këto përtregojin karakter'e tyre luftar. Ç'do Suljot i armatosur që ndë moshë miturake edhe dyke-gjymuar të mëdhenjtë bëhej pas pak luftëtar i sosur. Po edhe grat'e Sulit nuk bijin më poshtë nga burrat si mëma dhe si shorte: Nër luftrat gratë merjin pjesë vepërimesh dyke-u-prurë municje dhe të haëme; shpesherë u rrëmbejin armët burrave dhe luftojin në vënt të tyre për t'u fryjtur më tepër kurajë. Përveç trimërisë gratë Suljote çquajin dhë nga bukuria të pajuara natyrisht [1]).

---

1) Për hir të këndonjësit suplimentojmë këngën e mëposhtme mbi bukuriën e Suljotkavet sikurse e kumenton Muza e Labërisë:

*Vàshëza manile-verdhë,*
*Shkon me furkën dyke-tjerë;*
*Moj mike ballë-Suljote,*
*Më treti sevdaja jote;*
*Mike moj, mikez' e xhanit,*
*Mos na shko përpara stanit,*
*Se të ha qën' i çobanit.*
*O çoban, or derr' i dhënvet,*
*Ndë ke besë, bjerru qënvet;*
*«Qëntë s' janë për të vrarë,*
*«Gush' e bardh' ësht' për të parë».*

Okupata m'e kandëshmë e Suljotëve ish jeta dhënare nër malet, edhe kjo mjeshtëri, më tepër u zhvillonte instiktin luftar. Ndë kohët e para të kollonizimit kur gjithësej shtëpiarët e të katër katundeve mblidhëshin si nj'a 126, fuqia luftare ish' e vogël, po më pas, ndë dekadat e para të shekullit XVII (1700) popullimi u shtua nga refugjiatët të cilët nga frik'e Islamizmit përikjin ndë malet e Suljotëve. Dhe kështu ca-nga-ca të katër katundet u bënë një-mbëdhette të cilat ndë kohë lufte nxirjin katër mijë burra. Passi populli u shumua edhe resurset e vëndit nuk' mjaftojin, kjo gjë i nguste ndënjësit e saj në grabitje pronjash mi kuris të fqinjëve 'tyre. Pronarët e katundeve të grabitura ishin shumësia myslimanë të cilët me mos patur përkrahje nga patronët e tyre nevojitëshim të lypin miqësin' e invadorëve dyke-u bërë nër ta nenurdhratës tributi (*haraçi*), edhe kështu me kohë Shtet' i Suljotëve u formua një si konstruktë politike kurióze nga që subjektët e Sulltanit, bujqërit, shumë herë dhe ata parësi e Janinës ngutëshin t'u paguajn haraç, për ruajtjen të çifligjeve të tyre. Këto të holla q'u merjin fqinjëve nuk hyjin në arkë të vëndit po ç'do fis ose disa tok dyke-udalë për-zot katundeve për të mprojtur merjin *haraçin* dhe nga ato një pjesë e ndajin nëpër kllasat më të papasura; këto kllasa rronin më shumë me rrëmbime dhe vjedhje mi kurris të fqinjëve.

Po dispozitat grabitëse të Suljotëve nuk' tfaqëshin vetëm nga ato që thamë më lart, po edhe me anë të të tjerash paudhësirra të cilat kishin ngutur disa nga kollonitë afër katundevet të Sulit të çatdhesohen, dyke-lënë pronjat a veta ndë dishkretë të invadorëvet. Kështu pra, përngulja e Suljotëvet ndë vëndet që s' ishin të tyre, edhe madhimi i Shtetit të tyre, i bëjti Myslimanët fqinjë të ndërkryen kundë 'tyre me-që e shihjin që pronjat u ishin ndë rrezik prej këta fqinjë të rishmë. Që këtë epokë filluan vërvitjet e muhamedanëvet të Paramithisë dhe Margaritit, të Janinës, të Nartës dhe të Delvinës kundrë Sulit ndënë kryesi të reprezentantëvet të Predominatës Sulltanike. Nuk dihen hollësira të sigurta përmi keto

luftëra të Suljotëve me fqinjët e tyre, po vetëm dihet se me gjith shkeljet e parreshtura nuk mundën t'i farosin krejt se pozitat e tyre malësore u ndihmojin shumë. Nga luftat me më rëndësië gojdhëniet komemorojnë këto që pasojnë:

I). E Haxhi Ahmet Pashës më 1721. II). E Mustafa Pashë Janinës, 1754. III). E Doç Bej Gardhiqotit, Sundimtar'i Delvinës, 1759. IV). E Maksut Agë Margaritjotit, Vojvoda i Nartës, 1762. V). E Hassan Çaparit 1772, edhe. VI). E Beqir Pashës më 1779.

Shkakëtarë të gjithë konflikteve luftare ishin kurdoherë Suljotët të cilët si-kur-se thamë dhe më nalt invadojin në katundet e përqarkjeve fqinjë që ishin pronja të bejlerëvet më shumë.

Pas gjith këto që përmëntmë, kuptohet udobisht interesi që i-a donte Ali Pashës passi mori Pashallëkun e Janinës, t' u' a presë Suljotëve hovet e kuxuarshme edhe t'i përkulnjë dyke-dobëtuar fuqin' e tyre sa ish ndë shparga. Përandaj posa u vendos ndë Janinë aty e hodhi vërrejtjen e parë.

Në këto kohë (1788—1789) Suljotët ndodhëshin ndë një lëvizje më të madhe nga të tjerat. Dyke krisur lufta midis Rusisë dhe Austrisë kundër Tyrqisë, Perandorésha Katerina me mjet të agjentëvet të saj ngacmonte popujt'e krështerë subjektë të Tyrqisë ndë lëvisje kryengritëse kundër Portës. Një nga bicet ku u drejtuan këto intriga ish' dhe vatra e Suljotëvet, të cilët të kobuar nga propagandat e agjentëvet marin armët dhe me fórra shkelin krahinat që ishin ndën' urdhër të Ali Pashës, dyke-iplaçkitur pa ndonjë farë ndrojtje, edhe prunë ndë rrezik ç'do komunikatë rrugash.

Përpara një shteti të tillë, Ali Pasha i penguar nga punë të tjera s' mundej të ngrehte pllane vërvitjeje kundrë Suljotëve, vëtëm e gjet me udhë të çonjë një trup 3000 ushtarësh për të zënë pozita të forta rreth Sulit; që me kete mjet të ndalnjë invàzjet e tyre ndë viset e ndën' urdhër të tij. Kjo ishte një masë e përtashme duke-pritur rast më të mirë për t' i goditur ndë qoftë se nuk' qetohen, edhe nërmjet këtyre ktheu atencjën ndë tjatër anë

të sundimit tij që dhe ajo i përkiste qetësiës publike.

Ndë fushën e mezit të Vijosës edhe ndë distriktin e Konicës ishin 22 katunde muhamedanësh te cilat përbëjin krahinën që quhej Karamurát. Ndënjësit e kësaj krahine përqafosnë Islamizmin më 1760 ndënë punëngjamet që pasojnë: Këto katunde ishin të krështera ndënë parohië të Peshkopatës së Pogonit. Me gjith' që hiqjin të këqiat e dheut nga fqinjët muhamedanë rezistuan ndë këto vuajtje gjer më 1760, kur venduan të propitiojnë perëndisiën me mjet agjërimesh edhe pocaqi trupi; ndë qoftë se i nallti s' u-a ndërgjon lutjet e tyre, të kthehen ndë adhurim të Muhamedit. Më kot Peshkopi u kujtoj impietëtin e një vendimi të tillë. Karamuratasit agjëruan në Kreshmët e Mëdha të ati viti si as kurrë herë tjetër, edhe kur mbërrini nata e Ngjalljes dhe panë që nuk' u pruri as nonjë shërim të keqësiavet, mohuan fen' e Krështerë dyke dekllaruar që përqafosin Myslimanizmin.

Të rishmit Myslimanë të cilët patnë vuajtur gjer md' atë kohë nga fqinjët tjatërféas, ndë pakë kalim kohe ndënë krahët e fëës së re u bëjtin të këqij dhe pa masë të tmershëm mbi kurris të fqinjëvet tyre të krështerë dhe myslimanë pa çquarje, dyke-grabitur, dyke-vjedhur, dyke-vrarë dhe dyke-bëjtur gjithfarësh keqbërje që mundjin.

Ali Pasha nuk' ish' e mundëshme t'a duronte këte dezórdinë ndë këtë vënt të sundimit tij, përandaj çoj një fuqi luftare të mjaftme kundër Karamurátasvet, kapi parësin'e tyre, ndoqi dhe rrebeshòj ata më keqbërësit, edhe kësimjeti i shpëtoj për gjithëmonë vëndësit e krahinavet të Pogonit dhe të Përmetit nga frushkullim i paduruarshëm i Karamurátasvet. Gjithpo-këtë mjet përdori edhe kundër bejlerëvet të Konicës të cilët ishin të vërtetë tirranë mbi kurris të kllasavet rrëposhme të popullit, dhe bëjin të panumërta keqbërje dhe vrasje.

## KREJ VI.

Ndë vitin 1790, duke-vazhduar lufta e fllluar nërmjet Tyrqisë me Rusinë dhë Austrinë, Ali Pasha mori urdhërim prej K/pojës të bashkohet me Rumeli-Valinë i cili ndodhej ndë anët e Tunës, edhe ay me shpejtië përmarshoj me një ushtëri luftare të madhe të cilën e rekrutoj ndë Toskëri dhe ndë Thesali. Nukë dihen pikë-pas-pike vepërimet e tija ndë këtë fushatë, po traditat thonë që bëjti çudirra të cilat tregojin superioritétin e tij nga Pashallarët e tjerë të Tyrqisë. Më 1791, kur lufta ishte ndaj të mbaruar edhe po bëheshin marëveshjet për paqë, Ali Pasha dykë-parë që s'ishte nevojë të humbasë më kohë edhe me që çështje të sunimit të tij e lypjin të vij ndë Janinë, kerkoj lejë prej Divanit e cila i-u dhaj edhe dyke-marë pas më të shumën e ushtëriës tij mbërrini ndë Janinë.

Ndë kohë të absencës Ali Pashës, punët ndë Toskëri nuk' mbenë të qetuara. Suljotët as një dit s'i prajtnë lëvizjet kryengritëse dyke-përsëritur invazjet e përzakonëshme. Po sidomos, këtyre invazjave mâ së sosmi mundi t'u vë-jë krusmë trupi ushtëriak që kishte vendosur Ali Pasha nër pozitat afër kufirevet te Sulit. Ushtëri e Ali Pashës dyke-u-vërvitur pa rreshtur kundër invadorëvet i nxoniti të përcaktohen nër më të ngushtmet kufire ; këtë herë Suljotët humbën gjithë pshatrat e Tomorit, edhe më vonë, 1790—1791 humbën edhe të tjera 10 katunde të përqarkjes jugore të Çarkovishtës, dyke-u-prapsur nga kufiret e tribit gjer te Llak'e Boçarit.

Mbas-si u kthye Ali Pasha nga fush' e luftës sikurse thamë, dhe dyke-parë që këta bij të egër të naturës nuk rijin të qetë, vendoj që me mjet të një force të madhe t'i përkulnjë me kohë. Edhe pra ndaj gjymsës dytë të vitit 1791 mbeti dyke-u-shlodhur ay edhe ushtëria e kapitur nga lufta e Tunës. Më 1792 filloj preparátat edhe gatiti një ushtëri prej 10,000 burrash. Më 15 Jenar Ali Pasha vetë ndë ballë të ushtërisë, hypur mbi kalë të bardhë, mori rrugën për ndë Sul, nek edhe adversórët kishin bërë pre-

gatitje për defensivë. Kur harrijti ndë Shtat Katundet, pshatrat i gjet të shkreta se vëndësit ishin t' hequr nër górgat e malit.

Përpara se t'i goditnjë dërgoj dy kasnecë për t'i lajmuar të binden ndënë sundim të tij duke-u-premtuar lirië të plotme. Kryetarët ose Kapedanët e Tribit passi bëjtin një këshille midis tyre, venduan të mos binden fare po të kundrështohen gjer së sosmi, edhe u përgjeqnë kasnecëvet që Sulin vetëm me gjak munt t'a marë tjetrazi ata nukë përepen. Mbassi përcuall kasnecët, bëjtin një këshillë të përgjithëshme luftare pas së cilës venduan që: të zbrazen katundet, Samoniva, Suli, edhe Avariku, të sigurohen gratë dhe fëmija ndëpër shkëmbënjt' e paqasçëm të Qafës, edhe burrat e pushkës të zënë pritat ndë ngushtinat e Qafës, nër grykat e keqe të malit Shën-e-Prëmtes, si edhe ngushtinat ndërmjet tumbevet të Birit edhe të Kuçit; të tjera trumba më të vogëla të përpshihen nër të tjera pozita të ndorëshme, prapo një tjatër trumbë të zërë pritë ndë rrëzat e Kuçit.

Ali Pasha me të marë përgjigjjen e Suljotëve thërriti gjithë oficerët e tij edhe u vendua t'u vërviten Suljotëve ndaj agimit të ditës 20-ttë të Jenarit. Kështu passi e regulloj mirë ushtërinë, dha parollin e vërvitjes kundër Suljotëve të vendosur në pritat e tyre. Me gjithë ashpërinë të naturës vëndit, Shqipëtarët Alipashalias u turrën përmi pozitat e Suljotëve të cilët dhe ata u përgjeqnë me zjar të gjallëshm edhe pas një betejë burrërishte prej të dy palëve, Suljotët u ngutnë të përprapsen përpjetë malit; por u ndoqnë këmba-këmbës nga Alipashaliasit të cilët nuk vonuan të zaptojnë edhe katundin homonym, Sulin. Ushtëri e Ali Pashës tani ndodhej ndë kërthizë të Tribit pa hasur tjetër kundrështim serióz përveç një përpjekje afër Qafës me një numur të math Suljotësh të fortesuar ndë dy kulla t'afërta ndë të cilat passi ndoqnë garrnizonën s'andejmi, dërmuan dyert edhe hynë brënda dyke ndezur zjar mbi Suljotët e brëndëshmë të cilët si e panë që dotë vritëshin të gjithë duall nga një mazgall' i kullës dhe muar rráhon përpjetë. Po përpjekja m'e madhe ish beteja nërmjet

grykavet të Kuçit dhe të Birit nek të dy palët adversore një-kombas shprovuan trimërinë. Aty ishin mbledhur gjithë Suljotët edhe po prisjin ushtërin' e Ali Pashës, e cila dyke harijtur u vërvit kundrë ngushtinave të para ku passi shtinë ndë dore disa pozita të shëndosha ndënjtin të prëhen pak-herë edhe përsëri të pa-mbajtshëm u turrë kundrë fortesimeve të Suljotëve ndë pozitat e Qafës. Zjarri i paprajtur dhe i përgjakshëm i përçau rrjeshtat e Suljotëve, po prapë muntnë të rezistojnë ndë pritat e forta mjaft orë, aqë sa turrjet e vërtikshme t'Alipashaliasvet ishin pa efekt nga që s'muntjin t'u zbulojnë ballët e tyre dhe nga ky shkak edhe zjar' i Suljotëve të vendosur në brinjët e shkëmbënjvet i hante shëmtuar të këtëjsmit. Beteja po zgjatej disa orë dyke-mos-u dhënë rast Alipashaliasvet të bëjnë çap përpara dhe e sosmja, zhegu i vapës edhe ashpërimet e luftës i nguti të dy palët adversore të kapitur t'a rreshtin dyfegun. Ndë këto çaste si përmëndin gojdhëniet u tfaq një episod i cili inflluencoj krizën e luftës; Grat' e Suljotëve të përikura ndëpër shpellat e Qafës dyke-mos-dëgjuar më klithmat dhe brohoriët e luftës u shkoj mëndja që ushtarët e Ali Pashajt dotë kenë hyrë ndë ngushtinat andaj dyke-u-formuar ndë një trumbë u turrë për nde vëndi ku kërciste pushka, edhe dyke-flakur dhe rrungullisur befas gurrë të mbëdhenj përmi Alipashaliasit i ngutnë të prapsen pak hapa. Atëhere Suljotët dyke-përfituar çastin psihollógjik, rrudhë dhe ata me jataganët xhveshur dyke ndjekur adversórët të cilët zunë të ikin të parrjeshtë edhe më tepër kur papandehur i atakój një tjetër trumbë Suljotësh të pshehur ndë méjet e rrëzavet të një mali. Ndë këtë prapsje thuhet se ushtëri e Ali Pashës pësoj humbje të mëdha; gjër më 300 përmëndet numur' i të vrarëve dhe të të plagosurve. Nga Suljotët 80 ranë të vrarë edhe përmi 100 të plagosur. Midis të vrarëve përmënden Kiço Xhavella i cili u vra ndë një kullë përjashta ngushtinës bashkë me 16 shokë.

Ali Pashaj po pritte lajmet e përfundimit luftës ndë Bogorçë, edhe passi i mësoj, ngrihet dhe shkon

ndë Janinë dyke-lënë një fuqi të mjaftme ndë kufiret e Sulit. Kështu sosi e para shpeditë kundrë Suljotëve. Si harrijti ndë Janinë, Ali Pasha ishte afërmënç që s'munt t'a lente këtë çështje pazgidhur, po duke nërmejtuar që s'ishte rast i posaçëm për masa ekstréme çoj nër 'ta kasnecë njerës besnikë të cilët pas shumë biseda me Suljotët, lidhën traktat me kondita të hirëshme për të dy anët.

Që nga marëveshj' e sipërme kaluan disa vjet nër të cilët Suljotët ndënjtin, sidomos, të qetë. Ali Pasha u përmbushi gjithë lypjet dyke-u-dhuruar edhe mjaft selishta fushe që të mundjin të përmbahen. Po passi siguruan gjithë ç'u duhëshin, pas jo shumë kohë u rhyn grindje ndë farrë. Dy vjet pas traktatit të paqës kur vdiq Bajraktari Llambro Xhavella i cili me që edhe nga fisi edhe nga cilësit' e tij quhej si i ligjëshmë kryetar i Tribit, Suljotët prokllamuan ndë vënt të tij të birë Foto Xhavellën, i cili ishte nga mosha akoma minór. Ky preferim na e hidhënoj plakun luftar Suljot, Jorgji Boçarin i cili dhe ay çquhej nga fisi edhe nga trimëria; ky duke-kushideruar vethen si të degraduar se thoshte, që gradi që i-u dha Fotos i meritonte këti si më plak, mori mërië të madhe edhe iku nga mbledhja dyke-u-kanosur që s' dotë lente dy gurrë bashkë ndë Sul, edhe vajti ndënj mjaft kohë ndë pshatin Katund' i vjetër; aty jo vetëm që s' përzihej ndë as-ndo-një çështje të Tribit, po si dotë shohëm hyjti dhe ndë marëdhënie me Ali Pashën.

Ali Pasha mbassi me Suljotët mbaroj përnjimend, ktheu atencjën e tij mbi të tjera vënde të sundimit tij tek ishin tfaqur kompllote kryengritësë kundër tij. Të tilla lëvizje kish kupëtuar ndë përqarkjet e Çamerisë. Disa bejlerë dhe agallarë, grabitës të gjindjes së ngratë, dyke-parë fuqin' e 'ti që po shtohej nga dit dhe duke-ditur që ndënë sundim të tij s' dotë kishin lëmën e ngahershmë, po bëjin marëveshje midis 'tyre dyke-ngacmuar edhe Suljotët që t' i kenë aliatë. Përveç këtyre, edhe fqinjët sundimtarë. Pashaj i Beratit dhe i Delvinës e shihjin me sy të keq madhimin e 'tij, dyke-ndihmuar ç'do armik

të Ali Pashës. Andaj, Ali Pasha dyke-parë që, i qarkuar prej kaqë shumë armiq nuk' mundej t' i mbërrinte dot qëllimit të tij, ftoj disa nga parësi' e vëndit, edhe passi u numëroj qëllimet e nallta po dhe të mira për vëndin, i bindi të jenë me krahun e tij. Edhe ndë kohët kur ndënëmihte kundër sundimtarit të Beratit, Ibrahim Pashës, m'anë tjatër kish hyrë edhe ndë tratative mblesërore me 'të. Ndë Gusht të vitit 1793 vloj dhe mori të dy bijat e Ibrahimit për bijt' e vet Velinë dhe Myhtarë. Ky nërmartés e qasi me kompetitórin edhe i pruri shumë dobië ndë pllanet e tija për të pritmin.

Ndë periudhën kur Ali Pasha ngrehte pllane për indepëndèncën e vëndit që kish' ndënë sundim, jo shumë lark kësaj shkene konduktohej Pashallëku i Shkodrës. Sundimtari Kara Mahmud Pasha dyke ndjejtur vethen e 'tij mjaft të fuqizuar për t' i bëjtur-ballë Suveranit të tij (*Sulltanit*), edhe tue-bashkëpunuar me disa Bajraktarë të Shqipërisë Sipërme, nalltoj flamurin e kryengritjës kundër Portës [1]).

Kara Mahmudi e kushideronte vethen e tij si deshqendant të Skënder Begut; sundonte pothua pjesën më të madhe të Shqipëniës Sipërme, edhe ishte si një suveran gjymës-independent. Pra, nërmjet Pashallárëvet të Rumeliës që u urdhëruan prej Portës që të përmarshojnë kundrë të ndërkryerit ishte dhe Ali Pasha, i cili me vrap më 1794 passi rekrutoj një trup të math ushtërie (mídis të cilëvet edhe shumë Kapedanë të krështerë me shokët e tyre), marshoj së pari kundrë Kara Mustafa Pashës Ohrisë, i cili ishte aliat i Kara Mahmudit Shkodrës.

Passi theu edhe ndoqi vigorisht kryengritësit e

---

1) Këng' e marshimit Portës kundër Kara Mahmud Pashë Shkodrës me 1794 (Mbleta Shqiptarë, Th. Mitko, faqe 152).

*Endëni mendra, çelni mendra,* *A merret kala me shkallë?*
*E zeza Shkodrë ç'ka brënda!* *More halldup shallvare-gjânë,*
*Tre Vezira, por si qëna!* *Çaushollin qaj-e me lot,*
*Mahmud Pashën me levenda;* *Zoqt' e malet e havasë,*
*Tre Vezir' e njizet pashanj,* *Të shkoj gjâja e kryet sod.*
*Të gjith' ishinë të marrë,* *Të vrau aht' i fukarasë!...*

fortesuar ndë Korçë dhe ndë Ohri, i shtiu ndë dorë këto dy qytete edhe pushtoj gjithë pozitat e fortesuara t'armikut. Ndë këtë sukçes betejash Ali Pasha mori prej Sulltanit titllin «Asllan» d. m. th. Luan.

Po sukçeset që kurorëzuan armët e Ali Pashës, nuk ngjau gjith' ashtu dhe me ushtëritë Sulltánase që ishin vërvitur kundër Krejit të revollucjës, Pashës të Shkodrës. Ushtëria Anadollake që luftonte Kara Mahmudin më ç'do anë u dërmua dhe u shtyp prej trimave Shqipëtarë të Shkodranit aqë shëmtuar sa pas di-ca beteja të përgjakshme, Pashallárët e Rumelisë më s'ditnë nga të përprasen, prapo triumfonjësi Kryekumandan ndë ballë të Shqipëtarëvet të tij dykendjekur këmba-këmbës ushtërit'e Sulltanit shkeli gjer ndë Maqedhoni dyke-u-kanosur që dotë baresë edhe kundrë kryeqytetit të Perandorisë. Port' e Nalltë erdhi ndë një shtet aqë të dobët, sa u ngut, (dhe si-kur-se duket nga frika se mos Kara Mahmudi kishte marëveshje me Ali Pashën e cila harrinte vetëm të ishte edhe hyrja triumfóre e të dyve në kryeqytet ish e padyshimtë), ndë çastin e kritikshëm jo vetëm t'a amnestojë atë edhe kompliqët etij, po i kónferoj edhe gradin e Valiut Rumelisë bashkë me postin që kishte.

Pas mbarimit të përmarshimit që përfundoj me përkuljen e Portës së Nalltë u kthye dhe Ali Pasha me ushtërin'e tij ndë Janinë. S'mbetet dyshim që këto ngjarje të cilat i vigjëlloj me syt'e vet, i ndihmuan mjaft për trajtimin edhe kultivátën e farës t'independencës edhe ndërkryerjes kundrë Dovletit me që kishte aqë prova të gjalla për ngathësiën e guvernës Ottomane.

Sundim'i Ali Pashës më 1796 ndehej gjer ndë viset mesditësë t'anëdetjes Toskërisë, po disa katunde anë-detëse ishin në duart të Venecjanëve dhe të Pashajt të Delvinës. Prapo krahina e Nartës me buzët e mëngës së saj që ishin pronj'e Perandorisë edhe quhëshin të mëmës-perandoréshë (Validé Sulltanës), qeverisej prej një vojvodë i emëruar prej Stambollit. Ali Pasha në pllanet e tija për t'u përxgjeruar kishte nevojë do-e-mos për rrugë-daljë ndë det, për një liman pronjak si kur-se edhe për një

flotillë e cila i duhej për qëllimet e mëtejsme të tija. Andaj pra atencjën e tij e ktheu pik-së-pari te Vojvodllëku i Nartës si më i udóbëshm për t'u pushtuar, edhe me nërmjetimet e miqvet tij ndë K/pojë pas kohe mundi t'a pronjësonjë edhe këtë vënt.

Passi u bë zot i Mëngës të Nartës nuk vonoj të trajtonjë ndë arsenall të Nartës një flotillë prej disa anije lufte, ndë të cilat Kapitanët edhe naftërit i kishte të gjithë të krështerë.

## KREJ VII.

Ndë këtë periudhë kohe, afër Epirit po bëhej një ndryshim politik që kishte të bënjë jo pak ndë Shtetin e Ali Pashës.

Prishja e Statu-quo-së ndë Evropën qëndrore që u bë me mjet të kryengritjes së madhe të Francës edhe sukçeset e armëvet Frënge ndënë Gjeneral Bonapartin, efektuój edhe përndarjen e Demokratiës Venetikut, pas së cilës me mjet të traktatit të Campo-Formio-s nisiat Joniane që kishin Venecjanët hyjin ndënë pushtin të Frënqvet. Direktoràti i Përgjithëshm Frënk emëroj për administrator të vëndit pushtuar Gjeneralin Gentili, i cili nalltoj më 5 Korrik 1797 flamurìn tri-ngjyror mbi fortesat anëdetëse të Toskërisë si ndë Pargë, Prevezë, Vonicë dhe ndë Vuthrot. Këto dependenca të Shtetit Jonian kishin një importancë të madhë për demokratinë Venetike, jo vetëm politike dhe tregëtare, po edhe ushtëriake; I mbrami Proveditor i Statnisiave, Witman-i, ndë vitet e fundit t'administratës tij tue-mos-patur fuqi të mjaftmë per të përprapsur armiqtë që kanosjin Shtatnisiat, pat marë ndihma të mjafta prej popullit Toskërisë. Bregdetas (Himarjotë) kishte 800 burra luftarë ndënë kumandë të Vasil Priftit, Pargjotë 120 burra, Vonicjotë 500; gjith-po-ashtu proporsionisht i ndihmuan flamurit të Shën Markut edhe Suli dhe Preveza. Kësi-farësh me mjet te fuqisë armëve gjer nd' atë kohë i mbante lark detit Pashat e Kontinentit. Që nga beteja navale e Nebahtit ndë të cilën

u dërmua krejt fuqia maritime e Tyrqve, as një vapor lufte i Tyrqise nuk kish dëpërtuar ngushtinat e Korfuzit, edhe kështu e kishin ndë dorë lirin e deteve, të Ionisë edhe t'Adriatikut.

Ali Pashaj i paravëzhgoj shpejt-e-shpejt ndryshimet politike që u bënë edhe dobimet që munt t'i vijin pas fqinjëzimit të tij me Frënqtë; andaj pra vrapoj të vinjë ndë marëveshje me Komiserin frënk duke-u-shfaqur partizan i flagët i adoptimit të kanuneve të Francës, e. t. j. M'anë tjatër edhe Bonapartit i cili ndodhej krye-gjeneral n'Itali, pa harijtur ushtëritë Frënge ndë Shtatnisiat, me mjet të agjentit Konsullor të Francës ndë Nartë zotniës Duprè, i çon një letrë tue-i premtuar tratime miqësorë [1]). Ali Pasha

---

1) Letr' e Ali Pashës mbë Napolon Bonapartin e datuar më 1 Qërshor 1797.

«Respekti edhe venerata që ndjenj mbë ju, Gjeneral, edhe mbë kombin t'ënt të math e të pushtetshëm, më bëjtin që të mbilyp miqësiën tënde. Dyke-gjyrmuar shëmbëllin e monarhut t'im, përmbush dëshirën e përzëmërt që ndjenj. Prova të ndjenjavet sinqërshme kam dhënë përherë nër gjithë bashkëqytetarët t'uaj, të cilët pata fatin e mirë t'i njoh brënda ndë vëndin e sundimit t'im, edhe veçanërisht ndënë-konsullit t'uaj të këtushmë, zotniës Tozoni edhe agjentit t'uaj ndë Nartë, zotniës Duprè. Këta u ndodhë dëshmimtarë të gëzimit t'im kur mësova vitoriat t'ënde, edhe të urimevet t'ime të kulluara për proshperitëtin e demokratiës.

Të mëdhajat punëra t'ënde heroike, Gjeneral, të cilavet u habitem bashkë me gjithë botën, gërmojnë tek unë dëshirën që të kamatonj miqësiën t'uaj personale, prapo takuarja e zëmërheqjave t'ona luftare, është garantië e sigurt për mua që do t'e fitonj miqësiën t'uaj.

«Dotë jetë shumë e kënaqësme për mua të mar një provë të vogël për këtë, edhe të shtrëngonj më ngushtë lidhjet miqësore me heróun e Francës; edhe ndjenj një të vërtetë volëndim kur pranonj edhe përkrah cilin-do frënk që të hynjë ndë kufiret e provincavet t'ime.

«Këto ndjenja, Gjeneral, më japën kuxim të kërkonj prej teje hirin, që të më huash për një ose dy vjet, dy mësonjës të vlefshëm të artilérjës edhe dy bombardistë, të cilët dua të jenë kurdoherë ndënë urdhërimet t'ënde. Të lutëm pra t' i dërgosh ata me mjet të Zotniës Dupré, mbë të cilët dotë jem i përgjegjshëm si-kur-se edhe për shpagën e shërbimevet tyre të mira, edhe dot jem përgjithëmonë mirënjohës për këtë hir. Dëshëronj prej shpirtit, Gjeneral, të më ttaqet koha e rastme që të munt të të jap, prova të veneratës edhe të devotimit t'im».

shpërente që Krye-gjenerali frënk mundej t'i ishte i dobishëm ndë dispozitat pushtonjëse të cilat «Luani» i paravëzhgonte nër bërjet e tija d. m. th., për të pronjësuar di-ca ose të gjitha qëndresat e anëdetjes Toskërisë të cilat tjetër herë ishin të Venecjanëvet.

Napolon Bonaparti, edhe me proponim të tij Drejtoráti i Parisit pas pushtimit të nisiave Ioniane edhe pas hyrjes vitorëshme t'ushtërive Frënge ndë Dallmati, filluan të ngrehin më flashtë pllanet për pushtimin e gjithë Sinisiës Ballkanit; këto pllane më von muar mish e éshtra me anë të marshimit për n'Egjyptë, (1798) [1]) edhe pas proponimeve të cilat Bonaparti si Perandor i Frënqvet, i shtroj aliatit tij Perandorit, Rusiës Alexandrit I-rë. Nga këto shpjegohet promptituda që tregoj Gjenerali frënk për të ardhur ndë marëveshje me Ali Pashën të cilin dhe si sundimtar të një vëndi që fqinjëzohej me të ndë Shtatnisiat, qëllonte t'a ketë dhe organ që t' u shërbenjë qëllimevet të tija politike ndë gjëndjen që ndodhej atëhere shteti Ottoman; përandaj edhe letrën që i çoj Ali Pasha, Napoloni e botoj ndë gjith' organët e shtypit atëhershëm, prapo administratorit të Nisive Ioniane, Gjeneralit Gentili i urdhëroj të dërgonjë te Ali Pasha një kasnec i cili t'i tingëllonjë dispozitat e tija dhe t'a shoqëronjë atë ndë interesat e Francës. Bonaparti dyke-parashikuar rrukullimin e Shtetit Ottoman, ngulmoj për pushtimin e nisiave

1) Marshim i Napolonit I-rë kundrë Egjyptës. (Mbl. Shqipëtare, f. 154).

*Ingjilizi orgjyn detit,*
*Shartin Frënqëvet u-a çarti,*
*Stamboll i bani zâ mretit,*
*Hap-e syn' e bânu gáti.*
*Gati seferin çil-e,*
*Se me tynë jam i ngrati,*
*Francezin e ke me hile,*
*E po t' bie Bonapàrti.*
*Francezi me gra e burra,*
*Ndë Misir vajt' e u derth,*
*Bonapartit i pështoj shurra,*
*Kur e shtini Turku ndë rreth.*
*Ingjilizi Turkut i-u ba shoq,*
*Me-i arth hakut ktii dushmanit,*
*Nd' Abuqir donâmën i-a doq,*
*I zaptoj gryken e limanit.*
*Edh' ay Nemce i ngrati,*
*Po ruan si mica minë,*
*Pa de, se ç' bân Bonaparti,*
*Me i këcye Turkut mbë shpinë.*
*Edh' ay Moskof lanèti*
*Thotë Turkut jam me tynë,*
*Gjidinë e rraftë deeti,*
*E gjettë mbë Perëndinë,*

Ioniane edhe për të tjera qëllime, po veçanërisht, që të ndodhet përanë shtratit të lëngonjësit që të muntnjë, ndë orën e vdekjës, të marë pjesën që i bie.

Pas ca kohë vjen ndë Janinë préj Korfuzit kasneci Brigadieri-gjeneral edhe azhutant i Gjentilit, Z. Rosé, të cilin Ali Pasha e priti me gëzim të math dyke-i-bërë gjithë nderimet që meritojin njëj kasneci te dërguar nd' emër të Bonapartit. Kasneci frënk, nuk pandehu duket me kë ka të bënjë edhe nga faktet e tija duket që vepëroj me paméndësi, përandaj së shpejti ra ndë trap t' Ali Pashës, i cili dyke-përfituar nga ngathësi e atij e lajkësoj që ka për të qënë përgjithmonë miku i Francës. I tregoj ati për ndalimet e padrejta që patnë ata dhe ay ndë kohë të Venecjanëvet për të dëpërtuar ngushtinat, edhe i lypi që Guverna Frënge t' i apë lejë përlundrimi ndë ngushtinat edhe t'i çedojë ati Vuthrótin. Më pas i dekllaroj që si shpërblim të këtyre dotë jetë i lumur t' u furnizojë gjithë ushqimet edhe të tjera posaçië të Korfuzit, punë e cila ishte shum' e rezikshme për Frënjqtë nga shkaku i sipërtendèncës të flotës Inglize. Kasneci frënk i premtoj Ali Pashës që do t' i-a shtronje pretencjat Gjènëralit Gjentili, edhe pas një dit u kthye prapë ndë Korfuz i kënaqur prej hospitalitétit të fqinjit të ri. Pas ikjes të kasnecit, Ali Pasha u dërgoj Frënqvet të Korfuzit ushqime me të tepër, nër të cilat 500 qè te mirë edhe 200 deshinj; gjith-po-ashtu i furnizonte të ngrëna edhe flotillës Frënge që ishte ndënë kumandë të Admiralit Bruys.

Kasneci Rosé passi ardhi ndë Korfuz i komunikoj Gjentilit një-për-një kuvëndimet me Ali Pashën sikurse edhe kërkimet e tija, po Gjentili dyke-u-bërë m'i shkathët nga azhutant' i tij i dërgon Bonapartit dyke-i-shpjeguar proponimet e Ali Pashës të cilat i kushideronte të dëmshme për interesat e tyre, edhe Bonaparti i-a aproboj vërtet mendimin e tij që nuk lipset t'i bëhet asnonjë çedim ndë tokën e interesavet të Francës, po shtonte që Franca kurrë nukë dotë shihtë me sy të keq madhimin e fuqiës Ali Pashës, mjafton vetëm që ajo të mos bëhet për dëm

të Francës [1]). Ndë këto fraza të letrës dyke-parë Gjentili dëshirën e Bonapartit përmi lejën a dëpërtimit ndë ngushtinat, i-u përgjeq Ali Pashës dyke-i-dekllaruar që Guverna Frënge i ep lejë të plotme përlundrimi ndë ngushtinat.

Të tilla pra ishin dispozitat e Autoritétevet Frënge ndë Korfuz, kur ndë prëndverë të vitit 1798, Ali Pasha vendoj të shkelnjë Bregdetin (Himarën), nga arësyet që dotë shohim më posthë.

## KREJ VIII.

Ndë anëdetjet e Labërisë, ndë një sërth-malesh, banonte një fis Shqipëtarësh të dëgjuarshëm për trimërit' e tyre. Ky fis (trib), ishte Bregu-i-detit, (Himara e athershme dhe e sotme). Ndë këtë vënt vlukojin asi kohe katundet Shën-Vasili, Nivica, Llukova, Sinica e. t. j., të ndënurdhruara, formalisht vetëm prej Mustafa Pashë Delvinës. Arësyet armikësore të Ali Pashës kundër Bregdetasvet u javitnë nga shkaku se ata përkrahjin me mish-e-shpirt Pàshën e Delvinës, i cili i ngacmonte të bëjnë kryengritje kundër Ali Pashës. Me gjith' atë, ky u pat proponuar disa herë të rinë të qëtë dhe të mos u mbajnë-vesh intrigavet të Mustafa Pashës, po proponimët e keti nuk' i-a pranuan, edhe tentativat e tija që të shkelnjë Bregdetin nga an' e tokës kotësohëshin nga çetat kryengritëse të tyre, Përandaj pra, pas marëveshjes me Frënqtë, vendoj të vërvitet kundër këtyre çetash nga an' e detit duke-shkuar ndëpër Korfuz. Kështu, kuqendroj ndë Sallahòrë një trup prëj 12,000 ushtarë ndënë kryesi të Isuf Arapit, të cilët hipnë fllotillën edhe dyke-lundruar ndaj anëdetjeve të Bregdetit, debarkuan pranë katundeve Shën-Vasil, dhe Nivica, ndë liman' e vogël të Llu-

1) Është interes' i Demokratisë, thoshte letr' e Bonapartit, që Ali Pasha të pushtonjë një vënt të math, që të muntnjë t'i përkulnjë gjith' adversorët e tij, edhe kështu të muntnjë të bëhet një suveran i fortë, për t'i prurë shërbime Demokratisë t' one.

kovës. Passi zbritnë ndë tokë, Isuf Arapi dërgoj ndëpër katundet disa kasnecë ndek i ftoj Brekdetasit të vijin ndë marëveshje me 'të n' emër t' Ali Pashës. Po ata ndëvënt që t'i epjin përgjigjie, vranë dy nga kasnecët kur të tjerët passi me-zi shpëtuan vajtën dhe i dhanë zë Isuf Arapit për gjithë të ngjarat. Dyke-dëgjuar këto Isufi u mbush ndë mërië, edhe passi pjësëtoj ushtërin' e tij mbë dy detashàta, u vërvit kundër turmavet hryengritëse të cilat i shpërndau dyke-vrarë disa qindra prej 'ta; kryengritësit e Shën-Vasilit të ndjekur prej Isuf Arapit hyjtin ndë një kishë, edh' aty u ndes një betejë e përgjakshme midis Bregdetasvet dhe Alipashaliasvet, dhe pasi u vranë dhe u plagosnë nga të dy anët mbi 2000 shpirt, kryengritësit dyke-pare që rezistenca e tyre ishte e kotë, ngritnë flamur të bardhë për shënjë faljeje edhe u përdhanë nër duart' e Isuf Arapit[1]). Nga rrobërit 14 Kapedanëve u prenë kryet, edhe të tjerët u prunë ndë Prevezë. Përfundim i përkuljes të Bregdetit ishte përngulj' e Ali Pashës ndë anëdetjen e kundrejt Korfuzit me mjet të pushtimit të disa pozitavet strategjike, nga të cilat Manastir' e Shën-Vasilit e kështjellój një-me-një, edhe ndaj limanit të gjërë të Panormit ngrehu fortesë; kësi-mjeti i-u qas èdhe më afër limanit bukur të Sarandës.

Mustafa Pashë Delvina, kundër të cilit dreqtohej politik' e Ali Pashës, me urrejtje të madhe vëzhgonte që Port' e Nalltë e gjeti të mirë lëvizjen e armikut tij dhe jo vetëm kaqë, po edhe e nderoj

---

1) Betéja e «Shën-Vasilit» mbas Muzës Popullore:

*Kur ish tetë-qint seneja,*
*I dergoj Mehmush Kahpeja:*
*Ali Pashë ngreu eja,*
*Se ngriti krye raèja.*
*Falu, ó Shën-Vasil i shkretë,*
*S'falemi sa jemi vetë;*
*Ç'e pandeh ó Ali Pàsha,*
*Se mos jemi gra nga Narta,*
*Edhe djem nga Gjinokastra,*
*Të lonjç ti me ta nga nata?*
*Ne jemi Kapedanàta,*
*Major Lima kordhë-shpata,*
*Spiro Buti qafë-gjati;*
*Thotë Kapedan Sokrati:*
*Të mbahi, ó burra, mbahi,*
*Se u trëmp Ali Pashaj;*
*Dërgoj te Veli Agaj.*
*Veli Bè Tripolicanë,*
*Të dërgon Karaiskaqnë,*
*Gati i-a bëjti ordhinë,*
*Asqer dymbëdhetë mijë.*
*Të rrethosnjën Shën-Vasilë,*
*Nivicën dhe Bubarinë.*

atë dyke-i-oferuar me dekret miemërin *Asllan*, me anë të të cilit gjithkohësh urdhërohej te marë pjesë ndë marshimin kundër Pashës të Vidinit.

Ndë kohën kur ndë Toskëri ngjisjin ato që treguam, ndë Bullgari, ndë buzët e Tunës çmbështillej një nga shkenat nga të cilat është rrafshë Historië e Shtetit Ottoman ndë shekujtë XVII edhe XVIII. Një nga Pashat e fortë të Sinisiës Ballkanit, Sundimtar i Vidinit, Pazvan Ogllua, kishte nalltuar flamurin e kryengritjes kundër Suveranit tij, edhe i kështelluar ndë fortesat e pakuqeruëshme të kryeqytetit të tij, shkelmoj autoritétin Sulltanik. Me që pat ushqyer që prej kohësh qëllime për independencën e Pashallëkut të tij, kishte organizuar ushtëri të mjaftme, edhe fortesën e Vidimit e kishte tedarúqur me municje edhe ushqime për një rrethim të zgjatshëm.

I tillë ishtë i ndërkryeri, përmbi të cilin Porta çoj ushtëri të madhe ndënë kumandë të disa Páshavet t' Anadollit dhe të Rumeliës, me Krye-gjeneral Qyçyk Hysen Kapedan Pashën, Vezir' e Math të athershëm. Afër-mënç që ndë këtë marshim me rëndësi u urdhërua edhe *Luani* ynë të marë anë. Ali Pasha passi mblodhi një trup prej 30,000 Shqipëtarësh, u nis për ndë Vidin ndek u bashkua me restin e ushtërivët Perandoráke që rrethosjin Pazvan Ogllon. Po, ose nga shkaku i fortesavet të pakuqeruëskme të Vidinit, ose nga ngathësi' e Kryegjeneralit, ose nga grindjat edhe përçarjet që zotojin ndë rrjeshtat e rrethonjësvet, ose fundja m'e mundëshme, nga të këqiat ndë të cilat përshkonte nd'ato kohë Porta prej ndryshimit që po merjin punët nd' Evropë pas marshimit të Napolonit nd' Egjyptë, marshimi kundër Páshës të Vidinit po navigonte dyke-u-zgjatur rrethimi mbi tre muaj. Me gjithë që rrethimi po vazhdonte akoma, Ali Pasha mori lejë dhe shkoj me nxit prej ushtrinës së përgjithëshme dyke-marë pas gjithë trupin ushtëriak të tij edhe erdhi ndë Janinë. Shkakun e të kthyerit me kaqë link, di-ca nga shkrimtarët e jetës tij i-a shtien që ishte intrigë e organevet të Napolonit, i cili dyke-



NAPOLON BONAPARTI

Perandór' i Frënjqvet

Miku i Ali Pashës po edhe áqë herë ndë konflikte me 'të.

BKSH

pllanuar shpeditën kundër Egjyptës, dhe dyke-paravigjëlluar që dotë ndéshej ndë luftë më Portën, i epte dorë t'a majisnjë luftën e Vidinit që të zgjatej rrethimi. Të tjerë thonë që Ali Pasha iku prej ushtrinës se u ndrojtësua që Sarasqeri kishte qëllime të liga kundër jetës tij, nga shkaku që námëta Ali Pasha kishte marëdhënie me të ndërkryerin. Po nga të dyja, gjan qe e para të jetë e vërtetë, se edhe përpara se të marë urdhërimin prej K/pojës që të marshonjë kundër Pazvan Ogllos, Ali Pasha nga marëveshjet e tija me Frënjqtë si dotë shohim më poshtë, parëndjente që Bonaparti krijonte pllane pushtonjëse kundër Shtetit Otoman; ndë kohën që ndodhej ndë ushtrinë kishte korespondencë të rregullshme me Janinën edhe me gjithë Toskërinë, andaj më t'u lajmuar prej njerësvet të tij mbi vepërimet e Frënqvet, do-s'do edhe me vrap u kthye ndë qëndrën e Sundimit të tij.

## KREJ IX.

Folmë më lart përmi dërgesën e kasnecit Rosé, edhe për shpërblimin e Autoritétevet Frënge mbë sjelljet miqësore të Ali Pashës. Passi kaloj ca kohë pas përkuljes të Bregdetit, Ali Pasha u ngrit e vajţi për të vizituar pushtimet e rá edhe si u rrëzua pranë Vuthrótit ftoj me letrë administratórin e ri të Shtattnisivet gjeneralin Chabot për një bashkëfjalim, me qëllim t' i nxonitnjë Frënqtë t' i çedojnë Vuthrótin. Gjenerali Chabot i dërgon azhutantin e vet Kapitanin Cheffer të cilit i ngarkoj misiunën që me ç'farëdo mjet t'a këshillonjë Ali Pashën që jo vetëm të mos marë pjesë ndë marshimin kunder Pashës të Vidinit, po edhe t'i ndihnjë ati dyke-marshuar kundër Portës. Ali Pasha i dekllaroj kasnecit Frënk dyke-i-u-anëkuar që, autoritétet e Korfuzit si pas premtimevet të dhëna atij nukë përmbushnë as-një, dyke-mos-paguar as të debituarat të hamjevet që u furnizoj për përmbajtjen e flotës dhe të ushtërisë

Frënge të Korfuzit; pa kur i shfaqi qellimin e vërtetë të dërgesës tij, Ali Pasha i-u përgjeq se, si-do-që i vjen liksht t'i hidhënonjë miqt' e tij, po ësht' e pa mundëshme që të mos marshojë kundër Pazvan Ogllos. Kasneci frënk dyke ngulmuar t'a bintnjë, i thotë që nga sa ësht' i lajmuar armikët e tij rrahin t'a mërgojnë prej Sundimit të tij për të mundur t'a vdesin më udobisht. Po Ali Pasha i-u përgjeq se, posa që ka me vethe trimat Shqipëtarë, nga askush nukë trëmbej. Me gjith' këto, së sosmi i paska thënë që po t'i epnin Frënjqtë 10,000 ushtarë edhe 100,000 florinj dot' e akseptonte proponimin; me që Cheffer-i doj t' a rrente me shpresa fyle dyke-i-thënë që Gjenerali Chabot s' mundet t'i premtonjë një gjë të tillë, po Guverna Frënge pa fjalë dot' i-a pranonjë, atëhere Ali Pasha duke-dhelatuar Cheffer-in i thotë: «Frënqtë më kanë premtuar shumë, edhe mbase munt t'u zeja-besë po të më bëjin ndonjë mirëbërje, të pakën dyke-më-çeduar Vuthrotin, për të cilin kam nevojë të madhe, po gjer tani vetëm ndë fjalë u përcaktuan, andaj kupëtoni-e vetë juve ndë është se mjaftojnë vetëm fjalë ndë argumentin që më instigójnë». Pas këto, kasneci frënk u nda prej Ali Pashës.

Politika frënge pas qëllimevet që mëkonte mbë Sinisiën e Ballkanit kishte nevojë të madhe dhe lipsej t'i mbushte dëshirën një njeriu aktiv edhe i zoti, sindëkur e pati provuar me vepra Ali Pasha, po ata qëllojin t'a kobojnë me dipllomati. Përandaj ky dukeparë kështu, mori masat e posaçme për të mos rënë të pakën vetë ndë trap të Frënqvet. Me t'u kthyer prej bashkëkuvëndimit me Kapitanin Cheffer, komunikoj ndë K/pojë gjithë kompllotet e Frënqvet. Bonaparti nuk' ishte kapërxyer akoma nd' Egjyptë, edhe rellatat nërmjet Francës dhe të Portës ishin édhe miqësore, përandaj komunikatat e Ali Pashës s' u pritnë me nxehtië ndë Konstandinopojë.

Po Ali Pasha dyke-u-bazuar ndë kállkullat e veta nukë mbet' i plogët, po me aktivitét filloj pregatit-

jet e tija edhe ndënë të tilla kujdese dhe parëndjenja marshoj sikurse thamë, kundër Pazvan Ogllos.

Nermjet këtyre Gjeneral Bonaparti duke-ubërë zot i Malltës, po pregatitej te marshonjë kundër Egjyptës, po dyke-shkuar nër mënt që Porta nukë dot' e shihte me indiferéncë invazjen e tij kundër një province të saj, ndë këtë rasë e kujtoj përsëri Ali Pashën të cilit vërtet i-a dinte dëshirat e tij për independencë, po pa njoftur dispozitat e vërteta të tija mbë Frënjqtë, po vij akoma me shpresë që Tepelénasi dotë ndërkryhej për hir të tij kundër Suveranit. Për këtë dërgoj azhutantin Lavallete ndë Korfuz me nje letrë autografe [1]), edhe gjithkohësh me porosi t' i shtronjë Ali Pashës proponime pozitive, që d. m. th., Bonaparti e zaptoj Malltën edhe mbassi tani ndodhet nd'ato ujra me 30 vapore lufte edhe me 50,000 burra, dëshëron të bënjë marëveshje me 'të edhe të dijë ndë munt të ketë besim për këtë ; që përveç kësaj dëshëron të ketë tek ay njeri zyrtar të besimit tij, dhe që për hir të shërbimevet dhe mirëbërjevet q'u bëri Frënqvet, e ka në dorë, po t'i tregonjë besnikëri dhe po të dojë të bashkëvepërojë me të, t'i-a bënjë të pritmin e tij shumë më të lavdëruarshëm. Po thua se n'ato dit edhe

---

1) Letr' e Napolon Bonapartit mbë Ali Pashanë: —
I mbiveneruarshëm miku im, dyke-ju oferuar lutjët e mija për proshperitetin t'uaj dhe përmbajtjen e ditëvet t'uaja, mar nderin t'u informonj, që prej shumë kohe m'është bërë e njoftun dashuria juaj mbë Demokratinë Frënge e cila me qënë e tillë më gërmon dëshirën të di mjetet për t'ju dhënë prova të reshpektit t'im mbë ju. Dyke-kujtuar rasën e pritur vraponj t'u shkruanj prezentën letrë miqësore, të cilën pas porosiës t'ime dot' u-a ndorëzonjë një nga azhutantët e mij, i cili përveç kësaj mori dhe misiunën t'u shtronjë dica proponime. Me qënë që nuk' e di gjuhën t'uaj, mirëhirështoni të thëritni një dragoman (interpret) të besës dhe të sigurshëm, që më mjet të atij të kupëtohet me ju. Lutem t'epni besim të plottë për çfarë-do që ka për t'ju komunikuar nga ana ime edhe t'a dërgoni atë shpejtisht bashkë me përgjigjen të shkruar tyrqisht me dorën e vetë t'uaj.
Pranoni lutjet e mija edhe sigurimin e reshpektit mbë ju.

*Malltë 17 Qërshor 1798.*

BONAPARTI

Ministór' i Marinës dhe i provincave të Francës i shkrojti dhe ay Ali Pashës nd'emër të Drejtorátit të Përgjithëshme të Parisit tjatër letrë kënaqësiash për shërbimet e mëdha q'i pat prurë fllotës Frënge.

Kur mbërini Lavallete-i ndë Korfuz, mësoj që Ali Pasha ndodhej ndë Vidin edhe e kushideroj si të mbaruar misiunën që i ishte ngarkuar. Gjenerali Chabot passi mori urdhrim që t'a çonjë ndë Janinë letrën e Drejtorátit i-a ndorëzoj atë dhe bashkë me të edhe letrën e Bonapartit azhutantit tij z. Rosé i cili sakaqëherash shkoj për ndë Janine; si hariu atje u prit me nderime të mëdha prej bijvet t' Ali Pashës, Veliut dhe Myhtarit, të cilët i kishte lënë i áti në vënt të tij, edhe passi u dorëzoj letrat, i siguroj që edh' ata edhe àt' i tyre munt të mbështéten pa fare-ndrojë ndë miqësiën dhe përkrahjen e Guvernës Frënge. Pas këto Rosé-u u kthye prapë ndë korfuz q'atë ditë; m'anë tjatrë bijt' e Ali Pashës me mjet të një renduari (*tartari*) të veçanëshm vrapuan t'i apin zë átit tyrë për vizitën dhe komunikátat e Rosé-ut. Kjo ishte ngaja që, si-kur-se pamë më sipër me sa shpejtië iku Ali Pasha prej ushrinës së Përgjithëshme posa që mori mesàgjin.

Rosé-u mbeti tepër i enthusiuar prej pritjes së shkëlqyëshme dhe nga vërtetimet miqësije të bijvet Ali Pashës, dyke-pandehur që mundi të lozë rollin e posaçmë që kur të vij dita me ndihmën e Ali Pashës të vepërojin për pushtimin e Sinisiës Ballkanit, që së mbrami t'a shtypjin dhe atë vetë. Po dhe Ali Pasha nuk' mbeti ndë mefshtië se më nj'anë kasnecin e vu ndë gjumë për miqësin' e sinqërshme që kish mbë' ta, m'anë tjatër dyke-kuptuar qëllimet e pritme të tyre dhe propagandën që bëjin ndë Toskëri me mjet t'agjentëvet të tyre, mori masat e nevojshme për ç'do posibilitét.

Ali Pasha u kthye prej Vidinit ndë Gusht (1798) edhe sakaqëherash bëjti të tjera pregatitje që të muntnjë t'u bënjë ballë fqinjëvët të Shtatnisiave për ç'do të papritur që mundej të shkakëtohej nga ata; dhe jo vetëm ushtërinë që solli nga Vidini e mbante gati për lufte, po mblodhi edhe ushtëri të re. Për-

para dica ditësh u lajmua prej K/poje për aliancën që pat lidhur Porta me Rusinë dhe me Anglinë, andaj lypi lejë prej Divanit që dyke-baskëpunuar me aliatët t' i shtjerë ndë dorë pushtimet e Frënqvet nd' anëdetjet të Toskërisë. Tani ishte dyke-pritur përgjigjie prej K/poje e cila u vonua shkaku që marëdhëniet midis Portës edhe Demokratisë Frënge ishin akoma të zvarnisura.

Frënjqtë të Shtatnisiavet nukë rijin pa kallur intriga; azhutant' i Chabot-it, i njohuri Rosé për të cilin folme disa herë, bashkë me një tjetër oficer frënk i quajtur Steil të maskuar (bërë teptil) si lypanjarë shëtitjin qytetet edhe pshatrat e Çamërisë duke-ngacmuar popullin për t'u ndërkryer kundër Ali Pashës. Agjéntë sekrétë të Ali Pashës e lajmojnë për gjithë këto kur Rosé-u me Steil-in gjëndëshin ndë Filat. Sakaqëherash erdhi urdhër prej Janine që intriganët ndënë maskë lypanjáresh të kapen edhe kështu Rosé-u bashkë me Steil-in u prunë lidhur ndë Janinë, edhe s'andejmi ndë Konstandinopojë.

Dyke-pare Ali Pasha që inflluenca e Frëqvet po shtohej, edhe më tepër ndë të grekosurit e Toskërisë, vendoj t'i vë-jë një krusm këti rreziku q'e qarkonte, edhe ndë krye të Vjeshtës II-ttë 1798, vendoj t'i goditnjë Frënjqë të Vuthrótit, për t' i dëbuar s'andejmi. Më 5 të muajit që thamë, passi kuqendroj një fuqi të mjaftë ushtarësh, u vërvit kundër Vuthrotit edhe shtiu ndë dorë gjithë kodrat edhe bregoret përqark kështjéllavet të Vuthrótit, më qëllim t' u vërvitet Frënjqvet që ishin vendosur ndë 'to.

Kryetar' i garrizonës Vuthrotit lajmoj me-njëherë Gjeneralin Chabot ndë Korfuz, i cili dërgoj me vrap një trumbë ushtarësh ndënë Kapitanin Petit, i cili passi ardhi ndë Vuthrot edhe e pa se armiku ishte i shumët, i lypi Gjeneralit Chabot t'i çonjë edhe tjatër ushtëri. Atëherë Chabot-i niset vetë prej Korfuzi për ndë Vuthrot, bashkë më di-ca ushtarë edhe me Gjenëralin Berrier që t'i vëzhgëllonjë vetë fuqit' e armikut edhe nd'e lypte nevoja t'i drejtonjë personalisht vepërimet ushtëriakë. Posa harrijtën atje, brodhë të brimojnë pozitat e Shqipëtarëvet. Po tek

écjin ndëpër një kodrë afër njëj pirgu të Shqipëtarëvet, u panë syresh të cilët sakaqëherash me klithma brohorie dhe me mjet pushkë-shkrepjash dhanë parullën e turrjes dyke-u-vërvitur kundër Frënjqvet ndë sheshin që i ndante nga pozitat e tyre, edhe kaptuan përrojin që ishte ndë mes me aqe vrull, sa Frënjqtë të tmeruar dhe nga frika se dotë qarkohëshin, filluan të ikin me link. Një trumbë ushtarësh frënjq që ishin vendosur ndë një mej për të ndálur hovin e Shqipëtarëvet, dyke-parë që dotë kapëshin rrobër, lanë pozitat, armët dhe gjithë ç'kishin, edhe muar përpjetë malit, prapo të dy gjeneralët, Chabot-i dhe Berrier-i me ushtarët që kishin pas për-fill dotë zirëshin rrobër po të mos mbërrinte edhe për pak një griq ushtarësh Frënjq të cillët i shëllbuan passi u vranë përmbi 150 veta; të tjerët u përprapsnë me nxitim ndë fortesën e Vuthrótit. Të nesërmet Frënjqtë bashkë me xhandërmariën e Korfuzit edhe me dettarët të Vaillant-it (trimit), u ranë Shqipëtarëvet nga të gjith' anët. Goditja e Frënjqvet ish' e tërbuarshmë, po Shqipëtarët qëndrojin trimërisht ndë pozitat e veta me-që nuk, ishte akoma rast' i tyre për vërvitje. Beteja u ndesh e përgjakshme midis Frënjqvet dhe Shqipëtarëvet, kur të parët epjin me-të-madhe t' u zaptojnë pirgun po s'mundën dot me gjith' që kundër atij kishin kuqendruar forca të mëdha edhe bëjtin theror shumë ushtarë. Beteja u ngjat kështu disa orë gjer u ardhi volia Shqipëtarëvet. Kur më nj'anë qëndra e Shqipëtarëvet po e rrihte me sukçes atë të Frënjqvet, m'anë tjatër, krahu i djathtë i të parëvet u turr me një vrull aqë të pandalmë që t' u përçanjë edhe rrjeshtin e mënjgjër Frënjqvet, sa rrebesh' i tyre dotë ishte i shpejtmë; po ky trup' i Frënjqvet mundi të mbajë burrërisht pozitën e vet, edhe pas shumë ashpërime mundi të bashkohet me trupin e qëndrës, edhe kur Shqipëtarët po i gjyrmojin dyke-i-goditur, Frënjqtë tani më nuk shkrepjin po vetëm mbajin rrjeshtat gjer sa hyjtin ndë fortesë.

Pas këtë shuplakë që hëngri Gjenerali Chabot prej Shqipëtarëvet të Ali Pashës, u vërtetua që ç'do vër-

vitje e përsërishme ishte e kotme me që ushtëri e tij ishte krejt e dërmuar, andaj q'atë ditë shkoj ndë Korfuz me di-ca ushtarë dyke lënë të tjerët që i mbenë për mprojtjen e kështjellës Vuthrotit ndënë kumandë të Kapitanit Dutoir. Pas ardhjes të Gjen. Chabot ndë Korfuz, ndë një këshillë ushtëriake u vendua prej Frënjqvet përzbrazja edhe ikja e tyre nga Vuthroti, pas së cilës garrizona e Vuthrotit u pru ndë Korfuz. Ushtëri e Ali Pashës pas një dit pas ikjes të Frënqvet, pushtoj fortesën dhe katundin Vuthrot.

Kështu pra filloj të përmbushet dëshira e Ali Pashës, e cila ishte kuqerimi i pushtimevet të Venecjanëvet ndë Toskëri. Pa me që Vuthroti nukë kishte importancën ushtëriake që e kishin të tjera vënde të tokës, bie fjala si Preveza, andaj tani këtejza u kthyhen vërrejtjet e Ali Pashës.

Preveza, është një qytet anëdetje, dirgjet ndë hyrje të mëngës së Nartës mb'anë njëj sinisie e mbjellë plot ullinj, vreshta, edhe gjithfarësh kopshta me pemë edhe zarzaváte. Largon distansë 2 shtadesh [1]) prej Nikopojës së moçime me famë, edhe pranë Aktiut, ndek është bërë e madhja betejë navale e Augustit me Antonin. Limani i brëndëshm' i saj që quhet Margaronë, ësthë nga më të thellët edhe është përdorur qëmoti prej Romanëvet si Qëndre navale e Nikopojës. Preveza si qytet historik përmëndet i parë ndë vitin 1495 kur e kuqeruan Tyrqit, edhe ishte një katund pa emër; këta trajtuan limanë ndë Margaronë edhe passi emigruan një shumicë të mjaftë shtëpiarësh të Toskërisë, ngrehnë edhe fortesa. Qyteti nga përparimet që bënte tërhoqi vërrejtjen e Venecjanevët të cilët kishin ndënë pushtim disa pozita të kështjéllura ndë anëdetjet e Toskërisë. Ndë luftën kundër Tyrqisë më 1499 Venecjanët muntnë t'a kuqerojnë edhe e mbajtën gjer më 1530 kur ra prapë ndë duart' e Tyrqvet; po pas ndryshimet e përsëritme që u bënë ndë luftat e gjata të tyre me Tyrqit, qytetin e shtinë ndë dorë definitiv Venecjanët me mjet të traktatit më 1717; q' atëherë e përmbajtën

1) Një shtadë është 600 metro.

gjer më 1797 kur u shpërnda Republika e Venetikut. Prevezanët rronin jo vetëm prej tregëtiës maritime, po edhe prej ullinjvet të tyre që i kishin të shumë e të mirë; edhe popull' i qytetit gjer nd' atë kohë ishte gjer afëro 16,000 ndënjës. E tillë pra ishte Preveza, kur mbi ballkonet e fortésavet të saj u ngrit flamuri frënk më 1797.

Gjenerali Chabot dyke-venduar të vizitonjë nisiat edhe gjithë dependencat, përlundroj prej Korfuzit më 15 Vjesht' e I-rë 1798, edhe kur ardhi ndë Prevezë, me habi mësoj se përpara pak ditësh një ushtëri Shqipëtare ndënë kumandë të Myhtarit, të birit Ali Pashës, kishin atakuar qytetin, po që garizona e fortesës ndënë Kapitanin Tissot i nguti të hiqen s'andejmi. Kjo ngjarj' e papritur u kalli frikë Prevezanëvet edhe se u lajmuan që ushtëri Alipashaliase ishte ushtrinuar jo shumë lark qytetit tyre, edhe me që ndë shumë raste e patnë trathëtuar Ali Pashën u rinte sikur ishin ndë rrezik, përandaj disa nga ndënjësit passi muar me vethe gjën' e lëvizme, u çatdhesuan ndë ujdhesat Lefkadhë, Pakso edhe Ithakë, për sigurim; Gjenerali Chabot për t'u dhënë kurajë ndënjësvet dhe për të siguruar qytetin nga çdo invazje, urdhëroj trajtimin e disa fortesavet përmbi kënéll jo shumë lark rrënimevet të Nikopojës; për mbarim të shpejtmë të tyre çoj prej Korfuzi dy inxhinerë Frënjq me 400 punëtorë, edhe ndë kohë të shkurtër pas pllanit tyre u mbaruan mejet e nevojshme.

Ndë kohën e ndënjtjes së tij ndë Prevezë Gjenerali Chabot bëri marëveshje me një Suljot i quajtur Kiço, i cili ishte ndënjës ndë Prevezë që kur e kishin Venecjanët; me kërkim t'Ali Pashës Kiçua ishte ekspullzuar prej Venecjanëvet s'andejmi edhe pat përikur ndë Sul, tek pas hyrjes të Frënqvet ndë ujdhesat i shkrojti Chabot-it t'i epet lejë të vinjë ndë Prevezë dyke-i-u-dhënë prapë edhe pronjat e kufiskuara.

Gjenerali frënk jo vetëm e pranoj atë me shumë shokë të tij edhe e përrjeshtoj ndë rrjeshtat e garrizonës frënge të qytetit dyke-i oferúar gradin e Ka-

pitanit, po e ngacmoj atë që të vinjë ndë marëveshje me Suljotët për një aliancë kundrë Ali Pashës.

Passi mbaroj udhëtimin e tij ndëpër nisiat, Gjenerali Chabot u kthye prapë ndë Prevezë. Më 27 Vjesht' e I-rë inspektoj punët kështjellore të trajtuara ndë Nikopojë, edhe gjet atje afro 300 ushtarë Frënq, Kiço Suljotin me 600 shokë të tij, edhe nj'a 600 Prevezanë që punojin me aktivitét për të mbaruar ato; Pastaj thëriti me shpejtië prej Lefkadhe Sogjerin Hotte të cilit i ngarkoj mprojtjen e pozitavet të Nikopojës, edhe s'andejmi vajti ndë Korfuz.

Përpara se të mbarohen fortesimet e Nikopojës, Ali Pasha Kishte kuqendruar një ushtëri prej 1600 vetash ndë Llurë, katund ndë distansë 10 killometrash larg Nikopojës, edhe po pregatitej për vërvitje kundrë Frënqvet të Nikopojës. Për gjithë këto lëvizje u lajmua me kohë Gjenerali La Salcette, i cili kishte vendosur Kartierin e Përgjithshëm që nga Zakintha ndë Lefkadhë, dhe i cili vajti me vrap ndë Nikopojë bashkë me 450 ushtarë.

Ndaj mezit natës të 12 Tetorit, Shqipëtarët ndënë kryesi t'Ali Pashës vetë, filluan lëvizjet për të goditur ushtëriën Frënge. Ushtëri e Ali Pashës e kumanduar prej birit tij Myhtarit u vërvit kundrë kështjellavet të Nikopojës të mprojtura prej të-njëjnumërshm burrash midis të cilëvet ishin 60 Suljotë edhe 200 Prevezanë. Kiçua Suljoti për të cilin U bë fjalë më lart, dyke parashëkuar rrezikun q'i pritte, pat ikur pshehtazi q'atë ditë bashkë me di-ca nga shokët e tij. Atherë të tjerët që mbenë muar armët dyke-bërë turrje kundrë armikut të vërsulur edhe luftuan me durim të mjaftë gjer ndaj agimit. Posa zbardhoj dita e cila ishtë e lagatershme edhe deti ishte i furtunëshm, dy trumba frënge marën pozitë vërvitjeje dyke-goditur me-të-keq Shqipëtarët të cilët u ngutnë të përprapsen gjer ndë rrënimet e vjetëra; po ndë këtë çast bie i vrarë Kumandani i trumbës së parë, edhe u bë blluditje ndë rrjeshtat e ushtëriës frënge gjë që e kupëtuan Sqipëtarët edhe passi bëjtin një turrje të mërékullshme kundrë 'tyre i ndoqnë disa hapa; po atëhere Frënqvet që po prapsëshin

u vjen ndihmë trumba që lëftonte në krahun tjatër, edhe Shqipëtarët e humbën vëndin që fituan. Gjenerali La Salcette, i cili dreqtonte vepërimet e betejës, dyke-vënë re që vija e frënjqvet ishte rralluar dhe dotë thyhej, u përpoq t' a mbushnjë me ushtarë të tjerë, po nukë mundi ballafaqe ushtëriës Ali Pashës e cila shkonte përpara më hov të math. Ndaj orës 8 a. m., ndek beteja dukej e dyshimshme, e gjith' ushtëri' e Ali Pashës që ishte përmbledhur mbi një çukë t' afërme edhe nga e cila një e treta ishte kalori, e kumanduar prej vetë Myhtarit, i përndau rrjeshtat e armikut edhe po çapej përpara dyke-bërtitur me brohorië dhë dyke-hedhur zjar të parreshtur. Kaloria u vërvit më parë kundrë vijës frënge me vrull të pandaluarshëm, po dhe Frënjqte i pritnë me rreptësi të përqasçime dhe dyke-përdorur mitralozet e tyre rrëzuan mjaft të vrarë nga Shqipëtarët; po kundrështim' i Frënqvet u ndezi edh' aqë më shumë mëriën kalorisë Shqipëtare, e cila me një turrje te përsërieshme i vu perpara Frënjqtë dyke-i-vrarë e dyke-i-prerë pa mëshirë si të etjësuar për shpagë.

Disa nga kryetarët e Prevezanëvet të rrjeshtuar ndë qëndrë të Frënjqvet, të lemeruar nga klithmat triumfóre të Shqipëtarëvet, ikne me vrap dyke-tërhequr pas edhe gjith' ushtarët që ishin ndën' urdhër të tyre. Kur Gjenerali La Salcette po merrej për të bashkuar të dy krahët më qëndrën, që kësifarësh të mbushej zbrazja që u bë nga ikja e Prevezánëvet, Myhtari vërvitet përsëri me tërë kalorine Shqipëtare dyke-dëpërtuar për mes qëndrës së zbrazët të Frënjqvet edhe me mjet të kësaj lëvizjeje të vetëtimtë, i qarkoj Frënqtë duke-perçarë tërë rrjeshtat e tyre.

Ndë këtë çast ç'do shpresë shpëtimi për Frënqtë humbi. Gjithë-cili prej 'ta mejtohej për shpirtin e vet. Beteja rrjeshtore ishte mbaruar edhe vetëm dyelle po bëhëshin midis të dy anëvet adversorë. Shkrimtari frënk Malherbe, thotë që Frënjqtë dëftyen burrëri të madhe ndë këtë mundje. Sogjeri (Kollonelli) Hotte mprohej me kordhën e vet kundër dy Shqiptarëvet kaloriës, edhe dyke-luftuar kësi-mjeti

mundi të përiknjë i padëmtuar ndë fortesimën e anës mënjgjër, ndë të cilin po qëndrojin akoma Frënjqtë. Aty gjeti Gjeneralin La Salcette, i cili po përpiqej t'u fryjë heroizmë atyre që kishte përqark, po të ciët të platitur prej trumbavet të kalorisë Shqipëtare, po binin të vrarë njëri-pas-tjatrit. Të dy gjeneralët, La Salcette-i dhe Hotte-i me 25 ushëtarë po mbahëshin akoma. La Salcette-i ndë këtë të keqe nendoj të thërresë për ndihmë një bombardë të angurùar ndë Prevezë; edhe për këtë dërgoj dy ushtarë kuximtarë të cilët vrapuan të përmbushin urdhërin e gjeneralit. Po edhe ajo shpresë vajti humhur se njëri nga ushtarët i kapitur, u mbyt udhës, prapo ay tjatri dolli ndë liman të Prevezës po me mos gjetur bombardën, edhe tue-menduar që edhe kthehej prapë ndë Nikopojë ishte kot-së-koti, dyke-notuar dolli mb' anë të tejme edh' u ngjit ndë kështjellë të Lefkadhës. Nërmjet këtyre, të njëzet-e-pesë Frënjqtë ndënë Gjeneralin La Salcette dyke-luftuar parreshtur kundër Shqipëtarëvet që nga fortesima e tyre, mbaruan municjet; Shqipëtarët po ngjitjin vragën (pasagjin) e fortesimës, edhe bombarda nuk' po dukej kurkundi. Atëherë La Salcette-i passi e pa që ç'do rezistencë ish' e kotme, vendoj të përepet. Ngriti flamur të bardhë edhe passi i la Shqipëtarët të hyjnë liruar ndë fortësimë, i ndorëzon kordhën njëjt nga griqérët e Ali Pashës. Gjith-po-ashtu përdhanë armët e tyre edhe frënqt' e tjerë përveç tre nga ata, nga shkaku se Shqipëtarët i qesëndisjin dyke-i-quajtur të paburrëshm nuk' dojin të përepen edhe u vranë dyke-bërë duell me Shqipëtarët. Edhe dy të tjerë kanonarë që u kundrështuan, ranë të vrarë mbi kanonat e tyre.

Një qint frënjq të rrobëruar ndë këtë betejë, të përgjakósur u çuan përpara Ali Pashës i cili i priti me një simpathië të rrallë se mbushnë detyrën e tyre si ushtarë edhe pastaj u dërguan ndë Llurë tek u mbajtën të burgosur.

Kur ndë rrënimet e qytetit të vjetër të Augustit po bëhej lufta e përgjakshme që treguam, afër Prevezës po prezantohej një tjatër shkenë e lemeriëshme

e kësaj dramë. Trumeri (Kapitani) Tissot të cili i ishte ngarkuar mprojtja e qytetit, nuk' donte të mbetej shpektator i luftës së Nikopojës. Passi rregullon garrizonën e qytetit vrapoj ndë fushë të luftës kur La Salcette-i me Hotte-in u përdhanë ndë duarte Shqipëtarëvet. Kthehet me vrap, edhe passi zgjodhi nj' a 80 ushtarë, vendoj të bënjë turrje për të shkëputur nga duart' e Shqipëtarëvet të pakën të dy gjeneralët rrobër. Me çap të vraptë kapëtoj rrënimet e Nikopojës edhe po gatitëshin të çajnë fushën që ishte midis tyre edhe vëndit tek mbahëshin rrobërit. Po aty piqnin më ushtëri Shqipëtare e cila forcohej paprerë më harritjen e të tjerësh luftarë të cilët s' u epnin rast të bëjnë as një çap përpara. E sosmja, si e pa Tissot-i që përpjekja e tij ishte kot-e-kot, vendoj t' a neveritnjë këtë pllan, dyke-shkuar nër mënt që po të atakonte përsëri Shqipëtarët, mundej të bjente prishjen e bashkëkombasvet tij që ishin kapur rrobër. Edhe kështu dyke-ikur Frënqtë, të ndjekur nga një griq Shqipëtarësh, brodhë të hyjnë ndë Prevezë për të mpruar qytetin, po Shqipëtarët të pjesëtuar më dysh kishin marë një rrugë tjatër edhe harrijtin ndë Prevezë më përpara Tissot-it, tek pasi përzunë garrizonën hyjtin ndë qytet; kur pas pak mbërrini Tissot-i me shokët e vet i gjëti ata të vendosur ndë disa pozita brënda ndë qytet.

Trumeri Frënk si pa që gjëndet i qarkuar nga Shqipëtarët, u ep urdhër ushtarëvet tij të ikëjn me renda, edhe kështu dyke-zbrazur herë-herë pushkat kundër Shqipëtarëvet që po u bijin pas, një-e-tret' e tyre me Tissot-in harrijtën ndë liman, tek më parë patnë lënë ca anije të rezervuara, po anijat kishin lundruar s'ndejmi dhe as ishin për t'u kthyer. Shteti i Frënjqvet ishte i kritikshëm, Tissot-i rrjeshtohet me ushtarët ndë një të tillë pozitë, që mprohëshin edhe nga deti edhe nga shtëpitë që ishin këtej dhe përtej. Kështu mundi t'u-a ndalnjë një copë-herë vrullin Shqipëtarevët. Ndë betejë-e-sipër Tissot-i sheh dyke-ardhur për ndë të-hymë të mëngës, një bombardë me di-ca lundra, dhe pandehu se po i vjen ndihmë e dërguar nga kumandan' i garrizonës së Lef-

kadhës; po mjerisht për trumerin Frënk nuk' ishin sikurse pandehu, po ja-se-qysh: Një lundrëtar prevezan mik i Tissot-it dyke-parë së largu betejën, i-u afërua limanit edhe po i britte Tissot-it që të shkëputej ay vetëm prej pozitës dyke-i-premtuar t' a çonjë me lundrën e vet ndë Lefkadhë. Po s' duhet harruar që Tissot-i nuk' ishte i paburrëshm, edhe i përgjigjet lundrëtarit me zë të math që s'munt t'i neveritnjë ushtarët e tij ndë rrezikun e fundit dhe të shpëtonjë vethen e tij, vetëm e porositi atë të vejë të gjenjë bombárdën e ikur e cila çquhej së largu, edhe passi-t' i raportonjë rrezikun, t'a ngutnjë t'u vinjë ndihmë; bashkë me lundrëtarin Prevezan dërgoj dhe një ushtar frënk. Kur mbërrinë te bombarda, ushtari që ishte me lundrëtarin, si frikacak që ishte vendoj të shpëtonjë vetëhenë me që gjet rastin e pritur, dhe nëvënt të fjalëvet të trumerit, i vërtetoj ata që e pyetjin se të gjitha vanë humbur edhe se ç'do ndihmë që t'i epej Tissot-it ishte e kotme. Kapitani i bombardës, i bindur nga fjalët e bashkatdhetarit të tij se qëndrim' i atij ndë ujrat e Nartës ishte i panevojshëm, lundroj s'andejmi për gjithëmonë. Tissot-i dhe ushtarët e tij kur e shihnin me tejqyrë bombardën dyke-u-mërguar, zun' e nxirjin klithma të vrázëta nga dëshpërimi. E humbën fare torruan edhe kuximi i parëhershëm po u shdukej. Atëhere Tissoti e pikasi që po u qasej rrebeshi, edhe passi u adresoj ushtarëvet disa fjalë enthusiazmi, u kumandoj turrjen e mbrame.

Të kuturisur për vdekje Frënjqtë mundën të mbajnë një orë luftë me Shqipëtarët; rrugët të Prevezës thotë oficeri frënk Bellaire, u mbuluan nga kufomat e të vrarëvet dhe të së plagosurvet. Më së fundi fuqitë trupore të Frënjqvet u rronitën, dhe duart' e tyre më s' mundjin të mbajnë armë; Tissot-i vet' i nënttë mbenë po-si të shtyllosur më këmbë, të palëvismë, edhe me shvuajtësi i prisnin plumbat e Shqipëtarëvet, të cilët vrapuan edhe i kapnë rrobër.

Të nënttë rrobërit me Tissot-in ndë ballë u prunë përpara Myhtarit, pa ky i dergoj tek i áti i cili i priti me fjalë fisnike duke-u-shpallur që admiron

heroizmin dhe vetmohimin e 'tyre. I heshtur për pakë të grima Ali Pasha vërrente me simpathië rrobërit e tij, pastaj më një inoqencë të përzakonëshme u dha kurajë duke-u-thënë që dotë përpiqet me sa t' i mundej t' u-a bënjë më të ëmbël rrobërimin atyre edhe shokëvet të tjerë.

Pas këto rrobërit Frënjq u përdhanë për t' u rruajtur me kujdes njëjt nga trumerët e Ali Pashës i quajtur Beqir Çogaduri. Të nesërmet i lajmuan që dot' i shpien ndë Llurë ndënë eshkortë ushtarësh. Kur mbërrinë ndë Llurë i çuan ndë një fortesë tek ndodhëshin edhe rrobërit e tjerë Frënjq të Nikopojës. Të dytën ditë ndaj vagullimit, pas kanunit t' athershëm, të lidhur një-nga-një, përveç gjeneralëvet të cilët ishin të eshkortuar veçan dhe hypur mbë kuaj, pas shtatë orë udhëtim u prunë ndë Nartë, edhe s' andejmi i nisnë për ndë Janinë.

Pas këti rrugëtimi të përlodhshëm rrobërit bashkë me eshkórtën ushtëriake u afëruan ndë kryeqytetin e Ali Pashës, atje tek ashpekti i fushes së bukur dhe i liqenit të fjetshën buzë të cilit pasqyrohej i kandëshm throni i Tepelénasit, i shlodhi pakë të ngratët rrobër nga ashpërimet e udhës edh' u dha cá-zë shpresë që ndë mes t'asaj natyre të magjiëshme dot' u harohen tërë vuajtjet e shkuara. Veli Pasha, biri më i vogël i Ali Pashës u dolli përpara me një eshkortë kalori Mirditas, edhe rrobërit të gjyrmuar prej popullit Janjot, u çuan ndë pallat të Ali Pashës ku u dhane hamje, dhe barra shërimi të plagosurve.

Kaluan disa dit nga keto që thanë, kur një mënjgjes mbërrini në Janinë një kasnec prej Konstantinopoje dyke-çuar dekret (ferman) që të dërgohen të gjithë rrobërit Frënq ndë kryeqytet. Par dekretit, 147 rrobër, oficerë, ndënoficerë edhe ushtarë bashkë me të dy gjenerallët, ndë piskun e dimrit muar rrugën e gjatë dhe të përlodhëshmë për ndë Konstandinopojë dyke-shkuar ndë për Toskëri të Veriut dhe ndëpër Rumelië.

Si harrijtin ndë Konstandinopojë, Gjeneralli La Salcette, edhe Sogjeri Hotte u mbyllnë ndë Shtat-

kullat të tjerët oficerë dhe ushtarë ndëpër burgje të tjera tek mbenë gjer u bë paqa.

Pas pushtimit të Prevezës ushtëri e Ali Pashës shtiu ndë dorë edhe Vonicën, e cila ishte ndënë pushtim të Frënjqvet; garrizona e kësaj, ndonëse ishte e shumët, për të mos pësuar fatin e bashkëkombasvet tyrë të Prevezës që të nesërmet iknë prej qytetit pa fare rezistencë dyke-u-t'hequr ndë Lefkadhë.

Pas di-ca dit Ali Pasha dërgoj edhe kundër Lefkadhës ushtëri ndënë kumandë të Isuf Arapit, i cili ushtrinoj nga an' e tokës, përqark Pllajës, dhe s'andejmi ndëpër kenell' e ngushtë të hynte ndë nisië.

Ndë këto kohë (Tettor 1798) Tyrqia me Rusinë për t'i dhënë shuplakë hovit të Napolon Bonapartit, kishin bërë aliancë, edhe kështu flota Ruso-Tyrke passi kuqeroj Qithirën, Zakinthën, Qefaliniën edhe Ithakën, po drejtohej kundre Lefkadhës, ndënjësit e se cilës, te mërzitur nuk' dihet nga se, ishin ndërkryer kundrë Frënjqvet dhe dojin të hyjnë ndënë pushtim të Rusiës. Ali Pasha për t'i goditur qëllimit tij, përpara se te tfaqet flota Aliate u çoj Lefkadhjotëvet prokllamata për t'u ndërkryer kundrë Frënqvet edhe natën e 13 Tettorit u çoj dhe letra disave nga parësi e Lefkadhës tek përsëritte gjith' ato të prokllamatës, dhe disa premtime konditash të mira. Lefkadhjotët nga këto muar edhe më tepër urretje kundrë Frënjqvet, gjer sa kumandani i garrizonës dyke-parë që sa vij keqësohëshin shpiritat e popullit, urdhroj garrizonën të hiqet ndë kështjellë. Të nesërmet ushtarët Fënjq kur panë se ndë Pretorië ishte zbritur flamuri Frënk dhe ndë vënt të tij ishte nalltuar flamuri Rus, po pregatitëshin t'i bien qytetit me kanona, kur ndaj mbrëmjes të së 18-tës tfaqet përpara limanit Lefkadhës një shkádrë e flotës Aliate; Admiralët e flotës, Ouchakov edhe Kadri Beu, passi ftuan garrizonën të përepet dhe nuk dojin, filluan rrethimin e regullshëm të kështjellës; Isuf Arapi që ish' i ushtrinuar ndë Pllajë, ndë duresë të rrethimit nuk' rreshti së dhëni rrethonjësvet ndihmat e posaçme; Fundja pas 15 dit rrethim admirali Rus i ngusur që të mbaronjë shpejt punën tij, ftoj kuman-

danin e garrizonës të përepet, se, përkundrazi, do-të pranonte proponimin q'i pat bërë Ali Pasha që me 12,000 Shqipëtarë t'a kuqeronjë fortesën me asallt. Kumandani Frënk përsëri hezitój ndë krye, po dykeshkuar ndër mënt me ç'mënyrë luftojin trumbat Shqipëtare, akseptoj të përépet me traktat; garrizona dolli prej kështjellës më 4 Nëntor me nderimet ushtëriake të përzakonëshme. Përfundim' i kësifarëshm i rrethimit, nuk' e satisfaktój Ali Pashen, po nga rastet e kohës u ngut të neveritnjë pllanet përmi Lefkadhën dyke-e-ngritur ushtrinën e ngrehur ndë Pllajë.

## KREJ X.

Ndaj anëdetjevet të Çamërise, kundrejt nisiës Pakso, që çkëputet që nga jugë-perëndim' i malit Kroj' i Thatë gjer ndë det, duket një shkëmp konik me një gjërësië të përqarkme afro një kilometër maritime. Ndë majat e këti shkëmbi nalltohen edhe sot akoma murret e njëj fortese e cila ndë shekullin XVIII përbënte qytetin Pargë që dirgjej ndë të. Ndënjësit e këti qyteti pas gojëdhëniet ndë krye të shekullit XV-ttë rijin ndë qytetin e malit afërm Pezovoll, afro një orë lark detit. Shkaku i shpërnguljes dhe që i nguti Pargjotët të qasen përanë detit, ishte se, turma kusarësh të tmershëm ishin përhapur ndë rreth të Pogonit dhë të Lëvizhdës. Fortesa nuk' dihet ndë është ngrehur ndë këtë epokë ose më von edhe kur. Thuhet prapë se Pargjotët dyke-parë që u kanosej përherë rrezik prej keqbërësvet brigandë (kusarë), venduan të hyjnë ndënë protektim të ç'do fuqie Evropiane e pára që të tfaqej n'anëdetjet e tyre edhe se e tille u tfaq nër ta me flamurin e Venetikut. Me që Normandët asi kohe zotojin nisiat Joniane edhe di-ca pozita të fortesuara t'anëdetjes Torkërisë ësht' e mundëshme që ndënë protektim të këtyre kanë hyrë më së pari Pargjotët, edhe me ndihmën e tyre kanë ngrehur të re fortesën e vjetër. Po pas prishjes definitive të suveranitetit Normandian ose Napolitan, më 1401 ndë Shtatnisië dhe Toskëri, më 1447 Parga

hyri ndënë protektim të Venetikut edhe ndënë këtë mbeti rrjeshtazi gjer ndë vitet e mbramë të shekullit XVIII, gjyrmoi gjithë aventurat e gjata të luftave q'u bënë ndë këtë kohë midis Demokratisë dhe Portës, vuajti shumë gjer u rrebeshua fare edhe më 1537 mbeti shkretë; më 1572 i pa përsëri të mblidhen ndënjësit e saj kur edhe fortesa e saj rrëzuar prej Tyrqvet u trajtua m'e shëndoshë.

Parga sa kohë që ishte ndënë hije të Venecjanëvet, ndënjësit e saj kishin një autonomi të plotë, nga ky shkak qyteti i tërhequr nga fqinjët rreth saj që ishin ndënë xgjedhë, shumohej nga dit edhe mbrothësonte ndë qytetërim, dyke-u-bërë qëndrë tregëtije tranzitike jo vetëm e vëndevet Toskërisë, po edhe të Thësalisë edhe vëndevet áfërme të Greqisë.

Mal' i Perzovollit ishte kufiri që i ndante prej Çamëriës; i gjithë vëndi që zgjatej prej rrëzës këti mali gjer ndë det ishte gjithë ullinj edhe kopshta produktive. Që prej anëdetjes edhe gjer rrëzavet, shpeshtinat të portokaleve, të limonjve edhe gjith faresh pemë ishin të shuma, edhe ujra të kulluara prej majavet të malit me një rrymësie dhe fërfërim të kandësh vaditjin dheun pëllor.

E tillë ishte Parga ndë kohë të Ali Pashës, mbi të cilën pas sukçeset që numëruam dreqtoj vërrejtjen për t'e zapëtuar.

Venecjanët dyke-vigjëlluar qëllimet e Ali Pashës që posa u ngul ndë Janinë, për të parëdrojtur pushtimet e tyre n'anëdetje të Toskëriës e bënë Pargën qëndrë të kompllotëvet politike të tyre kundrë Ali Pashës edhe ç'do konspiracjë e disa Bejlérëvet të Çamërisë edhe e Suljotëve kundrë tij aty mbrujtej dhe gatuhej.

Kuptohet vetiu pra, me sa urrejtje e vështroj Ali Pasha flamurin Frënk dyke-valuar mbi Ballkonët e fortesës Pargës më 1797 edhe fuqiën ushtare që hyri ndë kostet Toskënore, si sukçesore e Demokratiës shkatërruar të Sh. Markut. Më gjith' atë Ali Pasha i bazuar ndë fuqin' e tij ushtëriake, nuk' prapsej as pak prej shpresës që ndë një rast të mirë t'a kuqeronte Pargën. Andaj pra përpara se të marë masat

më t'ashpëra i shkruan Gjen. Chabot ndë Kofuz dyke-i kërkuar çedimin e Pargës miqësisht; per t'u zhustifikuar per konduitën e tij përpara Frenjqvet i kujtonte që të përgjegjëshm ishin ata vetë edhe jo ky. Edhe passi nga ngjarjet e Vuthrótit këto proponime s'i akseptoj Chabot-i, Ali Pashaj sakaqëherash u kthye mbë Pargjotët, edhe që nga Preveza filloj marëveshjet.

Që natën e pushtimit Prevezës, i-u shkrojti parësisë Pargës duke-i-ftuar ata ndë subjektim. Pargjotët prisjin harritjen e flotës Ruso-Tyrke nër ujrat e tyre, andaj rrahnë të përfitojnë rastin dyke-vonuar përgjigjie; Ali Pasha i cili donte t'a përkapinj këtë rast, u çoj atyre një të dytë letrë dhe një tjatër të tretë me kanosje, tek i urdhëronte Pargjotët t'a dëbojnë s' andejmi ushtërinë Frënge. Letra e fundit i nguti Pargjotët t' i përgjigjen ati po prapë indefinisht, me qëllim përsëri që të fitojnë kohë. Po nd' ato-e-sipër, i komunikuan garrizonës Frënge të ngjarat edhe shtetin e keq ndë të cilin dotë harrijin po t' i kundrështohëshin Ali Pashës, edhe e bintnë atë t' a zbrasnjë kështjellën dyke-u-t'hequr ndë Korfuz, që të mos pësojnë ata dhe qyteti fatin e Prevezës. Passi iknë Frënjqtë, Pargjotët dërgojnë një delegacje te admiralët e flotës aliate e cila kish harrijtur tani ndë Zakinthë, dyke-lypur përkrahjen e tyre kundër Ali Pashës. Po përgjigjia e admiralëvet ishte fare e ndryshme. Ata i këshilluan që me nërmjetin të tyre të vijin ndë marëveshje me Ali Pashën. Atëherë ata dërgojnë ndë Prevezë një delegacje të fuqiplotme prej 4 vetash të cilët i ngarkuan me misiunën për marëveshje me Ali Pashën mbi perdhënien e qytetit. Kasnecët vajtnë ndë Prevezë më 30 Tettor 1798 edhe sikurse vërtet, e përmbushnë misiunën e tyre; u ndënëshkrua edhe traktati midis tyre dhe Ali Pashës. Kur kjo çështje mori funt midis delegacjes Pargjote dhe Ali Pashës, qytetarët e Pargës ndruan mendim për sa venduan, dyke-shpërehur ndë përkrahjet e admiralit Rus, pranë të cilit filluan të vepërojnë, edhe kur mbërrini në Pargë lundra që bjente kasnecët Pargjotë edhe përfaqësonjësit e Ali Pashës,

populli Pargjot i priti ata me ftohëtië dhe përtregime dezaprobimi, prapo mbi fortesë nalltuan flamuret e Rusiës dhe të Tyrqiës, për shënjë subjektimi nër admiralët e flotës aliate; edhe gjithkohësh i adresuan Ali Pashës një letrë të datuar më 9 Nëntor ndë të cilën i shkruajnë që s' ësht' e mundëshme të subjektohen te as ndo-një pushtet tjatër. Kur mori letrën Ali Pasha, i mbushur ndë mërië për shkeljen e traktatit, mori pas tij një divizje nga trupgardasit e vet edhe ndë një natë të llohëtershime me rrugëtim të vrapshëm harrijti në Margarit që eshtë 2 $^1/_2$ orë lark Pargës; q' aty u hoqi tejshkrim Pargjotëvet dyke-u-kërkuar përdhënien e shpejtme të qytetit. Të tmerruar Pargjotët me vrap vajtën te admiralët dyke-lypur mëshirën e tyre për shpëtim.

Admiralët nga njëra anë i qërtuan për viollatën e traktatit, po m'anë tjatër dyke-mos-dashur te prishej qyteti, i hoqnë vërrejtjen Ali Pashës që të mos bënjë nonjë atent kundër qytetit gjer të kanunohej çështja nga Guvernat respektive. Ali Paska për te mos u ashpëruar punët e hoqi ushtërin' e tij prej kufirevet të Pargës.

Po kjo nukë donte-me-thënë se me që hoqi ushtrinën hoqi dhe shpresat prej këti qyteti; jo, se ay çapej gjithëmonë ballëhapët dhe me kuxim mbë qëllimin e vet. Midis ngjarjevet të fundit u nderua prej Portës me titllin *Vezir*, si shpërblim për përzënien e Frënjqvet prej Toskërië [1]).

Ndë periudhën e lundrimit të flotës Ruso-Tyrke nër ujrat e Pargës, Admirali Otoman Kadri Beu, shtudijoj mirë vepërimet që bëhëshin ndë Pargë kundër Ali Pashës, edhe ay veçanërisht i këshilloj Divanit që ishte e udhës edhe e domosdoshme t' i permitóhej Ali Pashës të pushtonjë Pargën e cila ishte bërë trevë (limer) kusarësh. Port' e Nalltë i

1) I famëshmi admiral Anglez, Lordi Nelson, i cili lundronte nd' ato kohë ndë Pellgun Jonian, dërgoj një nga oficerët e vet për t'a përhiruar Ali Pashën nga an' e tij për kuqerimin e Prevezës, edhe gjithkohësh t' i shfaqnje regretin e ekshqelencës tij, që s'mundej t' a vizitonjë personalisht për t' e përhiruar Trimin e Shqipërisë.

aproboj shfaqjet e admiralit të saj, po nuk' ish' e mundëshme të vendojë as-gjë pa konsencjen e aliatit 'saj Rusiës, admiral' i së cilës kishte çuar një trumbë ushtarë Rusër ndë krye të Marsit 1799, edhe dyke ngritur mbi kështjellë flámuret Rus dhe Otoman, e prokllamoj qytetin të pushtuar nga ata, gjer të vendojnë aliatet për fatin e tij.

I këtillë zotënim i Pargës mbajti gjer ndaj Frorit të vitit 1800, kur me mjet të traktatit K/pojës, Shtatnisia edhe aneksátat e saj u dekllaruan Shtet Demokrátik, Ali Pasha u obligua të neveritnjë pretencat e tij jo vetëm mbi Pargën, po edhe mbi qytetet e pushtuara si Prevezën edhe Vonicën veç Vuthrótit nek u hoq me ushtërin' e vet; Aty bashkëpunoj me Aliatët ndë devastimin e Korfuzit dyke-u-dhënë atyre ndihma rishforcimi edhe municje; gjith-po-ashtu dhe me mjet të fllotillës tij i protektonte ata. Ndënjti gjer më 22 Fror 1799, kur ujdhesa e Korfuzit pas tre muaj rezistencë të Gjeneralit Chabot, u përdha ndë duart' e ushtëriavet aliate [1]).

## KREJ XI.

Kishin kaluar afëro tetë vjet që kur Ali Pasha përmarshoj kundër Suljotëvet, me të cilët sikurse thamë bëjti traktat dyke-u-dhënë gjithë të drejtat lirije me konditë që të rinë të qetë. Po këlyshët e Sulit, të lindur rrëmujëdáshës nuk prajtën shumë kohë edhe filluan përsëri grabitjet ede vjedhjet mbi kurris të fqinjëvet tyre përqark, edhe kështu shteti armiqësor midis tyre nukë rreshtej fare.

---

1) Ndë kohën e ndënjtjes nde Vuthrot u angurua një lundrë pirátësh (kaçákë-deti) prej Barbariës, ndë të cilën ndodhëshin di-ca oficerë Frënq të kapur rrobër kur kthehëshin nga Egjypta. Këta ishin: Sogjeri i Mekanikës Poitevin, Sogjeri i artilérjës Charbonel, edhe Profesori J. Béssières, një nga më të çquarshmit letrárë Frënq që i vajtnë pas Bonapartit nd' Egjyptë. Të gjithë këta Ali Pasha i liroj me mjet shpërblerjeje edh' i çoj me vethe ndë Janinë, tek ati të dytit nga ata i ngarkoj formimin të një shkolleje praktike ndë Bonillë afër Janinës.

Gjithë-këto, që Ali Pasha drejtërisht i emëronte tronditje të qetësiës publike, i epnin arësye t'i kushideronjë për armiq të rrezikshëm, edh' aqë më shumë se Suli si gjymës-independént, ishte edhe kërthiza rreth së cilës vërtitëshin edhe të tjera elemente intrigane kundër sundimit tij.

I tillë pra me qënë shteti i punëvet nd' atë vënt malësi, Ali Pasha e parashëkonte të rrezikuar zotërimin e tij ndë Shqipërin' e Poshtme, se veç Suljotëvet përmblidhëshin edhe disa kushpiratórë armiq të tij Bejlerë dhe Agallarë të Çamërisë, mbi të cilët kryesojin Ibrahim Pashë Berati (krushku), dhe Mustafa Pashë Delvina.

Thamë ndë krejin VI që, pas vdekjes të Llambro Xhavellës kryetar i Katër-katundit u njoft prej zgjedhjes së përgjithëshme djaloshi Foto, i bir' i Llambros, si trashëgimtar i këti ofiqi, dhe se Jorgji Boçari i çquarshëm nga mosha edhe nga trimëria, i zëmëruar që i-a rrëzuan vleftën, u hoq ndë qëndrën e fisit tij Katund'-i-vjetër, edhe kurre nukë prezantohej ndë mbledhjet e bashkëqytetarëvet të tij. Ali Pasha i cili e njihte mirë plakun Suljot për virtytat e tija, me mjet të njëjt nga besnikët trima të gardës së tij i quajtur Mitro Pallaska, hyjti ndë marëveshje me Suljotin e përvuajtshëm, i cili bashkë me të gjithë anëtarët e tribit tij u bashkuan me Ali Pashën i cili i pranoj krahë-hapët edhe i dhuroj për pronjë familiare katundin Bullgaréll pranë Xhumerkës, tek shpërnguli gjithë fisin e tij, edhe gjithkohësh e emëroj atë edhe Kryetar të Kapedanatës Xhumerkës.

Suljotët u zëmëruan tepër për bashkimin e Bóçarit me Ali Pashën edhe shumë herë i kanosëshin për t'a vrarë, dhe fisin e tij t'a farosjin po s' patnë ç' t' i bëjnë kurrgjâ. Një natë, di-ca ndënjës të Çekuratit dyke-u-rrëzuar ndë luádhet afër Janinës, vodhë ca kuaj të Ali Pashës që kullosjin. Ali Pasha e lajmon Bóçarin për këtë dyke-i-lypur ndjekjen edhe kapjen e vjedhësvet, edh' ay me disa shokë të armatosur vajti ndë Çekurat, i kapi vjedhësit të cilët i përdha vargoj-lidhur ndë duart e Ali Pashës. Mirë po këto vepërime të Bóçarit i ndezë më tepër Su-

ljotët, përkrahësit e autorëvet te vjedhjes, të cilët zunë së-rish të përhapin çeta brigandësh për të vrare Boçarin edhe Suljotët e tjerë që ishin ndë shërbim të Ali Pashës.

Nga shkaku i këtyre ngjarjevet Ali Pasha çoj edhe një trumbë ushtarësh për të çdukur ç'do keqbërjë të pritme. Kesi-mjeti e shkeli vëndin Suljot duke-kuqeruar pozitat e fortifikuara dhe ngrehu kështjella ndë Bogorçë edhe ndë Dervishanë; përveç këtyre, zapëtoj 14 pshatra të Sulit. Po midis Boçarit edhe bashkatdhetarëvët tij po ashpërohëshin punët edhe më shumë kur më von, ndaj Dhettorit 1799, një çete Suljotësh grabitnë 300 berra (dhën) ndë Rrapçisht, katunt ndënë zotënim të Ali Pashës, edhe i kapërxyen ndë Sul. Të dëmtuarit vijnë i anëkohen (i qahen) Ali Pashës i cili dërgoj Boçarin ndë Katundtë-vjetër; ky vajti edhe passi ftoj parësin' e Katërkatundevet, u lypi me të-urtë kthyerjen e berravet të grabitura. Po parësija nevënt që t' i kthejin gjën'-e-gjallë e insulltuan me shumëfarësh sharje të ndyra, andaj Boçari me shokët e vet iku s' andejmi duke-u-betuar që ka për të marë shpagë nga gojë-ndyrët. Pas di-ca ditë passi mori prej Ali Pashës shumë kafshë, çatdhesoj shumë shtëpiare të partit tij vëndës ndë katundet Suljote të Llakës, të cilat i shpërguli ndë Bullgarell edhe kështu u hoq përgjithëmonë prej Sulit. Po pak kohë pas ikjes nga Suli, Kryetari Suljot i rënduar nga mosha, ra vdiq dyke-lënë bijt' e tij nëkëmbës.

Nërmjet këtyre, konflikti i rishmë dukej më i paprapsëshm midis Suljotëvet dhe Ali Pashës i cili dykë-patur të shuma e të ndryshme arësyet lufte, i thërret Suljotët mbi shkak të ngjarjevet të mbrame edhe u kërkoj t' i ndorëzojnë penge për sigurim ndë kohën e pritme. Këtë u-a pat proponuar edhë Jorgi Boçari përpara se të mbahej prej Sulit, po ata si atëherë, ashtu edhe tani refuzuan të japën.

Ndaj buzë-prëndverës Ali Pasha filloj vepërimet për një vërvitje tjatër kundër Suljotëvet, dukë-mbledhur ushtëri ndëpër gjithë Shqipërin e mesme dhe të Sipërme, edhe përhapi bujë që kjo ushtëri pregati-

tej për kundër Napolon Bonapartit nd' Egjyptë, edhe ndë krye të Qërshorit 1800, duke-emëruar Krye-kumandan të birë Myhtar Pashën, ndë ballë të një trupi ushtërie të fortë ndënë oficerët, Isuf Arapi, Hasan Çapari, Sulejman Çobani, Zylyftar Poda, Beqir Çogaduri, Meço Bono, e.t.j, dolli prej Janine edhe passi u mërgua disa orë prej qytetit, i prokllamoj ushtërisë qëllimin e marshimit. Gjithkohësh, me që dyshonte mbë dispozitat miqësore të agallárëvet të Paramithisë, u përkujdes t'i bindinj të marën dhe ata pjesë ndë marshim. Agallarë të Paramithisë ishin nd' atë kohë, Islam Proni edhe Mahmud Dajlan' i Konispolës; këta ndë balle të 1500 burash zunë malin Vrizahë mbë veri të Sulit.

Ali Pasha vetë me një-mijë burra dëpërtoj ndëpër Varjadhë për ndë Sul, edhe vajti e ushtrinoj ndë Lipë, tek nguli kartiérin e përgjithshëm. Një trup ushtërie prej dy mijë burrash ndënë Zylyftar Podën dyke-marë gjith-po-atë rrugë kuqeroj kështjellën e Bogorçës; dy trupa të tjerë, njëra ndënë Beqir Çogadurin edhe Meço Bonon, edhe ushtëria ndënë kumandë të Isuf Arapit, Hasan Çaparit edhe Sulejman Çobanit, muar rrugën e Prevezës edhe passi kapërzyen lumin e Llurës u drejtuan e para për ndë Koçanopull edhe ndë Zermë, edhe tjatra passi shkoj urën e Aherit u drejtua për ndë Nemeckë. Kjo kumandë strategjike kishte për qëllim t'i shkulnjë Suljotët prej pozitavet më të forta, t'u përçajë forcat e më të shuma të tyre edhe dyke-dërmuar pjesat e përndara, Zylyftar Poda të zaptonte malin nga an' e veriut, edhe Isuf Arapi me të tjerët të pushtojne malet e mesditës-perëndimit.

Suljotët, te cilët që kur u kuqeroj Ali Pasha disa pozita të vëndit tyre ishin gjithmonë ndë paqetësië edhe ndë shtet luftór, paravëzhgojin lëvizjet e tija, edh' andaj me të pikasur invazjen e ushtëriës Alipashaliase, filluan shpejt-e-shpejt gatitjet e posaçme, edhe me vrapim zunë vise për defensive. Mbassi zbrazë katundet sheshóre edhe gratë bashkë me fëmijët i prunë ndë mal pjesëtuan fuqit' e tyre si mundën më mirë, edhe duall t'u bëjnë ballë.

Beteja e parë u bëjt ndë Nemeckë edhe ndë Liviqishte [1]) tek u përpoqnë me një çetë të madhe Suljotësh të cilët ishin ndënë kumandë të Foto Xhavellës edhe të të tjerë Kapedanësh, po të nesërmet pas përpjekjës, Xhavella u përpraps për ndë Sul, se mësoj që Kryekatundi ishte ndë rrezik të bjere ndë duart e Zylyftar Podës i cili shkoj ndëpër Bogorçë edhe mbërrini ndë Ville, katund katër orë lark Sulit. Një luft' e rreptë mori vënt pas di-ca ditë afër katundit Sistrun. Suljotët, permbi 1600 burra ndënë kumandë të më shperjéntëvet Kapedanë të tyre, venduan të goditin Ali Pashen vetë që ishte ushtrinuar ndë Lipë. Kështu pra dyke-u-qasur ndaj ushtrinës zunë pozitat më të mira përanë katundit Sistrun, edhe dërguan një çetë prej afëre 200 burrash për të brimuar edhe për të tërhequr armikun ndë pusi. Kjo divizjë dyke-u-çapur për ndë pozitat e Ali Pashës pranë Lipës u hoqi vërrejtjen të tejmëvet. Përqark Lipës ishte filluar të bëhej kuqendrim i fuqiavet të mëdha të Ali Pashës i cili qëllonte që së këtejmi të vërvitej kundrë malit; nër këto, të dy trupat ushtërie që zumë ngojë më sipër, të cilat hyjtin prej Llurës, dyke-qarkuar edhe dyke shtyjtur Suljotët për ndë mal, ishin bashkuar me Ali Pashën. Trup' i Suljotëvet ndënë kryesi të vetë Foto Xhavellës dyke-u-kacambitur me avantgardën e Ali Pashës filloj të dërmohet pas një betejë të përshkurtme, i ndjekur këmba-këmbës nga një trup i fortë i kumanduar prej Sulejman Çobanit edhe Mustafa Sygurrit. Po pas pak-herë kur mbërrijtin ndë tokë me të volitshme, Suljotët e përprapsur muar pozita vërvitjeje edhe betej' e përgjakshme u ndes, ndë të cilën u vranë mjaft njerës nga të dy anët; nga an'e Alipashaliasvet u vra edhe oficeri Sygurri; edhe pas një lufte disa orësh me që u err, të dy palët adversorë u hoqnë ndë ushtrinat e veta.

[1]) Përanë Liviqishtës ishte pritësuar një trup Suljotësh prej 200 burrash, të cilët u goditnë me ushtërin e Meço Bonos, edhe dyke-mos-mundur t'i bëjnë-ballë ushtëriës më të numërshme të Bonos u përprapsnë edhe ata edhe vajtin u bashkuan me Foto Xhavellën.

Të nesërmet ndaj agimit ushtëri e Ali Pashës u vërvit përsëri me fuqi të madhe per t'i shkulur Suljotët e vendosur ndë Sistrun, po nuk' ishte e mundëshme se këtu Suljotet mundën të zenë pozita më të forta nga të Alipashaliasvet edhe ishte kuqendruar trupi më i math i Suljotëvet prej 1700 vetash. Andaj pas një betejë të përgjakshme e cila mbajti 7 orë, u pernda edhe kjo pa ndonjë përfundim me rëndësie edh' u vranë shumë Suljotë, po edhe nga ushtarët e Ali Pashës jo të pakë [1]).

Nërmjet këtyre Ali Pasha vazhdoj të përmbushnjë pllanin primitiv të tij; urdhëroj di-ca nga oficerët e tij të baresin bashkë me ushtërit' e tyre për te mali Vrizahë, tek sikurse thamë ishin edhe Islam Proni me Dajlan Konispolën, që të bashkuar me 'ta të vërviten kundër Sulit edhe të çajnë rrugat e mesditësperëndimit. Me qënë që kjo lëvizje ishte ndë komunikatë edhe me trupin tjatër të Zylyftar Podës, sukçes' i Ali Pashës ishte i padyshmtë. Po tri dit pas betejës të Sistrunit, kur Suljotët ishin dyke-u-çlodhur pranë këti katundi, vjen një kasnec te Foto Xhavella i dërguar nga Islam Proni, mik' i lashtë i Xhavellës, me të cilin ishin bërë edhe vëllama, dyke-i-çuar një letrë të Kryetarit, me mjet të së cilës i kliiste ndë vesh pllanin e Ali Pashës edhe i propo-

1) Shpedita e Ali Pashës kundër Sulit më 1800.

*Tri zogëza po rininë,*
*Nde Qaf' e Shën Iliut,*
*Njëra shëkon Janinënë,*
*Tjetëra Kako-Sule.*
*E treta e m' e mirëza*
*Po logoris e thotë:*
*«U mblodhë Shqipëtarëtë,*
*«I-u turrë Kako-Sulitë,*
*«Me tre bajrakë shkuanë,*
*«Të tre radhë mbë rradhë;*
*«Njëri qe i Myftar Pashajt,*
*«Tjatri i Meço Bonos,*
*«I treti e m'i bukuri,*
*«Ishte i Zylyftarit».*
*Një Priftëreshë po thërret,*
*Kaha një brek i lartë;*
*«Ku jini o djemt' e Boçarit,*
*«O djemt' e Kuconikës;*
*«Turqit [1]) na mbuluanë,*
*«Duan t' na rrobërojnë,*
*«Tepelenë të na shpienë,*
*«Besën të na ndërrojnë».*
*E Kuconika sokëlliu,*
*Q' atje nga Avarika:*
*«Moj Priftëreshë mos u trëmp,*
*«As mos e shko nër mëndje,*
*«Tani të shohësh luftënë,*
*«Dyfegje Kapedanësh,*
*«Se qysh luftojnë trimatë,*
*«Trimat e Kako-Sulit».*

1) Do-me-thënë Shqipëtaret Myslimanë.

nonte Xhavellës që të turrej natën kundër ushtrinës të Vrizahës. Duket faqeza se ky çap i Pronit ishte fryti i nonjë marëveshjeje më të përgjithëshme edhe me të tjerë krerë, edhe kompllot kundër Ali Pashës.

Përandaj ndë një këshille luftare të Suljotëvet u vendua të gjyrmojnë këshillën e Pronit, dyke-pasuar me shpejtië pregatitjet për këtë çap. Vërtitja u bë me një turrje të pandalme prej 300 Suljotësh, ndënë kumandë të vetë Xhavellës, dhe tri orë përpara agimit të ditës së martë pas betejës të Sistrunit; ndë këtë përpjekje Suljotët u ndihmuan nga një pjes' e madhe e ushtërisë të trathëtorit Islam Proni, i cili u-a pat kallëzuar gjithë pllanet sekréte, edhe u bë një bollbë ndë ushtrinë, se m'anë tjatër edhe shumë kryetare Çamër, prapë me intrigë të Pronit nukë dojin të marin pjesë ndë luftë. Shteti i punëvet harrijti aqë liksht sa të nesërmet veç ushtarëvet të trathëtorit Islam që u shduknë me krytarin baskhë, edhe të tjerë shumë te deshkurajuar, zunë të dezertojnë nga rrjeshtat e ushtërisë. Ali Pasha i dëshpëruar që u trathëtua nga ay që s' e pandehte, thërriti përsëri ushtërin' e përndare ndë Shtabin e përgjithsëm që kishte ngrehur ndë Lipë, dhe dyke-parashëkuar që edhe ky atent dotë merte funt pa sukçes të mirë, nga shaku se ishte i qarkuar nga kushpiratorë të shumë dhe të pshehëtë, n ngut t'a neveritnjë pllanin e tij. Kështu pra mbet' i pabërëshm ndë ushtrinë gjer ditët e para të Vjeshtës së I-rë, edhe pas si dha urdhër të ngrehen pirgje nër pozita të forta të malit Suljot, vendoj t'i bllokojë ngushtisht malësorët përbrënda pusiavet tyre, dyke-urdhëruar kryetarët e trumbavet që vendosi nër 'to për garrizona të vigjëllojnë vëndin an' e mb' anë për të mos u kallur ndë malësi armë edhe të tjera posaçië lufte.

Shumic' e madhe punëtorësh u çuan prej Ali Pashës ndë ushtrinë për trajtimin e pirgjevet. Suljotët përpiqëshin për të kotuar ngrehjen dyke-vrarë punëtorët edhe dyke-u-vërvitur béfazi kundrë garrizónavet, po më kot se pirgjet u ngrehnë mbë një përqarkjë të gjërësiëshme të sërth-malësiës, edhe ndë distansë të ndryshme midis dy edhe pesë orësh.

Kështu kalonte koha, edhe fushata përcaktóhej herë ndë përpjekjet e garrizonavet për t' u-a bërë ngusht'-e-më-të-ngushtë qarkimin, edke herë ndë vërvitjet e hovëshme të Suljotëvet për të përçarë bllokadën edhe për të furnizuar posaçië lufte si-kur-se edhe ushqime të cilat u rallohëshin dita-ditën. Beteja të vogëla edhe lufta krahror-për-krahror bëhëshin të paprájtura të cilat mbarohëshin pa përfundime me rëndësi. Ndë një nga ato u plagos liksht edhe Foto Xhavella edhe me-zi shpëtoj i prurë mbi supet e Suljotëvet ndë Sul, tek lëngoj afëro pesë muaj.

Pirgjet u ngrehnë përpara se të kalonjë dimëri. U ngrehnë ndë 12 pozita, edhe që nga i pari gjer te pirgu i fundit distansa ishte pothua 20 orësh; ndë gjithë-cilën nga ato ishte vendosur garrizonë mbas madhiës edhe importancës të pozitës; veç atyre rij edhe tjatër ushtëri ndë të tjera pozita të përtashme për mbajtjen e bllokadës me më tepër severitét.

## KREJ XII.

Midis këtyre, ndë muajt e parë të vitit 1801, Suljotët të cilët ushqenin shpresa shpëtimi nga Çamërit fqinjët e tyre, bëjtin marëveshje me Krerët e kazavet që me sa të ishte e mundëshme, të shtrëngojin lidhje midis tyre edhe gjith armikëvet t'Ali Pashës, Bejlerë dhe Agallarë. Pas di-ca negoçiata, bëjtin marëveshje me di-sa nga parësi e Çamërisë, mbas se cilës kishin për t'u dhënë Suljotëvet ndihmë të hollash edhe të tjera të posaçme, edhe ndë nevojë të ndërkryeshin edh' ata kundrë Ali Pashës. Anëtarët e kësaj lidhjeje përveç Pashallarëvet të Beratit edhe të Vlorës, Ibrahimit edhe Mustafajt, ishin edhe Bejlerë-Agallarët: Haxhi Islami edhe Zejneli, vëllazëri e Pronjatëvet prej Paramithiës, Xhemat Bazja edhe Seit Xhemali nga Karbunari, Hasan Çapari nga Lugërati, Musa Rusua, Balo Hysua prej Margariti, Hassan Hushkumba prej Mazarakut, Maliq Grava nga Gumenica, Abdurahman Zëguri nga Várfanji, Muhamed Dajlani nga Konispola, Krerët e Dematit edhe të Sejkatit nga Filati, edhe të tjerë nga vise të ndryshme të Çamëriës.

Një e tillë ligë bjente ndë rrezik të math shtetin e Ali Pashës edhe kur mësoj hyri ndë kujdesë të madhe, po midis këtyre dashakeqës Ali Pasha kishte edhe ay të mjaftë miq për t'a shpërndarë edhe për t'a farosur këtë aliancë sa ishte akoma lonjáke. Kështu pra kundrë Pronjatëvet bëjti të ngrenë-krye agallarët e përqark Paramithiës gjer sa u ngutnë të neveritin qytetin me gjithësej ç'kishin ; kushpiratorët e tjerë gjithë me të tilla mjete i shkëputi prej ligës, disave nga ata dyke-u-marë edhe penk për sigurie. Kundrë Mustafa Pashë Delvinës dërgoj një ushtëri të madhe edhe bashkë me miqt' e partit të vet hyjti brënda ndë fortesë tek u kapnë shumë rrobër midis të cilëvet edhe gjashtë Suljotë, të cilët Pásha i Delvinës i pat marë për pënk mbas marëveshjes që u bëjt nga kushpiratorët. Mustafa Pasha vetë për të mos u kapur i gjallë nga Alipashaliasit kishte ikur përpara se të kuqerohet kështjélla; mâ së fundi krushkun e vet Ibrahim Pashën e Beratit e pruri ndë një shtet aqë të mizórëshmë sa e bëjti që i lypi mëshirën e tij, edhe mbassi e fali, Ali Pasha lidhi edhe besë aliance me të.

Gjithë vitin 1801 gjer ndë muajt' e parë të vitit 1802, Ali Pasha u muar me vepërimet për përkuljen e kushpiratórëvet, të cilët s'ish çudi që mundej edhe t'a dobëtojin përnjimend. Tani pra donte që t'i japë një mbarim gjëndjes anormale të Suljotëvet, po nukë donte që dyke-përfituar nga pafuqisië e tyre t'i rrebeshonjë, gjë që mundej t'a bënte ç'do herë. Po përkundrazi këtyre, burrat e Sulit nukë rreshtnin së gatituri për luftë dyke-furnizuar prej Parge municje edhe ushqime pshehtazi.

Sikurse e dimë nd'atë kohë Porta ndodhej ndë shtet përluftor me Francën ; një ditë një vapor lufte i kësaj fuqie i ngarkuar me armë dhe municje të dërguara prej Bonapartit për Suljotët të cilët ishin organë të tij, erth edhe angurój ndë Pargë ; e dimë që Bonaparti punonte parreshtur për realizimin e pllanevet të tija mbi Sinisiën Ballkane. Për municjet pra dhe armët Suljotët dërguan një trup 300 burrash ndë Pargë edhe i prunë ndë Sul. Ali Pasha me t'u

lajmuar për këtë, sakaqëherash i tfaqi Portës rrezikun, ndë të cilin ndodhej Shtet' i tij nga intrigat edhe vepërimet e Frënqvet, dhe proponoj nevojën e madhe që ishte për t'u shuajtur kjo shkëndijë revollte.

Pa vonuar shumë mori urdhërim prej Divanit të kuqendrojë ushtëri me shpërudhjet e arkës Perandoráke, edhe t'a përkulnjë me ç'do mjet Sulin. Me të marë dekretin Ali Pasha filloj me shpejtië pregatitjet, edhe pas di-ca muaj passi mblodhi ushtëri të mjaftme, dyke-emëruar për Kryetar të birë Veli Bejnë, proçedoj marshimin e mbramë kundër Sulit.

Më 27 Qërshor 1802, kur hyjti ushtëri e re ndë vëndet përqark Sulit, bllokada po vazhdonte me aqë rreptësi, sa mungesën e të posaçmevet pas pak e sukqedój fantóma e ziës-buke. Ali Pasha dyke-përcaktuar dhe përmbledhur zonën e bllokadës më nj'anë, edhe m'anë tjatër uria, sa vij i frushkullonte Suljotët, përandaj edhe e porositi Kryetarin e ushtërisë të mos bënjë as nonjë vërvitje sistematike kundër malësiës, edhe ushtërinë më të madhen pjesë, dha urdhër që të hiqët ndë katundet përqark; m' anë tjatër dërgoj te pleqësi' e Sulit të bir' e Jorgji Boçarit, Kiçon, për t'i ftuar të vijnë ndë marëveshje dhe të lidhin traktát. Vajti Kiçua ndë Sul edhe u komunikoj pleqësisë proponimin e Ali Pashës, edhe ata të drobitur nga vuajtjet e qarkimit të gjatë, me shpejtmësië akseptuan të hyjnë ndë marëveshje. Po Foto Xhavella, armik i papajcuarshëm i fisit të Bóçarit, kur pa adversor' e tij të vinjë ndë marëveshje ndëvënt të tij, mori mërië të madhe, edhe pas një bisedim të egër ndë mitingun e Pleqësiës, vete i kllet pishën shtëpiës vet, edhe ikën prej Sulit dukemarë pas gjithë shokët e tij, edhe vajti e ndënji ndë katundin Hortë, tri orë lark Sulit, edhe së këtejsmi armikësiat e lashta që kishin patur qënë midis átit të Kiços edhe atit të vet, u përseritnë nërmjet tyre.

Bóçari m'anë tjatër, përfitoj nga përçarja e Fotos edhe më s'u kthye të lajmonjë Ali Pashën mbi përfundimin e negoçiátavet për të cilat ishte dërguar, por mbeti atje me qëllim të marë kryetarriën të Sulit ndë-vënt të Fotos.

Ali Pasha ishte dyke-pritur Bóçarin të kthehej me përgjigje nga an' e Suljotëvet, po passi u lajmua një-për-një përmi të ngjamet, dërgoj e thëriti Foton për ndë Janinë dyke-e-hospetuar atë ndë shtëpi të Shéfit Policjës, Abaz Tepelenës. Mbassi e priti me afabilitèt të tepërshm gostiárin, Ali Pasha kuversój bashkë me të disa orë; kuversáta midis tyre ishte mbi përdhënien e Sulit ndë duart e Ali Pashës me konditë që t'u epej amnestië e plottë gjithë ndënjësvet. Fotua i cili e njihte më shumë nga kushdo tjatër shtetin difikullt t'Atdheut vet, edhe gjithkohësh i kuqeruar prej dëshirës që të mposhtohej adversór' i tij, e mori përsipër barën e marëveshjes midis Ali Pashës edhe Suljotëvet. Kthehet pra ndë Sul i eqipuar me dokumenta rekomandonjëse për të mos hasur pengime nga an' e rrethonjësvet të Sulit edhe passi i ftoj të gjithë bashkëkombasit e vet, u komunikój atyre gjithë proponimet e Ali Pashës.

Suljotët passi i dëgjuan nyjat e përdhënies, të cilat ndë substáncë nërvështrojin çatdhesimin prej vëndit tyre pa nonjë shpagim të hollash, kujtuan se nuk' ishte nevoja të akseptojin të tilla kondita, edhe i hodhë-tej të gjitha proponimet. Kështu Xhavella u ngut të ikinj s' andejmi i pabërëshm. Si u ktkye prapë ndë Janinë i komunikoj Ali Pashës mosgoditjen e misiunës, edhe mbeti aty posi edhe më parë.

Nukë kaloj shumë kohë kur edhe Bòçari, s'dihet nga ç'shkake, u ngut të kthehet ndë Janinë pranë Ali Pashës. Kështu pra, të dy Kryetarët e Sulit të cilët ishin edhe armiq midis tyre, tani ndodhëshin ndë hobor të Vezirit edhe ndë ç'do nevojë i kishte ndë dispozitë të tij.

Suljotët po vazhdojin me dëshpërim hostilitétet me ushtërinë rrethónjëse, dyke-dhënë edhe goditja herë-mbë-herë me ushtëritë Alipashaliase, po me mos mundur të rezistojnë shumë, me vrap shpráp-sëshin ndë pozitat e tyre. Një natë t'errët ndë dimër, 400 burra edhe 200 gra ndënë udhëheqje të gjashtë kapedanësh, zbritnë tatëpjete malit dhe i afërohen njëj pirgu që i thoshin Kulla e Villës me qëllim t'a djegin. Pirgu përmblithte 40 ushtarë ndënë kumandë

të Hodo Góranjit, edhe ishte një nga më të mëdhatë dhe më të fortat kulla që kishte trajtuar Ali Pasha. Një dit më parë një mesagjér i pat lajmuar Hodos për këtë edhe ay me gjith' ushtarët që kishte vajti dhe zuri disa prita përjashta katundit, ngaha besonte që kishin për të shkuar Suljotët, po të tejsmit këmbyen rrugë, edhe passi harrijtnë atje, zunë viset përqark me pandohmë që është dhe garrizona brënda, prapo njëri nga ata me një llos të bekurt çpoj kthisin e pirgut, dyke-hapur ndë të një vrimë mjaft të thellë, edhe passi zbrazi brënda një voze barut me fitil, i vu zjarrë. Ekshpllozj' e barutit e përmbysi godinën ndë pakë-herë, pastaj kur vunë re që s'ka ushtarë brënda, çanë dyert e deposévet, dhe si rrëmbyen prej 'tyre armë, municje sikurse edhe ushqime të mjafta, u-a ngarkuan gravet mbi kurrizet edhe iknë me link; gjër muar vesh garrizonat e pirgjevet fqinjë dhe gjer u ktkye Hodua i cili e pa që u kobua, Suljotët mundën të mbërrijnë ndë pozitat e tyre.

Me të tilla edhe me të tjera vepra luftare kaloj dhe vera e vitit 1803 gjer ndë Vjeshtë. Ndaj mezit të Vjeshtës I-rë Alí Pasha ndë një mbledhje ndë te cilën ftoj të marin pjesë të gjithë oficerët e tij, vendoj t'u japë adversorëvet të tij goditjen e sosme dhe të rrebéshme.

Ndaj zbardhëllimit të ditës së 25 Vjesht' e I-rë Veli Pasha i eqipuar me instruktat e posaçme, ndë ballë të një ushtërie të madhe, e shkeli malësinë dyke-u-drejtuar për ndë Sul; di-ca divizje të ushtërisë u ranë Suljotëvet të kështjéllur nër katundet Avarik, Qafë dhe Samonivë. Suljotët që merrëshin me defensivën e këtyre viseve, shkëputnë nga forcat e tyre 200 burra edhe u-a çuan ndihmë atyre që po mprojin kryekatundin Sul. Po këta pa harrijtur të marin vënt pranë bashkëluftarëvet të tyre, befas u gjëntnë ballë-për-ballë me një trup Alipashalias të vërvitur nga kurrizi me shpejtimën e vetëtimës ndënë kryesi të Kasëm Agë Tepelenës, edhe u gjëndën midis dy zjarresh dhe passi ranë të vrarë më të shumëtit prej 'ta, me-zi mundën të përikin ndë kodrën e sipërme të Sulit, që quhet Kuç, tek hyjtin dhe u mbyllë ndë një manastir të Shën-e-Prëmtes i

cili ishte rrethuar me një unazë murresh; aty ishin përikur edhe shumë shtëpiarë që kur invadoj ushtëria Alipashaliase. Ushtëri e Veli Beut duke-u-rënë katundevet Avarik dhe Samonivë, i ndoqi Suljotët të cilët dyke-u-shprapsur përiknë ndë kodrën e Vrimës, pranë Qafës, tek edhe atje ishin vendosur për siguri shumë shtëpiarë. Kësi-mjeti ushtëri e Veli Beut passi kuqëroj gjithë pshatrat e Katër-katundit, rrethosi ngushtisht këto dy pozita të forta, d. m. th., kodrën e Vrimës edhe të Kuçit, dyke-vendosur kundër 'tyre edhe di-ca kanona të lehta.

Afëro tre muaj ndënjtin Suljotët mbyllur ndë një kështjellë të ngrehur prej një kllogjeri i quajtur Samuil. Ndë këta tre muaj hoqnë shumë të ngratët nga uria; i vetëmi ushqim' i tyre ishte bar' i egër, fletët e shelgjishtavet, lëndet, edhe rrënjët' e drurëvet; po përveç uriës i cfilitte ata dhe étja më shumë; ujë nukë kishin prej as gjëkundi ngaha të marin se rrymën e ujravet të malit u-a kishin shtérrur.

Kësifarësh kalojin ditët dhe javët gjer-sa passi e panë që ç'do rezistencë e tyre ishte kot-së-koti, venduan të vijnë ndë marëveshje me Veli Bejnë për t' u përdhëne me kondita, edhe passi dekllaruan përdhënien, Suljotët çfaqnë dëshirën që pas traktatit të shkojnë ndë Pargë. Si delegat nga an' e Suljotëvet u emërua Foto Xhavella, i ndodhuri ndë Janinë, me që Suljotët e Kuçit ishin pjesa m'e madhe me fisin e tij, i cili u thërrit prej Veli Pashës, dhe bashkë me Xhavellën u emërua edhe Kapedani Plaku Kuconika.

Konditat e traktuara ishin këto që pasojnë:

I). Të dalin prej Sulit të gjithë Suljotët të armatosur, dyke-marë me vethe gjithë gjën' e lëvizëshme edhe të hidhen ndë Shtatnisië, ose ndë ç'do vënt tjatër të Tyrqisë me shpërudhjet e Ali Pashës. II). T'i shpaguanjë Ali Pasha për gjën' e palëvizëshme ose për ç'do sent që s'u ish' e mundëshme t'a marin pas. III). Për siguri t'u epen atyre penge të cilët të vejin bashkë më 'ta gjer te vëndi i deshtinatës tyre. VI). Të liret e lirë familja e Foto Xhavellës,

sikurse edhe 25 Suljotë që ndodhëshin si penk ndë Janinë.

Fundja më 12 Dhettor traktati a protokolli u ndënëshkrua prej Veli Pashës edhe prej më të çquarshmit oficerë të tij, edhe u pru te krerët Suljotë [1]).

Mbassi u mbaruan të gjitha, po bëheshin gatitjet për t'ikur me gjithësej. Me që ishte për t'u përdhënë edhe Kështjéll' e Kuçit, dërgoj Veli Beu pesë njerës, një të krështerë besëtar të quajtur Zisi Ekonom edhe katër të tjerë Shqipëtarë myslimanë, të cilët kishin për t'a përmarur atë bashkë me gjith municjet që ndodhëshin ndë deposétë prej Samuillit, për të cilin u bë fjalë edhe më sipër. Passi u zbras kështjella edhe u larguan s'andejmi Suljótët, të nesërmet, kur kasnecët e Veli Pashës bashkë me Samuillin edhe të tjerë Suljotë që mbenë pranë tij, po merrëshin me peshimin e vozevet me barut edhe po bëjin inventarin e shumëfarësh sende të tjera, të cilat kishte për t'u'a blerë me të holla Ali Pasha, befas, s'dihet ngaha, u ndes

---

*) **Traktati midis Ali Pashës dhe Suljotëve.**

„PERËNDIA PAQJE DHE FALJE"

„Unë, Pashaj i Delvinës, Veli Ali Myhtar Salih Tepelénasi, n'emër t'Ali Tepelenasit Trimit (Gaziut), Valiut të Janinës, Kryevendar' i Thesaliës, Dervenxhi Pasha, pjesëtar (membër) i Këshillës nalltë të Dovletit, të mbretit mbretërvet, të të lavdëruarshmit Sultan Selim, përndanjës i kunoravet të Kralevet, që mbretërojnë me lejën e tij ndë fronet e botës, u jap të Krështerëvet të Sulit prezentin traktat".

„I). Suljotet janë të lirë të ikëjnë prej vëndit tyre me armët, posaçië të luftës, ushqime dhe ç'farë-do tjetër që të duan të marën, për të vajtur ose brënda, ose jashtë Shqipëriës, ose tek-do që të dëshërojnë gjetkë".

„II). Premtohem t'u furnizonj pa të holla kafshët të nevojshme për të transhportuar plaçkat, posaçiët e luftës, ushqimet, të plagosurit, të sëmurit, pleqtë, gratë dhe fëmijët, gjer tek vëndi ku të vendosen".

„III). Dotë marën Suljotët që mbahen si penk prej Vezirit t'im átë".

„IV). Sa prej Suljotët që të dëshërojnë të rinë ndë Shqipëri dotë marën dhurëtisht dherra edhe katunde, dhe dot gjejnë për të gjitha nder, sigurië dhe protektim nga im-atë dhe nga gjith hoxhaku ynë".

baruti dhe një ekshplozj' e tmershme lëkundi tërë malin, dhe dyke përmbysur gjithë ç'u ndoth ndë të, gropósi ndënë rrënimet e saj të gjithë të ngojë-zënit më nalt, përveç një prej Suljotëvet i cili mundi të shpëtonjë dhe iku me renda. Thuhet se pishën barutit i-a vu pshehtazi Samuilli nga dëshpërimi i tepër, ose nga fanatismi.

Suljotët passi u hoqnë dhe duall prej Sulit u pjesëtuan mbë dy grupe: Fiset e Dragatëvet, e Zorbatëvet, e Xhavellenjet, e Panomarrëvet, e Dangëlliasve, edhe të tjerë fise të vegjël të cilët zgjodhën Pargën si vënt perikjeje, mbi dy mijë shpirt, të shoqëruar edhe prej Adem Beut, Ismail Pasho Bèut edhe Veiz Vasharit që ishin si penge, muar udhën për ndë Prevezë prapo fiset e Kuconikasvet, e Bushbënjet, e Mallamenjet, e Karabinenjet, e Fotomaraset, e e Boçarenjet e.t.j., të cilët preferuan të vendosen ndë vënde të Shqipërisë, përmi 2000 dhe këta muar rrugën e Zallëngës.

Disa nga shkrimtarët e asaj kohe përmëndin që, me t'u përndarë Suljotët Ali, Pasha shkelmoj premtimet e traktatit që bëri me ata edhe se i ndoqi t'i kapinj, ata që muar rrugën për ndë Pargë, afro kur ishin ndaj të hyrë ndë qytet, po sundimtari i Korfuzit, Konti Bozhenik të cilit i-u anëkuan Suljotët, i çoj letër protestóre Ali Pashës edhe kështu ky e

---

„V). E vërtetonj me betim këtë traktat të shënjtë dhe të pashkelëshme, edhe kurrë Suljot të mos ngitet, të shahet, ose të lypet ndonjë prej kurrë-kujt për të kaluarat".

„Për dëftin bese, një kopje e këti traktati dot' u epet Suljotëvet edhe Perëndia më djektë me zjarin e shkrepëtimavet të tija, po të mos e mbanj".

„E kushentuar, legalizuar dhe ndënëshkruar prej meje dhe prej bashkëluftonjësvet me mua bashkëvëllezër të mij, të gjithë Myslimanë Synitë".

*Ndë Sul 12 Dhetor 1863.*

**Veli Pashá Ali Zadé**

*Elmaz Bej, Ismail Bej Konicjoti, Muharem Myhyrdari, Ismail Pasho Bej, Hasan Dervishi, Ago Myhyrdari, Abidin Zarhani, Ymer Dervishi, Meço Bono, Haxhi Proni, Latif Hoxha, Hyso Toska dhe Abaz Tepelena.*

prajti ndjekjen e tyre. Gjith po kështu, me përfundime më të keqe, përmëndet edhe për grupin tjetër që mori rrugën e Zallëngës. Kishin harrijtur ndë katund që është 8 orë lark Sulit; aty për t'u shiguruar më mirë hyjtin dhe u vendosnë te Manastiri që quhet i Zallënges kur ndaj t'agumit të 16 Dhetorit u dukën nër rrëzimet një trup ushtarësh ndënë kryesi të Beqir Çogadurit, te po vijin. Suljotët ndënë kumandë të Kapedanëvet të tyre u kështjelluan ndë Manastir, edhe mbajtin një luftë të dy-ditme me Alipashaliasit. Pas dy dit, njëri prej Kapedanët, Kuconika, me partin e tij u përdhanë te Çogaduri, i cili takoj të jetë dhe vëllamë me Kuconikën se patnë shërbyer të dy bashkë ndë hobor t'Ali Pashës. Po të tjerë udënë Kiço Boçarin mbasi vendosnë gratë dhe fëmijën ndëpër shkëmbënjt e mëdhenj përmi Manastir, duall prej Manastirit, u vërvitnë mbi Alipashaliasit, me qëllim të përçajnë rrjeshtat e tyre, edhe pas nje goditje të kohëshkurtme, po të pergjakshme, dyke dëpërtuar përmes ushtëriës mundën të shpëtojnë 140 veta.

Kiço Boçari, si-kur-se thamë bashkë me 100 shokët e tij, së pari u vendosnë ndë Burgarell, tek ishin shpërgulur gjithë part' i këti fisi të Suljotëvet, po pas pak kohë dykë parë që ay vënt s'është aq' i mirë për ta, mori më vetëhe të gjithë shtëpiarët, si nj'a 1150 shpirt që ishin aty, edhe më 22 Dhettor vajti e pasnguli ndë një Manastir të Shën-Marisë ndë Vreshtanicë të Agrafës.

Nga sa kuptohet, Boçari nuk ushqente qëllime të mira mbë Ali Pashën edhe ngritja e tij prej Bullgarellit ndë Agrafë e kalli ndë dyshim Ali Pashën.

Nuk kaloj shumë kohë edhe i-u bë e njohur nga njerës besëtarë, që, një marëveshje komplloti kundrë Ali Pashës po éndej midis tyre, dhe përandaj nuk' e mënoj t'a shtypinj lëvizjen dyke çuar kundrë Suljotëvet një ushtëri ndënë kryesi të Beqir Çogadurit, Kostë Pulës, Ziko Mihal edhe Xhima Alekos, te cilët e rrethosnë an' e mbanë Manastirin dyke-i bllokuar ngushtë të brëndëshmit.

Pas tre muaj rrethimi, me që s' dojin të përepën,

ushtëri e Ali Pashës ndë një asallt të rreptë natën e 14—15 të Marsit 1804, pas një luftë të keqe i-u qasnë kështjellës, çanë dyert' e saj edhe hyjtin brënda ndë manastir tek passi prenë shumë nga ata, të tjerët u përdhanë. Kiço Boçari vet i 80 mundi të shpëtonjë dyke-dalë nga një derickë e manastirit. Nga këta që iknë, 65 veta muar malet e Agrafës, të tjerët 15 veta nër të cilët ish dhe i bir' i Kiços, Marko Bóçari, Trimi që lëftoj për lirimin e Greqisë, përiknë ndë Pargë, edhe s'andejmi ndë Korfuz, tek pas kohe vajtën dhe shumë Suljotë të tjerë [1]).

Suljotët e përdhënur u përndanë ndëpër vënde të ndryshme të Toskërisë dyke-marë si dhurëti prej Ali Pashës gjith-se-cili nga di-ca sllogje árash për të punuar ose edhe si bujqër ndë pronjat e tija.

Pa kaluar shumë kohë qetësie ndë Toskëri, një tjatër lëvizje u tfaq përsëri kundër Ali Pashës. Përsëri Bejlerët dhe Agallarët e Çamërisë, pa nonjë farë-shkaku, vetëm se ushqejin cmir dhe urrejtje kundër tij, të bashkuar edhe me Mustafa Pashë Delvinën, bëjtin një lidhje midis tyre. Kjo lidhje u bëjt ndë Qërshor 1804 prej Mustafa Pashës, Islam Be Kokës, Mehmed Dajlan Konispolës, Islam Pronit Paramithiës, Balo Hysen Margaritit, edhe Hasan Çaparit prej Fierri. Kushpiratórët venduan të kërkojnë dhe përkrahjen edhe bashkë-punimin e miqvet tyre të

---

[1]) Të gjithë Suljotët e ekshpullzuar prej Ali Pashës dhe të përikur ndë Korfuz, u përrjeshtuan ndë ushtërinë Ruse të Korfuzit ndënë kryesi të Rusit, Iwan Bikentor qe më 1804 gjer më 1806. Më pas shërbyen edhe përanë Frënqvet, 3000 burra që më 1807 gje më 1815. Kënga e më-poshtme kallëzon ngjarrjen pjesëtisht.

## SULJOTËT NDË KORFUZ

*Ti more Foto Xhavella,*
*Seç' na bëre me kapella;*
*Seç' u prem' e seç u vrame,*
*Sul' e shkretë ku e lamë?*
*Ali Pashajit i-a dhamë.*
*Nat' e ditë rim' e qajmë,*
*Fati ndë Korfuz na hodhi,*
*Zumë dorë te Moskovi;*
*Me Moskovin lith kuvëndin,*
*Të vemi të marëm vëndin;*
*Vem' e vdesim ndë dhet t'ënë,*
*Atje tek e patëm thënë:*
*Vdesim me dyfek ndë dorë,*
**Si dhëndurë me kurorë.**

MALET EDHE SHESHET E SULIT

BKSH

lashtë, Suljotëvet, edhe pra dërgojnë ndë Korfuz të bir' e Çaparit, Musanë, për t' u marë-vesh me 'ta.

Suljotët e pranuan proponimin edhe bashkë me Çaparin dërguan dhe ata delegatë ndë Pargë Foto Xhavellën, Kiço Bóçarin, Tushi Zervën ede Gjokë Dangllinë; atje kishte vajtur edhe Hasan Çapari bashkë me disa Bejlerë të Çamërisë edhe u be marë-veshj' e besë-lidhjes (aliancës), konditat e së cilës ishin vepërimi së bashku kundrë Ali Pashës për t'u shkëputur prej tij, për lirimin e pengjevet q'u pat marë për siguri, edhe mâ së fundi po t'u vinte mbroth puna, Sulin t'a nxirjin nga duart e Ali Pashës edhe t'u-a kthejin prapë Suljotëvet.

Passi u ndënëshkrua traktati u nisn' e vanë prej Korfuzi ndë Pargë të gjithë Suljotët sa ishin të zott' e pushkës si nja 300 veta. Ndë këtë kompllot kundër Ali Pashës, duket kjarisht vepëruan dhe autoritétet Ruse të Korfuzit të cilat u dhanë përkrahje të mjafta, dhe kjo u dëshmua se bashkë me Suljotët që vajtin ndë Pargë ishte edhe një grek nëpunës i Rusëve i ngarkuar me misiunë të përkujdeset për përmbajtjen edhe rrogë-pagesën e luftonjësvet, edhe t'u furnizonjë atyre të posaçmet e luftës. Kështu pra trup' t Suljotëvet që prej Parge vajti ndë Fierr tek u bashkua me aliatët që i prisjin aty.

Po edhe kjo aliancë e mërékullshme i pat ditët e shkurtëra edhe u kotësua që posa filloj veperimet, me që u gjënt kundrejt fuqiave ushtëriake të forta të Ali Pashës. Dhe kësi-farësh, mbas dica përpjekje heroike kundrë ushtëriave të Ali Pashës, Suljotët, të dërmuar passi bllatuan më të shumit e shokëvet të tyre. u kthyen ngaha patën ardhur, ndë Pargë, edhe s' andejmi prapë ndë Korfuz.

Pas përkuljes së mbrame të reakcionarëvet të përbrëndëshmë, Ali Pasha mori masa të rrepta për të shterrur ç'do lëvizje të armikëvet të tij dykengrehur ndë Sul edhe ndë vëndet e tjera të Çamërisë ndë ç'do pozitë të mirë kështjella edhe gjithfarësh fortesime.

## KREJ XIII.

Pas shpërndarjes të gjithë reakcionarëvet ndë shtetin e sunduar prej Ali Pashës, zotonte paqtim, edhe populli merrej vetëm me luftën paqëplottë të punës. As një vrasje ose keqbërje nukë dëgjohej kurrkundi. Andaj pra Guverna e Konstandinopójës, si shpërblim për këto shërbime, të cilat të rrallë ishin sundimtarët e asaj kohe që t'i bëjin, emëroj të bir' e tij Veli Bejnë, për governor të Pelloponisiës, edhe ati vetë i konferoj gradin Vali i Rumeliës, dyke-i ngarkuar misiunën që të bjejë ndë rregull anarhiën e paprajtur që zotonte ndë Maqedhonië edhe ndë Thrakë. Ndë këto vënde çetat e kusarëvet të emëruar përgjithërisht «*hajdutëri me kuaj*», të kurajuar nga Kryevendarët e Samokovës edhe të Shkupit, Halil Pashës edhe Karafejzi Pashës, cfilitjin pa mëshirë popullin e ngratë.

Ndë dekretin e emërimit të tij, urdhërohëshin të gjithë qeveritarët e provincavet t'i epjin ati gjithfarësh ndihmë. Kështu pra, i eqipuar me gjithë ç'i duheshin, ndë ballë të 5000 Shqipëtarëvet Tosk' e Gegë, kaptoj Pindon ndë Tettor të vitit 1804, dykelënë mëkëmbës të birë Myhtarë. Gjer mbërrini ndë Manastir ushtëri e tij shtohej e shumóhej parreshtur. Traversój me fuqin' e madhe Maqedhoniën gjer ndë Filibé dhe ndë Sofje, edhe e permbushi plotësisht misiunën e tij dyke-ndjekur edhe farosur krejt brigandët e kodravet. Vërtetohet që një pjes' e madhe e këti sukçesi i detyrohej njëjt nga oficerët e tij i qnajtur Myslim Gega i cili ishte tepër i zoti edhe i përvuajtshën ndë ndjekjen e kusarëvet.

Po midis këtyre Porta u frikua për ushtërin' e madhe që bëri Ali Pasha me vethe edhe dyke-esuspektuar atë, shpejtoj t'i dërgonjë një dekret të ri tek e urdhëronte atë të kthehet prapë ndë qëndrën e sundimit të tij me ushtërinë bashkë, edje jo vetëm kaqë po edhe gradin e Valiut Rumeliës i-a shterri.

Këtë animozitét e gëlltiti pa dashur Ali Pasha edhe pa mënuar u kthye ndë Janinë, krye-lartë që mbaroj

detyrën e tij po zëmër-thyer për sjelljen e pa-fisme edhe dinake të Portës së Naltë.

Sikurse e dimë, ndë Shqipërin' e Poshtme veç Ali Pashës zotojin edhe dy sundimtarë të tjerë, Pashaj i Delvinës edh' ay i Beratit të cilët nga cmiri ushqejin një urrejtje të madhe mbë Ali Pashën me gjithë që me atë të dytin ishin edhe krushq. Këta të dy sundimtarë Ali Pasha i kishte muriza ndë vepërimet e tija edhe pengimtarë përandaj donte t'i pastronjë tani që fuqit' e tija vlukojin.

Pra-po, kundër Pashës të Delvinës çoj ndë Jenar 1806 ushtërin' e tij me kanona të mjafta edhe passi e rrethosi, i kuqeroj fortesën, kur Mustafa Pasha bashkë me familjen e tij përiku ndë një nga çifligjet e tija afër Delfinës. Për këtë përmarshim Pouqueville-i thotë që dyke-shkuar nga Delvina kur po vij si reprezentant i Guvernës Frënge ndë Janinë, e gjet Delvinën të kuqeruar prej ushtëriës të Ali Pashës. Fundja Mustafa Pasha u ngut t'i dekllaronjë që i falet edhe t'i japë për penk dy djemt' e tij.

Më 1805 ambasada Ruse ndë Konstandinopojë protestohej pa rreshtur kundër Ali Pashës edhe Porta për të satisfaktuar namëta, Guvernën Ruse e zbriti Ali Pashën prej Pashallëkut të Thesaliës edhe gjithkohësh e pushoj edhe të birë Veli Pashën prej gradit që kishte bashkë me atë titull si Sundimtar i Pelloponisiës, edhe emëroj për Pashá ndë Thesali një nipn' e Ali Pashës prej motre, Ali Elmaz Bejnë, d. m. th., të bir' e Hajnicës edhe të Sulejman Beut. Po ky pas një kohë të shkurtër vdiq prej lëngjyeri.

Pas vdekjes të Elmazit, Ali Pasha dërgoj ndë Thesali një nga gjeneralët e tij si nëkëmbës, edhe gjithkohësh me mjet të miqvet të tij ndë K/pojë, ndër të cilët ishte edhe ambasador' i Francës, K. Sebastiani), përmundi t'i besohet përsëri Pashallëku i Thesaliës si dependencë, edhe u emërua së rish edhe i Pelloponisiës Sundimtar. Edhe kështu pra Shteti i Ali Pashës atëherë përshtrihej ndë Toskërië, Thesalië, Pelloponisië edhe ndë Greqi të Perëndimit.

Pamë më sipër që me anë të traktátit midis Rusiës dhe Turqiës të ndënëshkruar më 21 Mars 1800,

Shtatnisija mbeti ndënë protektë të Rusiës; Preveza, Vuthroti, Parga, edhe Vonica që ishin më parë pushtime të Venecjanëvet edhe të Frënqvet, të njohura si shtete demokratike, hyjtin ndënë zotënim të Portës edhe guvernohëshin prej një Vojvodë i quajtur Abdullah Bej i cili kishte qëndrën ndë Prevezë. Më 1806, kur punët ndë Evropë muar ndryshim, edhe më tepër kur marëdhëniet midis Rusisë dhe Tyrqisë ashpërohëshin dita-ditën, Ali Pasha përfitoj rasën e kohës edhe lypi ndë Stamboll t'i çedohen ati këto pronja të kuronës. Edhe Porta i-a shiti ato si pronja të jetëshme (*mylk-namë*) për 800 qése aspra. Pas-si i-u çeduan ato, zapëtoj përnjëherë Prevezën edhe Vonicën; Vuthrótin po e kishte ndënë pushtet të tij. Edhe posa krisi lufta Ruso-Tyrke vitin më pas, filloj të ngrehjë disa kështjella ndë Prevezë, sikurse edhe kundrejt Lefkadhës ngrehu fortesë edhe pranë 'saj palláte [1]), pllanin e të cilavet i-a pat dhënë oficeri Frënk Vaundoncourt i dërguar énkazi prej Autoritétevet frënge të korfuzit.

Nga të katër qytétet autonome vetëm Parga nuk' ishte ndënë sundim të Ali Pashës. Sikurse e pamë, ky qytet, i përdhënë Tyrqisë më 1800 bashkë me të tjerat pushtime, qeverisej autonomisht prej një Komiséri që ishte gjith' ay që qeveriste qytetet që zumë ngoje më sipër, edhe paguante një tribut posi edhe të tjerat qytete Preveza edhe Vonica.

Ali Pasha dëshëronte prej kohësh t'a ketë ndën' urdhër këtë qytet po kishte pengime të shuma nga an' e Rusërvet të cilët zotojin nd'ato kohë Korfuzë. Pas konventës t' Ali Pashës me Portën përmi qytetet që perbëjin kufederatën, me që Abdullah Beut i-u t' hoq ofiqi i tij, Parga mbeti si dependencë e Korfuzit, e qeverisur nga qytetárët e saj.

Rellatuam më sipër përmbi aliancën e Çamërvet me Suljotët edhe qysh mundi Ali Pasha t'a kotësonjë atë. Po pas kuvëndit me Portën permbi Pre-

1) Ndë këto pallate Ali Pasha hospetój madhështisht Mbretin e Suediës Gustav Adolf-in, i zbritur nga froni prej Bernadott-it.

vezën edhe qytetet e tjera, filloj të rregullonjë ca llogari që kishte me di-ca Bejlerë edhe Agallarë të Çamëriës. Së-pari shëndoshi pushtetin e tij mbë vëndet pëllore të Fierrit të cilat ishin të Çaparénjvet; edhe më pas ktheu vështrimin e tij mbë Pronjatët e Paramithiës. Dyke-pasur pranë tij si penk një të bir' e Islam Pronit mundi t'a ngusinj atë të përapë fortesën e Paramithiës, Shën-Dhonáton. Ndërmjet këtyre, ndë Filat, me prokllamátë të Hassan Çaparit bëhet një miting prej Çamër, Gjinokastritë, Sulladhjotë edhe Konispoljótë, tek vendimuan edhe i lypnë Ali Pashës, të t'hiqet nga vëndet e Fierrit edhe të heqinj ç'do pretencjë mbë Shën-Dhonaton, t'u përapë Sulin fqinjëvet t'afërm Agallarëvet të Çamëriës, edhe të lironjë të bir 'e Islam Pronit.

Ali Pasha me të marë këtë tejshkrim, u përgjeq që, fortesën e Paramithiës edhe Fierrin i pat blerë me të holla edhe se vëndin e Suljotëvet e kuqeroj me *ferman* edhe me gjak; me gjith-këto u përmbushi një nga lypjet e tyre dyke-liruar të bir' e Islam Pronit, i cili i premtoj se ka për të propaguar qetësinë ndëpër ata. Po Proni ndë-vënt të mbanjë premtimin që dha, i pezmatój edhe më tepër reaksionarët, edhe pa kaluar shumë kohë zunë tfaqëshin çeta kryengritëse ndë disa vënde. Ali Pasha çoj një fuqi të fortë ushtërijë ndënë kumandë të Sheh Maksut Agës edhe Ymer Begut nga Zavaláni kundër Pronjatëvet të Paramithiës, të cilët mbassi i rrethosi ngushtisht, i nguti të kapitullojnë dyke-proponuar kondita marëveshjesh ndër të cilat me t'u përdhënë kështjella, Pronjatët duhej të çatdhesohëshin dykemarë me vethe pronjat e lëvizëshme të tyre.

Passi u pranuan konditat, të gjithë këta, edhe me 'ta bashkë edhe disa të tjerë agallare, si Çaparénjtë, Maliq Grava, Isuf Demua, Balo Hysua edhe të tjerë, përiknë ndë Pargë; s'andejmi dyke-vajtur ndë korfuz pas pakë kohë shkuan ndë Egjyptë tek mbenë pranë Mehmet Ali Pashës i cili ishte kediv i Egjyptës edhe vlukonte asi kohe atje.

Kësi-mjeti Ali Pasha mundi t'a përndajë edhe këtë levizje të re të reakcionarëvet.

Kështu ishin punët, kur ndë krye te vitit 1807 krisi lufta Ruso-Tyrke, edhe tani Ali Pashës një tjatër shënjë i tërheq atencjën, kjo ishte ujdhesa Lefkadhë. Na është i njohur atenti që bëri Ali Pasha për të pushtuar Lefkadhën që posa kuqeroj Prevezën. Po këtë atent i-a kotësoj prezenca e flotës Ruso-Tyrke edhe përdhënia e kështjellës ndë duart e Admirálëvet Ouchakow edhe Kadri Bej. Mbas përndarjes të kufederatës vogël të së katër qytétevet Toskënore edhe passi i-u çeduan Ali Pashës me dekret, dyke-i-u-qasur edhë më shumë Lefkadhës, ndjeu ëndën e ritur më tepër tani për të përfituar prej shtetit të punëvet që vazhdojin ndë Evropë.

Dhe me të vërtetë atëherë ndë Evropën qëndróre edhe ndë Konstandinopojë zotëronte ylli i Napolonit, i cili me mjet të ambasadorit të vlefshëm të tij, Sebastian, mundi t'a shkëputnjë Sulltan Selimin prej inflluencës Anglo-Ruse, edhe rellatat miqësore midis Rusiës edhe Portës u ashpëruan më tepër pas zaptimit të Suveranitétevet prej Rusërvet; se për këtë me t'u lajmuar Porta, i çoj me vrap pashaportat Ambasadorit Rus pranë Saj, edhe passi mbylli ngushtinat e Dardanelavet edhe të Bostorit, dërgoj ushtëri të madhe me gjithë anijat luftare që t' i nxjerë Rusërit nga Suveranitétet. Edhe kështu me ngacmim të Bonapartit, Tyrqia dekllaroj zyrtarisht luftë kundrë Rusiës.

Dekllarata e kësaj lufte ishte parolli i vepërimit Ali Pashës kundër Rusërvet të Lefkadhës, i cili përveç kësaj kishte edhe të tjera shumë anëkime kundër Autoritétevet të Shtatnisiës, se që-kur-se më 1800 njdhesat Ioniane me traktat hynë formalisht ndënë protektë të Portës po realisht ishin ndënë Rusiën, autoritetet Ruse që ishin ndë 'to, nukë reshtjin së dhëni trévë (azill) ç'do keqbërësi të përikur nga pushtimet e áfërta të Ali Pashës, edhe më shumë pas kuqerimit të Sulit prej tij. Kjo sjellje e autoritétevet të Shtatnisiës që shkelmonte traktatin epte arësye jo vetëm Ali Pashës po edhe Portës vetë e cila i përmëntte këto ngjarje si një nga të parat shkakëtime ndë dekllaratën e luftës më 5 Jenar 1807. Shumë

prej të emëruarit *hajdutë* Suljotë edhe të tjerë, dykepatur për shtek Lefkadhën edhe ujdhesat e afërta, kur gjejin rastin invadojin ndë Toskëri edhe passi ripjin edhe sfilitjin vëndet e ndënë sundim të Ali Pashës, të ndjekur nga ay hyjin prapë ndë Lefkadhë, tek e shkonin me siguri pa as një farë-frike nga ndjékësi i tyre. Ndë kohën e paqës qeveritarët e Shtat-nisiës ndë shumë raste dojin të zhustifikohen për përkrahjen që u epjin invadorëvet, edhe herëherë për t'a satisfaktuar Ali Pashën, Rektóri i Lefkadhës kapte nga-ndonjë nga vrásësit që kërkohej prej tij, edhe me urdhërim të Pleqësiës e përepte ndër duart e Ali Pashës, edhe të tjerë dica si përfaqe ekspullzóheshin prej Lefkadhës.

Pas këto përtregime miqësore të autoritétevet të Shtat-nisiës, Ali Pasha héshti për ca kohë. Po ndë Jenar 1806 i dërgon Senatit ndë Korfuz një dokument të ri ndek përmëntte gjith-po-ato ankime edhe u lypte t'i përepjin familjet e armatorëvet që gjëndëshin ndë Lefkadhë t'i mbante për siguri; po këtë herë Guverna Shtat-nisiase refuzój t'i-a përmbushnjë lypjet. Mirë-po punët politike ndë Evropë ishin të pasigurshme edhe Shtatnisia kishte nevojë të furnizonjë prej tokës më të shumat e të posaçmevet për përmbajtjen e saj, përandaj përfaqësónjësi Rus i Korfuzit, Moçenigu, i proponoj Senatit t'a ketë mbë pekul Ali Pashën, me ç'do mjet t' a tratonjë mirë, edhe kështu një marëveshje bëhet midis Ali Pashës edhe autoritétevet Ruse me anë të së cilës, sidomos, kanunohëshin çështjet e skandullëshme edhe të zvarnisura. Kështu qëndrojin punët përpara se të kërcasë lufta Ruso-Tyrke.

Ali Pasha dyke-parë gjithë ç' sillej nga shkaku i hyrjes të ushtërivet Ruse nër Suveranitétet e veçanëshme, kujtoj që ishte rasti oportun për të realizuar edhe një nga ëndërat e tija me të kuqeruar Lefkadhën, e cila pas Prevezës edhe Vonicës kishte vleftë të madhe për të ndë pikëpamje strategjike. Andaj pra pa vonuar filloj pregatitjet e shpejta për vërvitjen e shtudijuar. Më t' u lajmuar për këtë Guverna e Shtatnisiës, dërgon ndë ujdhesë Kollonéllin

Rus Zages, edhe e forcoj garrizonën dyke-dërguar një fregatë ruse, dy brike [1]) edhe katër trumba Suljotësh nga ata që ishin përrjeshtuar ndë ushtërinë ruse. Kjo fuqi fryjti kurajë nër ndënjësit e nisiës edhe shumë nga nisjotët u rrjeshtuan si vullnetarë.

Lëvizjet e Ali Pashës tregojin se për së shpejti do-t'i binte ujdhesës. Garrizona e Prevezës sa vij po shumohej edhe forcohej, edhe punëtorë punojin dit-e-natë për trajtimin e gjith-farësh punë fortifikátash.

Gjithë këto pregatitje po bëhëshin, po as-një çap për vërvitje nukë podukej se sikurse thamë lufta Ruso-Tyrke nuk' ishte dekllaruar akoma. Pas dekllaratës të luftës, Porta me Guvernën Frënge u qasnë ndë marëdhënië miqësore, andaj Ali Pasha i shkrojti Napolonit t' i japë edhe ay ca ndihmë që të vërvitet kundër Rusërvet të Shtat-nisivet. Napoloni i dërgoj sakaqëherash vëllajt të vet Iosifit, që ishte mbret ndë Napolië, t' i çonjë Ali Pashës ndihmë të shpejtmë. Edhe Josifi pa vonuar fare i dërgoj një vapor lufte të math edhe një korvetë, të cilat passi lundruan që nga anëdetjet e Mbretërisë Napoliës, zbritnë ndë ushtrinën e Ali Pashës përkundrejt Lefkadhës një batalón artileristë me disa kanona edhe municje lufte ndënë kumandë të dy oficerëvet.

Kësi-farësh Ali Pasha passi kuqendrój fuqit' e tija ndë Prevezë, dërgoj një trup ushtërie të fortë ndënë kumandë të Isuf Arapit, edhe vendosi shtabin e përgjithëshm afër pozitës që i thonë Pllajë, ndë vëndin më të ngushtë të mëngës që ndan tokën prej nisiës. Dy oficerë frënq, Kollonelli Nicole edhe Trumeri Ponceton, mbërrinë ndë Prevezë më 18 Fror 1807, edhe me ndihmën e këtyre Ali Pasha trajtoj fortesa ndë majë të një kodre pranë vëndit që quhet Kastrë, edhe tjatër fortesë filloj të trajtonjë përmbi një kodrë që i thonë e Shën-Gjergjit, e cila nuk' largonte shumë prej Kështjellës së Lefkadhës. Gjenerali Rus, dyke-parë gjithë-këto, kumandoj zjar të përgjithshëm kundër Shqipëtarëvet, të cilët se parihërë u kthyen përsëri edhe vazhduan punën e tyre

1) Vapore lufte të asikohëshme.

gjer e mbaruan mirë fortesën e Shën-Gjergjit, mbi të cilën pas katër dit vendosnë dy kanona, me të cilat filluan rrahjen e *kalasë* së Lefkadhës, po edhe armiku u përgjigjej me zjar të paprajtur.

Ndërmjet këtyre, një mijë Shqipëtarë kishin zënë një pozitë kundrejt kështjellës së Lefkadhës ndek një Teqé e vjetër e cila ishte e shëndoshur me murre të çmërshta; aty ushtarët e Ali Pashës kishin prerë ç'do komunikatë të ujdhesës me anë deti. As-një lundrë s' mundrej të hynjë ndë liman' e Lefkadhës. Nga ky shtet tregëtia ishte prerë së-gjithash, edhe mungesa e më të nevojshmevet posaçië sa vij i sëndiste Rusërit edhe vëndësit nisjotë. Për shumë ditësh lufte të dyja anët beligjeránte përcaktohëshin ndë kanonada të njërjatërme pa përfundim. Së mbrami Gjenerali Rus dyke-vëzhguar që kanonat e kështjellës nuk' i dëmtojin fare Shqipëtarët e Teqesë, natën dyke-gdhirë 9 Mars, ngrehu përanë buzëdetjës një kështjellë, edhe passi vendosi ndë të dy kanona kalibri të math, edhe një tjatër kanon fushe mbi një brek midis Lefkadhës edhe Cekës, filloj t' u bjerë Shqipëtarëvet me qellim t' i shkulnjë prej Teqesë, po ushtarët e Ali Pashës nuk tundëshin fare dyke-u-përgjegjur trimërisht kanónavet të Rusërvet. Dykeparë Gjenerali Rus që edhe ky pllan strategjik nukë pruri sukçes, të nesërmet dha urdhër që, dy trumba Rusër edhe Suljotë, edhe si nj'a tri trumba vullnetarë vëndës, të shkojnë ndëpër kënéll' e ngushtë që e ndan Lefkadhën prej Toskërisë. Këta dyke-shkuar përpara edhe passi u pjesëtuan ndë dy trupa, zunë vënt këtej-e-përtej Teqesë ndek ishin Shqipëtarët. Ndaj agimit të 11-ttë Marsit po bëhëshin ca përpjekje të vogëla, po pas mezit ditës passi Shqipëtarëvet u erdhi një ndihmë e mjaftë ndënë kumandë të Isuf Arapit edhe Beqir Çogadurit, beteja u përgjithësua. Rusërit, të kumanduar prej vetë gjeneralit të tyre, ndë krye bëjtin një vërvitje të kuximshme dykezaptuar të përpjetat e kodrës ndek dirgjej Teqeja me qëllim të mbërrijin ndë fortesë edhe t'a kuqerojnë, po Shqipëtarët ndënë kumandë të të dy oficërëvet të tyre u vërsulën përmbi 'ta me aqë vrull të

shpejtë sa pas tri orësh lufte gjenerali Rus dyke-parë që do-të vritëshin të gjithë ushtarët e tij trumbetój shprapsje. Suljotët edhe vullnetarët e tjerë lëftuan edh' ata pas 'tyre po së sosmi kur panë se Rusërit u thyen, sakaqëhérash u vanë pas dyke-hyrë të gjithë ndë fortesën e Lefkadhës. Përmbi tre-qint ranë të vrarë e të plagosur nga an' e Rusërvet, midis të cilëvet edhe mjaft Suljotë vullnetarë; nga Shqipëtarët u vranë tetë edhe u plagosnë dy-mbë-dhettë. Edhe kështu, bombardimi i Lefkadhës po vazhdonte po-si edhe më parë. Këshilla e Korfuzit dyke-parë rrezikun e afërt të ujdhesës nisi të dergonjë atje fuqi të parreshtura të përbëra prej ushtëri të rregullshme edhe të parregullshme. Ndë këto të mbramet kryesonte një Kapedan i quajtur Jan Kapodhistrë [1]) me vullnetarë Korfuzanë. Ky mundi t'a ndihmonjë gjeneralin Rus ndë mprojtje të Lefkadhës se veç shokëvet të vet që kishte i bëjti që të marën anë edhe shumë nga të krështerët Kapedanë Shqipëtarë, si Kaçandónin, Kiço Boçarin, Kollokotronin, Karaiskon, cdhe të tjerë me shokët e tyre të çquarshëm ndë virtyta luftare, të cilët me që ishin ndë armiqësi me Ali Pashën, u mblodhë të gjithë për të mprojtur ujdhesën.

Katër muaj plot mbajti luft' e Ali Pashës me mprojtësit e Lefkadhës, edhe si-do-që nisia mprohej prej shumësiës të ushtarëvet Rusër edhe nga Kapedanët që thamë, Ali Pasha po bënte pregatitje edhe pllane për një asallt definitiv kundër ujdhesës edhe ishte sigur për kuqerimin e saj, po fatkeqërisht pllani i tij mbeti i pabërëshm nga shkaku që, pas betejës të Freedland-it midis Rusërvet edhe Prusianëvet me ushtërin 'e ndënë kumandë të Napolonit, më 10 Qërshor 1807, u dekllarua armistitë edhe pas pakë kohë Paqa definitive e Tilsit-it. Gjenerali Rus i Lefkadhës e lajmoj Ali Pashën për këtë. Ali Pasha me pakënaqësi e mori këtë lajm (që i-a kotësoj shpresat për kuqerimin e ujdhesës me dorëndihmën e Napolonit) edhe u përgjeq që ay nukë kishte marë asnjë

1) Ky u bë i parë Governór i Greqisë kur kjo fitoj independencën.

informatë zyrtarisht për armistitën, po, për hir të Gjeneralit ka për dhënë urdhërim të pushojnë hostilitétet. Po e vërtata që e bëjti Ali Pashën t'a përndajë definitiv rrethimin e Lefkadhës ishte pushtim' i Korfuzit prej Frënqvet që u bë e njohur pas pak si përfundim i konvencjës midis Car Aleksandrit edhe Napolónit ndë Tilsit. Këtë e mësoj Ali Pasha me kohë edhe u drojt nga ndonjë vërvitje nga an' e Frënqvet të Korfuzit kundrë Prevezës, me që edhe kjo ishte një pjesë nga pushtimet e Venecjanëvet ndë Toskëri.

## KREJ XIV.

Mbarimi i luftës Ruso-Tyrke më anë paqeje, u dha kurajë brigándëvet *(hajdutërvet)* të ndodhur këtu-këtje ndë provincat e Ali Pashës. Një nga këta brigandë ishte një prift i quajtur Papa Thimjo Bllahava ; ky u tfaq ndë Thesali me 1808 me një çetë të madhe ndë të cilën kishte përmbledhur edhe jo të pakë myslimanë Shqipëtarë armikë të Ali Pashës. Prifti Kapedán, i bazuar mbë fuqin 'e madhe të tij, vij me qëllim të përhapnjë çeta kryengritëse ndë gjithë vëndet e ndënë sundim të Ali Pashës edhe për-këtë kishte hyrë ndë marëveshje për bashkëpunim me Suljotët e Korfuzit edhe me të tjerë Kapedanë që ndodhëshin aty, të cilët atëherë ishin ndë shërbim të Frënqvet kur u pushtua Korfuzi prej Mareshallit Berthier ndë Korrik 1807. Këta Kapedanë, ndë kohën kur Shtat-nisia ishte ndë dorë të Rusërvet më 1804, përbëhëshin një trup gjer 3000 burra luftëtarë, edhe disa herë luftuan burrërisht ndë luftërat midis Rusërvet, Tyrqvet edhe Frënqvet ; Suljotët lëftuan edhe ndë Dallmati edhe ndë Itali. Ndër ditët që dolli Papa Thimjua ndë Thesali, ky trup i Suljotëvet të Korfuzit shëkohej me sy të keq prej Frënqvet, për shkak se mohuan të japën betim devotimi më që ishin më parë ndënë shërbim të Rusërvet edhe me as-një mjet nukë dojin të luftojnë kundër 'tyre. Krerëvet të këti trupi u dërgoj Bllahava edhe bëjti marëveshjë të luftojnë së-bashku kundër

Ali Pashës. Po pllani i Priftit (përgjithërisht i quajtur prej Labërvet, Papa-Dhemon), mbeti i pa-bërëshm se i-u káll ndë vesh Ali Pashës prej një nga oficerët e tij i quajtur Kapedan Delián Meçoviti.

Sikurse thamë Bllahava pas marëveshjës me Suljotët, ndë ballë të çetavet të tija rrudhi ndë Akarnani edhe harrijti gjer ndë Meteóret, ndek u pojt ballë-përballë me Myhtar Pashën [1]) të bir' e Ali Pashës. Pas dy orësh lufte me ushtërinë Alipashaliase, gjysmët nga shokët i-u vranë midis të cilëvet edhe i vëllaj, Thodhoráqi; të tjerët më të shumët ikën e lanë edhe më së fundi me ata qe i mbenë u shpraps edhe përiku ndë katundin Skopellë.

## KREJ XV.

Sindëkur e dimë që nga faqet e kaluara, përanë pragut të Shtetit Ali Pashës ishin edhe dy Pashallárë të tjerë independentë të cilët kishin ndënë sundim të tyre vënde mjaft të rëndësiëshme. Pasháj i Beratit edhe ay i Delvinës, që të dy me miq të fortë ndë Stamboll. Këta sundimtarë fqinjë Ali Pasha i kishte posi hálë ndë sy, se me gjithë-që sikurse treguam u hoqi nga një shuplakë, ata nuk rreshtjin së kálluri te Divani gjithfarësh kallëzime të rema kundër 'tij.

Pasháj i Beratit, Ibrahimi i cili ishte edhe krushk me 'të, me-qënë-që të dy bijat e tij ishin martuar me të dy bijt 'e Ali Pashës, i fortë kryevendár, i dëgjuarshëm për origjinën e tij se ishte prej derës

1) Beteja e Papa-Thimjos me Myftar Pashën, ndë Thesali më 1808.

*Myftar Pasha shkoj Vuninë,*
*Të piqetë me Vezirë:*
*Udh' e mbarë mbë qafirë.*
*Myftari shkoj Kallabakë,*
*Me ca djem me ca zëmbakë*
*Duke-ecur dit'-e-natë.*
*O, prift, o Papa-Dhemoni,*
*Na rrëfé, qysh t'a ep nomi?*

*Mun' te ura e Kastraqit,*
*U thye kordh' e Thodhoraqit.*
*O Kapedán Thodhoráqi,*
*Se ç' të vrau Karaiskaqi;* [1])
*Se ç' ta punoj Kapedani,*
*Kapedani Delijani;*
*Delijani Meçoviti*
*Të dha me dorë evgjiti.*

1) Trumér ndë ushtërin e Ali Pashës.

të Sinan Pashallárëvet të parët kuqeritorë të Toskërisë, i kishte cmir krushkut të vet, Ali Pashës, se fama e Sinánëvet u shduk, prapo inflluenca edhe fuqi e Ali Pashës sa vij po shtohej ndë Shqipërin e Poshtme ashtu edhe ndë të Sipërmen. Ali Pashës i vejin ndë vesh të gjitha intrigat që klliste Ibrahimi që t'a marë ndë mërië Divani, po nukë donte t'i vërvitej faqeza për të mos tërhequr defavórjën e Dovlétit. Andaj pra priste të tfaqej rasti oportun i cili t' i-a legalizojë ç'do vepërim kundër tij. Edhe rasti i pritur nukë mënoj të vinjë.

Që prej kohësh kishte ardhur ndë Janinë nga Egjypta, Ymerá Vrioni, një nga të çquarit bejlérë Shqipëtarë të Kazasë Beratit, i perzekutuar prej Ibrahimit dhjetë vjet më parë i cili i pat kufiskuar edhe tërë gjën' e tij. Ali Pasha e priti edhe e tratój miqësisht Vrionin armikun e Ibrahimit edhe e emëroj Mareshálll të ushtërisë. M'anë tjatër Ibrahim Pasha me mjet të një Frëngu që e kishte ndë shërbim të tij, këmbente letra me Autoritétet Frënge të Korfuzit, ndër të cilat lypte hirin e Frënqvet edhe i provokónte ata t'a urrejin Ali Pashën; di-ca nga këto ranë nër duart' e Ali Pashës të cilat ky i mbajti për t'i përdorur ndë kohë të duhur, edhe t'a prezantonjë Pashën e Beratit për trathëtor të interésavet të Shtetit.

Të dy djemt' e tij absentójin prej Janine; Veli Beu ishte ndë Pelloponisië edhe Myhtari ndodhej me ushtërinë Ottomane ndë luftën qe bëhej kundër Rusërvet përanë Tunës ndënë Vezir' e Math, Qor Isufin. Pas një këshillë me të gjithë oficerët e Shtabit të tij, Ali Pasha i ngarkoj Ymer á Vrionit barrën e marshimit kundër Beratit, me parosi që të kurcéhet jeta e Ibrahimit, edhe ky passi mobilizój një trup ushtërie të madhe, perpara muajit Tettor 1809 shkeli vëndet e Beratit dyke-shtyjtur-shkak se kishte për të shtënë ndë dorë pronjat e veta të cilat i-a pat kufiskuar Ibrahim Pasha.

Posa dëgjuan për gjithë-këto Bejlerët e Agallarët e vëndit, miqt' e Ibrahimit, nga rreziku që paravështrojin edhe për të prapsur zëmërimin e Ali Pashës ikën

edh' e lanë. Kështu pra plaku Pasha i Beratit u ngut të mbyllet ndë fortesë me ca të pakë ushtarë besnikë që i mbenë. Për gjithë këto e lajmuan Ali Pashën, i cili sakaqhërash u turr për ndë Berat ndë krye të një tjatër ushtërie të fortë edhe pas një rrethim tetë muajsh, ndë krye të Jenarit 1810 e ngusi Ibrahimin t'i përjapë fortesën edhe për penk të bir' e tij Selmanë, të përiknjë ndënë garantië të tij ndë Vlonë (qyteti vëntlerm i Ibrahimit), edhe atje të presë vendimin e Divanit.

Kështu pra Berati i kuqeruar prej Ali Pashës, me urdhrim të tij administráta e qytetit i-u ngarkua Ymerá Vrionit. Pas këto me që zunë po i vijin prej Stambollit qërtime edhe observáta nga an' e Divanit për konduitën e tij mbë Ibrahimin, Ali Pasha çoj ndë kryeqytet letrat të cilat e akuzojin Páshën e Beratit për kushpiratór të rezikshëm edhe për qeveritar të pa-zotin. Port' e Nalltë i peshój ngjarjet edhe e zhustifikój Ali Pashën plotësisht, dyke i-ngarkuar atij sundimin e Beratit, me titllin nëkëmbës-sundimtari gjer të épëshin urdhrime të ra. Ndë Vlonë Ibrahimi rrahu të ikënj me anë të detit po nuk' i ishte e mundëshme se dy vapore lufte ndënë kumandë të viqe-admiralit Ingliz, Comodor Taylor i kishin çárkur vrágën [1]). Po një natë mundi të ikënj me ca shokë të vet edhe u shduk ndë malet afër Bregdétet, ndek ndënj i pshehur ndë Cmokthinë që s' andejmi të kapërxenjë ndë Korfuz te Gjenerali Frënk Donzelot, edhe pastaj të shkonte ndë Konstandinopójë. Po Ali Pasha me t'u lajmuar për këtë dërgoj me vrap një trumbë ushtarësh për të kápur ikësin, i cili u gjënt tek ishte pshehur edhe u përdhá. Mbas këto ndënë eshkórtë u pru ndë Janinë ndek mbahej ndë Pallatet e Ali Pashës vërtet si rrop, po me gjithë pekulet edhe të mirat e Saráevet të Tepelénasit. Kësifarësh pas pushtimit definitiv të Beratit edhe përdhënia e sundimit ndë duart e gjeneralit të Ali Pashës, Ymerá Vrionit, i-u falë të gjithë sa hiqëshin për reaksionarë.

1) Anglezët kur bllokuan Frënqtë ndë Korfuz, i ndihjin ndë ç'do nevojë mikut të tyre, Ali Pashës.

Nga Bejlerët edhe nga Agallarët e Vlonës, ata që ishin të bindëshm nukë pësojin kurgjë, po disa prej 'ta që ishin kushpiratorë me Pashën e Beratit u prunë lidhur me vargoj ndë Janinë, edhe kamja e tyre u kufiskua. Këto vepërime me sukçés të Ali Pashës, i-a dymëzuan inflluencën e tij, se shumë nga Kryevendarët edhe Bajraktarët të Shqipërisë Perëndimit si, të Krujës, të Elbasanit, të Tiranës, të Kavajës edhe të tjerë, vëndet e të cilëvet nuk' ishin të qetuarshmë, i tfaqjin bindje edhe dojin të kenë marëdhënie të mira me 'të. Edhe ay Valiu i Rumelisë nga i cili inspektohëshin vëndet e zëna-ngoje më lart, i sillej përunjësisht Vezirit Shqipëtar, i cili ndë këtë kohë zotonte gjithë Toskërinë edhe vëndet e Ohrisë dhe të Korçës (veç qytétevet), përqarkjet e Delvinës edhe të Gjinokastrës, Bregdetin (Himarën), mez' e Shqipërise, Etoli-Akarnaninë me Greqin' e Lindjës gjer n'Attikë, Pelloponisinë edhe Thesalinë (Shehérin).

Qetësinë edhe sigurimin publik ndë predominatën e gjërësiëshme Ali Pasha e mbante aqë mirë me anë të dorës së tij prej hekuri që tërhoste të liqtë, sa edhe ata më fanatikët keq-përfolës biografë të tij, nukë i-a mohojnë. Eleméntet keq-bërëse ishin shdukur krejt; Hajdutëria më s' kuxojin të pipëtijnë fare. Di-ca kusarë të Limbozit (Olympit) edhe të Gramozit na duall ndë këto kohë, edhe hyjtin nër vëndet e Thesalisë tek plaçkitnë mjaft katunde, edhe më tepër ndër ndënjësit Myslimanë, po edhe keta pas ca kohe u kapnë prej ushtërivet ndjekëse të Ali Pashës të kumanduara nga kryetare Shqipëtarë trima edhe të zotët.

## KREJ XVI.

Zumë ngoje më lart për marëdhëniet e Ali Pashës me Napolon Bonapartin, i cili ishte Gjeneral i Demokratisë Frënge ndë Itali edhe ndë Malltë (1797). Hollësirat e më-poshtme do-të na bien ndë ekzaminatë më të fllashtë; edhe jo vetëm kaqë, po edhe përmbi marëdhëniet e tij edhe me Englezët; se

gjëndja e këtyre dy Shtétevet rivale njëra-me-jatrën, shteti gjithë trazime edhe rrëmuja që ndodhej asikohe Evropa, edhe më shumë Sinisi e Ballkánit, ka lidhje të ngushtë me aktivitétin e Ali Pashës si Suverán i një vëndi të shënuarshëm të Perandorisë Ottomane që ishte, edhe i cili u bë i njohur ndë gjithë botën politike t' asaj kohe. Fqinjëzimi i pushtimevet të tija mbë ujdhesat Ionike kontribuój edhe më shumë ndë rritjen e importancës së tij edhe t'a bënjë të domosdóshme nevojën e madhe të të dy shtetevet armike të lypin bashkëpunimin e tij. Ujdhesat Ionike ishin punkti (vëndi, pika) ndek muar vënt aqë-e-aqë konflikte për supremátë, trazyra të cilat muar funt me përnguljen definitive të Anglézëvet. Më shumë ky fqinjëzim e bëjti Ali Pashën objekt ndë pjesëmarjen e dipllomatiës të athershme. Ali Pasha i dëshëruar për t'u bërë vet-urdhronjës Suveran, sikurse edhe për të përndehur Shtetin e tij, të parat pika gjeografike që shihte përqark tij, edhe mbë të cilat lypej të kthente vërrejtjën e tij ishin sëpari-herë dependencat e Ujdhesavet Ioniáne Kontinentale, edhe pas ato ujdhesat, po veçanërisht Korfuzi edhe Lefkadha. Gjithë po për këtë qëllim Ali Pasha u qas ndë referéncë edhe me Rusinë, po, përzjerja e Rusisë ndë çështjen e Ujdhésavet Ioniane ishte e dëmshme për Ali Pashën, sepse Rusia ndodhej ndë bashkëpunim me Tyrqinë nga frika e rrezikut Napolónik që më 1798. Andaj pra me që më nj'anë zotërimi i përtashmë i Rusërvet përmbi ujdhesat, edhe më tjatër anë kishte edhe pakë urrejtje kundër Moskovitëvet, nukë i kënda të ketë të bënjë me 'ta.

Mëndje-mprehtë edhe me shpiritë dëpërtore Ali Pasha gjyrmonte me vigjëllim të pa-prajtur edhe me interés aventúrat e dramës së madhe që lozej nd' ato kohë mbi shkenën Evropiane, edhe si dashnór i krijimit të njëj Mbretërije Independente për vethe, përpiqej për-herë të përfitonte nga rastet që i epeshin. Përandaj ndë pariudhën kronike që rrjeth që nga kryengritj' e madhe Frënge, gjer te shpërndarja e dinastisë Napolitáne edhe nalltësúarja e Bourbonëvet, Ali Pashën e gjejmë herë mikun e

Frënqvet, herë përkrahës të Englézëvet. Po përhera ndë vepërimet e tija e kish synë edhe ngulmonte për aneksatën e Korfuzit edhe të Lefkadhës ndë Shtetin e tij. Shkrimtari Englez, Smart Hughes thotë që, kurrë Frëngu Kuqeritór (Napoloni) nukë mallónte aqë shumë vapore edhe kollonirra, sa dëshëronte Ali Pasha zapëtimin e ketyre nisivet, edhe këjo jo vetëm për themelimin e njëj fuqie maritime më të fortë edhe qëndrë tregëtare, po edhe për shigurim nga ç' do ngjarje e pafatme e punëvet, e.t.j.»

Napoloni edhe Autoritétet Frënge ndë Shtatnisië me gjithë mëriën edhe urrejtjën që kishin mbë Ali Pashën që kur u zaptój Prevezën sindëkur e pamë ndë faqet e kaluara, nukë rreshtjin së treguari përsëri miqësi tek ay, sepse më tjatër anë i-a kishin nevojën, nga shkaku që te ay shihjin njerin' e posaçëm për pllanet e përgjithëshme të tyre.

Po pas sukçésit të Frënqvet ndë Dallmati, edhe pas rrezikut që paravëzhgonte Ali Pasha se mundej t' i vinte nga ky omén *(punkt)* aqë i áfërt me kufiret Ottomane, e gjet t'arësyëshme të lithnjë miqësi me Anglézët, (më të papajcuarshmit armikë të Bonapartit) të cilët që prej shumë hohe i patne proponuar për një marëveshje me rëndësië. Për këtë qëllim filloj një e flagët këmbyerje dokuméntash të shkrojtura, të Ali Pashës më nj'anë, edhe të Këshillës së Kabinetit të St-James-it më tjatër, me mjet të sukçesórit të Nelson-it ndë kumandë të flotës së Mesdetit, Lord-it Callingwood.

Si përfundim i kësaj marëveshje ishte dërgesa e Major Leake-ut prej Guvernës Engleze ndë Shqipëri pranë Ali Pashës i ngarkuar me misiunë të studijonjë dispozitat e *Trimit* edhe të ekzaminojë që ç'farë përkrahje mundej t'i epte ati Guverna Britanike. Major Leake-u ndënjti shumë kohë ndë Shqipërië dyke-u-marun me shtudijimin e përnjohjes së vëndit ndë ç'do pikë-pamje, edhe me determinátën e mjétevet edhe gjithfarësh mënyrra përmbi mprojtjen të këtyre vëndevet kundrë ndonjëj invazje të papandehur të Frënqvet nga veriu i Shqipërisë.

Napolóni, i prokllamuar tani Perandór, sikurse e

pamë më sipër që ndodhej ndë marëveshje me Ali Pashën, posa u informúa përmbi vepërimet e Englezëvet ndë Shtetin e Ali Pashës, vendój dërgúarjen të Pouqueville-it si Konsull të Përgjithshëm ndë Janinë. Qëllimi i parmë i misiunës së këti dipllomati Frënk ishte shkëputja e Ali Pashës prej bashkëvepërimit me Anglezët edhe familiarizimi i tij ndë pllanet Frënge; veç kësaj kjo misiunë kishte për të shërbyer edhe për të tjera qëllime të brëndëshme tregëtare jo më pak të rëndësiëshme. Që ndë vitet më të lashta që nga kjo kohë, Janina kishte qënë thron Kónsulli të Përgjithëshm për mbrothësimin e interésavet tregëtare Frënge ndë Shqipëri të Poshtme nga vëndet e së cilës kantitéte të mëdha dhogash për anija nxirjin nga pyjet e pakryemë të atdheut të bukur.

Ndë muajin Nëntor 1805 Pouqueville i u nis prej Angone edhe mbassi ardhi ndë Ragusë të Dallmatisë, s' andejmi i lajmoj Ali Pashës mbërritjen e tij ndë kufiret Ottomane. Shoqërohej edhe prej Profesorit Béssierès i cili si i njohur mirë me Ali Pashën, kishte për t' i-a rekomanduar ati Konsullin Frënk.

Pouqueville-i ishte nga burrat e ditur që i vajtënpas Bonapartit ndë shpeditën e Egjyptës. Ali Pasha i priti ata ndë katundin Zicë, edhe ndë ditët e para të vitit 1806 Pouqueville i harrijti ndë Janinë, tek ndaj kryes të Marsit i ardhë nga Konstandinopoja dokuméntat ekzekutive. Ali Pasha i sillej tepër miqësisht edhe fisnikërisht përfaqësónjësit Frënk, po m'anë tjatër dipllomatisht gjyrmonte edhe ato më të vogëlat përçapa të Konsullit. Dyke-kaluar koha edhe politikat dyke-u-këmbyer njëra-pas-tjatrës, edhe Ali Pasha e ndroj politikën me Frënqtë. Fitimet e Napolonit ndë Ulm edhe ndë Austerlitz sikurse edhe prishja e aliancës Angllo-Ruso-Austriake, pati si përfundim aneksátën e Dallmatisë edhe pushtimin e Mbretërisë të Napolisë.

Napoloni sa vij po bëhej i tmershëm; inflluenca e Francës ndë Konstandinopojë vente mbroth ditë-më-dit me vepërim të ambasadorit të saj, Gjeneral Sebastiánit, edhe po pritej shkëputja e marëdhënievet midis Rusisë edhe Portës së Nalltë, rarë (rënë) ndë

trap të finókut ambasadór Frënk. Ali Pasha dyke-gjyrmuar me sy-hápje të hollësiëshme ngjarjet që bihëshin, u kthye përsëri te politika e parë, edhe vrapoj t'u dekllaronjë edhe Pouqueville-it edhe Gjeneral Sebastianit ndë Stamboll devotésën e tij mbë Perandórin e Frënqvet, të cilët si përgjigjësië i çuan Ali Pashës daróva të begatshme, ndërmjet të cilavet edhe një calinë (pushkë) të shkëlqyer të stolisur me gurrë të shumë-vlerëshm, dyke-i-dhënë gjith-kohësh edhe premtime për t'a ndihmuar që të emërohet Mbret i Shqipërisë. Kësimjeti rellácje të ngushta u bashkëlidhën midis tyre. Ali Pasha punoj mjaft me mjet të miqvet të tij ndë Konstandinopojë dyke-i-dhënë konkurs të math Sebastianit ndë përpjekjet e atij për shkëputjen e shpejtmë të marëdhënievet midis Portës edhe Rusisë. M'anë tjatër edhe Sebastiáni mori-anë mjaft për emërimin e bijvet të Ali Pashës, Myhtarit edhe Veliut si sundimtarë të Nebahtit edhe të Pelloponisiës.

Nga miqësi e Frënqvet Ali Pasha priste edhe të tjera dobime, bie fjala, t'i epjin konkurs për pushtimin e aneksátavet të anëdetjës Kontinentale të Jonisë, (e qeverisur asi-kohe prej Rusërvet), sikurse edhe për aneksùarjen e Lefkadhës. Këtë pllan Ali Pasha e vú ndë vepërim që kur hyjtin Rusërit ndë Suveranitétet, kur shtiu ndë dorë qytetet Preveza edhe Vonica veç Pargës që i dolli nga duart se u protestua enérgjik fuqiplótëshmi Rus i Korfuzit Bozheniku, edhe kur rrethosi Lefkadhën, ndë të cilën u përkrah mjaft nga Frënqtë, të cilët m'anë tjatër qëllojin të dishtraktójnë aténcjën e trupit ushtëriák që ishte ndë Shtatnisië edhe kësi-mjeti të lihëshin të lirë ndë lëvizjat e tyre ndë Dallmati.

Po ndër-këto, ndryshimi që po merjin punët ndë Evropë, nukë mënoj të inflluencójë edhe mbi marëdhëniet e Ali Pashës me Frënqtë ndë Toskëri; aqë më shumë e papritura marëvéshj' e armistitës midis Frënqvet edhe Rusërvet ndë buzët e lumit Niemen, i-a përmbysi gjithë studijimet edhe pllanet. Ali Pasha dyke parë vethen e tij të neveritur nga miqt' e tij Frënqtë, të cilët me qënë që nukë gjejin më interés

të vetë ndë rrethimin e Lefkadhës e ngritën atë, vrapoj, kur ishin dyke-u-bërë marëveshjet e paqës, si aliat që hiqej me frënqtë, të përdobihet për përmbushjen e dëshirës të zjarshme, t'i aneksohëshin këti ujdhesat Korfuzi edhe Lefkadha. Kishte kurajë për këtë çap pas premtimevet që i pat dhënë Napoloni edhe nukë dyshonte që do-t' i-a përmbushnjë me hir tani. Për këtë pra dérgoj te Perandór' i Frënqvet ndë Tilsit një kasnec të besuar i quajtur Guerri, i cili ishte Italian [1]) edhe po pritte përfundimet. Kasneci nukë vonój të kthehet dyke-çuar përgjigjen nga an' e Napolónit, që dëshira e tij këtë herë për fat të keq, nga rastet e kohës ishte e pamundëshme të përmbushej.

Me anë të paqës që u bë ndë Tilsit ndë Korrik 1807, ujdhesat e pellgut Jonián hyjtin përsëri ndënë suveranitét të Francës, e cila dërgoj për administratór, Gjeneralin Berthier. Jo më pak se kurdoherë, Napoloni i dha sundimtárit instrukta që t'i sillet miqësisht Ali Pashës, edhe jo vetëm kaqë, po edhe t'a ndihmonjë me ç'do mjet për ç'do sent, vetëm harrinte që interésat Frënge të mos dëmtohëshin. M'anë tjatër edhe vetë Napoloni i shkrojti Ali Pashës, dyke-i-dekllaruar shigurim të miqësisë së tij mbë atë, po mas-si u bëjt paqa midis tij edhe Rusisë me te cilën ishte edhe Tyrqia, u dha gjenerálëvet të tij urdhërimet e nevojshme që të meren vesh me 'të (me Ali Pashën d. m. th.) për përmbushjen e traktatit përmbi Shtatnisiën. Ali Pasha i lajkësuar nga sjelljet e hirësishme të Bonapartit, i dha gjithë ndihmën e posaçme për pushtimin e Shtatnisisë, me shpresë që të pakën të kishte përkrahjen e atij për të aneksuar Pargën. Ishte i kurajuar për këtë nga sjelljet miqësore të Perandórit Frënk, edhe të Autoritétevet Frënge të Korfuzit. Nga sa duket, Autoritétet e Korfuzit kaqë shumë i-a forcojin shpresat për

1) Ky Italian dinte shumë ghuhë edhe kish qënë dragomán interpret) i ushtërise Frënge nd' Egjyptë. Kur u kthye s'andejmi ardhi ndë Janinë, edhe Ali Pasha dyke-parë cilësit' e ija e mbajti ndë shërbim të tij.

Pargën, sa dërguan edhe kasnecë te Gjenerali Berthier për marëveshje mbi përdhënien e Pargës ndë duart e Ali Pashës. Edhe Gjenerali Frënk, i bazuar mbi porosit' e parreshtura që i çonte Napoloni për të mbajturit e rellácjevet miqësore me Ali Pashën sikurse thamë më nallt i dërgon Monarhut të tij proponimin e vet edhe të Autoritétevet të Korfuzit përmbi Pargën. Po Perandóri Frënk përveç që e quajti absurde (të pagjykimtë) këtë proponim, mori mërië kundër Gjeneralit Berthier, edhe për t'a kondemnuar kuximin e tij pas pakë kohë e zbriti nga post' i Sundimtarit, dyke-dërguar Gjeneralin Donzelot ndë vënt t'atij. Kësifárësh, edhe kjo tentativë e Ali Pashës për të aneksuar Pargën ndë Shtetin e tij u kotësua. Po ky kotësim shkakëtoj ndryshimin e politikës së tij mbë Frënqtë përsëri. Edhe kështu ndë vitin 1808 kur flota Engleze bllokój Korfuzin, Frënqtë të ujdhesës të ndodhur ndë shtrëngicë edhe mos-kamje për gjithë të nevojshmet më nj'anë, edhe të shterrur nga të hollat për pagesat e rrogavet të ushtërisë, dërguan ndë Janinë një delegacje për të marë prej Ali Pashës një hua të hollash për Gjeneralin Berthier, po Ali Pasha e përcolli delegácjen duar-zbrazët, dyke-u-thënë që nuk' është as tregëtar as barqér. Gjenerali Frënk që të marë shpagë për këtë refuzùarje, i lypi Ali Pashës t'i përjapë ati dependencat e ujdhesavet Joniane të Toskërisë sikurse edhe Vuthrótin afër Korfuzit, po Ali Pasha çoj metë-shpejtë disa trumba ushtarësh ndë Vuthrót edhe kështu mundi t' u-a kotësonjë Frënqvet vepërimet për vërvitje.

## KREJ XVII.

Prishja e miqësisë me Frënqte edhe bashkëpunimi me Englezët, i imponóhej Ali Pashës për interésat e pritme, edhe aqë më shumë se përvëç afërimit që bëhej midis Portës së Nalltë edhe Anglisë, parashëkonte Tepelénasi ynë që me këtë fuqi të detit i-a lypte nevoja të lithnjë miqësi për realizimin e ideálevet të tija mbë ujdhesat edhe mbë Pargën veçanërisht.

Më 1808 Ali Pasha filloj marëveshjet me përfaqësónjësit Englezë. Një i këtillë interview marëvéshjeje u bë ndë Prevezë midis Ali Pashës edhe reprezentántit Englez, Major Leake, edhe më pas Ali Pasha kishte korespondéncë me Kryetarët e flotës Angleze të Mesdetit. Dëshëronte, të marë-anë ndë përsëritjen e marëdhëniavet miqësore midis Anglisë dhe Tyrqisë, edhe ishte i zoti t'a bënjë këtë me mjetet për të cilat i vij tepër ndore. Edhe si-vërtét, marëveshja midis Anglisë me Portën ndë Konstandinopójë më 1809 i detyrohet më shumë Ali Pashës.

Nga shkaku i ndërkryerjes së Jeniçérëvet edhe i vrasjes të Vezirit të Math, Mustafa Bajraktárit [1]) i

1) Mustafa Bajraktári. i origjinuar prej katundit Goskóvë të përqarkjes Korçës, Kryevendár (Bej) ndë Rusçuk, nukë harrijti-dot të shpëtonjë nga duart kriminale të të pabindëshmëvet Jeniçerë, të dashurin e tij posi-bir, Sulltan Selimin e III-të nga i cili favorizóhej tepër edhe thërritej *baba* (átë) me gjithë-që vajti énkas ndë Konstandinopojë me ushtëri Shqipëtare të shumët. Mustafáj shpagon vrasjen e Sulltan Selimit dyke-vrarë vëntzënësin e atij, Sulltan Mustafan' e IV-të bashkë me shokët e partit të tij, edhe dyke-vënë ndë thron Sulltan Mahmudin e II-të më 1807 me konditë që të vazhdonjë reformat, edhe ay vetë u emërua Vezir' i Math. Po së mbrami Mustafa Pasha vritet nga Jeniçerët me gisht të vetë Sulltan Mahmudit, passi i pat larguar s'andejmi ushtërit e veta.

Kënga e tragjediës historike të Mustafa Bajraktarit :

*Sulltan Selimi çoj kartë,*
*Mbë Mustafa Barjaktárë,*
*Sot-e-sot, ndë je im-atë,*
*Më shpëtó sa jam pa vrarë.*

*Jeniçérëtë m' u ngrinë,*
*Do-të, më prishin të zinë ;*
*Vet' mbë ty e mbë Perëndinë,*
*Gjetk' ú nuk' e kam shpëtimnë.*

*Mustafaj, thrét Isuf Begun,*
*Prej Serézit : Mblith asqerë,*
*Stamboll jemi për të pjekur,*
*Do-të prishim Jeniçerë.*

*O Pasha, sa shum' e qave,*
*Si një bir Sulltan Selimnë,*
*Jeniçérëtë t'a vranë,*
*S' e shpëtove dot fat-zine !*

*Mustafa Pashë, ô lule,*
*Vure Mbret Sulltan Mahmudin,*
*Vethen t'ënde s'e kujtove*
*Vajt' e besove halldupin !*

*Të vran'o Pashá, të vranë !*
*Varfërove Shqipëriné*
*Besove Sutltan Mahmudin,*
*Të pabesin Osmanllinë.*

*Ô, Pasha, pse s' u mejtove,*
*Qysh e largove asqerë ?*
*I dhe besën Osmanllisë,*
*Q' ësht' i pabesë nga herë !*

*Medét ! O Pasha, o Zot,*
*Të gënjyen mor i mjerë,*
*Shqipëria të qan me lot,*
*Mbajnë zi derë mbë derë !*

cili projektónte reformimin e konstruktës ushtëriake ndë Tyrqi, kryeqyteti ndodhej ndë rrëmujë, edhe ç'do marëveshje e Divanit me të dërguarin Ingliz Adair, ishte e pamjaftuarshme. Atëherë, kur Adairi i cili po rinte bashkë me flotën e angurúar ndë Dardanélat, edhe po gatitej të përlundrónjë s'andejmi i pabërëshm, mori letrë nga an' e Ali Pashës i cili e këshillonte atë të presë zhvillimin e ngjárjevet; natyrisht pas pak kohë passi ra krejt poshtë politika Frënge ndë Konstandinopojë, filluan negoçiátat preliminare të marëdhenievet me Anglinë.

Këto shërbime të Ali Pashës përpara politikës Angleze nukë mbenë të pa-shpërblera. Pakë më von nga ato që ngojuam më nallt Guverna Angléze i dërgoj Ali Pashës disa batérja kanónash (topa) të fabrikúara ndë arsenall të Mbretërisë, edhe shumë qindra roketa [1]) të emëruara „*fusées a la congrave*", mekanizme lufte e inventuar rishmë nd'atë kohë.

Gjithkohësh, Majori Leake mori urdhër nga Llóndon-i të mbétet ndë Janinë përanë Ali Pashës për të stërvitur ushtarët Shqipëtarë ndë përdorim të kanónavet edhe të rokétavet, edhe të jetë edhe përfaqësonjës i Anglisë ndë Janinë.

Athere mâ Ali Pasha filloj kjarisht përkrahjen e interesavet Angleze, dyke-i-hapur limanet e tija lirisht tregëtisë Angleze edhe kryqësorevet (vaporevet lufte) të 'saj dyke-prokuruar me kondita të dorë-dháshme flotës Angleze gjithfarësh hamje edhe ç'do te nevojshme.

Napolonit tani as që i ndruhej fare sepse ay përveç që po merrej nër luftat të Sinisisë Iberike, as që disponónte fuqi maritime të njëj-fuqishme me të Anglezëvet.

Ndë funt të vitit 1809 passi u përzunë Frënqtë prej ujdhésavet Qithirë, Zakynthë, Qefalinië edhe Ithakë, të cilat i shtinë ndë dorë Anglezët, përsëri Ali Pasha

1) Fyej-zjarri të mbushura me cqufur edhe me qymyr. Këtë mekanizmë të rrebéshtë Ali Pasha e përdori për herën e parë më 1810 ndë rrethimin e kështjellës së Beratit ndek ishte mbyllur Ibrahim Pasha.

rrahu të përfitonjë nga sukçeset e miqvet të tij Anglezëvet. Ndë Prill të vitit 1810 kur flota Angleze bombardój qytetin edhe fortesën e Lefkadhës, Ali Pasha me ushtëri të mjaftë u vajti ndihmës Anglezëvet edhe ushtrinoj ndë gjith-po-ato pozita që ishte ushtrinuar edhe herë tjatër kur u vajti ndihmës Frënqvet kundër Rusërvet. Edhe kur pas një javë Frënqt' e Lefkadhës kapitulluan edhe përdhanë ujdhesën të cilën Admirali Oswald ndë emër të Anglisë e pushtoj, Ali Pasha dyke-i-çuar përhirimet e tija për sukçésin, i kujtonte që ishte e udhës t'i çedóhej ati ujdhesa, ndë pushtimin e së cilës kishte të drejta si politike ashtu edhe gjeografike.

Admirali Englez i-u fal-ndersë për ndihmën e mjaftë që i dha po sa për lypjet që i adresoj Ali Pasha, nuk' i bëri ndonjë përgjigje. Po m'anë tjatër, që të mos marë mërië Ali Pasha nga i cili Anglia priste shumë punë, i dekllarój ati që, Guverna Engleze i ep lejë të plottë të ngrehjë mbi anëdetjet Toskënore qëndrina (kazarma) për ushtëri të mjaftë sikurse edhe kështjella, të cilat Ali Pasha i bëri, po me kaqë vetëm nuk' ishte plotësisht i kënaqur mbas shërbimet që u bënte ndë interésat e tyre ndë det të Ionise ; me gjith atë nuk' e thyente zëmërën dykeshpresuar të shpërblehej më tej.

Kësifarësh pra, ndë këtë kohë, ndë marëdhëniet ndërkombëtare të Ali Pashës ballánsa printe më shumë për anë të Anglisë, edhe Janina këtë kohë ishte vatra e kundrështimevet kundër Napolonit. Aty Englezët punonin mbë fushë të mirë për qëllimet e tyre dyke-përkrahur Ali Pashën për të shkulur Korfuzin nga duart e Frënqvet.

Ndë Konstandinopojë inflluenca Frënge ish dobëtuar shumë po nuk' ishte akoma krejt zvjérdhur. Përandaj Guverna Frënge zu të anëkohet paprajtur te Divani kundër remonstrátavet të Ali Pashës; Qarjet e Guvernës Frënge u bënë kaqë të shuma, sa Porta akseptoj një pllan që i-u proponua prej Francës pas të cilit Ali Pasha ishte për t'u goditur ndë-një-kohë prej trupit ushtëriák të Korfuzit edhe prej ushtërisë të Dallmatisë që ishte ndënë kumandë

të Feldmareshállit Marmont. Nuk' ishte e pamundëshme që nga ky rrezik që i kanósej Ali Pashës të vinte edhe prishja e tij prej Napolonit, po sikurse thonë shkrimtarët e huaj kutemporanë, nga ky rrezik e shëllbój fati. Se më nj'anë Feldmareshalli Massena s' përparonte dot ndë Portogali ndek ushtëria e ndënë kumandë të tij u thye, edhe m'anë tjatër mos-sukçéset e Frënqvet ndë Sinisiën Iberike e ngutnë Bonapartin t'a çonjë atje ushterinë të Feldmareshallit Marmont që vepëronte ndë Dallmati. Po edhe Divani më pas e ktheu-mendimin e adoptimit të pllanit të Frënqvet kundër Ali Pashës mbas ndërmjetimet e Ambasadorit Englez ndë Konstandinopojë, edhe të cilit, pas sa thotë shkrimtari Englez, Smart Hughes, shpëtim' i Ali Pashës ati i detyrohet.

Sidomos, që ndë këtë herë Ali Pasha u kthye me mish-e-shpirt mbë politikën Engleze, Guverna e së cilës nukë pushonte së tfaquri ati dispozita të hirësuëshme. Është e njohur q'ateherë edhe më von, Englezët që shëtitjin ndë Shtatnisië, njerës të qelebritétit nga fisi edhe nga edukata, kishin simpathië të madhe mbë Trimin e Tepelenës dyke-e-mbiemëruar atë «Plaku Luan' i Shqipërisë» edhe çfaqjin admiratën e tyre dyke-e-prezantuar atë modell Suverani edhe Heró i cili për të mirën e qytetërimit luftonte edhe ndiqte eleméntet keqbërëse të cilat prej shekujsh cfilitjin edhe plaçkitjin Toskërinë.

## KREJ XVIII.

Ndë krejin e më-sipërmë bëjtim fjalë qysh Ali Pasha me mjet të Ambasadorit Frënk Sebastian ndë Konstandinopojë përmundi t'i dalë dekret prej Sulltan Selimit, me anë të të cilit biri i tij Veli Beu emërohej Sundimtár i Pashallëkut të Pelloponisiës. Ky Pashallëk, një nga më të shënuarshmit distrikte të Perandorisë, përbëhej prej 24 ngasëra (distrikte), me qëndrë Tripolicën, edhe ndehej gjer te kënéll' i Korinthit.

Veli Pasha u vendos ndë postin e ri ndë Mars 1807. Mbi këtë shënjë të Historiës Ali Pashës do-të

ndálemi përnjimend se këtu hasim një njeri i cili inflluencój mbi deshtinet e Ali Pashës, edhe është i pari shkakëtar i prishjes së Tepelénasit. Ky është Ismail Pásho Beu.

Pásho Beu, nga fisi prej një nga të parat familje të Janinës, që ndë moshë risie ra ndë mërië të Ali Pashës për një túrpje që pat bërë. U ekshpulzua prej Janine edhe pas di-ca vjet me nërmjetimet e miqvet të tij përanë Ali Pashës, u kthye prapë ndë Janinë, edhe pas jo shumë kohë bëri edhe lidhje familjare me Ali Pashën me anë martési. Nga ky atërim Pásho Beu hyri ndë rellàta te ngushta me moshatárin e tij Velinë, të bir' e Ali Pashës, të cilit i-a njihte karaktéret e tija ambicióze.

Me që ndë shpirt të tij Páshua ushqente urrejtjen e lashtë kundrë Ali Pashës, nuk' lij mjet pa përdorur për të kultivuar ténsjat e veta edhe nek i biri, që kësi-farësh t'a bënte atë vegël të verbër kundrë t'et.

Edhe si-kur-se vërtet, intrigáni Pasho Bej, nukë vonój t'i mbërrinjë qëllimit të tij dyke-i-kallëzuar Veli Beut që námëta i ati ishte ndë rellàta të paligjëshme me të shoqen e tij Zeveidénë. Me këtë mënyrë dyke-mbjellë Pásho Beu mollën e urrejtjes edhe me konkursin e njëjt nga sekretarët e Ali Pashës i quajtur Mantho Ekonom, rrënjósi te Veliu aqë çuditërisht dëshirën e marrë sa e bindi të besonjë që po të degradóhej i ati prej postit të nalltë që posedón, ishte fort e udóbëshme t'a trashëgonte ay atë. Më 1807 kur krisi lufta midis Portës edhe Rusiës, Divani për të shiguruar Pelloponisiën nga ç'do vërvitje e flotës Ruse, e pa t'udhëshme t'a vëjë atë ndënë administrátë të Ali Pashës duke-emëruar për Sundimtar një nga bijt' e tij. Ali Pasha i cili Pelloponisiën e shihte si një provincë të Shtetit të pritmë të tij, dërgoj atje Veli-Pashën bashkë me një trup 10,000 burrash. Kjo fuqi ushtëriáke ishte ngarkuar edhe për të ndjekur edhe farosur eleméntet trubullónjëse të vëndit të cilat mundojin edhe rripjin pópullin. Veli Beu kur u nis për këtë misiúnë i-u lut t'et t'i japë për këshillonjës edhe Pásho Bejnë. Ali Pasha nga dyshmimi që kishte mb'atë njeri të cilin

e shihte si suspekt, së pari i-a refuzoj lutjen të birt, po mbas-si Veliu ngulmoj ndë lypjen e tij, më së fundi i-u pranua. Dërgoj pra Ali Pasha e thërriti Pasho Bejnë prej Llarse tek kishte vajtur për vizitë, edhe passi i shpjegój importáncën e misiunës së tij si këshillonjës, lypi prej tij t'i premtonjë me betim që do-t' i përmbushnjë me besë inshtruktat e dhëna ati. Veli Pasha vajti ndë Tripolicë ndë Mars 1807, ndë krye të ushtërisë tij dyke-shkuar ndëpër Levadhi, Thivë edhe ndëpër Kënéll. Pásho Beu, për faqe të Ali Pashës u tregua përmbushës i shkathët i urdhërimevet edhe inshtruktavet të mëndje-mprehtit plak, po ndë mëndje të vet rrukulliste pllane qysh të përfitonjë prej shtetit të punëvet për qëllime të veta, nga të cilat i pari pllan ishte farósja e Ali Pashës me mjet të djalit të vet.

Sundimi i Veli Pashës ndë Pelloponisië nukë nxori dot pemë të ndylkme (të burme) nga shkaku që, si thuhet, vëndësit taksohëshin me pagesa të mëdha, edhe kësi-farësh populli mundohej ashpër nga Kolektórët (*taksildaret*).

Ali Pasha dyke-u-informuar për këto që ngjisjin ndë Pelloponisie, shumë-herë i dërgoj Veliut letra të qërtuarshme, edhe dyke-ditur që këto ngjisjin nga-që Veliu proçedonte pas këshillat e prapëta të Pasho Beut, u përpoq t'a bindinj të birë për t'a këmbyer Páshon me një tjatër këshillonjës ndë vënt t'atij, po më kot. Shteti i Páshos ishte i absolútëshm. Me proçedurat e tija dinake kishte mundur t'i rrënjosnjë urrejtjen mbë t'anë dyke-i ngacmuar gjithmonë ambicjen e kalbur për të zbritur t'anë nga posti që t'a sukçesonjë vetë.

Më 1810 ndë luftën Ruso-Tyrke, Ali Pasha vepëroj t'i ngarkohet birit tij Veliut kryesi' e një trupi ushtërie, me shpresë që kështu do-të gjente rastin e pritur për t'a shkëputur ca kohë nga këshilltari Pásho Bej. Di-ca shkrimtarë kumemorójnë që Ali Pasha donte t'a farosnjë Pasho Bejnë dyke-e vrarë atë po në këtë çap nukë goditi dot. Pas mbarimit te luftës Pasho Beu niset për ndë K/pojë tek u has me Këshllar-

Agën [1]) me të cilin ishte i njohur, edhe passi i kallëzój shtetin midis Ali Pashës edhe Veli Beut, i proponój ati me dinakëri të thellë qé Veliu mundej të ishte shum' i vlefshëm te Guverna Perandoráke, po të ishte që të vendónte prishjen e Ali Pashës. Këshillar Agaj dyke-i-a bërë të njohura gjithë këto Patronit të Nalltë, i dha kurajë Pásho Beut ndë pllanin e studijuar prej tij kundrë Ali Pashës, po ndënë-dhë edhe jo fáqeza.

U kthye pra prapë Veli Beu ndë Pelloponisië, tek i gjeti ndë një bollbë të madhe gjithë eleméntet e vëndit edhe ndë mizori të patreguarshme. Ky shtet anormál i ngarkohej Veli Beut për padrejtësirat që bëhëshin nga an'e nëpunësvet të tij edhe nga an' e parësisë. Përandáj nukë kaloj shumë kohë kur pas shumë peticje anëkimesh nga an' e vëndësvet kundrë Sundimtarit, së mbrami ndë Qërshor 1812 dolli dekreti Perandorák për ngritjen e tij prej Pelloponisiës ndë Pashallëkun të Thesalisë.

Thesalia si-kur-se më-sipër-thamë, që kur u emërua Ali Pasha si *Vezir' i Janinës*, ishte një aneksátë e Shqipërisë Poshtme, e sunduar prej Ali Pashës me anë të birit të vet, Myhtarit, si nëkembës; Myhtari kishte edhe gradin e Sundimtarit të Nebahtit. Nga kjo gjë Ali Pasha me mospëlqim e shihte këtë ndryshim se më nj' anë shtérrej prej pashallëkut të Pelloponisiës për të cilin dishtrikt kishte bërë mjaft therorësië për t'a poseduar atë, edhe më tjatër anë shëkonte edhe ndryshimin e shtetit të Thesaliës. Ishte vërtet që ky post me rëndësië nuk' i epej nonjë të huaji po prapë djalit të tij, mirë po, për besimin e Veliut kishte shumë shkake që të dyshmonte, andaj nukë kishte asnjë besim te ay, edhe aqë më shumë që si këshillonjës përanë tij ishte Pásho Beu, prapë, njeri tek i cili Ali Pásha deshkoperój një nga armikët më të këqinj të dinastiës tij. Prapo lipsej që edhe të birë Myhtarë t'a satisfaktójë për shterrimin e titullit edhe të postit si rezident i Thesaliës, edhe pashallëkun me

1) Nëpunës më i nalltë i pallatit, krye-kujdestár i haréme-vet te Sulltanit, edhe *Derven-Aga* (Inspektor).

rëndësië t'-i-a shiguronjë vethes, dyke patur ndënë pushtét edhe inflluencë atësore të tij Governorin veturdhronjës të Thesaliës, Velinë. Kjo e funtmja vetëm me mërgúarjen sidomos të Pasho Beut mundej të vihej nd' udhë.

Sindëkur e dimë Ibrahim Pashë Berati mbassi u kap rrob mbahej ndë Pallatet të Ali Pashës ndë Janinë po rrob vetëm për formë edhe kurrë i burgosur. Miqt'e tij ndj K/pojë përpiqëshin t'i nxjerin dekret për rishvendosjen e tij ndë postin ë parë po ky me që tani ishte tepër i shkuar nga mosha shkroj peticjë me dorën e vet per në K/pojë ndek dekllarónte që ishte i pazoti të sundonjë përqarkjen e Beratit edhe lypte me lutje që Port'e Nalltë të emëronte ndë vënt të tij dhëndërin e vet Myhtarë. Edhe kësi-mjéti më 1812 passi u mbarua lufta Ruso-Tyrke dolli dekrét Perandorák ndë të cilin emërohej Myhtari zëvëndës i Pashës të Beratit. Pas këti dekreti dolli edhe tjatër ndë të cilin i treti edhe m'i vogëli bir i Ali Pashës, i quajtur Ali Salih Bej, djalosh i ri, emëróhej sundimtar i postit të zbrazët të Nebáhtit.

Mbetej për t'u bërë paqtimi me Veli Bejnë, po për këtë lipsej të hiqej Pasho Beu nga mezi. Veli Beu ardhi bashkë me Pásho Bejnë nga Tripolica ndë Llarsë tek ishte throni i administrátës së re ndë Gusht 1812. Vëndi i shkatërruar ndënë sundimin e Myhtar Pashës i cili kishte edhe shumë kohë që absentónte nga qëndra e Pashallëkut, pësonte shumë keq nga kusarët e kodravet edhe nga Jeniçérët e qytétevet. Kundrë gjithë këtyre, Veli Beu me konkurs të këshillonjësit të tij Pasho Beut, u tregua ndjekës edhe dënonjës i rreptë. Pasho Beu qëllonte që, me këtë farë sundimi Veli Beu si administratór i ri të qasnjë dashurinë edhe devotimin e subjektëvet, të tërheqë hirështin' e armiqvet të Ali Pashës ndë K/pojë edhe ndë rast të pritur të bëhet organ' i prishjes së tij. Pa fjalë që për këtë qëllim Páshua përherë i-a mëkonte Veli Beut dëshirën për të zënë postin e t'et. Ali Pasha dykepipëlluar gjith-kéto parëndjejti nevojën e largimit të rrezikut që po i tirrej prej birit të vet, edhe thuhet se passi përsëri bëri nërmjetime të kotta tek i biri

qé t'a mërgonjë këshillonjësin prej tij, përdori tentativë kundrë jetës së Pasho Beut, si-kur-se passon : Ditën e Shën-Llázërit më 1813 ndaj perëndimit të diellit, shtatë trup-gárdas të Ali Pashës, kaluar erdhë ndë Llarsë tek kishin zënë vënt ndë një rrugë të ngushtë të qytetit, edhe kur Pásho Beu shkonte s'andejmi me një eskortë të madhe, të gjithë përnjëherë zbrazë-pushkë kundrë tij. Po për çudi, plumbat nukë goditën as Pasho Bejnë, as nonje nga njerëzit q'e rrethojin. Eskortatórët e Pasho Beut u përgjeqne me armë edhe mbajtnë katër nga atentatórët; të tjerëvet tre u ranë pas edhe dy nga ata, që ishin edhe të plagosur, i kapnë; vetëm njëri nga ata, i krështerë, mundi të shpëtonjë edhe të përikinj ndë Janine. Pas pakë kohë demnitarët (*njerëzit e ranguit*), që rrethojin Ali Pashën, dyke-parë gjëndjen edhe marëdhëniet e ashpëruara midis tij edhe Veli Beut, edhe që sa vij më shumë keqësohëshin, i-u lutnë t'u-a ngarkonjë atyre barën e paqtimit. Të ngarkuar me këtë misiunë 45 njerës të hoborit Ali Pashës venë ndë Tërhallë edhe q'aty e lajmuan Veli Bejnë që vijnë si miq familiarë, edhe i luten që t'i presë si të tillë. Veli Beu u çoj fjalë që të vijnë ndë Llarsë pa eskortë të armatosur, edhe passi i proponój Pásho Beut të largohet për di-ca dit, vajti ndë Çakëzi tek i priti kasnecët edhe ndënji me ta bashkë ndë pallatet e tija aty. Bisedimet midis gostiárëvet edhe Veli Beut nukë dihen, po dukët, që di-ca nga ata të lidhur me Velinë me anë lidhjesh familiare e bintnë dyke-idhënë të kuptojë që interesat e derës së fáməshme të Ali Pashës lypjin bashkimin edhe satisfáktën, edhe se dëshira e t'et lypsej përmbushur se kjo do-të ishte edhe për nder të vet.

U vendua pra të mërgohet Pasho Beu ndë Vollo nj'a dyzet ditë edhe më pas të kthehet te Veliu për të marë urdhrime nga an' e Ali Pashës. Kështu ndërmjetónjësit u kthyen në Janinë edhe Pasho Beu u ngut do-e-mos të shkonjë ndë Vóllo i eskortuar prej 1500 trup-ruajtës (trima), edhe i përcjellun, prej Veli Beut edhe prej Bejlérëvet të Llarsës. Térmi (*vadéja*) i venduar kapërxeu i pabërëshm edhe Pashua

passi e kuptoj që nuk mundej të shpërrenjë as gjë nga protektór' i tij, e sósmja, iku s'andejmi edhe vajti ndë Halqidhë tek një miku i vet i quajtur Beqir Pashë. Kësi-farësh pra me mjet të largimit të Pashos, Veli Beu ndë Thesali mbeti ndënë influencë të Ali Pashës.

Le të vijmë tani ndë atë shënjë të historiës ku e lamë Ali Pashën pas vendimit definitiv të Pashallëkut të Beratit. Kjo ngjarje pat inflluencë të madhe mbi shpiritat e Shqiptarëvet të Çamëries edhe të Labëriës që nuk' ishin akóma ndënë subjektim të Ali Pashës midis të cilëvet përmhahej si-do-mos, shteti i Mustafa-Pashë Delvinës.

Ndë kohët e para të vlukimit Ali Pashës, pashallëku mjaft-i-math i Delvinës kishte thron qytetin omonym, edhe përmbshtillte gjithë Çamërinë edhe një pjesë të Labërisë. Si-kur-se e dimë Ali Pasha ndë krye të kariérës së tij kur ishte vetëm Bej i Tepelenës ushqente ambicje për tittullin e Kryevendárit Delvinës, po që rrjéshtazi nuk' i harijtte dot qëllimit. Dyke-kaluar koha edhe dyke-i-u-rritur pushteti, shumë ngjarje të kohës i epjin arësye për t'a ndejtur shtetin e tij mbi zhurisdiktëm e Pashës së Delvinës, dyke-aneksuar disa përqarkje të këti Pashallëku.

Arësyet q'i epëshin Ali Pashës ishin, bashkëpunimi me Suljotët i shumë Bejlerëvet dhe Agallarëvet të Çamërisë, ndë kohët kur ata luftojin kundrë Ali Pashës, si-kur-se edhe paqetësi' e vëndevet që shkakëtohej nga kusarët, për ndjekjen e të cilëvet Ali Pasha ishte singullár. Dyke-prezentuar vethen' e tij përherë mprojtës të interesavet Sulltanike ndë Shqipëri, pruri-nd'udhë, edhe që përpara degradátës të Ibrahim Pashës, të aneksohen te Pashallëku i Janinës dishtriktet të Filatit të Margaritit, edhe të Paramithiës, edhe kësi-mjeti pushteti i Pashës të Delvinës dyke-u-rrëzuar dita-ditën, nukë ndehej më tej për-veç se ndë përqarkjet e Delvinës edhe të Gjinokastrës.

Pak kohë pas mundjes të Ibrahimit, parësi' e Çamërisë, Hasan Çapari prej Margariti, edhe Dajlani nga Konispoja, të trëmbur nga sukçeset e Ali Pashës ndë Berat ardhë edhe i-u përkulë ati dyke-i-betuar subjektim. Mustafa Pasha vetë dyke-parë rhymën e

influencës të armikut të tij që po rritej për dita, vrapój t'i tfaqnjë përkulje edhe për shigurim të përfáljes i çoj' ndë Janinë si peng djalin e vet, Sulejmanë. Kështu pra e gjithë Çamëria e pashtruarshme u fal e bindur ndënë këmbët e tij.

Po ndë vëndin tek një kohë zotnonte i fuqiëshëm Mustafaj, kishin mbetur akoma elemente të pabindëshme të cilët nukë dojin të njihjin pushtetin e Ali Pashës. Këto elemente ishin disa Bejlerë edhe Agallarë të Labërisë të di-ca nga qytetet edhe katundet midis të cilavet çquhëshin Gjinokastra, Delvina, Gardhiqi, Zhulati; Andaj pra tani i-a lypte nevoj' e madhe Ali Pashës që me ç'do therorië t'a shtjerë ndë dorë me forcë këtë krahinë.

Ndë krye të vitit 1812 passi pregatiti një ushtëri të mjaftë ndë të cilën rrjeshtohëshin edhe shumë të krështerë Kapedanë të famëshm, i çoj kundrë adversorëvet; shënja e parë e vërvitjes ishte Delvina edhe Gjinokastra. Pakë kohë përpara se të dërgonjë ushtërinë kundrë kryengritësvet Ali Pasha dërgoj te Mustafaj një nga Bejlerët e shënuarshm të Labërisë për t'i komunikuar ati që, e njeh si rezident të Delvinës ku mundej të mbetej për jetë. Gjith-kohësh dërgoj kasnecë edhe ndë Gjinokastrë për t'u kërkuar vëndësvet përkulje paqësore. Po ata kasnecët i dëbuan edhe pas një këshillë ndë Palavli tek ishin ftuar të gjithë unanimët venduan me betim bashkëvepërim edhe aliancë kundrë Ali Pashës. Ndë këtë lidhje na hyn edhe vetë Mustafa Pasha, i cili filloj të mobilizojë ndë Delvinë.

Posa i pikasi gjith-këto Ali Pasha, urdhëroj ushtërin e tij të kuqendruar ndë Janinë të marshonjë me vrap, edhe një trup prej 300 burrash u turr kundrë Delvinës, tjatri gjithë-po i aqënumërshmë, kundrë Kokátit, një i tretë trup ndënë Thanas Vajën kundrë Myrsjótëvet edhe Progonátasvet, i të cilëvet kryetar ishte Selim Beu, edhe fundja një trup' i katërtë ndënë Ymerá Vrionin u turr kundrë Gjinokastrës.

Thanas Vaja luftój Selim Bejnë edhe passi dërgoj ndë Janinë atë vetë edhe shumë të tjerë, i vajti ndihmë Ymerá Vrionit, i cili dyke-ndjekur përqark

Gjashtës një trup Gjinokastritë si nj'a 300 veta, kishte rrethosur Gjinokastrën. Ushtëri' e Vrionit kishte me vethe edhe artilerië mali mortjare, edhe roketa Angleze; pakë ditë bombardim edhe ca roketa, vegla luftare të panjohura ndë Gjinokastritët mjaftuan t'u japën dërmën, t'u kllasën tmerrë edhe ti' ngusin vëndësit të përépen pa kondita. Përmi marëveshjen e konditavet të përdhënies, vajti ndë qytet Thanas Vaja vet i tettë burrash, ndë shtëpi të Mustafa Beut. U mbluadhë parësi e qytetit, të cilët passi venduan të përepen dërguan te Ali Pasha Sheh Baba Hysenin t'i lypnjë mëshirë edhe zëmërgjërësië. I mallënjyer Ali Pasha nga lutjet e kasnecit i premtój amnesti pastaj thërriti edhe porositi Ymerá Vrionin të shtjerë ndë dorë kështjellën edhe t' i dërgonjë ndë Janinë disa nga parësi' e qytetit midis të cilëvet ishte Myrtezá Beu.

Përdhënia e Gjinokastrës i trëmbi Labërit edhe nga kjo nukë vonuan të përkulen gjithë katundet e para të përqarkjes së tyre edhe të Delvinës. Po edhe Delvina, tek që ndë krye u mbyll Mustafa Pasha bashkë me familjen e vet, vrapoj të gjyrmonjë shëmbëllën e Gjinokastrës. Mustafaj, pa pritur të rrethoset ndë kryeqytetin e tij, iku s'andejmi bashkë me gjithë parësinë Bejlerë edhe Agalarë, edhe përikën ndë katundin e fortesuar Gardhiq, i cili ishte ndënë zotnin të tij, i ndënjtur prej burrash luftëtarë, me qëllim t'i bënjë ballë armikut gjer mbë të sosme. Po përpara se të mbyllen ndë këtë katund, kur këta përmbluadhë gjithë fuqiat e tyrë ndë Palavli edhe pas një lufte të përgjakshme, u përndanë të dërmuar së gjithash nga ushtëri' e shumët e Ali Pashës.

## KREJ XIX.

Kështu, pas përkuljes të gjithë vëndit përqark, ushtëri e Ali Pashës çápej kundrë Gardhiqit, çitadéllë e fundit e Mustafájt me shokët e tij. Ky katunt i quajtur Garth edhe Gardhiq, i ndënjtur gjithtmonë prej Shqipëtarësh luftëtarë, dirgjet mbi një kodrë të lartër, edhe ishte natyrisht i kështjelluar se përveç

bugazit të thellë që e mpronte atë nga lindja edhe nga juga, pothua se cilado shtëpi si gjithë shtëpit' e moçime të katundevet të Shqipërisë, formonte fortesë të vogël; veç kësaj ishin ngrehur me kohë prej të ardhurit ndë 'të, transhérra (meje) të thella ndë të ndryshme pozita të malit, të cilat protektojin rrugën e ngushtë edhe të pashkuëshme që bjente ndë katund.

Ushtëria ndënë kryesi të Isuf Arapit, Thanas Vajës edhe Tahir Agajt, e rrethosi ngushtë katundin; më shumë së një muaj u bënë përpjekje të parreshtura midis rrethonjësvet edhe të resthósurvet, po pa përfundimë të shënuarshme, herë ndë vërvitja të përgjakshme të ushtëriës, herë ndë jashtturrje nga an'e luftëtarëvet të Gardhiqit. Po fundja me një asallt të përgjithshëm të ushtërisë Ali Pashës, passi u kuqeruan dy nga fortesat edhe u pushtua prej trupit ushteriák ndënë kumandë të Isuf Arapit edhe Thanas Vajës, u ngutnë të brëndëshmit të shtrojnë kondita fáljeje të cilat passi u pranuan prej Ali Pashës, Gardhiqi u përdha ndë duart' e vitoriózëvet. Pas konditavet të dhëna dokumentarisht edhe me vulën e Ali Pashës, Mustafa Pasha edhe Parësi' e Labërisë mbassi të dërgojin familjet e veta ndë vatrat e tyre, si-kur-se edhe di-ca nga Agallarët të çquarshëm të Gardhiqit, gjithëséj si-nj'a 60 burra, do-të eshkortóhëshin ndë Janinë të armatosur edhe të pa-dëmtuar, prapo të tjerët vëndës të Gardhiqit të falur do-të lirëshin te pangamë ndë vatrat e tyre. Nërmjét Gardhiqótëvet të çuar ndë Janinë bashkë me Mustafa Pashën, përn ënden, Demir Doçi, Matush Agaj edhe Islan Be Koka. Të gjithë këta passi mbërrinë ndë Janinë, Ali Pasha i priti shumë mirë s kurse e kish zakon, edhe veçanërisht Mustafa Pashën, [1]) edhe i vërtetoj ata për qëllimet e mira që kishte për të gjithë dyke-u-dhënë gjithë se-cilit dhoma të veçanta ndë Pallat edhe dyke-u dhënë ushqime të begatshme edhe të tepërshme.

---

1) Kur Mustafaj i ra nër këmbë edhe i lutej dyke-qarë për familjen e vet, Ali Pasha e shiguroj atë që sa të ronjë vetë, as ay as familj' e tij nuk' kanë për të pësuar kurrgjë.

Kishin kaluar di-ca dit që kur u prunë ndë Janine Mustafa Pasha edhe shokët e tij, kur një mbrëmje rreth fortesës Janinës dëgjohen zbrazje pushkash të dëndura edhe britje të cilat vijin nga an' e pallátit tek ndodhëshin rrobërit; di-sa nga të burgosurit kishin rrahur të evadójnë edhe gardiánët zbrazë pushkë kundrë tyre; kështu midis rrobërvet edhe gardianëvet u mbajt një betejë dy orësh gjer ndaj agimit tek u vranë disa nga të dy anët po as një nga rrobërit nukë mundi të ikënj. Të nésërmet passi u-a muarë gjithë ç'kishin me vethe rróbërvet të mbetur si-kur-se edhe Mustafa Pashës i cili pa fjalë ishte provokonjës i tentativës, lidhur me vargój i prunë ndë ujdhesë të Janinës edhe u mbyllë të tjerët ndëpër qeliat të Manastirit të Shpëtimtarit, edhe Mustafáj ndë një dhomë të pallatit të Ali Pashës që kishte ndë nisië tek ruhej me severitét, gjer-sa si-kur-se thonë, vdiq prej lëngjyeri; të tjerët rrobër mbetnë gjer kur u vra Ali Pasha.

Thamë që pas traktatit që u lith ndë Palavli midis Ali Pashës edhe Gardhiqotëvet, lipsej t'a përepjin katundin e fortesuar ndë të cilin mbetnë mbyllur Gardhiqotët e tjerë veç atyre që sikurse thame u përdhanë bashkë me Mustafa Pashën si penk, mirë po kur dërgoj Ali Pasha si kasnecë Tahir Agën edhe Isuf Arapin nde Bajraktar' i Gardhiqotevet Demir Agaj që të përépen, Gardhiqotët u dhanë përgjigje kasnecëvet dyke-i-sharë edhe dyke-u-tallur që s'e japën kështjellën edhe as që falen po që do-të luftojnë edhe të vdesin gjer më një. Kthehen pra kasnecët ndek Ali Pasha edhe i bien përgjigjen e Demir Agës, e cila përgjigje përveç shkelmimit të traktatit bashkonte edhe shnderimin ose turpniën e lashtë q'i patnë bërë Gardhiqotët familjes të Ali Pashës [1]). Atherë Ali Pasha kumandoj ushtërinë të jetë gati më parë për të pushtuar si-e-do-puna vëndet që i-u falë ati. Ndë mënjgjes pra të ditës 12 Marsit i eshkortuar prej një shumice të madhe

1) Shëkó KREJIN II të kesaj Historie.

trimash shkoj së pari ndë Gjinokastrë [1]). Vajtja e tij ndë Gjinokastrë kishte për qëllim të vëzhgonjë së áfërmi disa punë të qytetit edhe vendosjen e Autoritétevet të cilat do të reprezantójin regjimin e ri posa që vëndi u aneksua definitiv ndë Shtetin e tij. Me të vajtur aty i lajmoj Gjinokastritët që emëronte sundimtar të birë Salih Bejnë. Mbas pakë dit ndënjtje ndë Gjinokastrë tek la edhe një garrizonë një mijë burash, u nis për ndë Libohovë nek e motra Hajnica e cila pas vdekjës të burrit dytë të saj Sulejmanit, rronte ndë pallatet e saj afër Libohovës. Ali Pasha si erdhi aty pat me të motrën një bisedim të gjatë, objekt' i të cilit ishte fati që i priste ditë-zestë edhe gjemë-mëdhenjtë ndënjës të Gardhiqit. Të nesërmet një trumbë ushtarësh u dërgua prej Ali Pashës ndë Gardhiq me misiunë që t'i bjejnë ati të tërë turmën e meshkujvet të ç'do moshe. Oficeri i trumbës u komunikój Gardhiqótëvet urdhërin e Ali Pashës të cilët u ngutnë t'a ndërgjojnë, edhe pas pakë herë një sërth i gjatë Gardhiqotësh të pa-armët dyke-ecur ndë mes' të rrjeshtavet të trumbës ushtare xbrisjin të tatëpjetën e kodrës mbi të cilën dirgjej Gardhiqi. Si u prunë përpara Ali Pashës, ky i priti në krye me fjalë të qëtuëshme po pastaj i qërtoj ata për sjelljet e çndershme të tyrë, po u dekllaroj pastaj që do-t' i falte të gjithë edhe dot' i lënte të venë prapë ndë vënt të tyre. Këto fjalë ishin vetëm një ngushëllim i përtashmë së ndë të sipër-thanmen këshillë që pat me të motrën, Gardhiqotët u kondemnuan për vdekje. Vendimin i-a provokoj Ali Pashës e motra dyke-e gjetur të udhëshme që kështu merrej shpaga e turpniës së vjetër që u ishte rrënjosur ndë shpirt asaj edhe nënes [2]). Passi i lëshoj ata u poro-

1) Pouqueville-i përmënt një bashkëfjalim që pat pasur këtë ditë me Ali Pashën i cili i tha se kishte dëshirë që ditët e mbrame të jetës së tij t'i shkonjë ndë Gjinokastrë.

2) Këtu na duket rast' i mirë të shtojmë për së shkurtëri nga shkrimet të së famëshmes shkrimtare Shqipëtare, Dora D'Istra [2]) ndë librën e saj *Les femmes en Orient*, Libr' e

2) Dora D'Istra është pseudonimi i Princeshës Elena Gjika, bija e Princit Mihal Gjika i Rumanisë.

siti të bien nëpër hanet e Libohovës atë natë. Gardhiqotët u larguan të dëshpëruar, se më të përvojturit nga ata e pikasnë deshtinin që i pritte, edhe e mbushnë-mëndjen për këtë kur u gjëntnë të mbyllur nga ushtarët e Ali Pashës ndë Han' e Math të quajtur Han' i Valeresë i cili ishte i rrethuar me

---

*IV-të, letër e II-të,* ndë të cilën ndonëse e akuzon Ali Pashën po më shumë Hamkon edhe Hajnicën që ato më shumë e ngusnë Ali Pashën t'i rrebeshonjë Gardhiqotët, bie shëmbëlla të vrasjavet shumë më të këqia që janë bërë ndë Evropën e shekujvet të XVI-të e tëhu. Midis te tjerash përmi karakterin e gravet të Shqipërisë thotë këto që pasojnë:

„Shnderimet qe patnë hequr Hamkua edhe e bija ndë Gardhiq ndezë ndë zëmër të saj edhe të Hajnicës një urrejtje të papajcuar; sepse vendetta (ahmárja) ka akoma një infllueucë të madhe ndë këta male. Olimbiadha [1]) mëm' e Aleksandrit të math, e lindur ndë Shqipëri posi edhe Hamkua, është një shëmbëll që duket e shpiritit të ahmarjes të këti vëndi. E ndarë prej Filipit të Maqedhonisë, ajo u t' hoq ndë Toskëri që të pregatitnjë atje vendetën (ahmarjen). Besohet që ajo e pat armatosur vrasësin e Filipit të II-të. Ajo së sosmi e ngusi Kleopatrën, rivállen e saj, qe u varr. Nukë do-të mbaronj dot po të donja të bënj historin' e keqësiavet të saja të cilat u sosnë me anë të vdekjes së keqe (917 vjet përpara Kr.)

Hamkua i kishte të gjitha pësimjet (pasiunat) të mëmës Aleksandrit. Po, posi edhe Olimbiadha ashtu edhe kjo, dinte të presë kohë.

Hamkua vdiq pra pa parë që të realizohet ahmarja e 'saj kundër vëndësvet të Gardhiqit. Mir-po e dinte që sa të rronjë e bija, di-kush do-të mbetet pranë të birt që të mos e lërë që t'i harohen turpëritë që i-u bënë shtëpisë tij. Hajnica bashkë me rrekëtimat e mbrame të nënes vu-ndë-vesh edhe porosit' e fundit të 'saj.

Aliu s' u ndoth ndë shtëpi kur vdiq Hamkua. Ajo u-a la me të shkruar që të dyve motër-e-vëlla „që të eksterminojnë (t'i rrebeshojne) vëndësit e Gardhiqit ndek të cilët ra skllave bashkë me 'ta, edhe i nëmóste (i mallëkonte) po t' a shkelnin ndonjë herë këtë porosi.

Kur mbërrini Aliu ndë shtëpi Hamkua kishte vdekur. Tepër i hidhënuar (i pikur) që nukë mundi të dërgjonjë porosit e mbrame të nënes, Aliu betohet mbi trupin pa shpirt të saj, dyke-rrokur të motrën për dore, edhe kështu me dorën e tij mbi dorën e Hajnicës, që i ka për të përmbushur gjithë dëshirat e saj edhe se do-t' i farosnjë armikët e tij gjer më një.

Mbarë-vajtjet e Aliut nuk' ishin sa-do për ambicjen e Hajnicës. Ajo dëshëronte zhurritur për të dy bijt' e saj Elmazë

---

[1]) Olimbiadha ishte e bij' e Neoptolemit, mbretit të Toskërisë (Epirit).

një qark muresh. Numuri i gardhiqotëvet të mbyllur ndë këtë vathë. pas Pouqueville-it edhe gjyrmonjësvet të tij cifróhet gjer 500 shpirt të cilët po-sa hyjtin te hani u mbyllë dyert. Pas-si u bënë gjithë këto Ali Pasha dykë lënë pallatn' e së motrës edhe i eshkortuar nga një shumicë trup-rruajtes, vajti

edhe Ademnë ofiqet e Vezirátit. Aliu i cili s' kursente as-gjë për nalltësuarjen e bijvet të vet, nukë përkujdesej fare për të pritmin e nipërvet. Kjo indiferencë u këmbye ndë armiqësi kundër Elmazit kur *Padishahu* i paqetësuarshëm për fuqinë që po i shtohej përdita Ali Pashës, i-a rëmben Sheherin (Thesalinë) që t' i-a japë birit më të math të Hajnicës. Ambicióze sikurse ishte motër e Aliut nukë pshihte as gëzimin as pllanet e saja. Vij me qëllim të sundonjë ndë Tërhallë ndënë emërin e Elmazit që me aktivitétin e saj të muntnjë t'a bënjë Vezir djaloshin Elmaz Pashanë.

Mirë po nukë kalloj shumë kohë që nga emërimi i Elmazit ndë këtë post e kapi lijë-e zezë (variollë) edhe me gjithë përpjekjet e mjekut të pallatit vdekja e pamëshirëshme e shkuli befas nga krahët e nënes.

Me sytë të palëvizmë, me flokun të kërleshur, shtie sytë një copë-herë nek i biri, fytyrë-mvrojturë edhe me zë të vrázët mallëkonte Zotin edhe ditën që pat lerë. Të qarat me vaj edhe jamorkujet të gravet që e rrethojin përzjehen me bllasfemit' e saja, edhe Saráet e Tërhallës ngjisjin me ata burgje të damnuarësh të përshkruara nga vjershëtorët e mes-shekullit ndë të cilat kujet bashkë me nëmósjet formojnë një konqért të tmershëm. Posa u mbaruan funeráret Hajnica shkoj ndë Janinë ndek Ali Pasha i foli dyke-e-ngushëlluar për «hidhërimin e math».

Përkëdhélat e Adem-Beut, më të fuqishme nga fjalët e Ali Pashës përngjalljin shpresën ndë zëmër të nënes. Po edhe Ademi për së shpejti i vajti pas të vëllát ndë varr. Me gojë të shkumëzuar, Hajnica lypën t' i përjapin mjekët që «t' u pijë gjakun». Ali Pasha ishte ndë Thesali ndek mori përsëri ndë dorë pashallëkun që i ishte dhënë të nipt. Tahir Abazi i ngarkuar me Policjën e Janinës, s' mundej t' i shërbenjë tërbuarjes tó njëj nëneje të dëshpëruar edhe me gjith-këto kishte frikë t' i kundrështohet. Hajnica donte të vritej po e rruajtur më për së áfërti edhe me mos mundur të bënjë atë që kishtë ndër mënt, e kthen zëmëratën kundër Profetit. Nukë linte grat' e saj të mbajnë ramazanin, edhe vuri të rahën duke-shkepur ndë dru varfët *(dervishët)* të cilët i përzë me fjalë të ndyra nga pallat i saj; Ep urdhër t' u qethin perçet kuajvet edhe mushkavet të Ademit [1]). Tahiri dyke-pikasur që Hajnica ndë shka-

1) Këtë zakon e gjejmë ndër Thesaliasit e qëmotshëm. (Shih Euripid, *Alqesti*, vjershë 429).

nde Han' i Valaresë. Ishte dit' e Prëmte, Mars 15 i vitit 1812 pas-dreke, thote shkrimtari Anglez Smart Hughes, kur passi thërriti pranë tij Mirëditasit trupruajtës të vet, pjesa m' e zgjedhur e ushtërisë të tij gjithë katolikë, i urdhëroj ata të hyjnë ndë hobor të hanit edhe t' i vrasin ata që ishin brënda.

---

llúarjen e saj kish ndër mënt t' u vë-jë zjarrin saràevet fqinjë me barut-depónë, edhe që kësi-farësh ajo doj të flaknjë ndë erë Janinën e tërë, vrapoj t' i shkruanjë Vezirit: «Të shkonjë sakaqéhérash ndë Libohovë. u përgjeq Ali Pasha; po të ngarkonj me përmbushjen e dëshirës t' ime; të shkonjë me do-e-mos,» Hajnica nukë vendoj të bindet për të vajtur ndë Libohovë përveç-se passi thyejti edhe bëri iskëra me çekan pasqyrat edhe xhevahiret (gurët-e-shumëvlérëshm), passi dogji gjithë kazmiret edhe xhybet me qime të mira të saja; ndë zjarrin e saj edhe ndë dhëmpshurinë për vdekjen e të dy bijvet do-të donte të përmbysnjë krijésën e tërë. Përandaj pra q'atëherë e tëhu ajo më s' rrojti përveç-se për të këqia.

Gjëndja e çelevitur dhe e gazmuar e Libohovës, që zoton përsipër sheshit pëllor të Gjinokastrës, s' mundi t'a qetësonjë këtë shpirt të troshitur. Kur mësoj Hajnica për zaptimin e Gardhiqit u duk si-kur lindi përsëri: «S' të kam për të thënë më Vezir as vëlla, i shkruajti ajo Ali Pashës po të mos mbanç fjalën që i-u betove nënes mbi kufomë të saj. Ndë je i bir' i Hamkos t'a farosësh Gardhiqin; Zot së gjithash përmbi 'ta mos i haró turpet që na bënë ndë ditët kur na muar rrobër. Ora e ahmarjes harrijti edhe pra ata lipsen shuajtur prej faqes së dheut!»

Këto fjalë do-e-mos na çuditin. Po le të biem ndër mënt kapriçot e çuditëshme edhe të përgjákshme të Qezárëvet të Romës. Qezar Augusti, që të fillonjë Perandorinë, sakrifizój mijëra viktima ndë proshkriptat të triumvirátit.

Perandorët «apostolikë» Ferdinand i II-të [1]) edhe Leopold i I-rë [2]) të cilët gjejnë sot aqë apollogjistë ndë Perëndim, e patnë derdhur posi lumë gjakun e eretikëvet [3]). «Ali Pasha edhe e motra kanë qënë të frymëruar prej fismëriës *(zhénit)* despotike të Islamizmit sidozot Ferdinand-i edhe Leopold-i prej shpiritit të mostolerúarshëm të Romanizmit. A na vjen

---

1) Apollogjista e Ferdinandit të II-të kopión ópin llatin të La Mormain-it, *Virtytat e Ferdinandit të II-të*, përkthyer ndë gjuhën frëngjisht prej Leurechon-it, Paris 1638. Përqáset me F. Hurter-in *Geschichte Kaiser Ferdinands II.* S haffhouse 18 0—1853. Një shkrimtar anonim i shekullit të XVIII e titullój librin e tij të shkruar llatinisht: *Virtytat mbretërore të të shënjtit Ferdinand i II-të.*

2) Shëkó *Leopoldi I Römischen Kaysers, Apotheose*, 1705, in-folio.

3) Shëkó Schiller, *Lufta e tri-dhet vjétevet.* Alfred Michiels, *Ferdinand i II-të edhe konkordati austriak. — Restoráta katolike ndë Hungarië*, studijime të botuara ndë *Siècle.*

Po Mirëditasit refuzùan të përmbushin urdhërimin për vrasje njerëzish të pa armë [1]). Atherë Ali Pasha dyke-përmbajtur indignatën e tij u adresua nër të tjerët ushtarë të tij myslimanë po edhe këta të gjithë nukë dojin. Kur po ngjisjin gjith këto midis Ali Pashës edhe ushtërisë të sipërthënë, vjen tek ay Thanas Vaja, një nga oficerët e lartë të rrjeshtavet ushteriës bashkë me ushtarët që kishte ndënë kumandë të tij edh' i zotohet që t' i përmbushnjë urdhërin.

Atherë ushtarët e Vajës me të dëgjuar parollin e zjarrit nga Kumandant' i tyre, u turrën edhe dykekëcyer mbi të katër anët e parkut (*hoborit*) filluan të xbrasin-pushkë dëndur edhe zjar të pa rreshtur, kur të tjerë dyfegje rish-mbushur u epëshin atyre nga shokët që ishin përposh; fundja dyke-u-derdhur ndë vathë me jataganët xhveshur i masakruan ata që jetojin akoma. Një orë plot mbajti ky maqéll' i tmershëm ndë të cilin u përsuallën shkena të frikshme kur biri bij i vrarë pranë âtës edhe vëllaj pranë vëllajt. Maqelli prajti kur ra i vrarë edhe Gardhiqot' i fundit.

---

të besojmë që një Katerinë e Medikës *) të ketë më shumë shkruplla se-sa Hajnica? Shën-Barthelemi a nukë ka përqasje me maqélin e Gardhiqit?

Aliu edhe Hajnica i ndajtën rollet ndë vrasjet e Gardhiqit. Gjith-po-kështu edhe ndë Francë të Shekullit të XVI-të Katerina e Llorenës, dukéshë e Montpensiérit, tregonte po-atë enthusiazm për vrasje, posi edhe vëllaj i saj, herój i Shën-Bartelemit **).

Kur Veziri po vështronte që prej karavanserajit të Vuvallës vrasjen e njérësvet të Gardhiqit, një ushëtare (Hajnica d.m.th.) e pa-ndalëshme po dëpërtónte qytetin edhe i nguste gratë të heqin shnderimet më të papëlqyera ***).

1) Nga kjo sjellje provohet karakteri heroik edhe kalorës i Mirditasvet. (Smart Hughes, Travels in Sicily, Greece and Albania, in the latter and of the year 1812).

---

*) Mbretëresh' e Francës, e ëm' e Károllit te IX, që këshillój maqelin e tmershmë të natës të Shën-Barthelémit (me 24 Gusht 1572), kur u vran' e u prenë 25.000 protestanë Frënq.

**) Dukésha e Montpensiérit e përqáfosi mesagjérin (lajmëtárin) i cili i lajmoj vrasjen e Henrikut të III-të. „Vetëm për një gjë më vjen-keq, bërtiti ajo, që nuk' e dijti sa pa vdekur që nga unë i aidhi mortja".

***) Këto shkena gjak-ndézëse, nukë kanë ngjarë vetëm ndë Lindje (Orient). Kush nuk' e di se gjith-posi-këto gjérra të tej-së-tejsme (eksqése) janë bërë edhe ndë Itali nga *papalinët* të Papës Grigorit të XVI-të?

Kufomat e viktimavet të ngratë dirgjëshin njëra mbi tjatrën të mbytura ndë gjak. Me klithmat edhe brohoritë të ushtarëvet të Vajës përzjehëshin ndë desarmonië të cfilitshme kujet edhe rrekëtimat e atyre që hiqjin shpirt. Të nesërmet u vu mbi derë të hanit një tabellë me përmishkrimin që passon: «Dhashtë Zoti që kështu të humbasin gjithë armikët e familjes Ali Pashës» [1]).

Ditën e nesërme pas masakrës motër' e Ali Pashës, Hajnica, dërgoj ndë Gardhiq një trumbë ushtarësh për të përmarun gratë, pleqtë edhe fëmijët e katundit të cilët u prunë ndë Libohovë, edhe s'andejmi prapë ndënë eshkortë ushtarësh u çuan ndë Prevezë edhe i vendosnë ndëpër pronjat' e disa Gardhiqotëvet që ishin bërë qytetarë Prevezanë [2]).

Passi u mbarua kjo tragjedië, Ali Pasha iku prej Libohove, edhe dyke-udhëtuar vëndin përqark, u kthye ndë Kryeqytetin e tij, atje tek si-kur-se edhe ndë gjithë vëndet e ndënë zotnim të tij armiqt'e tij muar lemeriën; forca edhe influenc' e tij ndë tërë Shqipërinë harrijti tej-së-tejmes.

Ndaj fundit të vitit 1812 Ali Pasha mori një urdhër të Divanit të largohet nga qëndra e tij edhe të vejë ndë Tepelenë tek të mbetej gjer të marë urdhër të ri nga K/poja. Kjo masë defavoritéti e Divanit mbë Ali Pashën, u muar nga protestimet e rrepta edhe anëkimet e ambasadorit Frënk ndë K/pojë, edhe më

---

1) Ibrahim Manzour-i vërteton që, në vitin 1819 e pa me syt' e vet këtë të sipërthanme tabellë.

2) Rrebeshim i Gardhiqjotëvet, më 1812, (Mbl. Shq. Efth. Mitko, faqe 119).

*Gardhiqjotë o gunë-dhirë,*
*Ku e latë trimërinë?*
*U-bu-bu! burratë t'anë,*
*Ç'të keqe me sy që panë!*
*Janinë i shpunë të gjallë,*
*Me të pa-besë i vranë.*
*Mu'n te han' i Valarésë,*
*Plumbat vininë si vesë.*
*Mbë bataré i vrau djemtë*
*Mbyllur ndë hobor si dhëntë!!*

nj'anë nga qëndrimi armiqësor i Ali Pashës mbë interesat Frënge ndë Toskërië edhe ndë Shtatnisië, po veçanërisht nga një insulltë e flamurit Frënk ndë Janinë, e cila ngjajti si-kur-se passon : Kur një ditë Pouqueville-i kish dalë nga Konsullata, njerës zyrtarë të Ali Pashës hyjtin pahirisht ndë Zyrat e Konsullátës edhe muar kopje të korespondencës zyrtare të Konsullit Frënk.

Ali Pasha pra, dyke-i-u-bindur urdhërit të Divanit, mbeti për ca kohë ndë Tepelenë; po posa u informua për mos sukçeset e Napolonit ndë Evropë, pa pritur inshtrukta të ra prej K/poje, u kthye sakaqëherë ndë Janinë. Kjo reë e vogël e pahirësisë Sulltanike, ishte e para që u fanes ndë orizontin politik të Ali Pashës, po edhe shpejt-e-shpejt u shduk.

## KREJ XX.

Viti 1814 kaloj pa ngjarje të tjera, me rëndësi ndë Toskëri. Ndë Evropë, armët vitorióze të Frënqvet, pas farósjes të rrëmetit Napolónik ndë vëndet e shkretuara nga vetë Russët, pësuan mundje të parreshtura, edhe Evropa e bashkuar, u ngrit kundrë kuqeritórit të tmershëm. Këtë ndryshim Ali Pasha e gjyrmonte edhe nuk pushonte së kultivúari pranë Divanit idhenë të pushtetimit të plottë të Predominatës Ottomane ndë Shqipëri me mjet të pushtimit të Pargës së dëshëruar, e cila ishte ndënë pushtet të Frënqvet, të cilët ishin akoma zotër mbi Korfuzin. Passi mori lejën e Divanit pregatiti ushtëri të mjaftë ndaj mezit të muajit Jenar. Emëroj për gjenerall t' ushtërisë të birë Myhtarë, edhe për ndënëgjenerallë, Ymerá Vrionin edhe Ago Myhyrdarë. Kështu pra e dërgoj ushtërinë ndë Paramithië, që namëta të shtronjë di-ca agallarë brigandjetojës t'asaj përqarkje. Myhtarë e porositi të mbetet ndë Paramithië edhe me mjet trumbash të vogëla të gërmonjë kufiret e Pargës.

Po qëllimi i kësaj lëvizje ushtëriake ishte e pamundëshme t'i shpëtonte vërrejtjën konsullit frënk ndë Janinë, i cili sakaqëherash adresoj një protestim

mbë Ali Pashën përmi turrjen e padrejtë kundrë tokës Frënge. Ali Pasha u përgjeq se, me qënë që ësht' i informuar që Pargjotët merren-vesh fshehtazi t'a përjapën fortesën e tyre ndë duart' e Anglezëvet, e sheh me udhë t'a parambërrinjë qëllimin e tyre, posa që edhe vëndin e kushideron si të çeduar Portës me-anë të traktatit më 1800; gjithkohësh i lutej konsullit Frënk t'a ndihmojë atë ndë këtë vepër dyke-i-bërë emër Shefit Garrizonës t'-i-a përapë postin me kondita. Pouqueville-i e kuptoj rrezikun edhe dyke-dashur t'u'a bënjë të njohura këto Autoritetevet të Korfuzit, i përgjigjet Ali Pashës që vetëm Zotnia Donzelot, gjeneral' i Korfuzit ka pushtét të japë të tillë urdhër. Atëherë u dha rezollutë të dërgohet ndë Korfuz nga an' e Ali Pashës këshillonjësi i tij Jorgji Turtulli për t'u marrun-vesh mbi përdhënien e fortesës; gjith-po këti të cilin e kish edhe mik, Pouqueville-i i besoj një letrë ndë të cilën lajmëronte Gjeneralin Donzelot përmi gjithë ngjarjet.

Pas di-ca ditë Shefi i Garrizonës Pargës, me të marë prej Korfuzi njoftim përmbi rrezikun e afërt, u paragatit për defensivë, prapo Ali Pasha me mos marë as një lajm nga kasnec' i tij, urdhëroj më nj' anë kryetarët që ishin áfër kufirevet të Pargës të shkelin vëndet, m'anë tjatër fllotilla e mëngës së Nartës të lundrojë s' andejmi edhe t' i bjerë qytetit nga an' e detit; ay vetë shkoj me nxit ndë Prevezë për të vajtur më shpejt ndë qytetin e kuqeruar. Urdhëri u përmbush edhe natën e 22—23 Shkurt, një pjesë e ushtërisë dyke-kaptuar malin Pezovóll, ngaha formohej kufiri i vëndit të Pargës, dolli ndaj ullinjt' e përqark anëvet të qytetit (suburbiës) ndë pozitat e Zavollit edhe të Zelanicës. Gjith-po-atë mënjgjes u duk pranë anëdetjevet edhe fllotilla e Ali Pashës, e komanduar prej Anastás Makriut edhe Zeqirá Beut.

Garrizona Frënge e fortesës numëronte afëro 70 burra, edhe fortesa ishte e eqipuar me 34 kanona kalibri të ndryshmë, nga të cilët dy ishin vendosur ndë një nga fortesat pranë çitadellës. Kumandant i garrizonës ishte një grek i quajtur Haxhi Nikoll

ndë shërbim të Frënqvet (më parë ndë shërbim të Ali Pashës).

Posa u bë e njohur turrja e studijuar, një divizj' e garrizonës ndënë kumandë të vetë Kumandantit, edhe gjithë ndënjësit burra të dyfegut, zunë pozitat e përtashme përpara suburbiës, edhe me të harrijtur Shqiptarët ndë qarket rreth, u pritnë me zjar të gjallëshm nga an' e Frënqvet edhe Pargjotëvet të pshehur prapa gurrëvet edhe lisavet. Ndë krye të betejës Shqipëtarët muntnë t' a thyejn armikun po pas pakë-herë të tejmit të fryjtur me kurajë prej kryetarëvet të tyre, u bënë më të vërsulshëm edhe e përsëritnë zjarrin ndë gjithë vijën, aqë sa i ngusnë Ali Pashaliasit të përprapsen edhe të kështjellohen ndë shtëpit' e parme të anë-qytetit tek mprohëshin me më tepër flagësië. Gjithkohësh kanonat e fortesës kundruell suburbiës hithjin zjar të pa rreshtur kundrë Shqipëtarëvet, edhe u prune dëm të math gjer i ngutnë ndë shprapsje të përgjithshme, dyke-lënë mbi fushë të betejës 80 të vrarë nër të cilët ishte edhe trimi Daut Bej Tepeléna gjërië i afërt i Ali Pashës. Nga an' e Frënqvet u vranë 24 kanonarë edhe 13 Pargjotë. Ndë duresë të përjekjes fllotilla lundroj edhe hyri ndë liman edhe rrahu të shtjerë ndë dorë lundrat tregëtare të Pargjotëvet që ndodhëshin brënda, po passi zu të bombardóhej që nga fortesa, ngajti-ballë edhe u largua prej limanit. Ali Pasha ndodhej ndë Nikopojë kur me hidhënië mësoj për mos-sukçesin e ushtëriës tij edhe të fllotillës, po me gjith-këto dyke-mos-u-dëshpëruar kurrë edhe ndë dëmet, urdhëroj kryetarët e ushtërisë tij të ngrehin sa-kaqë herash një fortesë përjashta katundit Jaz, të pushtojnë vëndin përqark, edhe të jenë gati ndë parollin e parë të rishvërsullen me gjith fuqië kundrë qytetit. Ay vetë passi u kthye ndë Janinë me anë remonstrátash u përpoq t'a provokonjë konsullin Anglez Z. Forest, që, me nërmjetim të tij pranë gjeneralit Anglez që rrethoste Korfuzin, të përkrahej ndë tentativën për pushtimin e Pargës.

Dyke-kallkulluar të tilla vepërime nër Pargjotët bëri pllan t' u nçojë mosbesim mbë Frënqtë që kë-

simjeti të bjerë ndërkryerje kundrë garrizonës nga e cila të përfitohet ndë një kohë. Për këtë qëllim dërgoj një Pargjot që e kishte në shërbim të tij me një letrë për te Kumandant' i garrizonës Pargës, Haxhi Nikolliu, përmbajti' e së cilës ishte një marëveshje midis tij edhe Shefit të garrizonës.

Pllani i Ali Pashës me të vërtet pati sukçes, po nukë pruri rezulltetin që pritte. Pargjotët e kapnë çónjësin e letrës edhe dyke-parë rrezikun q' u kanosej nga shkaku i qëllimevet të suponuara të Haxhi Nikollit, u mejtuan që më s' u mbetej tjatër liman shpëtimi përveç se të ashpirojnë te hyjnë ndënë protekcje të Anglezëvet, edhe aqë më shumë së ndënë ata ndodhësin tani gjithë ujdhesat e Joniës përveç Korfuzit.

Kryetar' i fuqiavet maritime Angleze që mbajin bllokon e Korfuzit ishte Gjenerali Campbell, edhe sundimtar' i ujdhesës Pakso kundrejt Pargës ishte Majori Gordon. Këti të mbramit i dërgojnë Pargjotët një komision dyke i lypur protekcjen e Anglisë. Majori Gordon i-a transmitoj kërkesën Gjenelalit Campbell, i cili e akseptoj me konditë që Pargjotët vetë t' a ngrihjin shtëndardin (flamurin) Anglez mbi fortesë. Kondita vërtet ishte e rëndë, po me gjith-atë Pargjotët nukë hezituan përpara dilemës, edhe kësifarësh u bë marëveshja me Campbell-in që, t' u epet atyre një flamur Englez edhe ndëpër anëdetjet të përlundrojë një vapor lufte i Anglisë.

Më 21 të Marsit mbas-mesditjes u fanesnë dykeanës-lundruar fregatat Angleze, Bachant edhe Havamah; Pargjotët posa panë vaporet vune ndë vepërim pllanin e shtudijuar pej kohësh për zaptimin e fortesës. Të nesërmen me natë 200 burra t' armatosur zunë pozitat përqark portës së fortesës; gjithkohësh një grua e cila hynte liruar kurdoherë ndë fortesë me që ishte shërbëtore petka-lamëse atje, passi ngjeshi flamurin Anglez për mezi ndënë rrobet e saj, vajti edhe trokëllini portën e fortesës. Santinélla që ruante pyeti, edhe passi mësoj kush ishte, e hapi portën. Atherë më nj'anë gruaja po e mbante atë me fjalë, m' anë tjatër Pargjotët që ishin

aty afër, u turrën të gjithë brënda; kapin santinellën edhe ushtaret që flejin nde rruajtësore, edhe përpara se të kupëtonjë garrizona ç'bëhet, kështjella u mbush me Pargjotët e armatosur edhe me të tjerët ndihmëtarë që ishin brënda edhe jashtë qytetit edhe fortesës me të cilët ndodhëshin ndë marëveshjë. Frënqtë të surprizuar (të kapur befas) edhe të ndodhur pa armë, u ngutnë të përepen ndë duart' e Pargjótëvet. Akti u mbarua shpejtazi edhe afro pa fare gjakderdhje, përveç një greku, sekretar' i Shefit të Garrizonës i cili u vra pej Pargjotëvet se u epte kurajë Frënqvet për t' u rënë Pargjotëvet. Kur ishin dyke-u-bërë këto edhe passi u kap e gjithë garrizona që ndodhej ndëpër qytet, u nalltua mbi ballkon' e fortesës flamuri Anglez, të cilin posa e panë Anglezët e fregatës që lundrojin aty-drejti, brodhë me shpejtië edhe zbritën ndë tokë një grig Korsikánësh ndënë Majorin Gordon, edhe pushtuan qytetin edhe fortesën; garrizonën Frënge e çuan ndë Korfuz me fregatën Bachante. Kështu pra Parga hyjti ndënë pushtet të Anglisë.

## KREJ XXI

Vitet që rrjedhën që nga ky fakt gjer më 1819, nukë tfaqin as nonjë ngjarje me rëndësië ndë karierën e Ali Pashës, veç vepërimevet edhe përpjekjevet të tija për realizimin e dëshirës së tij mbë Pargën. Pas përndarjes të dinastiës Napoleonike prej Suveranëvet të aliatur, edhe passi u bë, alianca e Shënjtë, e tërë Europa edhe pas 'tyre edhe Perandoria Otomane e troshitur edhe e dallgëzuar aqë vjete nga luftra të përgjakshme, dolli ndë liman të paqës. Mirë po Sinodhi i Viennës që dedikój paqën Evropiane, edhe traktati i vitit 1815 midis Anglisë, Rusisë, Prussisë edhe Austrisë, i dha Ali Pashës rastin e mirë për kuqerimet e tija të ra edhe paqësore. Kur po vihëshin ndë Vienë bazat e paqës Evropiane, ishte e nevojshme të épej një deçizjë edhe përmi Shtatnisiat të cilat më parë ishin ndënë urdhër të Frënqvet, po të cilat Anglezët i patnë kuqeruar dyke-lëftuar Napolonin. Shteti i mirë i pu-

nëvet u vu nd' ndhë, edhe traktati i Parisit më 5 Maj 1815 midis Rusisë edhe Anglisë, nisiat Joniane i-a lente së mbrames ndënë protekcjë. Ndë këtë traktat nuk' u bë as një fjalë përmi Pargën, se ndë kohë të Venecjanëvet ndënë zotënim të të cilëvet ishin Nisiat Jonike, me që Tyrqia zotonte mbi tërë Shqipërinë, Vuthrotój, Parga, Preveza edhe Vonica, kushiderohëshin pushtime të pashkëputmë të Venecjanëvet, edhe aneksata të pandara të Shtetit të tyre. Këto aneksata gjyrmuan edhe aventurat edhe deshtinet ndëpër të cilat kapërxyen nisiat Jonike që nga përndarja e Demokratisë Venedikut prej Napolonit, gjer ndë kohë të rënies së tij. Përandaj ndë gjithë konvencjat të bëra ndë kohën e shkuar midis atyre Fuqiavet që patnë të bëjnë njëra-pas-tjatrës nërmjet tyre përmi shtetin të nisiavet Jonike, ç' do që vendohej për nisiat, gjith-po-ay fat kushiderohej edhe për këto aneksata. Po me anë të traktatit të vitit 1800 u bënë ca kanune të veçanta përmi ato pas formimit të pronjavet privilegjóre (*Imlaqi Humagjun*) ndënë predominatën e Portës, e cila pas traktatit të më sipërthënë kushideróhej si Suveráne përmi ato pronja.

Më 1817 u ndënëshkrua ndë K/pojë një marëveshje midis Portës edhe përfaqësonjësit të Anglisë Sir Trère me anë të së cilës Anglia përnjihte se nga shkaku i interesavet të saj edhe me që nukë kishte as nonjë të drejtë mbi Pargën, i-a çedonte atë Tyrqiës, zotit të saj të ligjëshm. Gatónjës i kësaj marëveshjë thuhet se ishte vetë Ali Pasha i cili nukë rreshtte së prezantuari Portës rreziket ndë të cilat shkonte qetësia publike nga elementet keqbërëse edhe reakcionare të cilët e kishin Pargën si vënt përikjeje ose trevë, edhe gjëndeshin ndë marëveshje me Suljotët sikurse edhe me të tjerë armiq të Perandorisë. Ndë këto introdukta Ali Pasha kishte përkrahës edhe komisarin e nalltë Anglez mbi ujdhesat Jonike, Z Thomas Maitland për marëveshje me guvernën Angleze. Korespondenca të paprajtura vejin-e-vijin midis Korfuzit edhe Janinës. Mâ së pari Ali Pasha posa u lajmua përmi ndënëshkrimin e marëveshjës,

lajmoj Zotniën Maitland më 13 Mars 1817, që komiseri i veçánëshm i Portës, Ahmed Effendiu, harrijti ndë Janinë. Atherë Maitland-i dërgoj ndë Pargë Llokotenent-kollonéllin De Bosset me 300 ushtarë Anglezë, i ngarkuar me misiunë t' u komunikojë ndënjësvet përmi vendimin e çedimit të vëndit të tyre, edhe t' u këshillonjë atyre bindje. De-Bosset-i vajti ndë Pargë me ushtarët e vet edhe kur pas-si ndënj ca ditë i shkruan Maitland-it që lajmi i komunikuar nër Pargjotët i pruri ndë dëshpërim, Maitland-i i-u përgjeq dyke-i-dhënë inshtrúkta të marë masa për ç'do trazyrë që munt të bënjë pjesa keqbërëse e vëndësvet.

Pargjotët, pas shpalljes të komunikátit prej De-Bosset-it, bëjtin një mbledhje ndë të cilën përfunduan që nuk' u pëlqen të jetojnë ndënë sundim të Ali Pashës, edhe e gjetnë me-udhë që me gjithë-sej të ç'atdhesohen prej vëndit të tyre passi të marin shpërblerje të pronjavet të tyre. Shumë nga parësia ishin kundrë këti vendimi nga shkaku që, ata dyke-parashikuar fundin e gjëmëshmë të atdheut tyre ishin shoqëruar pej kohësh me Ali Pashën dyke-e-quajtur për detyrë të përpiqen për shigurimin e fatit të pritmë të tyre, po-ashtu edhe të qytetarëvet të vet, posa që do-mos-do kishin për të hyrë ndënë pushtetin e Ali Pashës.

Si delegat' i Anglisë për marëveshjet mbi përdhënien e Pargës u emërua Konsull' i Anglisë ndë Patrë, Zotnia John Cartwright, edhe delegat' i Portës, po-ay që zumë ngoje më nallt, Ahmed Beu. Vepër e parë e delegatëvet posa ardhë ndë Janinë ishte ndënë-shkrimi i një farë traktati preliminár ndënë datë 17 Maj 1817, pas së cilës si konditë çedimi të Pargës, u caktua dëmshpërblim' i ndënjësvet, edhe pas-si të bëhej kjo do-të passonte zbrazja e fortesës prej ushtëriës Angleze edhe përdhënia e saj ndë duart' e delegatit të Portës.

Më 19 Maj pas ndënë-shkrimit të traktatit, delegatët shkuan për ndë Pargë. Këtyre u vajtin pas edhe një shumicë persónash (njerës) nër të cilët kishte pariën sekretár' i Ali Pashës, Mantho Eko-



KËSHTJELLA E PARGËS

ВКSH

nomi, burrë-shteti i matur edhe mjaft i dijshëm. Nesërmet pas ikjes së tyre vajti pas si eshkortë një trumbë ushtarësh Shqiptarë prej 250 burrash, e cila tendësoj ndë Paramithië, pakë orë lark Pargës. Po delegatët edhe eshkort' e tyre u ngutnë të mbeten për ca dit ndë Margarit, të ndalur nga Shefi i Garrizonës të Pargës i cili vuri për shkak një shtërgatë që ishte përhapur ndë disa vënde të Toskërisë gjer-sa numuri i eshkortës të Ahmed Beut u përcaktua ndë 26 burra, të cilët dyke-shkuar prej Paramithiës më së fundi hyjtin ndë qytet më 5 Qërshor. Më 18 të ati muaji të dy delegatët botuan Proklamátë nër ndënjësit e Pargës, me mjet të së cilës passi u bëhëshin të njohura vendimet midis të dy Guvernavet, i ftoiin ata të shpallin liruar deçizjën ata që dojin të lënë vatrat e tyre, gjëja e palëvizme do-t' u shpërblehej mbi bazë çmimimi të drejtë, dyke-u-paguar gjithkohësh edhe shpërudhjat e vajtjës ndë nisiat Jonike; Proklamata e delegatit Ottoman i instigonte Pargjotët të mos e abandonojnë (ikine-të-lenë) dheun vëntlerm me premtim të ç'farë-do përkrahje nga an' e guvernës së tij.

Këtyre proklamatave, një përgjigje e me-një-zë u dha nga an' e Pargjotëvet, edhe kjo ishte: abandonimi i dheut vëntlerm, edhe ç'atdhesimi i të gjithë Pargjotëvet prej Pargës.

U emëruan pra çmimonjësit, që i kishin prurë me vethe delegatët prej Janine, nër të cilët De-Bossete-i shtoj 24 Pargjotë nga më-shperiéntët qytetarë. Delegatët nga an' e Ali Pashës edh' aqë më shumë Manlho Ekonomi, përdorën ç'do mjet për t' i kthyer nga vendim i tmershëm i çatdhesimit, po ç'do lutjë ishte krejt e kottë; kishin venduar definitiv të ikine-t'a-lënë atdhenë edhe të venë ndë ujdhesat Jonike.

Çmimónjësit dyke-vajtur përpara me punën e tyre, e gjithë pasunië e ndënjësvet, veç shtëpivet u çmimua prej tyre mbi bazë kontraktesh shitëblerjeje, vendime gjykatoresh e. t. j., për 10 000,000 frënga; nërmjet kësaj pronje të palëvizme ullinjtë, kopshtat, edhe të tjerët drurë produktivë (*te pemëtë*) u çmimëzuan për 200,000 lira sterlina; mbetej edhe çmi-

mëzimi i pasuriës kamunale edhe kishëtare, kur Llokotenent-kollonelli Maitland urdhëroj rreshtjen e punevët të çmimëzimit, dyke-thërritur gjithë kohësh edhe delegatin Cartwright.

Rreshtja e punevët të komisiónit që ishte ngarkuar me përdhënien e Pargës u ngjat për shumë kohë, pothua se gjer ndaj krejit të vitit pasmë (1818). Ndë intervall të kësaj kohe Shefi i Garrizonës Pargës, De-Bossette-i u thërrit ndë Korfuz më 18 Korrik 1817 edhe u nëkëmbësua ndë krye prej Kollonellit Patrick Stuart, edhe më pas prej nipit vet Iacob Maitland. Komisioni vetë passi absentój për disa kohë nga ujdhesat Ionike, kur ukthye, i ftuar prej Ali Pashës, vajti ndë Prevezë bashkë me një shumicë të madhe shëtitarësh (me të cilët ishin edhe zonja fisnike Inglize edhe Lordhë, që ndodhëshin ndë Korfuz), tek ju bënë pritja të shkëlqyera edhe gostirra të begatshme nga an' e Ali Pashës. Shumë darova (dhurata) u dhanë si anëtarëvet të Komisionit ashtu edhe atendancës (pásësvet) së tyre.

Fundja më 20 të Marsit 1818, Protektóri i Pargjotëvet, Maitland-i, me mjet të një prokllamate të re, dyke-dekllaruar që vonimi i çmimëzimit pat për shkak ca anëkime të drejta të delegatit Ottoman përmi çmimësimin që u bë, e kushideron atë si të pavlerë edhe të pa-qënë, edhe lajmëroj të emërohen çmimëtarë të rinj, për t' u dhënë një funt pengimevet që i dalin, mjerisht, vëndit i cili u vendua definitiv të çedohet.

Këtë herë u emëruan çmimonjës eskllusivë të cilët kallkulluan vleftën e pronjës së pavëlizme me gjithë pronjat civile komunale edhe kishëtare ndë cifrën 11,500,000 frënga, prapo çmimonjësit e Ali Pashës e kalkulluan atë 5,118,000 frënga përveç pasjes kishëtare të palëvizme. Po edhe këtë çmimësim të ri Maitland-i e vulosi dyke-shkruajtur ndënë të që ishte i eksagjeruar (i tej-së tejmë). Passi kaloj prapë shumë kohë me mjet të një prokllamate të datës 4 Mars 1819 shpalli që, me as nonjë mënyrë nukë mundej të shtohet suma e 150,000 lirave sterlina, d.m.th. 3,755,000 frënga, edhe se Guverna Angleze nukë

kishte obligatë përmi pagesat e shpërudhimevet të emigratës të ndënjësvet, po zotohej vetëm për pagesën e dëmshpërblimit pas emigratës definitive.

Pargjotët u hidhënuan edhe e quajtën padrejtësi këtë punë të komisionit, dyke-thënë që, edhe vetë çmimëtarët e Ali Pashës e ngrihjin dëmshpërblimin shumë më të math nga cifra që kishte caktuar Komiseri Englez. Përmi këto një interview i rishm u bë midis Z. Maitland edhe Ali Pashës pas të cilit më 15 të Marsit një fregátë Angleze debarkój një divizjë pej 150 burrash ndë Pargë, edhe m'anë tjatër Shef' i garrizonës u lajmój Pargjotëvet se mbërrini koha që të pushtohet fortesa nga ushtëri e Ali Pashës, mbas marëveshjës së mbrame midis Z. Maitland edhe Ali Pashës ndë Vuthrot.

Ushtëria pushtónjëse e Ali Pashës ishte tendosur ndë rrëzat e mallit Pezovóll e urdhëruar që të rijë aty gjer të ikin Pargjotët prej qytetit.

Ashpekt i mallënjyershëm ishte ndë mënjgjezin e ditës 15 Prill kur një gjindje e tërë bëjin pregatitjet e emigratës prej të përmallshmit të tyre dhé vëntlerm. Edhe gjith-po-atë ditë pas dreke, afëro 4,000 gra, fëmijë edhe burra, hipën mbi fregatën Angleze Glascow edhe ndë lundrat që i kishin të tyret Pargjotët, me lotte të hidhura nër sy, të marë mbë qafë të parësiës ambicioze të qytetit, u kapërxyen ndë ujdhesat, ndëpër të cilat u përndanë, murgër edhe të pa-vatër. Me të ikur Pargjotët, 300 ushtarë të Ali Pashës u shkëputën pej ushtërisë edhe ardhë tendosnë afër njëj manastiri jo shumë lark qytetit; m'anë tjatër, Llokot. Kollonelli Maitland pas di-ca dit, mbassi vajti ndë Prevezë mori prej Ali Pashës sumën e venduar të dëmshpërblimit prej 3,755,000 frënga, pastaj nga Korfuzi bëri-emër për kapitullátën e kështjellës të Pargës. Më 28 Prill 1819 hyri ushtëri' e Ali Pashës që ndodhej jashtë qytetit edhe pushtoj fortesën dyke-nalltuar flamurin e saj.

Vetë Ali Pasha hyri ndë qytetin e dëshëruar më 2 të Majit të ati viti, tek rregulloj punët e vëndit edhe kolonizoj ndë të një numur të math shtëpiarësh të katundevet fqinjë edhe passi vu themelet e një

pallati magnifiqient (të shkëlqyer) brënda ndë fortesë, u kthye ndë Janinë.

## KREJ XXII.

Zapëtimi i Pargës i-a ngriti Ali Pashës edhe më shumë importancën politike të tij. Shteti i tij këtë herë ndedej mbi të tri copat e Toskërisë, mbë dishtriktet e Ohrisë edhe të Korçës, mbi vëndet e Agráfës edhe të Aspropotamiës, mbi vëndet që nga Levadhia gjer ndë kufiret e Thesalisë, mbi vëndet e Etolloakarnanisë, Lokudhës edhe Foqidhës gjer përbrënda vëndevet të Thessalisë. Veç këtyre influenca politike e tij ishte përhapur tepër edhe ndë vëndet e Shqipërisë Sipërme, të Maqedhonisë edhe ndë Thrakë. Shteti i tij kishte gjat-gjërësië 11,400 Killometra të katërçipta edhe ndënjës afëro 1,700,000.

Me që harrijti ndë një të tillë pozitë, ëndëra edhe dëshira e independencës të cilat prej kohësh e imagjinónte, zuri të fuqizohet për dit, edhe aqë më shumë se përveç shkallës që harrijti edhe pasunës së madhe që kishte, ishte i bazuar mbë bashkëpunimin e bijvet edhe të nipërvet të tij, si-kur-se edhe mbë devotimin e ushtërës trime ndënë kumandë të gjenerallëve të tij të famëshm. Përveç këtyre kishte edhe disa trupa ushtërie që manevróhëshin prej oficerësh Evropianë [1]).

---

1) Shteti Otoman, ndë kohë te Ali Pashës nukë kishte as një kushtruktë ushtëriake. Ushtëriat e tij i përbëjin turmat e Jeniçerëvet edhe ato trupa të shumëta edhe të shumëfárëshme që mblidhëshin hópe-mbë-hópe ndënë flamurët e gjymsëhënëzës, të cilat Pashallarët e vënde-mbë-vëndevet ishin të detyruar t' i mobilizójnë.

Janë të njohura përpjekjet e Sulltan Selimit edhe të Sulltan Mahmudit për reformuarjen e Shtetit Otoman edhe për introduktën (këllitjen) e sistemit ushtëriak që zotonte ndë Evropën e Krështerë, përpjekje të cilat me-zi ndaj fillimet e dekádës së dytë të shekullit XIX-të u kurorëzuan me surçes të plottë me mjet të farosjes së Jeniçerëvet.

Ali Pasha i pat kapëtuar avantázhet të ushtërisë së rregullshme, edhe me sa i ishte e mundëshme u përpoq të formonjë di-ca qëndra ushtërie Evropiane ndë vëndet e ndënë sundim të tij.

Po pllanet/ ambicióze të Luanit Shqipërisë i kotësoj një frymë urréjtjeje që fryjti prej K/poje. Ishte e deshtinuar që nga kjo epokë të perëndonte për gjithmonë ylli i tij. Që prej shumë motesh armiqt' e shumë të tij kishin mbjellë farën e mërisë kundrë tij ndë K/pojë. Po ay që shkakëtoj goditjen efektive kundrë Ali Pashës ishte Ismail Pasho Beu.

---

Po ushtëri e Ali Pashës përbëhej më e shumëta prej elemente të parégullshmë, përandaj një e pakët pjesë e ushtërisë tij kushideróhej ushtëri mbas sistemit Evropian. Nga të shumët të huaj që shëtitjin Shqipërinë nd'ato kohë edhe që na kanë lënë përkujtime të ndryshme janë informatat përmi numurin që harinte ushtëri e Ali Pashës. Nga këto më të hollësishme duken të Frëngut Ibrahim Manzour me që ky pat shërbyer mjaft vjete pèranë Ali Pashës si Kumandánt i lartër i xhenit (trupit ingjinérëvet) Mbas këti shkrimtari pra Ali Pasha kishte ushtëri gjer 8000 burrash e cila mundej të trimëzohej ndë kohë nevoje. Këtë ushtëri e përbëjin:

I) Çohadarët, ushtarë të zgjedhur, të cilëvet shumë herë u ngarkohej supertendenca e çifligjevet edhe e stanevet të shuma, edhe detyrat e mesagjerëvet (lajmëtarëvet) ose të tjera të tilla punë që ndryshojin nga mjeshtëria militare, ruajtës të depositvet e.t.j., shkurt me-thënë, jo punë ushtëriake.

II) Çarkaxhijtë, që ishin trup-ruajtësit (Trimat) e Ali Pashës. Ndë këtë trup përrjeshtóhëshin ushtarët që ishin çquar ndë trimëri. Këta i vejin-pas Ali Pashës tek-do kaluar, edhe ishin zakonërisht ekzekutórët e vendimevet të dënimevet për vdekje, përveç vârjevet të cilat ekzekutohëshin eskllusiv (vetëm) nga ghypët (evgjitët).

III) Gegët. Këta përbëjin pjesën më të zgjedhur të ushtërisë se parégullshmë të Ali Pashës Që të gjithë vullnetarë (vetëdashës) nga trumbat luftëtare të Shqipërisë Sipërme, nga ata që s' kishin hyrë nonjë herë ndënë Shtetin e Ali Pashës, ishin të përzjerë Myslimanë dhe të Krështerë të dhogmës së Perëndimit, Mirëditasit e famëshm, të cilët çquanin nga kuparáneja e zezë pa ajo e Myslimanëvet bashkëkómbas të tyre ishte e kuqe. Të gjithë pothua ishin të Kalorisë. Trima të shprovuar, edhe e kishin tepër të zhvilluar ndjenjën të nderit ushtëriak, nga karakteri shumë të sjellshëm edhe të dishiplinuar gjer mbë devotesë. Kumandan' i këti trupi ushtërie ishte një Gegë Mysliman me një ndënë-kumandan Gegë të Krështerë.

IV) *Asqeri*, që ishte turma e shumët e Toskëvet, Labër edhe Çamër. Këta përbëjin këmbësinë parimore (prinçipale) të ushtërisë.

Përveç këtyre trupa të parregullshme Ali Pasha kishte organizuar edhe këto që pasojnë trupa ushtërie të rregullshme:

I) Një batalon këmbësie prej 744 burrash përveç oficerëvet.

II) Nje shkadrón kalorie prej 26 burrash përveç të graduarvet.

E pamë më nallt këtë Ismail passi iku prej Thesalie bashkë me 100 trupruajtësit e tij përiku nde Pashaj i Halqidhës. Si mbeti ca kohë atje, nga frik' e Ali Pashës se námëta kalli njerës t' a vrasën, u ngut të ikënj ndë Karistë ku u prit prej vëllezërvet Bejlerë Ymer edhe Ibrahim; po edhe atje vetëm dhjetë dit ndënji, se i lajmuar nga miqt' e vet ndë K/pojë që edhe ndë Karistë nuk' ishte ndë siguri edhe se as që ishte e rastme koha që të përikënj ndë K/pojë, u mbarkua mbi një fregatë të Bejlerëvet që zumë ngoje më sipër edhe i shoqëruar prej Ymer Beut, debarkoj ndë Çezmé *(Qidhoni)* nde një miku i vet i quajtur Memus Bej. Aty i adresohet sundimtarit të Qytahjës, Shaqir Pashës, i cili i-u përgjeq se me që nukë do të hynjë ndë mërië të Ali Pashës ngutej të mos e përkrahnjë edhe as që mundej t' a qasnjë. Atherë Ismaili vendoj të vejë përsëri ndë Tyrqi të Evropës; debarkoj ndë Kavallë edhe s' andejmi me një mijë mundime edhe pas shumë aventura u hoth ndë Dramë nde Mahmud Beu*);

---

III) Kanonarë *(topçinj)*, 218 burra, afëró të gjithë të Krështerë.
IV) Bombardistë *(kumbaraxhinj)* 108 burra.
V) Trup' i ingjinerëvet *(i zhenit)* i organizuar nga oficerët Evropianë d. m. th. prej frëngut Ibrahim Manzour edhe prej një Italiani i quajtur Caretto.

Kryetárë pra të këtyre trupavet të rregullshme ishin kohë-mbë-kohë, së pari Ali Arapi, i cili pat shërbyer si oficer ndë ushtërin' e Napolonit ndë Egjyptë edhe pas këti një i Krështerë i quajtur Kristo Pallaska.

Kumandanë speçialë të batalónavet të këmbësisë kanë pas qënë Kasëm Demçja, Veis Vashari edhe Pano Lekljoti.

Kumandan i artilerjës ishte për pakë kohë një oficer Italian i quajtur Agostino Fappano, i myslimanizuar ndë Janinë edhe i paseмëruar Veli Aga. Po më pas Kumandan i parë i artilerjës edhe i bombardistëvet ishte Qako Lekljoti.

Fundja, i emëruari trup' i ingjinérëvet nukë përbëhej nga burra të veçanëshmë po kishte vetëm di-ca oficerë nga të cilët çquhej si shum' i zoti oficeri Ibrahim Manzour. edhe të tjerët ishin, Vicenzo Miccarelli më parë prift Italian, Don Santo Monteleoni, Siqelian, ky ishte krye-ingjinér i Ali Pashës më 1816 i cili trajtoj kështjellën e vogël te Ajasë pranë Pargës, edhe Napolitani Caretto.

*) Ky ësht' ay që bashkë me Musta-Be Qafëzezin përmarshój me ushtëri të madhe ndë kryengritjen e më-pas te Greqise.

Aty përiku Pashua se u lajmua që Ali Pasha i-a zbuloj trevën ndë Kavallë. Dramalliu Mahmud Bej, i pasur edhe i fuqishëm nd' atë vënt, me t' i-u lajmuar ardhja e tij e priti krahë-hapët edhe i premtoj përkrahje edhe miqësi. Vij me pandohmë Ismaili që aty mâ mundej t'a kushideronte vethen ndë shigurië edhe prëhje. Po perzekutónjësi i tij nuk flente. Ali Pasha passi mësoj shtegun e tij me mjet të miqvet të tij ndë K/pojë përmundi ti dalë një dekret Perandorák i cili urdhëronte ekshpullzimin e Pasho Beut ndë ujdhesën Lemno. Po lumërisht për Pashon çonjësi (*bumbashiri*) i fermanit u dërgua një nëpunes i plogët i Portës edhe miqt' e Pasho Beut edhe të Dramalliut mundën t' i lajmojnë me kohë për t' u marë masat e posaçme që kasneci të mos haset fare me Pasho Bejnë. Edhe kësi-farësh *bumbashiri* i pabërëshm u kthye prapë ndë K/pojë. Po pas këtyre ngjarjeve Pasho Beu lipsej të merte masa sigurimi kundër perzekutorit. Passi përndau trup-ruajtësit e tij ndë vise të ndryshme dyke-mbajtur me vethe vetëm tre nga ata, u psheh brënda ndë një të ndame të një quari (grazhdi) të Dramalliut, tek pati durimin të rijë dy vjet e gjymsë ndë mospikasje të askurkujt, veç protektorit.

Po përgjonjësit e Ali Pashës më së fundi mundën t' a deshkoperójnë edhe këtë trevë të Ismailit. Atherë ky për të mos i-u ngarkuar mikut të tij, Dramalliut, iku natën edhe vajti prapë ndë Halqidhë ; s' andejmi hypi një lundrë prej Spece, mbërrini pas shumë dit lundrimi ndë një liman të vogël afër Kafirës, edhe s' andejmi vajti ndë fortesën të Karistës. Po edhe aty nukë mundi të kobojë vërrejtjën e njerëzvet të Ali Pashës; Vojvoda i Kserohorit i quajtur Dalip Aga Përmeti, me të mësuar përmi përikjen e Pashos ndë Karistë, kur ky ndodhej ndë një kullë rurale të Ymer Beut, mundi të vendosnjë një voze barut ndënë kullë edhe i vuri zjar fitilit, po lumërisht për ata që rijin ndë kullë baruti nuk' mori zjar edhe të nesërmet u kuptua shkaku i tentativës. Si e pa Pasho Beu, që u bë e njo-hur ndënjtja e tij aty angazhój (pajtoj) një lundrë prej ujdhesës Psarë edhe zbriti

ndë një liman të Thrakës ngaha mori rrugën prapë për ndë Dramë nek Mahmud Beu. Këtë herë Mahmudi absentónte pej Drame i ndodhur ndë K/pojë. Pasho Beu i degjizuar, vet' i tretë u psheh për disa muaj nër ca barinj edhe bujqër të Dramalliut. Po persëri Ali Pasha u lajmua për ardhjen e Pashos ndë Dramë. Pesë të Krështerë, njerës besnikë të Ali Pashës vajtën ndë Dramë edhe mihnë një ndënëterrë ndënë shtëpinë tek ishte pshehur edhe herë tjatër ikësi, dyke-pandehur që atje do-të ndodhej edhe tani, edhe i dhanë zjar njëj sume të mjaftë baruti, nga ekshpllozj' e të cilit i tërë pallat' i Mahmud Beut u përmbys edhe u doq bashkë më gjithë pasuniën e tij që kishte brënda.

Kjo ngjarje, për dëmin e math që u bë edhe passi u pikás cili ishte faktori, pruri zëmërátë ndë K/pojë, edhe kur Dramalliu lypi drejtësi edhe satisfáktë, mori përgjigjie që, po studijohet rreptësisht shteti i Ali Pashës edhe konduita e tij përpara Guvernës Qëndrore, edhe e kështillojnë që të ketë durim ca kohë. Prapo Pasho Beu dyke i-ardhur tepër rëndë për dëmin q' e gjet protektor' e tij për shkak të vet, u ndes, edhe aqë më shumë se veç këtyre ishte lajmuar që familj e tij ishin bërë rrobër prej Ali Pashës edhe burgosur ndë Janinë edhe më pas ndë Tepelenë. Nga këto Pasho Beu vendoj të prozhetonjë me një vërsulje më të kuxuarshme ndë K/pojë kundrë armikut të papajcuarshëm. I ndodhur ndë letrëkëmbim të dëndur me miqt' e vet edhe të Dramalliut ndë kryeqytet, mbante veshët ngrehur për gjithë ç'ngjisjin ndë Shtetin e Ali Pashës edhe dyke-mësuar që prej di-ca kohë mundonte (s' dihet përsé), ndënjësit e katundit Dibrë të përqarkjes së Shkodrës çoj ndë K/pojë dy peticje. Njëra nga ato ishte e së shoqes së tij e burgosur ndë Tepelenë edhe tjatra e ndënjësvet të Dibrës, me mjet të të cilavet kallëzohëshin vuajtjet e tyre. Këto peticje i-u dhanë Sulltanit ditën që kthehej nga *Falja e Së Prëmtes.* Sulltani passi mësoj përmbajtjen e peticjevet thërriti përanë tij Vezirin e Math të atëhershëm Halet Effendinë, i cili sikur-se e dimë ishte miku i Pasho Beut, edhe nga

ay mësoj një-për-një gjithë shkaket e perzekutimit të Pashos prej Ali Pashës. Atherë Sulltani dha urdhrim të epet ndë Divan një dekret (*ferman*) me anë të të cilit Pasho Beu lirohej prej ekshpullzimit (syrgjynit) edhe thërritej të vinjë ndë Stambóll.

Ky akt' i Sulltan Mahmudit, d. m. th. deklináta e masës së rreptë kundrë njëj armiku të Vizirit Janinës, edhe thërritja reshpektive e atij ndë Kryeqytét, ishte bubullima e për-së-larkme e cila parëlajmonte greminën e nesërme të Ali Pashës, edhe si e tillë bëri përshtypje të madhe ndë Konstandinopojë.

Pasho Beu me të harrijtur ndë K/pojë u emërua ndë post të Autoritétevet, edhe ndë pakë kohë dyke-u-bashkuar me ata po ngrehte pllane për mjetet e katastrófës së tij. Posa u informua Ali Pasha për këto ngjarje, thuhet se paskërka çuar ndë K/pojë ndë Shkurt 1820 dy njerës të devótshëm për t' a vrarë Pasho Bejnë. Edhe atentáti u rrah me të vërtet po fati i ndihu përsëri Páshos. Më 1 të Marsit të dy atentatórët të cilët pej disa dit vozitjin ndë Stamboll edhe përpiqëshin të gjejin kohë edhe voli, vijnë kaluar përpara shtëpisë Pasho Beut, kur ay po rinte ndë një dritare të unjët, shkrepnë të dy bashkë kundër tij, po që të dyja plumbat nuk' e goditnë. Tërhóqi edhe Pasho Beu një pisqollë kundrë tyre po ata iknë. Ndë zbrazjet e pisqollavet brodhë shumë njerës edhe dyke-gjyrmuar ikësit kapnë njërin nga ata i cili ndë interogátën që i-u muar dekllarój që Ali Pasha i pat kállur.

Kjo ngjarje shkakëtój një shkandháll (zallahië) të math edhe ndézi zëmëratën e gjithëvet po vëçanërisht të Sulltanit aqë më shumë se shtëpia tek rinte Pasho Beu dirgjej vetëm di-ca çapa lark palátevet. Armiqt' e Ali Pashës, miqt' e Pasho Beut bërtisjin që qysh Porta nukë merte masat e mbrame kundrë tij t'a luftonjë edhe t'a zbresë nga ky post dykevendosur një tjatër ndë-vënt të tij. Mirë po një përmarshim Sulltanik kundër Ali Pashës do-të bjente lëkundjen e tërë godinës politike të Osmanllinjvet edhe do-të ishte parolli i ndërkryerjes të disa provincavet të Perandoriës. Përveç kësaj lipset të shtojmë

që edhe fuqia edhe organizata administrative e Ali Pashës reshpektóhej nga më të naltët nëpunës të Shtetit, edhe sidomos takonte edhe përkrahjen e di-ca ambasadorëvet Evropianë ndë Konstandinopojë.

Mirë po këtë herë me që puna u shtyjt prej vetë Suveranit të Naltë, ata që merrëshin me këtë punë venduan të vënë ndë vepërim prishjen e Ali Pashës me ç'farë-do bllatimesh (therorësië), edhe më shumë se, fama ishte përhapur tek-do për rrësqet fabullóze të tija, edhe ënda (apetiti) për të zaptuar pasunit e Ali Pashës ishte një nga kordet (*dyzénet*) që tingëllonte ëmbël ndë veshët e Padishahut edhe të Sadrazémëvet të tij.

Pra masa e parë që u muar nër sy prej Divanit ishte përzënia e komisérëvet edhe nëpunësvet të Ali Pashës prej Kryeqytetit; e dyta ishte pushimi edhe zbritja e bijvet të tij nga postet e Pashallëkevet që kishin, edhe veçanërisht nga ay i Thesaliës, se ky vënt me qënë áfër Pashallëkut Janinës, ishte dera e hyrjes të ushtëriavet Perandoráke. Lipsej pra që vënd' i Thesaliës të delte nga duart' e Ali Pashës. Përandaj u çua përnjëherë ndë qëndrë të Administratës, Sulejman Pasha, të cilit i-u ngarkua edhe ofiqi me rëndësi i Inspektorit të rrugavet Thesalisë edhe Toskërisë (*Dervenat Nazër*), ofiq të cilin e kishte prej 40 vjet Ali Pasha. Gjithë këtò masa u muar me proponimin të Ismail Pasho Beut. Pasho Beu mbassi mori urdhër sekrét prej Sulltanit që të meret-vesh me Vezirin e Math për këto punë, ndaj Marsit më 1820 u proponua që e mira ishte që Porta të përdornjë masa të urta ndë krye mbë Ali Pashën, edhe proponimet ishin si-kur-se passojnë: I) Zbritja graduále nga Pashallëket e Thesaliës, Nebahtit, Beratit, edhe të Delvinës. II) Përcaktim i Ali Pashës vetëm ndë Pashallëkun e Janinës, edhe III) Ftimi i tij që të apë demisjën edhe nga Pashallëku i Janinës, dyke-u-t'hequr ndë Tepelenë.

Proponimet e Pasho Beut u pranuan edhe me shpejtië u vunë ndë vepërim. U emëruan edhe sundimtarë të Pashallëkevet këta që passojnë: Ismail Pasho Beu, sundimtar i Janinës edh' i Delvinës, Baba

Pashaj i Nebahtit, edhe Nuri Pashaj i Beratit; gjithkohësh këta u urdhëruan edhe të mobilizójnë.

Importáncën e másavet që u muar ndë Stamboll e kupëtoj shpejt-e-shpejt Ali Pasha; andaj dyke-moshumbur fare kohë mblodhi me vrap memorandume nga an' e ndënjësvet subjektë të tij, edhe organizój dërgesën e një deputácjeje ndë K/pojë për të provuar që populli nukë kanë as një qarjë kundrë tij. Ndë këtë kohë Ali Pasha ndodhej në Pargë edhe me t' u lajmuar aty që punët po ashpërohëshin, sakaqëherë dërgoj ndë Korfuz sekretarin e vet Mantho Ekonomin, tek me mjet të Komisionerit Englez shpërente të kishte nërmjetimin e Guvernës Britanike përanë Portës. Po përgjigja e Komisionérit i-u dha që, Guverna Angleze nukë mundej të përzihej aspak tani ndë çështjen e tij, vetëm një gjë mundej të bënjë nga an' e tij thoshte Komisioneri që, do-t' e kushideronjë vethen e tij të lumur t'i shpëtonjë mikut tij Ali Pashës jetën si-kur-se edhe pasuniën e tij ndë qoftë se i çon ndë Korfuz; shkurt me thënë i garantóhej për shpëtimin e tij dyke-porositur Kapitanët e vapórevet të lundrojnë përanë anëdetjevet të tija. Kaqë qjë i premtuan Ali Pashës miqt' e tij Anglezët, po as nonjë konkurs tjatër.

Thamë më sipër që organizoj një deputácje për t' a dërguar në K/pojë bashkë me memorandumet nga an' e ndënjësvet, dyke-i shtruar Divanit fakte përmi gabimin ndë të cilin ndodhej për masat që ishin marë kundrë tij dyke-marë nër sy intrigat e shpifura nga dëmdáshësit të interesavet të Perandoriës edhe aqë më shumë ndë këtë epokë kur nër Grekërit subjektë të Perandoriës zotonte një lëvizjë e pazakónëshme kundrë Suveranit të Nalltë, i kujtonte Divanit që nga këto gjërra rrezike të mëdha i kanosëshin Shtetit, edhe mbaronte dykë-thënë që, si shërbénjës besnik i Perandoriës e kishte për detyrë t' i bënjë të njohura gjith-këto.

Memorandumet nga an' e subjektëvet edhe informátat e Ali Pashës të çuara ndë Divan bëjtin me të vërtet një përshtypjë të madhe edhe u biseduan gjër-e-gjatë, po kundrështarët e tij të cilët ishin të

shumë, edhe më i tmershëm Pasho Beu, protestojin nxehtisht që komunikatat' e éndura të Ali Pashës nukë meritojin vërrejtjë, se këto kishin për qëllim vetëm prapsjen e masavet përmi perzekutimin e tij, edhe se po të mos luftohej ketë kohë Shteti do-të harrinte ndë përçarje të mëdha.

## KREJ XXIII.

Ali Pasha dyke-mësuar që proçedura e re e tij ishte krejt e kotë, edhe mëndje-mbushur që ishte e pamundëshme të shprente për nonjë ndryshim të dispozitavet të tija përpara Portës së Naltë, vendoj definitiv të ngrerë Flamurin e Kryengritjes kundrë *Padishahut* dyke-vënë ndë vepërim pllanet e studijuara pej motesh, për independencë. Por pllani lypte bashkëpunëtorë, se fort të pakë ishin anëtarët e tij idealistë të independencës. Dërgoj pra letra qarkëtore ndë të gjith' anët e sundimit edhe apóstujt' e tij brodhë nga të katër çipat e Shqipërisë.

Pas këto ndë Maj 1820, ftoj ndë një miting të përgjithshëm gjithë parësiën që rijin lark vepërimevet të tija, të cilëvet u shtroj përpara që me konkursin e tyre do-të mundjin t' i shtypjin udobisht ushtëriat Tyrke edhe kondidat e paqës të diktohëshin përpara K/pojës vetë, kur po t' a lejin përkundrazi vetëm ndë këtë rrezik, të përçarë do-të shtypëshin prej Tyrqiës më pas. Mbaroj dyke-u-dhënë të kupëtoinë që, qëllim' i tij ishte formimi i një SHQIPËRIE SË MADHE vetqeverimtáre, independente edhe koshtutore, mbas sistemit të Mbretërivet të qytetëruara. Kësifarësh gjithë parësia që ndodhëshin ndë mërië me'të u bindën edhe i dhanë BESËN, që do-të luftojnë përanë tij me gjith fuqiat e tyre. M'anë tjatër edhe Kapedanët e Krështerë të gjithë, të gatijshëm i dhanë BESËN që do-t' e përkrahin gjer ndë të sosme. Thuhet se Bajraktarët ose Kapedanët e Greqiës Tokës i proponuan Ali Pashës të marë kryesinë të një lëvizjeje qëllim' i së cilës të jetë shkëputja e gjithë Shqipëriës edhe Greqiës prej Shtetit Ottoman. Ali Pasha e paskërka akseptuar këtë me konditë të

emërohej ay Suveran' i Shqipërisë edhe i Thësalisë, prapo Greqinë bashkë me Pelloponisiën t'a ketë ndënë hije të tij. Më pas Ali Pasha u premtoj veç armëvet edhe municjevet t' u epte 7,500,000 grosh, edhe po të deljin faqebardhë ndë qëllimin e independencës, vëndet e Greqisë të quhëshin të ndënurdhërshme te ay vetëm me anë të pagimit të tributit të së dhjetës. Po gjithë këto marëveshje mbetnë vetëm pllane të pabërëshme nga shkaku që nukë mbretëronte sinqeritét nga të dy anët.

Ndë këtë kohë Guverna e Stambollit po epte urdhrime mobilizimi mbë gjithë sundimtarët e Sanxhakëvet të Thrakës edhe Maqedhonisë, edhe gjithkohësh porositi sundimtarin e ri të Thesaliës, Sulejman Pashën, të pregatitnjë ushtëri edhe të marshonjë kundrë Ali Pashës. Ky passi ardhi ndë Thesali adresoj një prokllamatë edhe nër të Krështerët subjektë që të armatosen edhe të pregatiten për vërvitje kundrë të ndërkryerit. Prokllamata e Sulejmanit u pranua nga të Krështerët po pruri mërië nër Myslimanët e Thesaliës të cilët e quajtin për rrezik këtë masë edhe bëjtin protestime të rrepta ndë K/pojë kundrë Sulejman Pashës. Nga ky shkak u thërrit s'andejmi kur po gatitej të kapërxenjë malet e Pindos. Si harrijti ndë Selanik, me urdhrim të Sulltanit i-u pre kryet i akuzuar si kushpiratór kundër interesavet të Mbretërisë.

Ali Pasha që ndë krye të të korravet 1820, dykepërfituar nga plogësia që tregojin armiqt' e tij ndë kuqendrimin e ushtëriavet të tyre kundrë tij, thërriti një këshille ushtëriake të madhe, ndë të cilën nga të shumat mendime që u shfaqnë, zotoj mendimi që të pushtohen për defensivë gjithë katundet e malevet të Toskërisë edhe Mesditës-Perëndimit Maqedhonisë, si-kur-se edhe vëndet e Shqipërisë Sipërme, edhe dha kumandë si-kur-se passon: Fortesën e Janinës do-t'a mpronte vetë Ali Pasha, të Beratit djemt' e tij Myhtari edhe Saliu, të Prevezës Veli Beu, Tepelenën i bir' Myhtarit, Mahmud Beu, Pargën i bir' i Veliut, Mahmud Pasha, Sulin, Myrto Çalua, Nartën, Dalip Përmeti, Paramithiën, Tahir

Abazi, Gjinokastrën, Meço Bonua, Përmetin Elmaz Mahmudi, Melesinin Ilias Agá Zylyftari, Korçën edhe Ohrinë Xhelaledin Beu. Të tjerë oficerë Shqipëtarë do të zinin pozitat e Këlsyrës, të Pesë-Pusevet, Vuthrótin, Sarandën edhe të tjera. Përveç këtyre, nga kryetarët e Krështerë, Andronuçit i-u ngarkua të zërë viset e Levadhiës, Karatasit, Thermopillat, Kolo Sturnarit, Aspropotamiën, Ndreko Iskos Agrafën, Iorgo Zogut Olympin (Limbozin), Bllahavénjvet, Haset, Jani Varnaqotit Kseromerin, edhe fundja shumë të tjere Kryetrumerë Shqipëtarë Muhamedan' e të Krështerë u ngarkuan të zënë pozitat mbi udhët e malevet të Pindos.

## KREJ XXIV.

Kur gjithë këto po endëshin ndë Shtetin e Ali Pashës, ndë K/pojë m'anë tjatër dolli dekréti Perandorák që pritej pej kohe edhe i cili e dekllaronte Ali Pashën *fermanlli*, me-thënë fajtuar krime trathëtie edhe armik i përnjohur i Perandorisë po të mos tfaqej aty e dyzet dit ndë K/pojë përpara pragut të florishtë të *Portës së Lumtësiës*, për apollogjië. Të dyzet ditët kapërxyen edhe Ali Pasha si përgjigjje mbë dekllaruarjen po pregatitte me shpejtië ushtëri të madhe me municje të tépërshme. Divani m'anë tjatër prej kohësh dha urdhërim mobilizimi po pregatitjet e tyre bëheshin shumë me ngathësi nga gjëndja ekonomike mizore e Shtetit Ottoman. Po si-do që ishte shtet i punevët, Kryetar' i fuqiavet ushtëriake Tyrke ishte Ismail Pasho Béu.

Urdhërimet e përmarshimit u dhanë si-kur-se pason: Një trup ushtërie ndënë kumandë të Pasho Beut edhe të Mahmud Dramalliut kish për të rhyrë me anë të Perëndimit Maqedhoniës edhe të Thesaliës ndë Toskëri; tjatër trup pej afëro 3,000 shpirt ndënë kumandë të Pehlivan Hasan Pashës, i miemëruar *Baba* nga shkaku i moshës tij të lashtë, do-të zbriste me anë të Maqedhonisë së Lindjes ndë Thesalië, edhe s' andejmi ndë Greqi të Tokës për të pushtuar edhe Pashallëkun e Nebahtit. Të tjera trupa

ushtërie ishin për t' u çuar prej Valiut të Rumelisë Selim Pashës edhe prej Shkodranit Mustafa Pashës. Gjithëkohësh një shkadron' i flotës Tyrke u urdhërua të lundrojë për ndë anëd-tjet Toskënore për të bashkëvëpruar me ushtëriat Perandorake.

Prapo shkadroni dyke-lundruar prej Bosforit mbërrini ndë anëdetjet e Toskërisë, edhe m'ane tjatër ushtëri e Baba Pashës dyke-hyjtur ndë Thesali bëjti një mijë keqbërje edhe plaçkitje kundrë gjithë ndënjësvet. Pas këto dyke-shkuar ndëpër Thermopyllë shtiu ndë dorë pothua se pa nonjë kundrështim dishtriktet e Levadhiës, edhe të Thivës, edhe po çápej për ndë Nebaht. Këtu duhet të shënojme që, nga Kapedanët e Krështerë që pat vendosur Ali Pasha për të mprojtur viset e sipër-thëna, disa nga ata me ngacmim të një sekretari grek që mbante Baba Pasha i lanë pozitat e tyre dyke-u-bashkuar me ushtëriat e gjeneralit Tyrk. Dy prej 'ta, Andrucua i Levadhiës edhe Karatasi i Thermopyllavet, oficerë besnikë të Ali Pashës, passi mbetnë vetëm me shokët e pakë të tyre, edhe të ndjekur edhe nga vëndësit, posa harrijti avantgarda e ushtëriës Tyrke u hoqnë edhe vajtin te Ali Pasha.

I bir' i Ali Pashës, Veli Pasha që ndodhej ndë Nebaht, përpara se të mbërrinjë ushtëria Tyrke ndë Thesali, la kryegarrizonas Islam Be Konicën edhe passi çoj familjen e vet ndë Prevezë u nis e vajti ndë Janinë, tek passi mori instrukta nga Ali Pasha, u kthye prapë ndë Prevezë e cila i ishte ngarkuar për t'a mprojtur.

Shefi i garrizonës së Nebahtit, me të parë ushtëriën e Baba Pashës që po qasej vendoj t'a përjapë fortesën pa-u-këshilluar fare me oficerët e tij, dyke-u-dhënë urdhër ushtarëvet që ruanin të dalin nga fortesa edhe të zënë di-ca pozita të përtashme jashtë qytetit. Të ngratët ushtarë të bindur ndë urdhërim të Kumandanit duall jashtë kështjellës dyert e së cilës u mbyllë posa u larguan s' andejmi. Atherë ushtaret muar malet përpara rrëmetit të math të Baba Pashës, edhe m'anë tjatër trathëtori Islam Bej përdha vethen e tij edhe kështjellën ndë duart e gjenerálit

Tyrk. Kësifarësh Baba Pasha shtiu ndë dorë kryeqytetin e Pashallëkut që i-u oferua, edhe dyke-kuqeruar gjithë vëndet e Ali Pashës ndë Greqi të Lindjes, po çapej për ndë Etollo-Akarnanië, shtiu ndë dorë Mesollongjin edhe Etoliën edhe tendësój jashtë Vonicës; aty pritte harritjen e flotës që së bashku me ushtërin' e flotës t' i vërvitet Prevezës. Varnaqóti me shokët e ndënë kumandë të tij u t' hoq edhe ky dyke-vajtur ndë Janinë. Midis këtyre Ali Pasha mëson që i ngarkuari për mprojtjën e Nartës, Dalip Përmeti kishte hyrë ndë marëveshje sekréte me Baba Pashën për t' i-a përdhënë ati postin, andaj dërgoj besëtarin e tij Elmaz Agë Meçon me 3000 Shqipëtarë të cilët posa vajtën trathëtorin e vranë edhe fortesën e Nartës e shtinë ndë dorë.

Kur punët ndë jugë të Toskërisë edhe ndë Greqi të Tokës po vejin kështu, Valiu i Rumeliës Selim Pasha prej Manastiri po shkelte Shqipënin' e Mesme, edhe avantgarda (balli i ushtërisë) e tij po i afërohej fortesës së Berátit. Posa u informuan për këtë të bijt e Ali Pashës Myhtari edhe Saliu ikën-e-lanë fortesën edhe shkuan me vrap ndë Gjinokastrë pa-ukundrështuar fare rrëmetit të Tyrqvet.

Ndë këtë kohë shkadroni i flotës Tyrke u drejtua për ndë Vlonë tek passi zaptoj më parë fortesën e saj shtiu ndë dorë edhe qytetin, dyke-përzënë s' andejmi të pakët ushtarë të Ali Pashës që ishin aty. Edhe kështu ndë pakë dit Vlona edhe Kanina hyjtin ndënë pushtetin e Sulltanit. Gjith-po atë fat pati pas pak edhe Korça. Më tutje flota dyke-marë anëdetjet me radhë kuqeroj pa gjakderdhje Sarandën edhe Vuthrótn.

Është për të çuditur qysh ndë interváll të pakë javësh e gjithë ar ëde j' e Toskërisë që nga Vlona gjer ndë Prevezë, edhe pjesa m' e madhe e vëndit që zotonte Ali Pasha ra ndë duart e ushtëriavet Tyrke pa fare rezistencë. Suljotët që ndodhëshin ndë Korfuz kur mësuan që flota Otomane ndodhej ndë Prevezë, 300 veta pej'ta, ndënë kryesi të Bajraktarit të tyre Noti Boçarit vajtin nde Kumandan' i flotës Ali Beu edhe lypnë të bashkëpunojnë me ushtëriat Sull-

SULLTAN MAHMUD I II-TË
REFORMATÓRI
Që çoj ushtëriat e shumëta kundër Ali Pashës.

(Hipur ndë fron më 1807 me ndihmë të Shqipëtarit
Mustafa Bajraktarit (Sh. f. 102).

BKSH

tánase kundër Ali Pashës, dyke-u-lutur që t' u permitóhet të kthehen përsëri ndë Sul nër vatrat e tyre. Lypja e tyre u pranua edhe batalón' i Suljotëvet u bashkua me ushtëriat Tyrke.

Kryetari i ushtëriave Otomane, Ismail Pasho Beu u nis pej Llarse më 15 Gusht 1820, edhe Dramalliu me një ushtëri prej 6000 burrash po écënte për ndë Toskëri dyke-kapërxyer malet e Pindos. Ismail Pasha me 3000 ushtarë dyke-ardhur ndë Allasonjë edhe ndë Grebené, po shkelte gjithë për nd'ato vise dyke-dëpërtuar kufiret e Maqedhoniës. Divizja e parë e ushtëriës Dramalliut passi goditi kullat e mëdha që ndodhëshin udhëve të malevet të Zigojt mbërrini gjer ndë Mecovë. Ruajtësit e këtyrë kullave që përbëjin ushtërin' e ndënë kumandë të Ymerá Vrionit me urdhër të Gjeneralit të tyre u përprapsnë dyke-vajtur ndë Janinë [1]).

Divizja e dytë e ushtërisë Tyrke jo vetëm nukë hasi kundrështime, po gjith-po-ashtu pa fare ndalim shkeli gjithë vëndin e Toskërisë. Ndë pakë ditë gjithë këto trupa ushtërie harrijtin njëra pas tjatrës përpara fushës Janinës edhe tendësuan ndë vëndet përqark katundit Kaçka. Ismail Pasha, i cili harrijti pakë më pas nga Dramalliu, vendosi kartierin e përgjithshëm ndë pozitën Bunilla. I pikturëshm (i bukur) ishte ashpekti i fushës Janinës kur ushtëriat e shuma edhe të ndryshme tendësuan që nga pozita Kaçka gjer te kisha e vogël e Shën-Kollit të Kopanës ndë buzët e Veri-Perëndimit të liqenit.

## KREJ XXV.

Po kundrejt këtyre fuqiave Tyrke edhe defensiva e Ali Pashës nukë binte as-pakë më poshtë. Fortesa e Janinës, natyrisht edhe arhitektonisht e fortë ishte e patundëshme nga punët kështjellóre të rëndësiëshme që i kishte bërë Ali Pasha që kur mori Pashallëkun

1) Ymerá Vrioni passi mori mjaft të holla edhe premtime nga Kryetarët e ushtëriës Sulltánase nuk rezistoj fare ndë batejë, ndónëse ishte i fuqishëm të mos i lente ushtëriat Tyrke të përparojin me aqë shpejtië.

e Janinës. Ishte e eqipùar me kanona të shuma edhe kalibri të math, me municje të tépërshme, edhe ndë unazë të saj përmblithte kështjellën e famëshme *Yç-kala*, ndë të cilën ishin edhe depótë të barutit. Përjashta fortesës së madhe ndë distancë afëro një mijë metrash mbë jugë të *Yç-kalasë* nalltohëshin *Lithariçët*, kështjella te paluftuarshme ngrehur mbi një kodrë ndë të cilën ishte trajtuar edhe një kullë (pirg) e fortë. Pakë kohë përpara rrethimit ishte mihur me aktivitét një transheë e gjërë edhe mjaft e thellë që përmblithte gjithë qytetin e Janinës që nga lindja mbë perëndim. U trajtuan edhe di-ca parqe (mbylltina) të forta që nga maja e kodrës të Profetit Ili ndë rrëzat e së cillës mbarojin mbë të dy anët të dy hargjet e transheës (*hendekut*).

Ndë kohën e rrethimit lëvizj' e madhe zotonte tek-do, dit'-e-natë ndënjësit merrëshin me fabrikátën e armëvet, të municjevet, edhe me transportin edhe vendosjen e tópavet edhe të obuzevet (gjylet). Mbë ç'do vënt Ali Pasha vetë ishte prezént vij-rreth ndëpër transheat kaluar ose më këmbë dyke-kuversuar bashkë më punëtoret. Veç këtyre edhe nga tedaruqet e tjera Ali Pasha nukë kish mbetur pas; të haëme gjithë-farësh kishte qeverisur për dy vjet e gjymës rrethim. M'anë tjatër flotilla e vogël e përbërë prej lundrash t' armatosura, shiguronte komunikatën e fortesës me nisiën e cila ruhej prej një garrizone të madhe ndënë kumandë të Tahir Abazit, sikurse edhe me vëndet e tokës prej të cilavet porépsej mjaft qyteti nga të nevojshmet.

Përpara se të harrijnë ushtëria Tyrke përpara Janinës, Ismail Pashë Serasqeri pat kallur intriga pshehtazi ndëpër kryetarët e transheës së madhe, edhe një natë Ymerá Vrioni, Zilihtar Poda, Myhyrdar Poçja, Ago Jashari, Lekë Nuçua, edhe Dervish Hasani, oficerë të mirë të Ali Pashës bashkë me 3000 veta dyke-lënë pozitat e tyre dezertuan edhe të pa pikasur shkuan përtej ndë ushtrinën e armikut. Gjthkohësh çëta kusarësh të cilët i ndërkryejti prezenca e shkadronit të flotës Tyrke ndë anëdetjet, edhe tradicionáli zakon për plaçtitje ndë kohë rrë-

muje, invadojin dyke-plaçkitur vëndin përqark Janinës; disa nga ato banda plakosnë brënda ndë qytet dyke-hyrë gjer ndë mëhallën e Saraevet. Mbi këtë akt kaqë të kuxuarshëm qytetarët u trëmpnë; Atherë Ali Pasha del prej kështjellës ndë ballë të trupruajtësvet të tij për të qetuar shpiritat e popullit edhe për mprojtjen e tyre po më kot se ndënjësit e qytetit dyke-parëndjejtur një rrezik passi transhea që rrethonte qytetin u neverit prej Vrionit zunë të ikëjn nga shtëpitë dyke-marë me vethe ç'harrijtin të marin nga gjë' e lëvizme edhe u përndanë ndëpër katundët e Kurentës edhe të Zagorit. Dyke-parë këtë Ali Pasha, edhe i ngutur nga shkake strategjike, urdhëroj më 25 Gusht t' i viret zjarri qytetit. Kësimjeti ndë pakë orë me ndihmën e lëndës inqendiáre të hedhur që nga fortesat, tym edhe flagë të mëdha zunë diljin nga të katër çipat e qytetit fatkeq. Zjarri ndë pakherë i rrebeshoj shtëpit' e qytetit midis të cilavet ishte edhe pallat' i bukur i Veli Pashës.

Pas neveritjes të transheës edhe pas djegjes të qytetit, viset që kishte ndë dorë ushtëri e Ali Pashës u përcaktuan vetëm ndë fortesat që ishin midis transheës edhe pirgut të Lithariçit nga kanonat e të cilavet mprohëshin. Këto fortesa dirgjëshin ndë mëhallët e Llucës, të Shën-Mariës edhe të Livadhjotit. Edhe me gjithë dezertuarjen e aqë burravet që ishin ndënë urdhër të tij, i mbeti *Luanit Plak* edhe një fuqi luftare e fortë edhe e mjaftme për t' u përgjegjur gjithë nevojavet të luftës.

Nër këto-e-sipër me të harrijtur Ismail Pasho Beu, i vijnë këti Krerët Shqipëtarë dezertorë edhe disa të tjerë Bejlerë edhe i-u falë këti. Pakë dit më pas harrijti përpara Janinës edhe Baba Pasha prej Narte dyke-çuar pjesën më të shumë të ushtëriës tij. Ndë márshin e tij për ndë Janinë Baba Pasha dogji ndë katundin Móllanj pallatet e Ali Pashës edhe ç'do katundi edhe ç'do tëmpulli të krështerë që haste rrugës tij u klliste zjar me që takoj të jetë tepër fanatik. Edhe kështu passi harrijti edhe ky, Pashallárët më të rëndësiëshm që ishin mbledhur ndë fushë të luftës edhe që ngrehjin pllanet e rrethimit të së

famëshmes gjer ditën e sotme «*Kala të Janinës*» ishin këta që passojne: «Valiu i Rumeliës, Selim Mehmed Pasha, Ismail Pasho Beu ose Pasho Ismail Pasha, Mahmud Pashë Dramalliu, Hasan Pasha ose Pehlivan Baba Pasha, Isuf Pasha, Abaz Pasha edhe Çarkaxhi Ali Pasha; prapo e gjithë ushtëria e ndënë të ndryshmit gjenerallë Tyrq permblidhej gjer 80,000. Fuqia ushtërïake e Ali Pashës përpara se të fillohet rrethimi ishte gjer 32,000 ushtarë.

Nukë kaloj shumë kohë edhe midis kryetarëvet të ushtërisë rrethonjëse po veçanërisht nërmjet Valiut Rumeliës, Pasho Beut edhe Baba Pashës u ngjall një grindje nga nakari që ushqejin mbë njëri-jatrin. Ali Pasha dyke-gjyrmuar me hollësi edhe mosfjetje ngjarjet ndë ushtrinë të armikut, pllanoj të përfitonjë nga rasti i kohës dyke-vënë ndë vepërim ç'farë-do mjet për të trazuar armikët. Pakë dit pas djegies së qytetit afro një mijë burra të Krështerë t'armatosur edhe ndënë kumandë të Andrucit, dyke-dezertuar prej fortesës vajtin ndë ushtrinën Tyrke edhe lypnë të rrjeshtohen ndënë flamuret e Serasqerit Tyrk. Ky ishte një pllan i Ali Pashës i marun-vesh me besnikun Kapedan Andrucin se shpërente që dyke-patur ndë ushtrinën armike burra të devotshëm te ay, të përfitohet ndë rasë të volitshme. Pllani nuk' u godit mirë si për qëllimin që u ngreh po m'anë tjatër përsëri mori funt të dobishmë për Ali Pashën se Ismail Pasha mbassi nuk' i zuri besë Andrucit e nguti atë edhe shokët e tij të ikëjn prej ushtrinës me mënyrë të mirë. Po ata si iknë nga ushtrina Tyrke mbetnë ndë fushë dyke-u-pjesëtuar ndë turma të vogëla zunë gjithë rrugët që bijin për nd' ushtrinë dyke-vrarë ushtarët që largohëshin nga trumbat edhe dyke-kapur ata që bijin ushqime edhe të tjera posaçië edhe kësi-mjeti e prune ushtërinë Tyrkë ndë një gjëndje anormale të papërshkruarshme.

Thamë më nalt që bijt' e Ali Pashës Myhtari edhe Saliu passi lanë postet e tyrë ndë Berat kur mbërrini ushtëria Tyrke, përiknë ndë Gjinokastrë. Nukë kaluan shumë dit edhe passi muar premtime nga an' e Selim Pashës për amnesti edhe se Sulltan Mah-

mudi kishte për t' i emëruar Sundimtarë n' Anadoll, që të dy u përdhanë ndë duart' e Selim Pashës. Myhtari i eshkortuar dyke-shkuar nga Tepelena tek garrizónte i bir i tij e urdhroj edh' atë t' u'-a përapë fortesën Tyrqve edhe t' i vente pas, po Mahmudi nuk' e dëgjoj fare t'anë dyke-mbetur ndë rruajtje të postit të tij të cilin i-a pat besuar i gjyshi.

Shëmbëllën e Myhtarit edhe të Saliut e imitój pas pak edhe Veliu dyke përdhënë Prevezën ndë duart' e ushtëriavet armike. Pas dí-ca dit të gjithë bijtë edhe nipërit e Ali Pashës që u përdhanë paburrisht nër Tyrqit, u prunë me garrizonë ndë K/pojë, edhe s'andejmi i kapërxyen ndë Asi të Vogël (Anadoll).

Sjellja e tillë e bijvet të Ali Pashës pruri ndë zemër të trimit plak vrer edhe zëmërim bashkë kur mësoj qysh i lanë gjith' ato pozita strategjike me rëndësi pa u kundrështuar fare kur nuk' ishin edhe aqë keq ndë rrezik, dyke-e-neveritur atë vetëm në kryeqytetin e vëndit të cilin burrërisht edhe kryelartë përpara pak javësh e zotnonte. Di-ca nga shkrimtarët e jetës tij thonë që, kur dëgjoj për përdhënien e të bijvet, dekllaroj me sy të përlotuar që i mohon t' i ketë më për bijt'e vet, se posa që u përdhanë me dashje nër Tyrqit ishin të pa-vlefshëm të mbajnë emërin e tij.

## KREJ XXVI.

Po edhe në ushtrinën armike punët nuk' vejin mirë. Përçarja e Pashallárëvet kryetarë sa vij merte fushë. Kryegjenerali *(Serasqeri)* dërgonte kallëzime edhe anëkime të paprajtuna ndë K/pojë kundrë Baba Pashës edhe kundrë Valiut të Rumeliës dyke-i-kallëzuar si kundrështarë të vepërimevet të tija edhe se ndodhëshin ndë marëveshje sekréte me Ali Pashën për të sjellë përndarjen e fushatës. Nukë kaloj shumë kohë që nga këto kallëzime, kur një dit Baba Pasha u gjënt i vdekur ndë tendë të tij edhe përmi vdekjen subite të ati u përhap që e helmuan njerës të kallur prej Serasqerit. Vdekja e Baba Pashës ngacmoj mosbesimin e Selim Pashës edhe përandaj urrejtja

midis tij edhe Ismail Pashës u rrit edhe më tepër. Po edhe Suljotët patnë të bëjnë jo pak me Kryegjenerálin e ushtëriavet Otomane. Këta dyke-ardhur ndë ushtrinën tyrke pas përdhënies të Prevezës i-u lutnë kryegjeneralit të përmbushte premtimin q' u pat dhënë Shefi i Shkadronit të fllotës Ali Beu, përmbi rishvendósjen e tyre ndë Sul. Po Kryegjenerali passi u mejtua mirë i-u dha si përgjigjie që, Guverna Tyrke është e gatiëshme t' u çedojë atyre për kollonizim vëndet e Fierrit, po kurrë nuk munt t' u permitonjë vendosjen ndë Sul. Ky refuzim pruri shumë mërië nër Suljotët të cilët edhe iknë prej ushtrinës mbi një mijë shpirt sa ishin edhe vajtin u tendësuan ndë Shën-Koll të Kopanit ndaj buzës liqenit tek u urdhëroj atyre Serasqeri.

Nërmjet këtyre asnonjë akt luftar me rëndësi nukë po merte vënt. Nga të dy palët vetëm artileria punohej; nga an' e fortesavet bombardojin ushtrinën, këta prapë përgjigjëshin gjith-po-ashtu që nga baterjat e ndryshme, edhe dëmet reçiproke ishin të paka. Së mbrami pas një mos-aktivitet të gjatë më 15 Vjesht' e II-të ndë një këshillë në shtabin e përgjithshëm të Tyrqvet u vendua kuqerimi i *Kullës së Litharíçit*, me asallt. Passi u emëruan trumbat që do-të bëjin asalltin, pas një bombardim të gjatë, rrethonjësit u vërsulë kundrë fortifikátavet të Litharíçit edhe kundrë visevet të tjera të qytetit që ishte ndë duart' e ushtëriës Ali Pashës. Po rezistenca e garrizonës të *Kullës*, e cila kishte një trup ushtarësh Çamër edhe Mirditas, ishte aq' e rreptë sa pas tri asallte të paprajtur *Sulltánasit* u ngutnë të përprapsen me dëme të mëdha. Atherë passi dolli edhe garrizona e pirgut që e kumandonte vetë Ali Pasha, të përprapsurit e Osmanllinjvet u transformua në mundje të plottë, edhe vetë shtabi i përgjithshëm i rrethonjësvet me-zi shpëtoj nga zjarri i rreptë i Ali Pashaliasvet. Edhe kur ushtëritë Tyrke ishin të dërmuara krejt u harrijti ndihmë një gjeneral Tyrk me 3000 shpirt edh' atëherë ushtëri e Ali Pashës me urdhër të tij e ngarkuar me plaçkë të shumë u kthye dyke-hyrë prapë ndë fortesat. Humbjet nga të dy

palët në këtë betejë të tërbuar ishin përmi 300 nga an' e Sulltanasvet edhe 40 nga Ali Pashaliasit.

Kur vjeshta po kalonte kësifarësh, ndë ushtrinën Tyrke shteti po keqësohej edhe më shumë. Mbi grindjen edhe përçarjen që zotonte midis gjeneralëvet Tyrq u shtua edhe grabitja. Turma ushtarësh Tyrq brithjin vëndin dyke-xhveshur edhe dyke-plaçkitur katundet e mjera. Edhe për gjithë këto padrejtësirra që u bëheshin katundarëvet akuzóhej Serasqeri i cili kushideróhej i përgjegjshëm me qënë i pazoti të mbanjë urdhërin ndë ushtëri. Me-qënë-që zjarri që prej batérjavet vazhdonte parreshtur nat'-e-ditë kundrë fortesavet të Janinës, më shumë pa qëlluar fare, municjet e luftës zunë të rallohen për së çpejti me-gjith'-që prej K/poje dërgohëshin përdit. Edhe kur m'anë tjatër mahmudiet vijin me barrë nga Kryeqyteti, shpërudhjet (*harxhet*) pa masë edhe fraudat i lejin përherë të zbrazëta arkat e ushtrinës.

Ky shtet' i punëvet e kalli ndë frikë Ismail Pashën se e shihte që rrethimi po xgjatej pa nonjë përfundim. Kështu ishin punët kur një dit të Nëntorit Suljotët e ushtrinuar në Shën-Koll të Kopanit vunë-ré që nga bombat e hedhura për nd' ushtrinë të tyre as një nukë pëlciste edhe se dy lundra peshkatare lundrojin me rregull ditën ndë anët e liqenit edhe afër ushtrinës së tyrë. Për çudi muar di-ca nga ato bomba edhe dyke-i-thyer gjetnë nër 'to letra të vogëla të cilat përmbajin me pak fjalë ftime nga an' e Ali Pashës për të bashkëkuvënduar ndë kështjellë. Gjith' atë natë Noti Bóçari bashkë me dy të tjerë Suljotë dyke-i-hipur lundrës që ishte atje afër hyjtin ndë fortesë tek Ali Pasha i priti miqësisht, pastaj u shtroj përpara rrezikun e shigurtë ndë të cilin ndodhëshin dyke-ndënjur në ushtrinën armike edhe se ishte i lajmuar pej burimesh të shigurta që Port' e Naltë e pat urdhëruar Ismail Pashën t' i dëbonjë nga ushtrina edhe t' i farosnjë me kohë. Shkurt me thënë u proponoj atyre bashkëpunim edhe aliancë me kondita që ky t' u epte një sumë të hollash, edhe gjith'-kohësh t' i epte urdhër kumandanit të garrizonës të Sulit që t' u' a përjapë Sulin atyre.

Për shkëmbim të këtyre Suljotët të rrëmbejin armët kundër ushtëriës tyrke duke-e-trazuar atë me ç'do mjet. Për shigurimin e konditavet ishin për t' u këmbyer nga të dy anët pengje. Kasnecët Suljotë dyke-dëgjuar këto u kthyen ndë ushtrinë edhe u komunikojnë shokëvet të tyre proponimet e Ali Pashës. Proponimet u akseptuan me një zë nga të gjithë Suljotët edhe natën e dytë, gjith-po-ata, të shoqëruar edhe nga pengjet të cilët ishin, e shoq' e Marko Boçarit. me të dy djemt e saj, vëllaj i Markos, Kostë Boçari edhe e motr' e Drakos, ardhë te Ali Pasha edhe passi ndënëshkruan traktatin muar një sumë të madhe të hollash, municje, si-kur-se edhe të bir' e Myhtar Pashës, Hysenin, si penk nga an' e Ali Pashës, edhe u kthyen pshehtazi ndë ushtrinën e vet. Prapo natën e 12 Nëntorit passi bëjtin pregatitjet e posaçme dërguan më parë grat' e tyre të ngarkuara me hénët edhe me municjet ndënë ruajtje të Noti Boçarit edhe ca të pakë burra të dyfegut, të tjerët si nj' a 300 burra ndaj agimit dyke-ngjitur kodrën përmbi ushtrinë të Sadovicës, filluan të ndezin-dyfek dyke-vrarë sentinellat që ishin përqark ushtrinës Sulltánase. S' andejmi zbritnë edhe dyke-ndjekur një trumbë ushtarësh të cilët i kish dërguar Serasqeri, muar rrugën për ndë Sul tek prej Shefit të Garrizonës, Myrteza Çalos muar ndë posésjë gjithë viset e fortifikuara përveç Qafës, të cilën nga shkake të ndryshme nukë donte t' u-a përjapë atyre. Këjo skakëtoj një mosbesim nër Suljotët të cilëvet u shkoj-mëndja që Myrtezáj kishte urdhër sekrét që të mos e përjapë kështjeliën.

Edhe kështu pas 17 vjet pocaqië edhe vuajtje nër vënde të huaja Suljotët shkelën ndë tokën e atdheut të përmallshëm. Nukë kaloj shumë kohë që ndë Sul u kuqendruan afro 3000 burra luftëtarë, fuqi mjaft e kushideruëshme pas pozitës që kishin edhe pas vleftës të burravet q' e përbëjin atë. Pakë dit pas këto një mijë Suljotë ndënë kumandë të herojt Marko Boçari goditnë një eshkortë ushtarësh Tyrq, të cilët çonin ndë ushtrinë 400 qerre me municje edhe ushqime. Passi i vranë më të shumëtit nga të 400

kalorësit të eshkortës edhe gjithë materiallë u-a zaptuan, e çuan atë ndë Sul. Pas këtë vepër Markua dykevajtur kundrë ngushtinës të rrugës fortifikuar të së Pesë Pusevet, e kuqeroj kështjellën pa luftë, me që garrizona iku posa i-u qasnë Suljotët, edhe kësimjeti i-a preu ushtrinës komunikatën me Nartën edhe me Prevezën.

## KREJ XXVII.

Lajmet e më-naltme edhe më shumë ajo e pushtimit të ngushtinës së Pesë-Pusevet e prunë Ismail Pashën ndë një trubullim të math, edhe pas një këshillë luftare ndënë kryesi të tij, gjenerálët Selim Pasha bashkë me Hasan Baltaxhiun muar barën e rishpushtimit të pozitës së rëndësishme. Edhe pra dyke-u-vërvitur me një trup 5000 ushtarësh hyjtin me vrull të math ndë ngushtinë të Pesë Pusevet midis së cilës një vragë e ngushtë edhe bokërrimë bij ndë fortesën e vogël që dirgjej ndë sgrip të një shkëmbi. Markua me t' u lajmuar me kohë për vërvitjen e studijuar, u ngrehu prita ndë grykë të ngushtinës edhe kur armiku pa nonjë farë ndrojtje u vërvit kundrë fortesës, zjarri i dëndur i garrizonës që e priti atë mbë flakë, i përndau tmerrërisht rjeshtat e tyre dyke-u-kallur dërmën. Kur pas pak Tyrqit filluan shprapsje, të kobuar Asiatët e tresh u gjëndën nërmjet zjarrevet të fortesës edhe zjarrit të pritësuësvet ndë ngushtinë. Atherë u bëjt bollbë edhe rrebesh i math mbi ushtërinë Tyrke, se më nj'anë binin pochtë prej zjarrit që u vij nga pritat e Suljotëvet, m'anë tjatër gremisëshin ndë ikjen e parregullshme. Pesë qint kufoma mbuluan rrugën e ngushtinës, edhe së sosmi ushtëria që mbeti bashkë me të dy gjeneralët, me-zi shpëtoj dyke-përikur në ushtrinë krejt e shkatërruar.

Po përveç Suljotëvet mbinë edhe të tjerë armikë në rrjeshtat e ushtëriës rrethonjëse. Kryetarët Shqipëtarë si Ago Myhyrdari, Ziliftar Poda, Tahir Abazi edhe të tjerë oficerë të Ali Pashës që dezertuan kur filloj rrethimi, u penduan për sa bëjtin edhe i lypnë

Ali Pashës t' i pranonjë të kthehen nek ay. Kësifarësh nuk vonoj kohë që një marëveshj' e plotme u bëjt midis miqvet të lashtë, përfundim' i së cilës ishte dezertimi i gjithë atyre prej ushtrinës armike, edhe të zenë viset e përqarkjevet të Kurentës edhe Zagorit, dy gjer tri orësh distancë edhe s' andejmi të mos e lejin ndë prëhje armikun. Kështu pra Ali Pasha passi siguroj bashkëpunimin e të tillëvet trima, edhe dyke-parë debandádën që zotnonte ndë ushtëriën armike, vendoj të proçedonjë një akt luftar të kuxuarshëm, për t' i dhënë Sulltan Mahmudit një goditje të shëndoshë edhe të mjaftuëshme që t' a përndanjë rrethimin. Kështu pra pas vendimit, me anë letrash edhe kasnecësh u muar-vesh me krerët Shqiptarë, si-kur-se edhe nër Suljotët dërgoj plakun Tahir Abazë [1]), edhe përcaktoj ditën edhe orën e vërvitjes së përgjithëshme kundrë ushtrinës, si-kur-se edhe shënjat të cilat që nga *Yç-Kalaja* do-të epjin parollin e vrullit jashtë fortésavet.

Mirë po për fat të keq pllan' i Ali Pashës i-u bëjt i njoftun Serasqerit Tyrk nga një letr' e Ali Pashës e adresuar mbë Suljotët që i ra ndër duar, e cila përmbante edhë parullën «Flori edhe Shpatë». Sakaqëherash Serasqeri mori masat e nevojshme për t' i bërë ballë edhe t' i-a kotësonjë vrullin jashtë fortésavet. Mbas pllanevet të Ali Pashës, vërvitja kundrë ushtrinës do-të bëhej që nga tri vise të ndryshme: I) Që nga kështjella, II) Nga perëndimi tek kishin shtabin Kryetarët Shqipëtarë, edhe III) nga an' e Mesditësit ngaha ishin për t' u vërvitur Suljotët. Tri dit përpara ditës së fiksuar, fortesat filluan të prezantojnë një lëvizje të madhe. Edhe ditën e 13-ttë të Jenarit 24 orë pa prajtur mbajti bombardimi kundrë ushtrinës Sulltanase topat e të cilëvet nukë përgjigjëshin fare me që municjet u ishin sosur. Prapo natën e ditës 13 më 14 përpara agimit, posa

---

1) *Dërgoj fjalë posht' e lart'*
*E ngriti* **kahuristanë**,
*Tahir Abazë një plak,*
*Ndë Sul e ngriti* **rajanë**.

u dha parulla që nga kulla e Tri-Kështjelavet (*Yç-Kalasë*) me anë të roqetavet duall garrizonat që nga fortesa edhe nga Lithariçi gjithësej 3000 burra të zgjedhur ndënë kumandë të trimavet oficerë nër të cilët Ali Pasha vetë hypur kalit të bardhë epte kumandën superióre. Ndë një çast u vërsulën kundrë ushtrinës me aqë vrull sa pas pak-herë të gjitha artileriat e para të rrethonjësvet që ishin ndë mëhallën e Llucës, të Kalluçezmës edhe të tjera pozita, u kuqeruan, edhe përprasj' e armikut për ndë ushtrinë u transformua ndë ikje të parregullshme, e cila keqësohej edhe më shumë nga errësira e natës. Rrebesh' i krejtm i ushtëriës Tyrke ishte i sigurtë po të ishte që të përmbushej plotësisht pllan' i Ali Pashës, i cili ishte aqë sigur përmbi efektin e sosëshm, sa me mjet të lundravet atë natë kishte çuar një forcë ushtare të madhe nga an' e Kastricës për t' u-a qarkósur shprapsjen Sulltánasvet. Po proçedimi nukë vajti mbarë gjer më në funt me që nukë muar rjesë të gjithë aliatët ndë këtë fushatë; Suljotët më nj' anë me mos marë letrën që u çoj Ali Pasha nukë dijin orën e vërvitjës, m'anë tjatër kryetarët e tjerë ndënë kumandë të Myhyrdarit, pas parullës u qasnë gjer ndë Zellovë, 2 orë lark Janinës, edhe dyke-parë që Suljotët nuk' u vërvitnë, u prapsnë ndë pozitat e para. Nër këto, trup i garrizonës, i cili pas marëveshjevet si të goditte ushtrinën, dotë hasej edhe të bashkohej me Suljotët, po écënte me link për nde vënd' i caktuar. Po për fatkeqësië, atë pozitë e kishte pushtuar me kohë Ymerá Vrioni me ushtarët e ndën' urdhër të tij, prapo Ali Pashaliasit dyke-parë Shqiptarët edhe dyke-i pandehur për Suljotë, posa që këta u përgjeqnë edhe ndë parullë, bënë të venë për nde'ta me pandrojtje, kur befas aty u pritnë me zjar të gjallë i cili u dërmoj rrjeshtat tmerërisht. Dyke-parë kështu pandehnë se ishin trathëtuar nga Suljotët edhe passi e panë që ç'do rezistencë ishte e kotme filluan shprapsjen për ndë qytet. Po shprapsja u ishte prerë nga ushtëritë të ndënë kumandë të Dramalliut edhe të Hassan Pashës. Atherë beteja u bë e përgjithëshme edhe

tek-do lëftojin me tërbim edhe krahror-mbë-krahror. Së sosmi, garrizona trime po e pafatme u ngut të neveritnjë pozitat që pat kuqeruar edhe të prapset ndë fortesat e qytetit.

Ky jashtë-vrull kundrë Tyrqvet ishte vepra luftare më e rëndësiëshme e Ali Pashës ndë rrethimin e gjatë të Janinës, nga numur' i ushtëriavet që muar pjesë nga të dyja anët, edhe për dëmet që vuajti ushtëria Ali Pashaliase, kur përmi një mijë burra nga më të zgjedhurit ushtarë të tij ranë ndë fushë të betejës. Humbjen e tyre Ali Pasha e ndjeu me pikëllim nga shkaku që më të shumit e të vrarëvet ishin nga trup-ruajtësit e tij më të lashtë, më trima edhe më besnikë, të gjithë ritur ndë hobor të tij që ndë moshë mituráke.

Kështu pra pas këtë betejë vitorióze po me dëme të mëdha Ali Pasha largoj ç'do shpresë për nonjë jashtë-vrull të ri, edhe e gjet me udhë të mbanjë vetëm defensivë kundrë ushtëriavet Tyrke, që kësifarësh dyke-u-ngosur armiku me të shkuar koha mundej t' a ngrerë rrethimin. Edhe për të siguruar edhe më shumë miqësinë edhe aliancën me Suljotët u çedoj atyre Qafën, prapo Krerëvet Shqipëtarë që ishin ndë shtet armiqësór kundër rrethonjësit edhe që ndodhëshin përqark ushtrinës u këshilloj bashkim edhe marëveshje më të ngushtë nërmjet tyre edhe me Suljotët. Pas pakë kohë Bajraktarët Shqiptarë me që s' mundjin të rijin më aqë shumë afër kundrejt ushtrinës armike, vajtin ndë Sul edhe bashkë me Kapedanët e malit bëjtin marëveshje për bashkëvepërim edhe aliancë për anën e Ali Pashës.

## KREJ XXVIII.

Port' e Naltë dyke-parë që rrethim' i Janinës po zgjatej i padobiëshm edhe që ushtëria e dërguar ndë rrethimin e kështjellës ishte ndë parregullim, mbushimëndje (u kunvins) që këto vijin nga inkapabilitéti i Serasqerit Ismail Pashës, andaj vrapoj t' a nëkëm-

bësonjë atë me Sundimtarin e Pelloponisiës, Hursid Pashën, gjenerál mjaft i zotí edhe i kuxuarshëm, të cilit i oferój edhe titllet e plot-fuqiëshmit të Perandoriës, si Vali i Rumeliës, Sundimtar' i të tri pjesavet të Toskërisë, edhe Inspektor i rrugavet (*Dervenat Nazër*).

Hursidi të cilit Porta ndë krye të vitit 1821 i ishte adresuar dyke-porositur atë të vigjëllonjë lëvizjet e grekërvet, ay dha si përgjigjie që lëvizja revollucionare e grekërvet i detyrohej gishtit edhe përkrahjes të Ali Pashës. Kjo gjë më shumë e nguti Portën që i ngarkoj ati kryesin' e Kumandaméntit të lartë të ushtëriavet rrethonjëse. Hursid Pasha passi la ndë Tripojë si nëkëmbës të tij Qóse Mehmet Bejnë, u hoth ndë Toskëri dyke-kapërxyer Pindon ditët e para të Marsit (1821) me fuqi të mjaftme edhe me eshkortë madhështore. Gjith-poashtu me nderime edhe me pompë të madhe u prit Serasqeri i ri nga të gjithë pashalárët e ushtëriës Sulltánase.

Mori pra Hursid Pasha dreqtorjën e punëvet strategjike të rrethimit Janinës edhe pik-së-pari pruri dishiplinën, rregullin ndë ushtëri edhe bashkim ndë vepërimet militare. Pastaj perzekutój gjithë elementet keqbërëse dyke-dhënë urdhër ndë një dit vetëm të kondemnohen për vdekje përpara ushtrinës shumë myslimanë edhe të krështerë pa çquarje. Dërgoj me vrap kasnecë nër Suljotët që të përbinden te ay duke-u-premtuar amnesti. Po si mori nga ata përgjigjje refuzimi çoj një trup ushtërie prej dy mijë ushtarë ndënë kumandë të një gjenerali anadollák edhe pushtoj katundin Varjadhë pranë Sulit, për të ndálur invazjet e Suljotëvet nga të cilët vuante shumë ushtrina për të posaçmet që dërgohëshin prej anëdetjevet të Toskëniës të cilat bijin nër duart e invadorëvet. Gjithkohësh pushtoj pozitën e Strunit edhe ujdhesën e liqenit Janinës. Garrizona e nisiës e përbërë prej një mijë shpirt, pas një betejë të përgjakshme u përdha, edhe kështu Ali Pasha u shterr nga di-sa pozita strategjike me rëndësië edhe nga mjete komunikátash edhe për të furnizuarit e të nevojshmevet të luftës.

Po me gjithë përpjekjet e sevérshme, Hursidi nukë mundi dot të bjejë nonjë ndryshim dobëtimi jo vetëm fortesavet të famëshme të Janinës, po as ndë Shqipëtarët e tjerë që ishin vajtur ndë Sul edhe së bashku me vëllezërit e tyre Suljotë lëftojin për Ali Pashën kundrë ushtërisë Tyrke. Edhe kështu, kur Hursidi si Vali i Rumeliës edhe si Inspektor i udhëvet, ishte dyke-u-marun me punët e rrethimit të Janinës edhe me dërgimin e fuqiavet ushtëriake ndë Greqi, pengime të mëdha haste ndë vepërimet e tija nga Suljotët edhe nga Shqipëtarët e tjerë që ishin bashkë me 'ta të cilët vepërojin ndë pragun të Shtabit të tij. Ata dyke-u-vërsulur shpesh-herë kundrë Osmanllinjvet që ndodhëshin ndë Varjadhë, pas pakë kohë mundën të shtien ndë dorë kështjellën e Rrënjës përanë Pargës edhe limanë me mjet të të cilit mundjin sigurisht të furnizojnë armë edhe municje nga ç'do anë.

Po përçarja edhe farosja e aliatëvet të Ali Pashës e cila me gjithë perpjekjet e Hursidit nukë goditi dot gjer atherë, mbërrini pas pak nga rastet e kohës. Përpara pakë kohësh kishte harrijtur ndë ushtrinën Tyrke sundimtari i Shkodrës, Qahja Beu (i cili ishte edhe mik i lashtë i Ali Pashës) vet' i tri-mijë shpirt. Me nërmjetim të këti, Hursidi akseptój të bëhet një armistitë midis 'tij edhe Ali Pashës që mbaso të merte monjë funt rrethimi. Për këtë proçedój Hursidi më nj'anë dyke-parë fuqin' e Ali Pashës që kishte për t' i bëjtur ballë, m'anë tjatër edhe nga shkaku i shtetit kryengritësór që ishte përhapur ndë Grekërië; përandaj edhe me t' u përfunduar armistita, Hursid Pasha çoj kundrë kryengritësvet të Greqisë së Tokës një trup ushtërie ndënë kumandë të Ismail Pasho Beut [1]), edhe një trup tjatër për forcimin e Nartës e cila nga të katër çipat kanosej nga Suljotët edhe nga Shqipëtaret e tjerë aliatë të tyre. Po ushtëria e ndënë kumandë të Pasho Beut u munt ndë vëndet përqark Kombótit, edhe mbetinat

1) Pasho Beu posa harrijti Hursid Pasha, u zbrit nga post' i Kryegjeneralit *(Serasqerit)*.

e trupit shkatërruar përiknë ndë Nartë. Gjith-po-atë fat hoqnë edhe Tyrqit e kështjelluar ndë Varjadhë edhe pozit' e tyre u kuqerua nga partizanët e Ali Pashës. Edhe kur këta pas dërmuarjes të ushtëriës Ottomane po studijonin t' i bien Nartës edhe s'andejmi Hursid Pashës ndë fushë të Janinës, ja te u vjen një mesagjér (lajmëtar) i dërguar prej Ali Pashës për t' i lajmuar të rreshtin hostilitétet nga shkaku që u filluan negoçiatat për përdhënien e fortesës Janinës. Ky lajm edhe vendim i Ali Pashës i dëshpëroj sakaqëherash aliatët edhe u-a ftohu zellin e tyre.

Këto ngjisjin ndë muajin Tettor. Ndaj të dalët të këti muaji kur Narta ishte rrethuar nga aliatët e Ali Pashës, shteti i Ismail Pasho Beut, që ndodhej mbyllur ndë kështjellën e qytetit, dita-ditën ashpërohej, kur Hursid Pasha mbassi fitoj liri lëvizjesh me shkak të armistitës që thamë, dërgon Ymerá Vrionin me një trup 6,000 ushtarë (mjerisht Shqipëtarë më të shumët), për të përndarë rrethimin e Nartës. Vrioni dyke-vepëruar intriga mbë njëkombasit e vet të cilët ishin aliatë të Suljotëvet, me premtime të rrema mundi të shkëputnjë edhe t' i bjejë me anën e vet ushtarët e Tahir Abazit, të Ago Myhyrdarit, edhe të Elmaz Meços. I bashkuar me 'ta u vërvit kundër rrethonjësvet më 17 Nëntor edhe pas di-sa asallte të përgjakshme, me jo të paka humbje i nguti mprojtësit e Nartës t'a përndajnë rrethimin edhe t' ikëjnë ndë Thesali, ndë Greqië edhe gjetkë.

Kur këto po ngjisjin ndë Nartë ndë Prevezë edhe gjetkë, negoçiatat midis Serasqér Hursid Pashës edhe Ali Pashës po zgjatëshin pa nonjë përfundim nga shkaku që dinaku kryegjenerál Tyrk ngulmonte ndë përdhënien e tij edhe të fortesavet pa kondita. Edhe ndë interváll të zvarnisjes së negoçiatavet Hursidi me pabesië përmundi të pushtonjë kullën edhe fortesat e shëndosha të Lithariçit, dyke-blerë me argjënt Bajraktarin e Gegëvet që mprojin kullën. Kësi-farësh Ali Pasha u përcaktua më pas vetëm

ndë fortesën prinçipale, ndë të shumë-fámëshmen «*Yç-kala*» [1]).

Hursid Pasha për t' i shpaguar Ymerá Vrionit shërbimet që i pruri Dovletit, shkakëtoj të avansó het (të hypet) prej Divanit me gradin Pasha, edhe gjithkohësh emërimin e tij ndë postin e Sundimtarit Janinës edhe i Delvinës ndë vënt të Pasho Ismail Pashës që ishte për t'u emëruar. Edhe sikurse vërtët, pas ca kohë harrijtin prej K/poje dekrétet (*fermanet*); me anë të njërit dekrét zbritej Ismaili edhe emërohej vënd' i ndënjtjes së tij në Didimotikë, nek passi shkoj prej ushtrinës pas jo shumë kohë gjet vdekjen pas urdhërit të Sulltan Mahmudit, prapo tjatri dekret perandorák u leçît me pompë (*salltaná*) të madhe ndë ushtrinë. Më pas Hursid Pasha thërriti ndë një mbledhje gjithë Shqiptarët Vrionistë, edhe passi u prezantoj rrezikun ndë të cilin ndodhej *Shtet' i Osmanllnjve*, dyke-u-gërmuar fanatizmë, i ftoj të gjithë të bëjnë gjith-se-cili detyrën e vet për të farosur armikn' e Sulltan Mahmudit, Ali Pashë Tepelénën i cili gjithkohësh quhej edhe armiku i *Islamizmit* sepse u ndihmonte Grekërvet.

Fjalët ngacmonjëse të Hursidit prunë së shpejti pemët e pritura jo vetëm nër anadollakët, po edhe nër ata miqt' e Ali Pashës të cilët parashikojin fundin e gjëmëshmë të tij. Edhe trathëtorët që kishin marë pjesë ndë këtë mbledhje nuk' u mjaftuan vetëm me kaqë po passi nxuar një listë ekzákte të njëkombasvet të tyre që kishin mbetur besnikë te Ali Pasha u dërguan kasnecë gjërinjvet të tyre që të vejin t' i

---

1) Tradita thotë që Zonja Vasiliqi *) qante dit-e-natë kur mësoj që të gjitha fortesat u zaptuan nga ushtëritë Tyrke; m'anë tjatër Muza Popullore rreh t'a ngushëllonjë dyke-i-thënë:

*Hesht Zonja-Vasiliqi,*
*Derë-bardha, lumja ti,*
*Hesht mos qaj o moj e marë,*
*Se ne kemi* **Yç-Kalanë** ;
*Pa kemi Ali Pashanë*
*Që është* **Asllan** *i gjallë.*

*) Këndonjësi dotë shohë më tëj përmbi origjinën e Zonjë-Vasiliqisë.

këshillojnë ata që ishin ndë fortesë për të ikur s'andejmi edhe t' a lejin vetëm Trimin Plak! Edhe mjerisht, për shnder të Historisë t'onë kjo gjë edhe u bë; gjërinjt' e ushtarëvet të fortesës dyke-pandehur që interes' i tyre e lypte të prishej Ali Pasha, vejin gjer përposh murrevet të kështjellës edhe dyke-u-thërritur ushtarëvet me emër, i ngacmojin të dezertojnë, me premtime që përveç amnestiës do-të merjin edhe rrogat që kishin për të marë nga Ali Pasha. Pra-po ata, të lajkësuar nga zotimet atraktive, pas dy dit ndaj agimit, çelën portat e fortesës edhe dyke-ikur s'andejmi vajtin u bashkuan me ushtërinë Tyrke. Ali Pasha dyke-mësuar për pabesiën edhe trathëtin' e bashkëluftarëvet, edhe me mos ditur ç' të bënjë tjatër për shpëtim të jetës së vet, e la fortesën ndë fátin të saj edhe vet' i shtatë-dhettë burrash që i mbenë besëtarë u t'hoq ndë pallatn' e vet ndë *Yç-Kala* edhe aty u mbyll [1]). Me që pej motesh Ali

1) KRYENGRITJA E ALI PASHËS KUNDËR PORTËS SË NALLTË.

**Ashtu si këndohet edhe sot ndë gjithë Shqipërinë**

I.

*Kush e ka parë* **Asllan** *Alinë*
*Nd' atë të shkretën Janinë,*
*Ndë* **Kala** *mbyllur të zinë,*
*Rrahu të kthenjë Shqipërinë.*

*Ditën e* **Sulltan Nevruzit,**
*Na erdhi i zi* **haberi,**
*Mëri e Sulltan Mahmudit,*
*U përpiq* **Ali Ezdëri.**

*Urdhëroftë Perëndia,*
*E na nxjertë jaqe-bardhë*
*Thanë na vjen Rumelia*
*Njëzet-e-dy Pashallarë.*

*Përpiqu o i gjori plak*
*Ndë* **xhepánet** *e ke jolenë,*
*Se të digjesh e ke me* **hak**
*Zapëtove gjithë dhenë.*

*Bënu* **vukuf** *Sulltan Mahmud,*
*Mos e nnëgjó* **Sheh Islamnë,**
*Kësaj pune i gjej* **hudut,**
*Se prishe tërë* **dynjanë.**

Pasha kishte parashikuar posibilitétin e një të tillë rreziku, andaj ndëpër patózet e dhómavet të pallatit kishte stavosur një numur të math vózesh me barut, edhe gjithë rrësqet e tija i kishte vendosur ndë të

---

*Më një-zet-e-një të Gushtit,*
*I-a rrethuanë* **Kalanë,**
*I thoni Sulltan Mahmudit*
*T' i çonjë* **„Itllak-fermanë".**

*Topi krisi të shëtunën,*
*Prej kalasë an' e mb' anë,*
*Të mjtë m' a bënë dhunën,*
*Janinë m' a prun* **nizanë.**

*Ju Labër posi çifuti,*
*Që më latë mua fatzinë,*
*Ju preftë Sulltan Mahmudi,*
*Prishtë vethen e shtëpinë.*

*Një mij' Geg' e dy mij' Toskë,*
*Qëndruan me Ali Pashanë,*
*Ata vunë kryet poshtë,*
*Me kordhë ndë dor' u vranë.*

*Janinë, Janin' e shkretë,*
*Ç' të pata ndërtuar vetë*
*S' të gëzova as vet' as djemtë,*
*Rëntë zjarri e të djektë.*

*Duro gjyle dhe* **kumbará,**
*Moj kalaja me bedena,*
*Se lëfton me Padishah*
*Ali Pashë Tepelena.*

*Të parë shtatë Vezirë,*
*Se ç' u hodhë ndë Janinë,*
*Hedhin* **gjyle** *me* **zinxhire,**
*Sipër mbi Vezir-Alinë.*

*Ku jini ju Parësia,*
*Pas vdekjes t' ime ç' do-t' thoni,*
*Kur t' u shajnë* **Osmanllia,**
*Vall' o zot, ju ç' do-të boni?*

*Dhe djemt' e mij si* **çifuti,**
*Që më lanë mua plaknë,*
*I preftë Sulltan Mahmudi,*
*Më turpëruan* **hoxhaknë.**

*As aman Gegët e mij,*
*Pushkat e tara me flori.*

ndamet e sipërme. Depozétë qëndrore të barutit të fortesës komunikójin me këtë vënt me mjet ndënë-térrash (*llagëme)* të gjata. Ndë këto apartaménte pra përiku me gjith familjen e vet midis së cilës çquante

---

*Forcë dhe zëmër s' më mbeti,*
*Iknë Gegët e më lanë,*
*Më ra përsipër Dovleti,*
*Do-t' më gërryenj* **binanë,**

*Rakip Bej, bëni* **gajrét,**
*Dhe ju* **asqer' i kalasë,**
*Se kemi për dy-zet vjet,*
**Zahiré** *kësaj* **belasë.**

*Dhe zoti durim më dhashtë,*
*Se unë do-të përpiqem,*
*Sa të kem gjak edhe áshtë,*
*Se i gjalli nukë jipem.*

II.

*Ashtu kish qënë e thëna,*
*Për Vezir Ali Pashanë,*
*As-kujt nuk' i shkonte mëndja,*
*T' a prishte Mbreti* **„Asllanë".**

*Përmbi qindëra Vezirë,*
*Kish* **tërsëllëm** *me të vërtet*
*Kujt-do që e shkoj ndë* **fiqir,**
*Nga ay mir të math* **lebét.**

*T' a dini me të vërtet,*
*Trimëri e tij u dit,*
*I tillë Trim Vezir më' s' mbet,*
*Të vinjë ndë këto dit.*

*Thotë ay: luftë s' duaj,*
**Nizá** *të bënj me Dovlet,*
*Qërthëlluar një-zet muaj.*
*Trazoj det edhe sterét.*

**Ahu** *gjet Ali Pashanë*
*Që ra ndë mëri të Mbrett,*
*E trazoj* **Kahuristanë,**
*Funt-e-krej ndë* **sher** *i kllet.*

*Dërgoj fjalë posht'e lart,*
*E ngriti* **Kahuristané,**
*Tahir Abazë një plak,*
*Ndë Sul e ngriti* **rajanë.**

e bukura Zonja-Vasiliqi e mbiemëruara *Veziréshë.* Përanë stavës së vozevet të barutit kantitét i së cilës ishte e mjaftme për t' a përmbysur edhe për t' a bërë hi tërë fortesën edhe gjithë qytetin e Ja-

---

*Forcát' e zëmër s' më mbeti,*
*Iknë Gegët e më lanë,*
*Më ra përsipër Dovleti,*
*Dot' më gërryenjë* **binanë!**

**Dalldisi** *Pashaj si burrë,*
*T' a dini se unë s' trëmbem,*
*Tha që «Unë, s' bënet kurrë»,*
*Te Rushiti*) nukë jepem.*

*Rakip Bej, bëni* **gajrét,**
*Dhe ju asqer i kalasë,*
*Se kemi për dyzet vjet,*
**Zahiré** *kësaj belasé.*

*Shëkoj t' u epte* **gajrét**
**Asqerë** *t' a sill mbë* **karar**
*I gjet ndë* **myshaverét,**
*Që i bojin kokën* **pazar.**

*E zoti durim më dhashtë*
*Se unë do-të përpiqem.*
*Sa të̈kem gjak edhe áshtë,*
*Se i gjalli nukë jipem.*

*E më tej ku-do të vemi,*
*Bëri bé Fehim' l mirë* **)
*Vasiliqi zjar e kemi*
*Të digjemi me Vezirë.*

---

III.

*Kështu déshi Perëndia* ***)
*Që u shkulën Mbretëria,*
*Veziritï-u prish* **kapia.**

*) Të Hursid Pasha d. m. th.

**) Vëllaj i të shumë-fámëshmit Selim Çami që mbante fitilin ndezur dit-e-natë për t' i vënë zjar ndënëtérrës (llagëmit).

***) Ndë kohën e rrethimit të Janinës, kur një ndaj-natë-herë Ali Pasha po shëtitte kalnar ndëpër qytet bashkë me një shumicë trimash për inspekcjë, që nga një *penxhére me kafas* të një shtëpie së vogël podëgjon një këngë të kënduar nga një zë femërór. Një gocë myslimane me zërin e saj të ënjgjëllshmë edhe me një mellodië të kandëshme po i-a thoshte këngës së më-sipërme e cila profetësonte prishjen e Ali Pashës.

Ndónëse i pa-ngeshëm edhe tepër i dëshpëruar për fatin e keq, Ali Pasha përnjëherë i qëndrón trimat që i vejin pas edhe mbassi urdhëroj që *Këngëtóreja* të dalë pakëzë te porta, e daroviti atë me një grusht florinj.

ninës, vuri besëtarin edhe të devótshëmin ushtar të tij, Selim Çamin me një fanár, i të cilit fitil i ndezur digjej parreshtur, edhe e porositi atë që në kumandën e parë të tij, t' i vij zjarrin barutit.

## KREJ XXIX.

Hursid Pasha me t' u lajmuar për vendimin e dëshpëruarshëm të Ali Pashës, sakaqëherash e ndali hyrjen për ndë fortesë. Kësifarësh për tri dit me radhë portat e kështjellës mbenë të hapëta; kurrkush nukë hynte as delte. Ditën e tretë Ali Pasha i dërgon fjalë Hursidit t' i dërgonjë një njeri të besës se ka për t' i bërë komunikime me rëndesi edhe Hursidi i dërgoj Peshqir Aganë të tij me dy qëngje edhe të tjera hamje edhe darova të shumëvlérëshme [1]). Pas përshëndoshjet edhe sallutimet e përzakonëshme kasneci i Hursidit u pru prej Ali Pashës ndëpër dhomat që përmbajin rrësqet edhe ndë ndënëterrë. Edhe passi i tregoj ati gjith' ato stava të panumurta të vozevet me barut edhe Selimin, ënjgjëllin e rrebeshit i cili rinte ndë grykë të llagëmit dyke-mbajtur gati fitilin, i thotë ati t' i japë zë Serasqerit, që qëllim' i tij është t' a flaknjë nd' erë fortesën me gjithë ç' ka brënda po të kuxonjë ndokush të shkelnjë këmbën mbi çitadellë; edhe se mundej të kushentónte për të përdhënë vethen e tij edhe fortesën, vetëm po t' i ndorëzohej ati një dekrét amnestie për t' u prezentuar përpara Sulltanit t' i shpjegonjë goja-gojës

---

*Një mij'-e-treqint* **rixhalë,**
*Që i mbaj Veziri pranë,*
*Me dor' e dhanë të gjallë.*

*Shtatë-dhettë vjet që rrove,*
*Sa zë dielli dhe shtrove.*

*So-s' të dhanë Vilaéti,*
*Po të gremisi Dovleti.*

**I MADHI VEZIR,**
**T' ERDHI ME PAHIR.**

1) Zakone tradicionale të Osmanllinjvet të cilat i përdorjin edhe mbë Evropianët.

shkaket e ndërkryerjes edhe të mbetej ndë postin e Sundimit ay edhe bijt' e tij si-kur-se ishin përpara kryengritjes.

Hursid Pasha mbassi mësoj hollësisht nga kasnec' i tij përmi gjëndjen e fortesës edhe lypjet e Ali Pashës, i-u mbush mëndja që *Asllani Plak* ndë çastin kritik nukë do-të hezitonte as pak të proçedonjë aktin e fundit. Andaj ftoj me vrap ndë një këshillë gjithë Pashallarët edhe oficerët e ushtëries tij të cilëvet u shtroj përpara bisedimin përmi këto pika edhe lypte mendimin e tyre që ç' lipsej të bëjin.

Mendimi i gjithëvet ishte që bisedimi të përsëritët edhe ndë Divan; m' anë tjatër Ali Pashës t' i epet një dokument i shkruar me ndënëshkrimet edhe vulat e gjithëvet sa ishin ndë këshillë përmi sigurimin e plottë të tij, gjer sa të vij përgjigjia prej Konstantinopóje. Pas këto u ndënëshkrua sakaqëherash dokumenti edhe më 8 Dhettor i-u dërgua Ali Pashës i cili si-kur-se përmëndin dëshmojës okullarë (vetpamës), e pranoj me gëzim dyke-shpërejtur që kërkimet e tija do-të akseptohëshin shpejt-e-shpejt.

Mbassi kaluan shumë dit që nga ndorëzim' i dokumentit, Hursid Pasha me mjet të Hassan Pashës, i komunikoj Ali Pashës që, pas lajmet që kishte marë prej K/poje, lypjet e tija hasjin shumë pengime, edhe ato mundej t' akseptohëshin vetëm kur Ali Pasha për tregim të reshpektit mbë Padishahun të vendonte të largohej si-do-mos prej çitadellës tek-do që të dëshëronte, dyke-pritur ndë siguri vendimin e naltë, edhe sa-për Selim Çamin, sentinellën e barut-deposesë mundej t' a lente ndë rruajtje të llagëmit (ndënëterrës). Kjo komunikatë ngacmoj ndë shpirt të Ali Pashës mosbesim edhe dyshim të cilat një-mendi përpara shpresës ishin flejtësuar. Përandaj i tha kasnecit që do-të mejtohet edhe do-t' i përgjigjet Serasqerit.

Pas tri ditë këshille me këshillonjësit e vet dykegjykuar ndë mëndje të tij që s' kishte si bëhej tjetrazi, e lajmoj Hursidin që, dyke-u-zënë besë vërtetimevet të sigurta të Serasqerit edhe të Shtabit të tij, vendon të hiqet ndë ujdhesën e liqenit Janinës.



UJDHESA NDË MES TË LIQENIT JANINËS

Ndek është vrarë Ali Pasha më 24 Janar 1822.

BKSH

Ky ishte i pari edhe mâ i madhi gabim që pat bërë Ali Pasha ndë gjithë jetën e vet, edhe këtë gabim e pagoj shumë shtrënjt, e pagoj me jetën e tij. Dyke-u-lënë t' i shkasë hollësi e zakonëshme e shpiritës së tij mendore, ra ndë trap të Kryegjeneralit Tyrk, jo si një dipllomat plak po si ay më i përgjithëshmi i mortshëm !

Po të mbetej i patundshëm ndë vendimin e parë të tij, që të rij ndë çitadellë rruajtës i pafjetur i barut-depósë me fitilin e gatiëshëm të Çamit besëtár, pa fjalë që do-të shëllbonte jetën dyke-takuar amnestinë nga an' e Sulltan Mahmudit. Po i tillë ishte deshtini ose «*e-thëna*» të jetë e sosmja e tij.

Ndë mënjgjes pra më 2 Jenar 1822, Ali Pasha zbriti prej «*Yç-kalasë*» që prapa fortesës edhe hypi mbë një lundrë dyke-çuar me vethe restin e qarkut të tij familiar bashkë me Zonjë-Vasiliqinë, edhe sendet më të vlerësme të palatit. Ndë një të dytë lundrë pas tij vejin shumica e trup-ruajtësvet të tij. Pas një lundrim të shkurtër po të shpejtmë, lundrat harrijtën ndë ujdhesë tek passi debarkuan hoqën ndë Manastir të Shën-Pandelimonit. Aty Ali Pasha dyke-kushideruar vethen e tij ndë shiguri zgjodhi për ndënjtje qelitë nga an' e Lindjes të së sipër-thânmit Manastir. Manastir i Pandelimonit ka një park (avlli) mjaft të gjerësiëshm, brënda ndë të cilin dirgjet tempulli; përqark ndë të tri çipat janë qelitë ndë të cilat venë rinë Janjotët ndë verë. Ali Pasha vet' i katërtë rij ndë dy dhoma mb'anën e lindjes; ndë dhomat e tjera përanë tyre rijin shumica e trup-ruajtësvet të tij.

I përcaktuar ndë këtë ndënjtje të pavlérëshme i djeshmi Vezir i fuqishmë shkonte ditët edhe orët ndë mejtime edhe nd' agonië dyke-gjetur pakë ngushëllim vetëm ndë pekulet e Vasiliqisë [1]).

---

1) Me qënë-që émëri i Vasiliqisë ose më mirë i «Zonjë-Vasiliqisë» është edhe sot tepër i dëgjuar mbë ç'do kënt të Shqipërisë, do-të japim pakë hollësirra përmbi origjinën e saj edhe qysh e çoj-puna të merret që e mitur si skllave prej Ali Pashës, qysh më pas harrijti sikurse edhe sot përmëndet «E bukura Veziréshë», favoritja edhe konfidenta e Ali Pashës:

Hursid Pasha i çonte ati jo vetëm ushqime edhe ç'do që i duhej me të tepër, po edhe muzikantë, edhe

---

Vasiliqia ishte prej katundit Plehëvicë të Çamërisë, edhe bijë prindërsh të varfër. Ndë këtë katund na ishte vendosur një bandë prej falsifikonjës monédhash *(ata që derdhin pàre kallbe)*. Ali Pasha mori urdhër prej Stambolli që me ç'do mjet të kapet kjo bandë ndë këtë katund edhe fajtuarët të varren të gjithë edhe katundi të prishet.

Ali Pasha mbërrini pa zbárdhur dita ndë Plehëvicë, i kapi fajtorët ndë fllagrant-delikt, i çoj të gjithë ndë varrje, edhe po pregatitej, pas urdhërit që kishte të farosnjë pópullin e katundit, kur një gocë e mitur 12 vjetsh, e cila as që e njihte cili ishte, vjen i bie ndër këmbë edhe dyke-qarë i thotë:

«O zot, rrofsh-e-qofsh, mos m' i vra nënen edhe vëllezërit e mij të pa-faj. Babáj na ka vdekur, ti pra na qofsh përkrahës, ueve nukë patmë bërë as-gjë që të tërheqim mbi krye t' onë zëmëratën e zotërisáte. Jemi ndoca fëmijë të varfër; mua mer-më zotrote edhe më vërë ndë skllavet e tua, mbaso ke edhe të tjera váshëza vërsnike (moshatare) me mua».

Ali Pasha ndjeu një trubullim të panjohur ndë shpirtit, e rroku gocën e mitur nga të dy duart edhe e mori mbë krahë. «Mos qaj bijë e mbarë, i thotë ay, qetësohu, unë jam vetë Veziri, edhe mos kij fare kujdes, bija ime, pallati im paskëtaj ka për të qënë shtëpia jote. Trego-më nënen edhe vëllezërit e tu, ti u-a shpëtove jetën».

Shumë vjete Vasiliqia e cila ishte e Krështerë, mbeti virgjëreshë. Edhe kur vendoj që të jetë një nga zonjat e Ali Pashës mbeti besnike e feës saj; Ali Pasha nuk' e ngusi kurrë që të myslimanizohet; Përhera, ndë ç'do rast e zij-ngoje mbretëreshën e pritme *) dyke-lëvduar edhe dyke-ngritur gjer mbë qiell virtytat e saj.

Ali Pasha jo vetëm i-a respektonte konviktat Vasiliqisë po i pat stolisur ndë të ndarat (apartaméntat) e saj një dhomë me konizma (paraklishë) edhe u epte lejë dhiakonéshavet (kallughérkavet) të venë t'a shohin përhëra.

Edhe kur grat' e tjera të haremit më të lashta ose më të ra nga mosha kishin titllin e *hanëmevet* (zonja te haremit) Vasiliqia kumandonte posi një Mbretëreshë e dashur, edhe e

*Vasiliqia bërtet urdhëron***)*
*«Vezir ô Ali Pasha*
*Vurr-u zjarrin topavet*
*Dhe digj-e Janinënë.*

*Dhe ju Janjotë mos rini*
*Fëmijënë t' i kërreni*
*Ca ndë Nartë t' i çoni*
*Dhe ca Prevezë t' i bjeni».*

*) Kështu i pëlqente t'a quanjë.
**) Nga strofet e më-sipërme duket influenoa që kishte Zonjë-Vasiliqia mbë Ali Pashanë:

për-dita vejin tek ay për vizitë shumë nga Krerët e ushtrinës edhe zbavitëshin me 'të di-ca orë, dykemos-pushuar së dhëni shpresa përmi efektin e fatshëm të lypjes së tij te Dovleti.

Së mbrami passi kaluan edhe disa dit, Hursidi mori përgjigjen definitive prej K/poje edhe passi thërriti gjenerallët më të rëndësiëshm të tij, leçiti përpara 'tyre úrdhërin Perandorák i cili bënte emër që Ali Pasha të vritej edhe e gjithë gjëja e tij të kufiskóhej; pastaj i pyeti të gjithë cili nga ata dëshëron të bëhet përmbushës i vendimit të shënjtë. I pari nga ata që ishin atje dolli Qose Mehmed Pasha, i cili e mori fermanë edhe e vu mbi krye; kjo doj-me-thënë akseptim i misiunës së naltë. Gjithpo-atë dit Hursid-Pasha me mjet të Hassan Pashës, i komunikój Ali Pashës që, fermani Perandorák harrijti edhe me që dëshira e Padishahut ishte të prokllamohej pas-si të hynte Serasqeri ndë qytet, përandaj duhej të epte urdhër për t' u marë masat e posaçme, që hyrja e ushtëriës Otomane ndë fortesat të bëhet e liruarshme. Ndë këto Ali Pasha u përgjeq që, e sheh të do-mos-doshme zbritjen e tij ndë fortesë për përmbushjen e formalitétevet të ligjëshme për përdhëniën, edhe më tepër për t' i urdhëruar goja-gojës *Çamit* t'a lere postin e barutdepósë se tjetrazi Selimi me as nonjë mjet tjatër nukë munt të bindet të shuanjë fitilin. Po kasneci i Hursidit ngulmonte me ç' do mjet, dyke-lypur të përmbushej me kohë urdhër i Sulltanit, se ndryshe të gjitha do-të vejin kot.

---

bënte emërin e saj t'a bekojnë të gjithë fat keqtë të cilët e gjejin përhera të gatiëshme për t' i-u bërë ç' farë-do të mirë.

Sa herë Ali Pasha ishte i goditur prej fatit edhe ndjente nevojën e njëj shpirti të dashur edhe besnik aqë më shumë i ngjitej me më tepër seriozitét Vasiliqisë. Thanas Vajës, ekzekutorit të të dënuarvet, i pakësohej nga-dit infllluenca, sepse këshillat e Vasiliqisë ishin kurdoherë të preferuara prej Ali Pashës kundër mendimevet të Thanasit ndë çështjet penale.

Kur kishte *Veziri* ndonjë të keqe ose trubullim mbë gjirin e Vasiliqisë derthte lote dhëmpshurie, edhe ajo i-a pshinte ballët e zjartë, i-a pushonte pikëllimet e tija me përkëdhelimet e saj edhe me fjalët e ëmbëla.

Atherë gjëmë-madhi «Luan», i shtyjtur nga instikt i dasharojtjës, edhe i dhelatuar nga premtimet e rrena të Serasqerit Tyrk, nxjer edhe i ep kasnecit tespiet pej guri-të-shumëvlerëshm dyke-i-thënë që ky ishte parolli midis tij edhe besëtarit Çam, për të shuajtur fitilin edhe për t'u larguar prej ndënëterrës (*llagëmit*).

Edhe si-kur-se vërtet, Hasan Pasha dyke-u-kthyer nga nisija ndë fortesë pas pak-herë vajti nde Selim Çami edhe po-sa i tregoj tespiet e të Zott', ay përnjëherë pa as një fjalë shuajti fitilin pej fanarit, edhe me atë bashkë shuajti edhe jetën e të Zott, dyke-u-larguar prej ndënëterrës e cila sakaqëherash u pushtua nga ushtarët tyrq.

## KREJ XXX.

Mbas këtyre, ndaj pasmesditës të 24 Jenarit, trupruajtësit e Ali Pashës që vigjëllójin përqark ujdhésës, i lajmuan që një tokicë lundrash plot me ushtarë dukëshin ndë zall të liqenit dyke-lundruar për ndë ujdhesë. Ali Pasha dyke-dëgjuar këtë lajm u kap prej emócjë edhe passi i urdhëroj ata që kishte përqark të jenë gati për ç'do eventualitét, po pritte me padurim harijtjen e lundravet. Passi kaloj no-një gjymës ore po-thua një trumbë ushtarësh tyrq dykepasur ndë ballë Qóse Mehmed Pashën i cili mbante hapët përpara krahrorit *fermanin*, edhe me atë bashkë edhe Kaftan Agë-Serasqeri, hyjtin ndë hobor të Manastirit të Pandelimonit që nga dera e Lindjes. Ali Pasha i ndënjtur mbi një nimë të sallës së qelivet, posa që pa ushtarët tyrq dyke-hyrë brënda, briti me një zë të gjëmimëshm të mos çapet kurrkush përpara se të vërtetóhet mirë përmi përmbajtjen e *fermanit*. Mehmed Pasha me të shpejtë bëjti di-ca çapa, ngjiti shkallën e vogël, edhe i gjyrmuar vetëm prej Kaftan-Agës i adresohet Ali Pashës dyke-i-treguar lart *fermanin*, edhe me një zë të rreptë e urdhëron t' i përkulet Urdhërimit të Naltë si shërbëtor i Padishahut. Po nukë harijti dót të mbaronjë fjalën kur Ali Pasha dyke-nxjerë pisqollën e artë prej silahes e zbras kundrë Anadollakut të cilin e plagosi për mortje. Atherë sakaqë-

herash shtiu edhe Mehmed Pasha plumbi i të cilit e mori Ali Pashën ndë krahun e djathtë ; Gjith kohësh trupruajtësi i Ali Pashës, Fehim Çami (vëllaj i Selimit) dyke-zbrazur pushkën e vet, strijti për-dhe të vdekur Kaftan Aganë, po ra edhe vetë më pas i vrarë nga ushtarët e Mehmed Pashës.

Atherë passi zunë vise të dy palët, u ndes betej' e rreptë, edhe u vranë shumë ushtarë të Mehmedit, gjer-sa di-ca nga ata, dyke-hyjtur brënda ndë qilarin e ndënë dhomë të Ali Pasha zbrasjin mbë të sipërmë pa qëlluar. Ali Pasha i mbajtur prej trupruajtësit e tij u pru ndë dhomë edhe u vu mbi një shtresë me plagën e rëndë të krahut. Nd' atë çast një nga plumbat e hedhur që përposh i dëpërtój ndë krahror Edhe me gjitht' atë trimi plak nukë rreshtte së-bërtituri me zë të vdekmë, të luftojnë gjer më një edhe të mos përepen të gjallë në duart' e Osmanllinjvet.

Po një nga trupruajtësit, dyke-vështruar që Ali Pasha po epte shpirt, hapi dritaren e dhomës edhe dyke-thirrur edhe dykë-bërë shënja u dekllarój Sulltánasvet që përepen. Sakaqëherash u rreshtën krismat e pushkavet edhe sa nga trup-ruajtësit e Ali Pashës që jetojin, hodhë-poshtë armët edhe u përdhanë. Më pas, Mehmed Pasha i plagosur, u ngjit lart edhe i preu kryet Ali Pashës i cili tani kishte dhënë shpirt, edhe të mbytur ndë gjak u'a tregoj ushtarëvet që ishin ndë hobor të Manastirit.

Të nesërmet, kufom' e Ali Pashës u pru ndë Janinë. Kryet e tij u ballsamua, edhe mbi dhisk t' argjënttë u çua ndë Konstantinopojë, prapo trupi i tij i pakryemë u varrós me nderime nek Xhamia Fetije përanë varrit të së shoqes Emine, ndë varr të cillin pej vjete e kishte pregatitur për vethen e tij.

Mbas ca kohë dekret perandorák urdhronte edhe dekapitátën (krese-prerjen) e të gjithë bijvet edhe nipërvet të Ali Pashës të cilët guverna Tyrke passi u përdhanë i kishte mërguar ndë Anadoll. Krerët e të gjithë këtyre u varruan ndë një vënt ndek edhe kryet e Ali-Pashës, përkundrejt Portës të Silivriës ndë Konstantinopojë, varr i cili dirgjet edhe sot, po thua-se ndë çip të rrugës ndë Manastir të *Ballëkllisë.*

* * *

E tillë ishte e mbramja e burrit të Tepelenës i cili dëpërtoj përmbi gjashtë-dhettë vjet jetë aktive edhe ka zënë vënt ndë galërië të kutemporánëvet të Historiës.

Ali Pasha e famëzój edhe e bëjti émërin e tij të dëgjuar ndë gjithë botë. Edhe sido që e pati sósmjen, Shqipëtarët duhet t' i-a admirójnë trimërinë, posi edhe Muza Populore që thotë :

*T' a dini me të vërtet,*
*Trimëria e tij u dijt,*
*Dhe i këtillë Trim më s' mbet,*
*Të vinjë ndë këto dit.*

— FUNT —

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

26.001.—Shtypëshkonja Dim. C. Ionescu, Str. Câmpineanu, 9. Bukuresht.

BKSH

FRËNGA 8. =

I. M. QAFÉZEZI
HOTEL „AVRAM"
BUKURESHT
RUMANIË